Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Hënë 21 Gusht 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 20 - ÇMIMI 1 LEK

Trathti kundrejt Shqipnis!

Churchilli ia bën theror Titos Shqipërin e veriut

Lajmërohet zyrtarisht: «Me datën 12 e 13 Gusht Kryeministri Winston Churchill ka ba takime me Kryeministrin jugosllav dhe me Titon, në të cilat janë shoshitë çashtje politike dhe ushtarake në mënyrë të përzemërtë. Marshalli Tito dhe Kryeministri jugosllav kanë propozue me vijue diskutimet, të cilat janë të frymëzuem nga dëshirë i të dyja palëve, me qëllim qi me dhanë kontributë të mëdhaja për të mirën e Jugosllavis.

Simbas qarqeve informueme mirë mësohet se bashkë fjalimet e Churchillit dhe Titos në Romë kanë pasë natyrë mbi pretendimet e këtij të fundit mbi tokat ballkanike. Tito nuk kënaqet me kufijt e Jugosllavis së paraluftës — por ka edhe pretendime të tjera mbi tokat shqiptare e italiqane.

Me qenë se gjendja ushqimore e bandave të Titos asht keqësue dëshprimisht, thuhet se Churchilli paska vendosë me u dhanë banditëve të Titos koncensjone të tjera, me qëllim qi me i pasë gjithmonë kah ana e vet.

Greqija përgjon Shqipërin e Jugës

Veterani i politikës greke, Filip Dragumis, deputet, Ministri i Informatave dhe Nënsekretari i Shtetit për Punët e Jashtme, e hapi qartas çashtjen e aspiratave greke të mbasluftës tue thanë se Qeverija greke nuk mundej me i pranue kufijt para 1939 së. Thelbi i bisedimeve dhe i shoshitjeve ekziston eade veçanërisht për arsye se aleatët e mëdhej nuk i kanë deklarue haptazi qellimet e tyne të mbasluftës mbi Ballkanin me qenë se ata janë shumë t'okupuem me aktet e funditë të luftës me Gjermanin. Situacjoni paraqet vështirësina të tjera për shkak të gjendjes të ngatërrueme të punëve greke në Kajro, ku pengmet ndërmjet Papandreut dhe Komitetit Malsuer t'EAM-it janë keqësue për shkak të ndihmave qi Papandreu ka marrë në Kajro. Me qenë se krahinat ma të pasura greke, Maqedhonija dhe Traqia gjinden i endë nën robni, Dragumis ka deklarue se asht e nevojëshme me sigurue kufijt veriorë të Greqis kundra nji mësymjeje t'ardhëshme ballgere, Prusija ballkanike. Ministri ka vu veçanërisht në dukje gjendjen e ishullit Tasos, i cili ndodhet vetëm tri kilometra ndërmjet Bullgaris dhe detit Egje. «Si mund të jemi të sigurtë në nji pozitë të tillë?» ka pyetë Dragumis.

Dragumis ka qenë shumë i kënaqun qi Turqija ka pre marrëdhanjet me Gjermanin. Fati i Greqis asht i lidhun ngushtësisht me at'e të Turqis, dhe të dy vendet i kanë lanë mbas dore aspiratat dhe revendikimet tokësore.

Dragumis ka ekzaminue edhe çashtje të tjera të randësishme, të cilët i përkasin veçanërisht fatit të Dodekanezit e të Shqipnis.

Kthimi i Dodekanezit Greqis vë rehet prej grekëve si nji çashtje e përfundueme dhe, simbas mendimit t'atyne qarqeve, vështirësinat e ardhëshmë do të jenë të lehtësueme nga marrëveshtja ndërmjet qeveris greke e turke për sa i përket çashtjeve të strategjis tokësore. Por Shqipnija asht nji problem ma i math. Dragumis nuk i ka kursye as fjalët qi vijojnë: Shqipnija duhet të pushojë së qenuni nji kryeurë pushtimi i Greqis nga ana e italjanëve dhe duhet me sigurue gjithashtu tokat jugore të sajë qi gjinden në Veri t'Epirit, si garanci. Shqipnija nuk mund t'eksistojë pa mbështetjen e nji fudije të huej. "Dragumis nuk ka dyshue kurr se do t'i mungojnë ndihmat nga ana e qeveris britanike, me qëllim qi qevesija greke të marri pësëri fuqin e përparëshme dhe të mkamet si shtet i fortë.

Falnderojm Greqin, por s'na duhet Protektorat e saj!

Të gjithë shqiptarët e kanë pa nji herë lojën e mbrapësht të trathtis angleze në ket vend. Në vjetin 1913 në konferencën e Londrit u vunë nënshkrimet e Anglis, të Francës, t'Italis bashkë me ato të Rusis e t'Austro-Hungaris në deklaratën e pamvarsis së Shqipnis. Dy vjet ma vonë po ai ministër i jashtëm i Anglis, me porosinë e asaj qeverije, në të cilën luente asokohe nji rrol kryesor edhe Churchilli, ua shiti Shqipnin serbëve, italjaneve dhe grekëve në marrëveshjen e mshefët e të poshtëri e cila do të jetë gjithmonë nji njollë e keqe për historin e Anglis.

Sot përsëri po luhet në kurriz të Shqipnis po ajo lodër. Ndërsa Attlee, Eden dhe Hull kërkojnë paturpësisht prej shqiptareve vetvrasjen tuj u thanë

nëve, Churchilli po e tradhton tashma Shqipnin tue ia lanë në dorë Titos. Churchilli dhe Tito ja u takuan në Romë me 13 të Gushtit. Qeverija britanike dha lajmin përkatës zyrtar qi në këto fletore po riprodhojmë. Churchilli e din se çetat e Titos janë tue vdekë urije. Sulmet e pareshtuna të gjermanëve dhe të vullnetarëve kroatë e muslimanë nuk janë tue i lanë të qetë. Depozitat e tyne ushqimore janë sosë. Qytetet janë prishë e rrenue prej bombarduesve amerikane, tokat kanë mbet djerr për shkak të rekrutimit të përdhunshëm të bujqëve, gjaja e gjallë asht therë e ngranë. Krahina pjellore e Kosovës, ku bujku shqiptar punon në qetësi, e josh Titon dhe çetat e tija, prandaj Churchilli i ka [illegible] Titos, po vetëm K[illegible]

Mendoni gërmadhat e katundeve të shumtaj të cilat në vjetin 1922 i dogjën grekët! Vetëm nji fuqi e madhe i ka njollë deri më sot kufijt e Shqipnis. Kjo fuqi e madhe asht Gjermanija. Dhe po Gjermanija asht ajo qi pajisi divizionin «Skanderbeg» me armë dhe me instruktorë. Sikur mos t'ishte divizioni «Skanderbeg» urdit e Titos çprej kohësh do t'a kishin grabitë krahinën e pasun të Kosovës. Dhe kështu Shqipnija e Mesme dhe e Jugut do të kishin mbetë pa bukë. Kuitoni zinë e tmerëshme të bukës në mbarim të luftës së parë, boin[illegible] doni qi të përsëritet[illegible] kohe pra[illegible]

Studim në zëmrën e E[illegible]

Si shkojnë student[illegible]

S'ka shumë kohë [illegible] përpar[illegible]

Gazeta

Lirija e Shqipnis

Gazeta
Lirija e Shqipnis
Nr. 1 - 7; 12 - 25; 27

Botimet Oshtima
Seria RiShtyp
Tiranë MMXVIII

LIRIJA E SHQIPNIS

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

Të „Halën 19 Qershuer | BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 | 1944 - Nr. 1

Efektet e tmershme t'armës së re

Londra dhe bregdeti jugor në flakë

Zjarret në Llondër duken 200 Km. „Meteora-Dynamit" është vetëm fillimi i grushtevet Kundër Anglisë

Kumtesa e F. t'Armatosura gjermane njoftonte më 16 qershor:

"Anglia e Jugut dhe vetë qyteti i Llondrës u goditën, natën e kaluar dhe sot paradreke, me një eksplosiv të ri të kalibrit më të math..

Më 17 qershor Komanda e N. e F. t'Armatosuna njoftonte: Qysh prej datës 15 qershor prej orës 23.40, Anglija jugore dhe qyteti i Llondres ndhodhen, më pakë ndërpreje, gjithënjë nënë zjarrin e eksplozivet t'anë më të rëndë, Munt të llogaritet me çkatërrimet më të mbedhenj nër ngastrat e goditura.

Më 18 qershor Kumtesa e K. së Naltë përcaktonte: Zjarri m' i math dhe afro pa pushim, mbulon Londrën dhe Lagjet e saj të jashtme.

Mbi efektin e tmershmë të armës së re gjermane japin një pasqyrë korrespondentet e Llondrës të gazetavet svedeze, ndonëse qeverrija engleze urdhëroj shpejt një censurë te rrepta përkatëse. Për të mos u marrë vesh rëndësija e çkatërrimevet, në Angli, qeverrija e Churchill-it porositi edhe Dhomat të mbajne keshtien më të plotë.

Si pas kumtesës së Mbrojtjes aerore të 16 qershorit, pakë orë pas goditjes, vëndet e qëlluar ishin kthyes, tërësisht, në një det flakëshi kaqë të tmershmë të efektit t'armës së re gjermane. Bregdeti jugor i Anglisë çquhëj prej flakës edhe që nga ana tjetër e Kanalit, që në orët e para të mbrëmjes 16 qershor. Atje ku eksplozivi i ri mbinte mbi tokë, shkakëtohëshin zjarre aqë të mbedhenj sa s'jane parë kurra të të tillë n'Angli.

Eksplosionet gjigantëske të cilat, qysh prej natës të së Premtes e drothnë tokën e Anglisë jugore dhe atë të Londrës si një tërmet i fortë. Dhe e kthyen ajrin në një det Flakësh. shkakëtuan, pa dyshim, një habitje me të madhe se ajo e invadimit. Në të vërtet. ketu është fjala për një çfaqje të habitëshme, për një çpikje. e cila. si pas shënjavet të para, do të sjellë nji ndryshim radikal në disa pjesë të Teknikës s'armëvet.

Efekti I kësaj arme të re gjermane të kalibrit më të rëndë, për të cilen vetëm emri «Meteora-dinamit» duket si ky m'i përshtatshmi, është teper i math. si pas sa është konstatuar gjer tash.

Kjo armë e re mundi të sjellë ndryshime të ndjeshme ndër planet luftarake t'armikut, dhe pregatitjet e Anglis së Jugut, në qoftë se këta ndryshime nuk kanë ngjarë qysh tashi

Vënja në përdorim e kësaj arme të re është një vepër ushtarake e pregatitur me kujdes të math e të gjatë.

Gjer tashi si gjë e sigurtë është që kjo çpikje përbën vetëm fillimin e asaj që Komanda ushtarake quan «Hakmarrje». Dhe kjo armë e re është vetëm njëra nga sa e sa të tjera. Kjo përbën si thamë vetëm fillmin e një vargu të gjatë armësh të fsheshta.

Për sa i takon efekti, le të vlejnë vetëm këta dy shëmbuj. Një kervan fornizimi armik që rrastisi në zonën ku po binte nje «Dinamit-Meteore» u mbulua i lëri në flakë. Anije të ndezura ndriçomin orizontin dhe detin.

Shëmbëll i dytë është se zjarret e mbëdhenj të Llondrës dukëshin në një largësi prej 200 km. Arrësyeja që kjo armë e re nuk është përdorur akoma në frontin e invadimit qëndron vetëm atje së vepërimi i saj arrin aqë lark sa munt të dëmtonte edhe trupat t'ona.

Humbje të pergjakëshme armike në Francë

Kuartieri i Përgjithëshme i Fuehrerit, 18 qershuer.

Kumtesa e K. së Naltë njofton:

Zjarri m' i math çkatrimi vashdon, afro pa ndërprerje, mbi Llondër dhe lagjet e saj të jashtme.

Në bregdetin e Normandisë armiku sulmoi edhe dje, më kot, me fuqira të mbëdha artilerije dhe tanksesh. Ne pjesën veri-lindore dhe në jugo-perëndim të Tylit-it trupat t' ona të korracuara i thyen të gjithë sulmet kundërshtarë. Një depertim i vogël armik u spastrua pernjëheresh prej një kundërsulmi. Në lindje të Caumon-it, nga juga e Livry, trupat t' ona pushtuan naltësinat e veriut. Pika qendrore e zjarrit që zona jugëperëndimore e Balleroy, ku Amerikanët u përpoqën të çponin ballin t' onë, me fuqira shumë të mbëdha, në drejtim të S. Lo. Të gjithë sulmet e tyre u çprapsnë me humbje të pergjakëshme për ta. Vetëm në këtë sektor armiku pati 1000 të vrarë. Nënë këto humbje kaqë të mbëdha, ay u kthye përsëri në vëndin prej ku ish nisur. Në sinisë e Cherbourg-ut, armiku i vashdoi sulmet e tij përsëri në zonën S. Sauveur, por me zi mundi të pushtonte pakë tokë. Fuqira të mbëdha të Luftwaffe-s sulmuan me sukses, gjatë gjithë ditës, në fushën e betejës. Aeroplanë të luftës dhe torpila mabjtës qelluan dije me bomba dhe me torpila katër anije armike perpara Kryeurës. U vertetuan zjarre dhe eksplozione. Një Kryqesor i math u dëmtua rëndë.

Në perëndim të sinisë së Cherbourg-ut një konvoli ynë çprapsi një sulm anijesh të shpejta kundërshtare dje fundosi nji syresh.

Bateritë t' ona fushore dhe bregdetare qelluan anije luite armike dhe anije transporti në gjirin e lumit Seine. Nëndetëset gjermane fundosën tre Kundërtorpilonjës kundërshtare në zonën perëndimore të Kanalit.

Bateritë t' ona aerore të lehta dhe të rënda, qysh prej fillimit t' invasionit kanë rrezuar 301 aeroplanë lufte, 5 ngarkese, kanë çkatërruar 20 tankse dhe kanë dëmtuar rëndë një Kryqëzor. Armiku që zbarkoi në bregdetin e veriut dhe në jugëlindje të Nisisë Elba, me një kundërsulm nga ana jonë u hoth përsëri në det. Vetëm prej Mesdhe armiku një kryeuree të vogël. Luftime të rrepta po shvillohen në rrethet e Capoliveri-t, ku armiku mundi të zbarkonte prapë dje. Një bateri bregdetare e nisisë Elba dëmtoj rëndë një Kryqëzor engles të klasit „London".

N' Italinë qëndrore, pika kryesore e luftimit është zona në jugë të Perugia-s. Me gjith fuqit' e tija të mbëdha tanksesh, armiku me zi mundi t' a shtynte ballin t' onë vetëm në disa pika.

Në gjirin e Gjenoves u shvilluan goditje të rrepta midis anijevet t' ona të sigurimit dhe anijesh të shpejta armike. Në këto përpjekje u dëmtuan disa anije kundërshtare.

Në bregdetin adriatik, pranë S. Gjergjit, u fundosen dy anije zbarkimi kundërshtare prej artileris s' onë.

Në frontin e Lindjes:

Në Jugëlindje të Witebskut dhe në jugëlindje të Nowoshew-it njoftohen luftime vetëm në lumin Berezina. Grupe aeroplanësh të rëndë luftimi sulmuan natën e kaluar, stacionet hekurudhorë të Gomel dhe të Nowosibkowit, me resultat të mirë. Zjarre te mbëdhenj u shkakëtuan në stacion, nër qendra municioni dhe nër të tjera depo.

Në një sulm që bënë bombardonjësit sovjetikë kundër një karvani gjmeran në bregdetin verior të Norvegjisë, gjujtësit t' anë dhe baterija antiaerore rrëzuan 37 aerorë armiq. Të tjerë 30 aeroplanë kundërshtare u rrezuan prej mbrojtjes s' one aerore në një sulm mbi Kirkenes.

Naten e kaluar aeroplanë angleze të veçuar hodhen bomba në rrethin e Berlinit dhe në tokat e Renanisë e Westfalise.

Togeri Lent, komandant i një skuadrilje nate, gjatë natës 15—16 qershor rrzoi të 100 tin kundërshtar.

Aeroplane t' ane luftimi sulmuan objektiva n' Anglinë jugore.

Top antitanks gjerman në vepërim

Oficerat amerikan dhe gjendja n' Itali

Oficera amerikanë të administratës që bajnë pjesë në komisionin e kontrolli të aleatve përshkrojne, si dishmitarë të gjallë, se popull n'Italin e Jugut, Anglin Amerikën nuk e konsideruan aspak si çlirues prej terrorit bolshevik por si nji invador qi i ka sjelle këtij populli shtypje, uri dhe rezige si për italianët edhe për të gjithë popujt e tjerë, tue kercnue njikohesisht me bolshevizimin. Korespondenti ushtarak i fletores «Daily Lerald», Emery Pearce, pershkron nji vizit të bame në nji shkollë italjane në Italin e Jugut, me këto fjalë: Ka qenë e vetmja shkollë që kam vizitue ndonje herë por s'kam pam qeshje të fëmijve, fytyra fëmijësh në gaz, por vetëm fëmij të zymtë prej mjerimeve. Nji fëmij 10 vjeçar që i mësonte të vegjilit njohnit elementare mbi gjuhën anglishte, u mësonte a tyne këto fjali: „A keni nji copë bukë për mua. Kam shum uri, zotni. Mandej tue iu drejtue korespondentit ushtarak tha me za të naltë: duhet t'u sillni fëmijve ato që janë gjanat ma të nevojshme. Edhe mësuesja filloi me anku, tue bam këtë pyetje: a u kujtohen ato problema matematike që fillojnë me këto fjalë: shkova tek furtari dhe bleva nji bukë per 4 lira „? Tash këto problema fillojnë kështu: shkova te furtari e bleva nji gjysëm buke për 400 lira dhe buka ka qenë e vjetër dhe e mykur, përveç kësaj, përpara furtarit qendronin me qindra fëmij të vegjël të shkym e të reskosun që kërkonin nga nji copë bukë e që nuk vijojnë shkollën, sepse prej çliruesave nuk marin bukë.

Në lidhje me veprimtarin e nji prefekti, të vum në fuqi prej amerikanëve, në qytetin e Napolit dhe që asht amerikan; me origjinë italiani, gazeta «Times» ban këto shënime: Prefekti ka kujdesue që rrugët e qytetit të pastrohen. Prefektit shum kush i shkon me bam vizitë, tue i paraqitë ankime, ky i përcjell me shoka dhe u mban nga nji fjalim permbi përgjegjesit e italianve në këto çaste. Gjykimin permbi politiken e çlirimit që po ndjekin anglo-amerikanet n'Itali, sikurse deklaron gazeta «Times» le ta baj nji kundershtar i fashizmit i cili për shume kohë ka gjet strehë në shtetet e bashkume. Ky kundershtar i fashizmit deklaroi këto: Roosevelti dhe Hulli dinë kaq përmbi Europën, sa unë për mbi Kentuckyn. Që të jem ma kjartë politika që ndjek Roosevelti dhe Churchilli ne Europe asht e mallkume. Ata s'dinë gja përmb i Europen dhe, përveç kësaj kanë këshilltarë të këqij

Si e mësoj bota invadimin

Kur, më 6 qershor, pakë minuta pas mesnate, skuadrat e para anglo-amerikane filluen sulmin e tyne kundër bregdetit prendimor t' Europës, po në të njëjtin çast filloj edhe gara e të gjitha agjensivet të botës për të përhapur, kush e kush më parë, lajmin e invadimit. Këtë garë e fituan, plotësisht, agjensitë gjermane.

Në New-York bubliku që i shtrëngua, të priste tri orë, pas njoftimit t'agjensivet gjermane, gjer sa arrijtën lajmet e para prej Llondre. Kësisoj ngjau, pra, që gazeta: e New Jorkut nxuarnë botime të posacmë të mbushur vetëm me lajme gjermanë.

Që me të vërtet një turp, për agjensit'e lajmevet, pohimi, me gërma të dukëshmer i më të mbëdhavet gazeta të New-Jorkut Gjermanët njoftuan se invadimi filloj.

Jo ndryshe ndodhte edhe në Llondër: gjer më ora 10 para-dreke pjesa m'e madhe e polullit engles s'kish as dijën më të vogel mbi ngjarjet që kjshin filluar disa orë me parë.

Një Grusht të rëndë komunistëve të Shqipëris se Jugut

Mehmet Shehu pëson një humbje prej 729 të vrarësh, 155000 fyshekesh dhe 5 deposh mnnicionif të ndryshme

Gjalë muajvet të fundit, ishin formuar, në Shqipnin' e Jugut, disa qendra bandash komëniste, qi gëzonin një simpathi të dukshme nga ana e Englezëvet dhe e Amerikanëvet. Rrolin e Ksyëtarit të ketyre bandave e loste Shqiptari bolshevik Mehmet Shehu, i kudo mirënjohuri gjakpirës i pa ngopur.

Pasi, gjatë shumë kohësh, nuk ishte bërë, nëpër malet e pashkelëshme të Shqipëris Jugës, ndonjë sulm nga an e Gjermanëvet, bandat e ngritën hundën, formuan një qeveri bolshevike dhe, kështu, na shpallën një "Shqipni komuniste,, alla "Sovjet,,! Flamuri me Shqipen dykrenore ay, simbol' i përjetëshëm i fuqis së popullit të Skenderbeut, u shkel dhe a gris e, në vendin e tij, u ngrit ay i kuqi me drapën e çekan!

Për të mos i lënë bandat t' a kalonin masën dhe pas si ato e mnushën kupën, këto ditët e fundit, një grup gjerman deshi t' i bënte një vizitë të shkurtër "Republikës sovjetike,, dhe i sulmoj banditët pikërisht në folet' e tyre, Rezultati i këtij grushti të papandehur kundër Anglo-bolshevikëvet që, me të vërtetë, i tmershëm: Pas luftimesh të rreptë dhe plot vujtjesh nëpër male e gryka, bandat lanë 729 të vrarë e 393 robër, midis këtyre, 104 femra.

Pregaditjen dhe pajisjen e këtyre bandave terroriste e tregon, kjartazi, plaçka e zënë: 2 topa antitanks, 12 mortaje, 23 mitraljoza, 8 mitraljoza antitanksa, shumë, mitraljoza dore dhe 396 pushkë. Veç këtyre u zu edhe një sasi e madhe monicioni të ndryshmë: 155000 fyshekë, 300 predha autitanks, 120 bomba flufuruese, 800 bomba dore dhe 5 qendra municioni këmbësorije, artilerije dhe mortajesh. Një humbje e rëndë për teroristët duhet të kenë qenë edhe të 1100 kg. eksplosiv q' u shtinë në dorë nga një sulm' i rrufeshmë.

Këto humbje rëndësohen edhe nga kapja e një spitali të trasnsportuarshme enlezë, prej 30 shtretnish, i pajosun me barnat e duhur, nga ajo, e një uzine armësh me të gjitha pjesët përkatëse, nga kapja e një rrobaqepësije, e një këpucëtorije dhe ajo e një depoje të pasur ushqimi. Këto humbje dhe kjo plaçk'e zënë tregojnë një sukses të plotë të Alpinëvet dhe të granadiervet gjerman, ndonëse në kushte shumë të vështirë, dhe dëshmojnë se ata goditën, edhe një herë me kohë e si duhej.

Armiqt' e Shqiprisë, të çdo njgyre qofshin, duhet të mos harojnë që trupat gjermane s'u lenë prehje dhe qetësi bandavet në balkan. Ato i ndjekin këmba këmbës dhe u futin grushte pikërisht ndër folet' e tyre dhe po atëhere, kur levizja armike kujton se formoj nje qendër të fortë kundërshtimi.

Grushti i fundit gjerman q' iu dha "Republikës së Mehmet Shehut,, duhet t' ua shkurtonjë diçka të ardhurat në ar rroglarëvet të Moskës e të Londrës. Një punë e vazhduar me muaj, u asgjasua në pakë ditë dhe "heronjet' e Shqipnis së Jugut, bashkë me Udhëhekësit e tyre dinakë, më s' dinë nga t' ia mbajnë dhe, kudo, u çfaqen, si gogol, bataljonet gjermanë.

Anglija qysh tashti asht e humbun

Zbulime të nji gazetari amerjkan: në London e në Washington janë të vendosun t' a kqyrin pa ba asnji çap Bolshevizimin e Ballkanit

Belgrad — Parashikime interesante ban nji artikull i nji redaktorit të vjetër të gazetës «New York Times,» Ray Brok, në lidhje me punët e Ballkanit dhe të Lindjes së Mesme. Ky artikull, që u botua në gazetën franco-kanadeze «Le Bloc,» zbulon, në menyrë të pa mëshirëshme, qëllimin e Sovjetëve përkundrejt Ballkanit. Në mënyrë të veçantë janë interesante zbulimet e këtij gazetari në lidhje me pyetjen se përse Anglija hoqi dorë prej interesave të saja të Ballkanit në favor të Sovjetëve, e përse, në lidhje me këtë çështje, Turqija i ndërpreu bisedimet e saja ushtarake me Anglinë.

Në Jugoslavi po vlon nji luftë civile, shkrun Brok. Topat dhe të hollat vijnë prej Rusis sovjetike, porse gjaku asht jugoslav. Qëllimi i kësajë lufte civile asht nënshtrimi politik e ushtarak i krahinave sërbo-kroate tek Bolshevikët, që kështu, ma në fund, këto krahina të pushtohen edhe prej armatave të kuqe, që të realizohet qëllimi i mbramë i Moskës, do me thanë inkuadrimi dhe aneksimi Jugoslavis në gjirin e Unionit Sovjetiki. Unioni Sovjetik po realizon, me nji plan të paracaktuem, qëllimet e veta si ne Juge-Lindje e në Lindje ashtu edhe në Europen e mesme.

Censura britanike e Kairos, sikuer pohon Brok, i cungoj në nji mënyrë katastrofale lajmet e shtypit mbi konferencën e Kairos dhe të Teheranit, kështu që kjo çensurë nuk le asgja që të botohet në favor të Mihailoviçit. Në vend të kësaj, Londoni ka dhanë udhëzime të tjera, që synojnë me e shtue urrejtjen e bolshevikëve në Lindje e në jugë-lindje t' Europës. Këto udhëzime të reja duhet të nderpresin çdo kritikë kundra politikës së jashtme angleze dhe të asajë amerikane. Në London e në Washington e kanë vendosun të pranojnë Bolshevizmin e Ballkanit, pa ba asnji hap kundra. Kjo do të thotë, me fjalë të tjera, se Armata e Kuqe mund të kalojë lirisht për kah Prendimi, Brok thotë se ai, si korespondent i vjetër i Ballkanit, i Turqis dhe i Lindjes së Mesme e të Afërme, mbas këthimit të tij në London e në Washington, i ka dëgjue me veshët e tij direktivat e reja dhe ndalimet për me kritikue. Censuruesit ne Kairo e në London kanë kërkue, bile, edhe falsifikimin e telegrameve për me u ba qefin komunistave të Titos. Ata bajnë gjithçka për me e përkrahë regjimin komunist të Titos. Gjithashtu asht nji përmbledhje gënjeshtrash komunikata mbi fitimet e mbi sukseset ushtarake të bandave të Titos. Edhe vetë gazetat serioze anglo-amerikane i përhapin këto gënjeshtra e ma në fund ata inkurajohen edhe prej zyrash të tjera t' informatave, bile edhe prej Ministris së Jashtme.

Përse ndjek politika angleze këtë rrugë të bindjes ndaj Sovjetët? pyet Brok tue

Qysh tash mund t' asgjasohet

"Sikur të donim, qysh tash mund t' a asgjasonim Perandorin Britanike, u deklaroi e përkohëshmjë amerikane, që botohet nën titullin "New Veek". Po kjo gazetë, në nji artikull të saje pohon se eksistenca dhe sigurija e Dominioneve dhe e popujve kolonjalë anglezë gjithmonë e me tepër po mvaret prej Roosevelt-it, se sa prej Churchilit.

Gjendja jonë vazhdon të jetë jashtzakonisht e rëndë, deklroj kapiteni amerikan B. Morton nga Denver, i zënë rob në veri të Caen-it. «Mbi të gjitha, humbjet e ushtris s' onë t' invadimit janë shumë të mbëdha dhe e kalojnë çdo parashikim. Rëndësija e ketyne viktimave do të mund t' i njoftohet publikut vetëm ca nga ca.

Ndalimi q' u bëhet tash, prej Englezvet, të plagosurvet, të kthyer n' Atdhe nga luftimet e invadimit, për të mos biseduar, më asnjeri, mbi aventurat e tyre me të vërtet të tmershme, është tipikisht englez. Ndër në një gjë e tillë do të që e pamundëshmë. Né duam të dimë se ç'ndoth në të vertet. Nuk duhet të na i tshehin që humbjet t'ona janë tepër të rëndë dhe që ka të ngjar q'ato të shtohen më tepër."

Reshteir engles Jack Printon, pas marrjes rop, nga Gjermanët, deklaroj: Ndërsa xbritja në tokë dhe luftimet q'e vashduan këtë qenë të tmershmë, vetë tmeri filloj athere kur, rreth nesh. s'kish më veçse të vrarë e të coptuar, Ne nuk munt të ecnim përpara pa shkelur mbi të vrarët e mbi plagosurit t'anë. Nuk kishim kohë t'i mbulonim të dhanë njikohësisht këtë përgjigje: «Tash për tash e lyp oportunizmi politik, prej anës angleze, që të lëshojë pè në lidhje me kërkesat sovjetike në Ballkan, për me pasë kështu duer të lira n' Europën Prendimore, n' Indi, n' Afganistan dhe deri diku n' Iran.» Ky oportunizëm anglez ka qenë porsi nji dush i ftohtë për qeveritë e vogla aleate, të cilat kërkuen mbroje prej Anglis, qi i tërhoqi mbas vehtes tue u bam premtimin e së drejtës së vet-vendimit, Fjalimi i Churchillit, i mbajtun më 22 Shkurt në Dhomën e Komuneve, asht nji dëshmi se qeverija britanike në punët shit-blemjës së sajë më Moskën u nenshtrohet të gjitha kërkesave sovjetike në Ballkan. Politika ballkanike e Sovjetëve prcj propagandistëve bolshevikët të përtej Atlantikut asht e kjartë: Bolshevikët duen, ma së pari me manevra të ndryshmë t'a pregatisin pushtimin e Ballkanit prej anës s' ushtris së kuqe, mandej aneksimin e Jugoslavis dhe të shteteve fqinj përtej Unionit Sovjetik. E sikur të pyesim qarqet politike angleze se ç'ka mendojnë ata në lidhje me këtë çashtje, atëherë ata përgjigjen tue çue supat, e tue lanë të kuptosh se Anglija qysh tashti asht e humbun.

Kujtim për reformën e kapeles të bame në Turqi prej Ataturkut

Istambul.— Dikur— Ataturku shkoi në qytetin Tschankri, nga Veri të Ankaras. Në ket rast, si u paraqit përpara popullit me kapellë mbi krye. Njikohëtisht porositi parin' e qytetit për me heq fesin e me i vum kapellat që ai kishte sjellë me vehte. Natyrisht situata që mjaft kritike, por, me gjith këtë, prrsonaliteti i Ataturkut ma në fund fitoi mbi tradicionin. Tash qytetarët e qytetit Tschnkri vendosën për kujtim të reformës së kapellës të bame në këtë vend, t'i ngrëhin nji përmendore Ataturkut, nji statuje tri metrash të naltë të figurës së tij. me kapellë në keye.

Robrit anglo-amerikanë janë te tmeruar

„Rreth e rrotull nesh vetëm të vdekur e të coptuar - Disa nga shokët e mi u çmëndën, unë humba arsyen"

Era e kufomavet u bë, shpejt, m'e ndjeshme se ajo e zjarrit dhe e barutit. Nga të veshtirët dhe nga krypa as nuk munt të hanim, se ishim ngjeshur, gjer në grykë, në llom e në gjak.

Disa nga shokët e mi u çmëndën dhe u turrën drjet në zjarrin e armi-



Alarm në bregun e Atlantikut

vdekurit, se lufta vashdonte pa pushim.

Robër amerikanë q'arrijtën në Paris, çfaqin gëzimin e tyre q' i shpëtuan skëterrës së bregdetit t'invaduar. Ja se ç'tregon një tetar nga Cincinati: Në fillim, unë isha i gëzuar për "trip,,, in, për shëtitjen t'onë defrimi n'Europë, por tmeri që ndjeva më pas nuk munt të përshkruhet. Edhe vetëm kur i mejtonj ata çaste, dridhem si purtekë. Q'athere nuk vura më gjumë në sy,,, Telegrafisti engles Reginald Werker nga Llondra, i rënë rob në bregdetin e Normandisë, deklarëj se ndërlidhjet midis tokës franceze dhe agjensivet të Llondrës janë jashtzakonisht të kufizuara. Midis korrespondentësh englezë dhe amerikanë ka lindur një luftë private, se sicili syrish dò t'i japë lajmet e tija më parë nga shoku. Unë qeshë dëshmimtar, vashdon Workeri, kur gjenerali Montgomery iu përgjigj njëj oficeri të shtabit, q'i paraqiti ankimet e shtypit: "Thuajuni zotnivet që ndërlidhjet t'ona janë të mjaftuarshme, se ne kemi nevojë vetëm për kabël lajmesh të mira, passi lajmet e hidhur arrijnë kurdoherë me kohë...

LIRIJA E SHQIPNIS

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Premte 23 Qershuer 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 2 - ÇMIMI 1 LEK

Nga të divizionet kundërshtarë 25 për qint jasht perdorimit

Gjer afro më 15 qershor. humbjet e aleatevet, në ballin e invadimit, arrinin në 100.000 veta

Ndërsa Eksplosivet e ra gjermane përplasen, pa ndërprerje, mbi nisinë britanike, dyke shkakëtuar çkatërrimet më të rëndë, në ballin e invadimit luflimet vazhdojnë me ashpërsi të pazvogëluar. Humbjet e armikut janë, jashtzakonisht të randa. Si pas një kumtese të Kuartierit të përgjithëshëm të Gjeneral Feldmarschalit von Rundstedt, qenë futur, në ballin e invadimit, në bregdetin normandes, afro 500000 ushtarë aleatë, gjer afër datës 15 qershor, për të Marrë pjesë në betejën e madhe. Dy të tretat e kësaj ushtërije kishin xbritur në tokë që më parë. Nga kjo konstatohet se zbarkimi, më 6 qershor, i armatës së parë amerikane dhe i asaj së dytës engleze, kish një karakter decisiv dhe se beteja, në Normandi, paraqiste, të paktën, gjysmën e kujdesimevet aleate për invadimin e përgjithëshmë.

Passi divizionet gjermane nuk bëjnë gjë tjatër, më parë, veç se të luftojnë, dyke ua lënë rezultatet e fitimit javëvet të arthme, gjer në këtë çast, është e vështirë të jepen sasinat e sakta të humbjevet nga an' e trupavet englezë, amerikane dhe kanadeze. Me gjithë këtë, dyke u mbështetur në disa llogarira të dokumentuara me kujdes, mbi humbjet aleate munt të thuhet sa vazhdon :

Nga të 16 divizionet e xbritur nga deti dhe nga të 4 divizionet e ulur prej qjelli, prej Amerikanëvet, Englezëvet dhe Kanadezëvet, afro 23 për qint u bënë të pa perdorëshme brënda 200 orëvet të para të betejës . Kjo përbën një humbje prej 60000 gjer 70000 njerës. Po të përfshihen edhe humbjet në det, kjo sumë munt të arrinte edhe të 100000.

Humbjet më të rënda i patën divizioni i 82 të dhe i 101 amerikan zbritur nga qjelli. Ata u asgjasuan gjer 70=90 për qint. Nga njëjësitë engleze, humbjet më të mbëdha i pati divizioni i 6 parashutist. Për sa u takon humbjevet në material, e tregon vetë fakti se Eisënhover-i humbi, në tetë ditë, 300 tanse, sasi kjo q'u përgjigjet dy divizioneve të korracuara englezë.

"Dërgonani mjekë !,,

Humbjet e sipërme kundërshtare, këto ditët e fundit u shtuan jasht masës. Një provë mbi këtë është kumtesa e K. të P. të F. t'Armatosura e datës 18 qershor, e cila thosh se Amerikanët e paguan me 1000 të vrarë orvajtjen e tyre për të çpuar vijat t'ona, në jugperëndim të Balleroy, në drejtim St. Lo. Tashti bëhet i njohjtur edhe një tjatër fakt mbi humbjet e tmershme armikë: më 17 qershor, ushtarët amerikanë pranë St' ho u thirrnin ushtarëve gjermanë, m' at' anë vijës : «Dërgonani mjekë dhe ne do t' jua lëshojmë prapë robërit t' uaj !» Dhe kjo nuk do të thotë se Amerikanët së kishin sjellë mjekë të mjaftë. Përkundrazi, ne e dimë se ata kishin sjellë një sasi të tepëruar. Kjo tregon më tepër, që mjeket e shumtë amërikanë s'ia dalin dot numurit të math të të plagosurvet. Shumë nga këta të plagosur janë të shtrënguar, dendur, të presin edhe një ditë të tërë, gjer sa të mundin ë kënë edhe vetëm një lidhje për plagët e tyre.

Kush ka me i u shmangë veprimit ka me u varë

Bujku ukrajnas, Feder Grischtschenko, i cili, bashkë me disa shokë të tij, tue shkapërcye frontin e Dniesterit, erdhi tek trupat gjermane, ku bani përmbi fatin e vend-lindjes së tij. Cudivka, këto deklarata : Në katundin t' onë, përnjiher mbas ardhjes së trupave sovjetike erdhi nji komisar çifut me nji repart të trupave NSWD. Këta mblodhën popullsin e katundit dhe komisari mbajti nji fjalim të gjatë përmbi jetën e bukur e të lirë në Unionin Sovjetik. Në mbarim të fjalimit deklaroi se në vendin t' onë së shpejtit do të zbatohej ekonomija e sistemës së Kolkozëve. Shumica e katundarëve, prej provash të vjetra, e dinte se shka do me thanë kjo, e prandaj nuk qe në gjendje me e mshefë tmerin e vet. Komisari e kuptoi përnjiherë përshtypjen që banë mbi katundarët fjalët e tija dhe prandej e hoqi maskën. Në mënyrë ma të poshtme filloi me i sha katundarët e me i kërcnue këta me pushkatim, si armiq të popullit dhe si sabotuesa. Përnjiherë na u drejtuen agjentat policor dhe filluen me krye kundra nesh ake t' ulta rafjesh e goditiesh. Mnija e çifutve u drejtue në mënyrë të veçantë kundra 70 vjeçarit Petro Golubenko, i cili tue qëndrue në vijën e parë, i tha nji fqiut të tij «Tashti erdhi fundi ynë.» Mor ngatrestar ke me e pa se shka do me thanë me e nxitë popullin kundra autoritetit sovjetik,» i bertiti këtij plakut komisari sovjetik, Mandej ai dha urdhen që t' a varin plakun e gjorë me nji litar tek nji lis. Na të gjithë duhej të benim sehir këtë skenë të llahatarëshme. Komisari urdhnoi mos me e largue kufomën, që kështu të shërbejë si shembull i tmershëm friksimi për krejt popollin. Na të tjerëve na detyruen mandej, nën keqpërdorime të marshonim ditë me radhë pa ndonjë kujdes e pa ushqim, për tek nji fushë përqendrimi. Kush gjatë rrugës rrëzohej nga lodhja e nga mundimet, atë e vrisnin tue qëllue prapa zverkut. Në fushen e përqendrimit na caktuen në nji bataljon ndëshkimi dhe pa na pregatit aspak, na dërguen në front. Na e përdorëm rastin ma të parë për me u aratis dhe tash dëshiri ynë ma i math asht që në radhën e vullnetarëve, të luftojmë kundra munduësave t' onë

Të tjera mjete luftarake ma të forta

Fletorja « Neue Zuricher Zeiting » boton një bashkëfjalim që pati korrespondenti i saj, në Berlin, me Drejtorin e shtypit të Reikut, Dr. Dietrich, mbi përdorimin e armës së re gjermane «Unë s'tregonj ndonjë të fshehtë« tha Dr. Dietrich, kur iu them se rrëkeja e eksplosivavet dhe valët e zjarrit do të vashdojnë akoma kundër objektivit ushtarak Angli jugore dhe, bile, si munt t' ju siguronj, më një vark mjetesh të tjerë, édhe më të fortë, gjer sa Anglija t'a kuptonjë se systëmi gangster i sulmit ajror, adaptuar pre 'saj, do të jetë po fundi i saj. Për këtë, populli engles le t' u jetë mirënjohjtës Zotnivet Churchill, Vansittard dhe sa e sa të tjerëve, që caktuan, si qëllim të luftës, çfarosjen brutale të popullit gjerman. Në Gjermani s' ka pasur kurrë qëllime të tillë përkundrejt popullit engles. Lufta jonë nuk i bëhet popullit engles, por atyre q' e shtynë në këtë luftë Anglinë dhe botën e tërë.,,

Korrespondenti sviceran vërren: "Por n' Angli thuhet se bombardimi i qytetevet dhe i visevet gjermane, prej Englezëvet dhe Amerikanëvet, ndonëse me humbje të popullatavet civile, prapë ka një karakter strategjik, ndërsa arma e re gjermane nuk godit, përgjithësisht, objektiva ushtarake, por duhet të konsiderohet vetëm e vetëm si një armë terrori.,, Drejtori i shtypit përgjigjet : " Ju vetë i kini parë çkatërrimet nër qytetet Berlin. Hamburg, Kolonjë, Mannheim, Frankfurt, München etj. që ata i kanë quajtur objektiva ushtarake, prandaj do t' ju jetë mbushur mëndja në se edhe lagjet e banuara e veprat kulturore përbëjne objekte ushtarake, për t' u mbuluar, barbarisht, me bomba. A mos duan vallë në Londer t' a përginjeshtrojnë dhe a nuk e kanë thënë vetë gazetat engleze, muaj me radhë, që e tërë Anglija e veçanërisht Llondra ësthë vetëm një depo e përbashkët materiali luftarak ? S' ka, pra, dyshim se goditja e një vëndi të tiltë me bomba dhe eksplosiv është absolutisht një vepërimin ushtarak.,,

Pyetje : N' Angli thuhet se arma e re nuk ka karakter ushtarak, se ajo nuk ka mundësinë e një vepërimi të caktuar.

Përgjigjë : Eksplozivat e ra gjermane kanë, të paktën, po atë siguri shënje që kanë edhe bombat engleze, të flakura, kuturu dhe pa parë tokën, prej një lartësije 10000 metrash dhe për mbi retë. Si shëmbëll të njej sigurije shënje, nga an' bombardonjësvet Anglo-amerikanë, Zviceranët munt të marrin ç' ka ngjau uë Schafthausen.



MERRNI SHEMBËLL

Populli shqiptarë me pranin e ushtarve gjerman në token e tyne, ka parasysh nji mbrojtje, që toka e tyne të shpëtojë prej tmerrit anglo-amerikan. Fotografit t'ona tregojnë mbaitas : vullnetarë mysulman për në luftë kundra bandave komuniste. Në të djathten : Ushtarët gjerman mysafire te nji katundarë.

Trupat parashutiste aleate bëjnë "Fjasko,,

Pozitat e tyre s' kanë as pak proporcion me humbjet e pësuara

Brënda pakë orëve, muarnë funt, në një pellk gjaku, në ballin e invadimit, të gjitha pregatitjet e bëra me muaj e ndofta me vjete dhe me një kujdes të math. Dhe kështu do që me do e mos. Vërtetohet se Anglo - amerikanët, humbën, pa eksagjerim- në pakë orë, një pjesë të rëndësishme të trupavet të tyre më të zgjedhura, të cilavet ata u kishin kushtuar kujdesin dhe zellin të posaçme. Nër manevrat dhe stërvitjet e parashutistvë e kishin pandehur krejt ndrye she, dhe jo kurrë ashtu si u dolli në të vërtetë. Këto tuba përbënin të panjohurën një llogarije që gjer tashti kish dhënë vetëm pakë prova të vleftës së saj reale, po të zbresim udërmarrjet e parashutistëve amerikanë ner fushatat e Pacifikut. Dhe në të vërtet fuqija luftarake e trupavet parashutiste njihej nga ndërmarrjet e atyreve gjermane. Anglo - amerikanët u dërhoqnë t' i pervetonin e t' i vleftësonin eksperiencat t' ona dhe të formonin, me parashutistët, trupa që të paraqisin elitën e ushtëris së tyne Detyra e këtyre trupave do të ishte, pa dyshim, t' i sulmonin së brëndë, shmi mbrojtjet e Atllantikut nër sëktorët e rëndësishmë për trupat e detit, dhe kështu t' i goditnin nga prapa pregatitjet dhe ndëri lidhjet gjermane. Por, për këtë ndërmarrje, ata qenë te detyruar të pagushin një «taks» shumë të lartër gjaku. Shume grupe luftimi u asgjasuan aty për aty, brënda pakë orësh pas hikjes në tokë, ose u shtënguan aqë teper, sa më së fundi u dorëzuen.

Anglo - amerikanët, natyrisht- kishin pa rashikuar humbje. por që këto të ishin aqë të rënda, nuk e pritshnin kurrë, ashtu si e pohojnë edhe vetë. Përfundimi i kësaj udërmarrjeje nuk formon, natyrisht, ndonjë kapitull të jashtëzakonshëm në historin' e luftës, por ay tregon, pa dyshim, një "fjasko jë dorës së parë dhe pozitat e pakta që mbajnë Anglo - amerikanët s'janë aspak në proporcion më humbjet e pasuara.

Kryekomandant' i një armatës gjermane në Ballkan
në një fjalim me prefektin e Vlonës, me rastin e një inspektimit

Shakara bajate të Kryetarit të Çetes

Përshtyjet e një Korre spondenti të Reuter-it të zënë rob mbi shtabin e Broz-it - Lajmet engleze mbi ushtarin gjerman vetëm „propagandë"

Korrespondenti i Reuterit pranë bandavet komuniste në Balkan. John Talbet, cili, kohët e fundit, me rastin e sulmit të parashutistëvet gjermanë, u zu rob, bashkë me një korrespondent lufte englez dhe një amerikan, u pyet mbi përshtypjet e tija, 'Ne arrijtëm këtu paratri javësh,, tregon Talbot, " banonim në një shtëpi të veçantë dhe qëndronim pranë shtabit. Unë merresha vetëm me disa "stories,, dhe nuk shkruanja lajme. lufte, Në s' kemi marrë pjesë me bandat dhe nuk kemi qenë kurrë nër male. Pata një bashëfjalim me Kryetarin e Bandavet, Broz. Për siguri më të plotë, ay banonte në një shpellë dhe atje ia bëmë vizitën. Ay u shmangej pyetjevet t'ona dhe e ngatërronte fjalën me disa «shakara» bajate. Nënë emrin e math «Marhshal» ië them të drejtën, unë kisha perfytyruar diçka krejt tjatër. Sulmi gjerman që për né fare i papritur. Kur filloj bombardimi, ne duallmë shpejt nga shtëpija dhe u futëm në një gropë. Por, pak më vonë. u zumë rob. Që mjaft pun' e vështirë për né, por më së fundi, muntmë t'i bintnim ushtarët gjemane që ne s'ishim komunistë, por vetëm korrespondentë eglezë dhe amerikanë. Na mori me vehte një grup parakadutistësh. Ata na përdorën mirë. Na dhanë cingare dhe biskota. Disa skena të vogla që tregonin sjellen e këtyre ushtarëve më së miri, m' a mbushnë mëndjen se ideja që né kishim mbi t'a, që tërësisht fals. Unë e pashë me me syt e mij se si këta ushtarë i shpunë në vent të sigurtë dhe u dhanë kurajo disa grave q' u ndodhë në rrezik. Unë duhet t'a pohonj se lajmet t'anë mbi trupat " SS „ janë vetëm propagandë" Mbi vërejtjen t'onë që Englezët dhe Amerikanët duhet të mejtohen se si mund të jetë gjendja, në se Bollshevikët e mundin Gjermanin. dhe kësktu Europën të tërë, dhe në se Englezët besojnë me të vertetë që nisija e tyre do të kursehet nga bollshevizmi, korrespondent i Reuterit, që siguroj se ish i partisë konservative, u përgjiq. duke mbledhur supat : "Lufta të bën shok me këdo", ndërsa kolegu i tij, fotografisti Slade, tha, me ngashë rim: Ne duhet të kemi mëndjen me Rusinët.

Lajme të ndryeshme

Aeroplanë terroristë sovjetike sulmuan, për të tretën herë, spitalin e qytetit Vardos të Norvegjisë, dyke qëlluar me armet e tyrë edhe brënda dritorevet. Ndërtesa që e pajosur me një kryq të kuq që shihej shumë për së largu.

Ministri i jashtëm englez Eden, mbi pyetjen në se vendimet e kartës s'Atlantikut vlejnë edhe për nisitë e Egjeut, deklaroj : "Shtatuti i kohës pas luftës i këtyre nisive nuk munt të caktohet hë për hë.

Dredhija sowjetike

Stokholm. Qershuër — Rrethet zyrtare sovjetike në Washington e në New York përpiqen, natyrisht, me e paraqitë pjesëtarin e Komisjonit të Tregtis Sovjetike. Kapitenin Kravchenko. si një "Llogaritar të parandësi„ e si një "t' aratisun,, dhe kështu me svogluë sënsacjonin qi "targimi,, i tij prej Sovjetëve në Shtetet e Bashueme ka shkaktue, në këtë kohë, një kokëçarje pak si të madhe mbi methudhat sovjetike. Për sa i përket «Logaritarit të parandesi,», Kraschenko i ka tregue shtypit amerikan, me paraqitje dokumentash, se si ay mbrenda Komisjonit të Tregtis, ka pasë detyrën ma kryesore. d. m. th. me blë për Bashkimin Sovjetik metalin. dhe se për ket qellim ka bamë rrugë të gjatë nder Shtetet e Bashkueme, tue lidhë kontrata me miljona dolla rësh e se ai nuk asht vetëm një llogaritar thjeshtë, porse një metalurg. Kravchenko qi arrini në Washington ne Gusht tc vjetit ë katuem me pasaportë diplomatike. të cilen pëgjithësisht nuk ia apin njij llogaritari, duket se ne kohët e fundit ishte ne dyshim të Sovjetëve, që tashti e pohojnë mbassi i preu marrëdhanjet e veta me ta se, e kishte marrë «urdhnin për me u kthye». Çka do të thotë ky urdhnin për njerëz, qi janë marrë me sy të keq prej Sovjetëve, nuk ka nevojë aspak për spjegime.

Opinioni publik amerikan interesohet shumë për deklaratat e tija, e njikohësisht lajmet në lidhje me largimin e tij a mbi deklaratat e tija mbi politiken hipokrite të Moskës, shtypi amarikan i paraqit si sensacjone të mëdha. Gazeta " Stokholm Tidningen., deklaratat e Kravchenko-s, në një përmbledhje simbas burimit prej New York ut, i paraqet kështu : Kravcheko pohou se Qeverija sovjetike Komitetin e shduki sa për formë, pse, në të vertetë, ky po vazh don gjithmonë t' i perkrahë partitë komuniste ne vendet e ndryshme. Prandaj terminologjija e re demokratike e Moskës s'asht gjë tjetër veçse një marrëveshje mbrapa së cilës mshihen qëllimet e vërtete të Komunizmit. Këto qellime të mshefta kanë shkaktue krijimin e Komitetit pansllav të Moskës dhe krijimin e Bashkimit Kombëtar polonez me një program racjonal të dukshem. Gjithashtu Kravchenko-ja theksoi se politika sovjetike në Ballkan eshe perkundrejt Cekis gjoja bazohet në qellimin e njillojë garancije per një bashkëpunim të pergjithshem të popujve t'Europës, porse, në të vertetë. kjo politikë ndjekë, krejt qellime të tjera praktike. Qeverija sovjetike zyrtarisht ka çfaqë dishiren e vet per me i perkrahë Qeveritë demokrate n'Itali e në vendet tjera. porse në të vertetë kjo permban një orvatje per me i pajtue qellimet e veta me ato t'aleatëve qi kështu të mund të shtijë, në regjimin e ardhëshëm të vendeve të tjera, komunista të ndigjueshem qi mandej të veprojë per qellimet e saja.

Gjithashtu janë shumë interesante pohimet e Kravchenko-s, qi pak kohë perpara ka qenë si drejtor i një stabilimenti industror ne Moskë. mbi gjendjen e pergjithëshme qi sundon në Bashkimin Sovjetik. Bashkimi Sovjetik - thotë Kravchenko - s'ka ba ndonji orvatje serjoze per me i dhanë popullit rus qofië edhe hrin ma elementare kështu populli rron në terror dhe në një shtypje të papershkrueshme. Moska regjimin e saje të paligjë e të dhunshem e shtriu prap edhe në krahinat e ripushtueme. kështu qi burgjet e fushat e perqendrimit prap. u mbushen. Zotnit e Kremlinit po pregatisin prap një brezni per luften ma t'afertë. Ma në fund Kravchenko, tue permendë prijsin e komunistave amerikanë. Brovder, tha se ky mban veshun at petk politik qi ka veshë Stalini. Në qoftë se Kravchenko deklaroi në një intervistë se ai ven vehten nen mprojen e opinjonit publik të shteteve të Bashkueme, at'herë shumë fletore këtë mbroje e interpretojnë si një perpjekje të Kravchsnko-s Kundra „Methudhave të terrorit të G. P. U.-s" e të Komiternit qi Ushtrohen edhe në vendet e tjera jashtë Bashkimit Sovjetik. Fletoret permendin në këtë rasë fatin e Trozky-t ose permendin rasen e "vet-vrasjes,, s'ish-Shefit të Policis Sekrete. gjenerali Krivizky. i cili u shduk nga sqena mbas publikimit të disa nga aventurat e tija sa qe Shef i Policis Sekrete. Gazeta e Washingtonit. "Times Herald,, në një kryeartikull. kerkon qi Komiteti per politiken e jashtme në Senat t'a sigurojë Kravchenko-n si dëshmitar perpara se t'a ljkujdojë këtë G. P. U.-ja.

Për t' u pirë në kupët!

"Djali im u suall aqë mirë në burg. sa a falën glysmën e dënimit !..

"Të shtrëngonj dorën, se munt të jesh me të vertet krenar për djalin t' ënt!

Si nga herë...

"Zoti Profesor, a nuk doni të na mbani sot një konferencë për mbi trulë ?..

"Më von, më von, sot kam diçka tjatër inë kokë !..

LIRIJA E SHQIPNIS

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

Të Hanën 25 Qershuer 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 3 - ÇMIMI 1 LEK

Vazhdimi i zjarrit të rreptë gjerman mbi Londren

279 qerre t'armatosuna sovjetike të shkatrrueme

Humbje veçanerisht të randa t'anmikut në fushen e betejes te keshtjellit te Cherbourgut

Komanda e naltë e fuqive t' armatosuna njofton :

Nder luftimet e ashpra rreth kështjellit të Cherbourgut, anmiku psoi humbje veçanerisht të mdhaja, në msyemjen e tij kundra grupeve t'ona të mbrojtes, të cilët qindruen me trimni shëmbllore. Vetem n'orët e natës, mbasi humbem disa vija mbrojtsë t' ona mbas luftimeve t' ashpra s' afermit anmiku mujti më i a mbrijtë rretheve të qytetit në juglinje e jugperendim.

Në rrethin e Tillyt anmiku msyeni me fuqina të mdhà. Luftimet atjè janë në zhvillim të plotë. Baterilë t'ona bregdetare, me gjithë zjarrin e math të baterive të njisive detare, dhe msymje të rrotullueshme të avjacjonit, ndihmuan me fryt luftimet toksore. Perveç ksaj atà qelluem pikrisht edhë kryqzorët dhe torpedinjerat anmike.

Kah perendimi i Seines baterilë bregdetare ushtarake qelluen një vaporr transporti prej 5000 tonelatash, dhe e ndezen flakë. Një vaporr vrejtues si edhë shumë vaporre të tjera anmike, u detyruen m'e kthye udhen. Po në të njetin drejtim detàr, u qellue një vaporr i shpejtë dhe një vaporr i math transporti prej një mine, dhe u ndezen në flakë.

Vapore t'ona të shpejta, dhe fuqit t'ona të pararojës, në luftime me njisitë detare anmike, qelluen në shej të perpikët torpedinjerat anmike.

Baterilë e largta të marinës së luftës shkatrruen në kanalin afër Dover një vaporr anmik prej 7 000 tonelatash.

Zjarri shketsuës i randë vazhdon në Londër dhe ndër rrethet e jashtme.

N'Italin e mesme anmiku msyeni me fuqi të mdha ballin t'onë të lindjes rishtas, nder pozitat e ndryeshme. Mbas luftimeve t'ashpra që vazhduene deri n'orët e mbramjes, anmiku mundi me 'i shtye vijat t'ona të pjesës bregdetare pak kilometra. Nder vende të tjera të gjitha msyemjet u zmbrapen.

Në lindje divizionet t'ona qindrojnë në mbrojte të rreptë në krejt ballin e mesëm, kundra ofenzivës sovjetike, me fuqina të mdhà infanterije qerreve t'armatosuna, e ajrore. Anmiku mundi me zgjarue msyemjet e veta vetem kah veriu i Mogilew, kah lindja hekurudhure Smolenskut, dhe veçanerisht në rrethin e Witebsk. Nder të gjitha vendet e tjcra sulmi i anmikut mbas luftimeve të rrepta e plot ndryeshime u smbrap. 252 kerre t'armatosuna anmike u shkatrruen: Ndjeksat edhë bateria kundra ajrore rrxuen 42 areoplana sovjetik

Në mes të Polozk e Pleskau bolshevikët banë sulme të shumta të pàfrytshe, ku humben edhë 27 qerre t'armatosuna të tjcra

Një grup bombarduesash amerikan, msyeni rishtas token rumune, dhe hodhi bomba mbi Ploeshti. Fuqitë ajrore gjermanë, rumune e bullgare, rrxuen 23 areoplana anmiq, ndër të cilt 20 katermotörsha.

Bombardues veriamerikan ban një msyemje terroristike dje në oren e drekës mbi Bremen. U banë dame nder banesa. Po pullsija pati humbje.

Naten bombarduesat englez hodhen disà bomba mbi Berlin. Ne token e Reichut, si edhë në vendet e zaptueme e diten e naten u shkatrrueñ 59 aeroplana anmiq.

Zjarri i Artiljeris gjermane mbi perqendresat sovjetike

Ushtarët gjerman vrejna me vemendje prej llogareve të tyna, frytin e zjarrit të tyne

Mashtrimet e Rooseveltit në pagë

Stokholme. — Përzjemja pa nonjë rezultat e politikës së Shteteve të Bashkueme në punet e botës kritikohet në mënyrë t'ashpërt prej senatorit republikan Bricher dhe para të gjithash prej shumë fletoreve. Kështu për shembull gazeta e New York-ut "Dayl Mirror" në lidhje me disa deklarata të politikanëve të pagës i sulmon këta ashpërisht tue shkrue këto: "Jo Mister Hull, programin t'uej të pagjës shtjeni në xhep dhe meruni njher me gjana ma të dobishme ... Proole mat t'ona janë këtu në shtëpinë t'onë edhe jo jashta shtëpis s'onë. Por si duket politikanët t'onë të Washingtonit e quajnë t'udhës të krijojnë problema për ne në vëndet e tjera të botës. Kështu në të ardhmen mbas planeve të Roosveltit o të Hull-it na duhet të marrim përglegjësina për gjithçka që ndodhet në botë. Nga kjo do të rjedhë që na nuk do të kemi qetësi për vehten t'onë. Prandaj një politikë e tillë vetëm në një gja mund të na çojë d. m.t h. në falementimin e plotë të politikës së jashtme të Shteteve të Bashkueme e cila mandej do të orvatej me të kotë të stabilizontë një botë dhe t'a siguronte pa caktue as një kufi.

Vetem fillimi i hakmarrjes

Ministri i Reichut, Dr. Goebbels, në artikullin e tij, në numrin e fundit të së Përjavëshmes "Das Reich", thotë se rrjedhja e gjerlashme e invadimit po provon një vark të tërë parashikimesh politikë dhe ushtarake që i ishin bërë, prej kohësh, në Gjermani. Munt të thuhet se u vertetuan edhe parashikimet ushtarake dhe psikologjikë për sa i takon hakmarrjes, të paktën' nga sa shihet gjer sot.

Shpresohet, vashdon Mintstri, se ketë radhë do t'i jepet besim më tepër parashikimit gjerman, si pas të cilit, kjo faza e parë e deritashme e hakmarrjes përbën, në të vërtetë, vetëm hyrjen e asaj që do të kryhet Në do të dalim me armë të ra dhe akoma më të forta dhe pikërisht n'atë çast, që neve do të na duket si m' i përshtatëshmi.

Ministri cik edhe faktin se, me invadimin, mer funt një her' e mirë, baza e sy stemit luftarak anglo-amerikan për të futur në luftë, sa të jet' e munuur më shumë., popuj dhe ushtëri të huaja dhe kështu, me gjakun e këtyre, ata të sigurojnë interesat dhe t' ia arrijnë qëllimit.

Englezët dhe Amerikanët, shkruan Dr. Goebbels, me këtë invadim do të goditen munë damar dhe në një mënyrë t' atillë, sa s' e kanë ndjerë kurrë, në historin' e tyre, qysh prej luftës së parë botnore. Korrespondentët luftarake anglo-amerikanë e quajnë invadimin, jo ndryshe, por një sinfoni gjaku dhe llomi. Bëjnë pjesë të invadimit edhe spekullim nër bursat e Londrës e të New Jorkut, ku, prej gjakut t'ushtarëvet anglezë dhe amerikanë, bëhet ar.

Viktimat e Udhëheqësvet të çmëndur luftarakë anglo-amerikanë po rrëzohen për një çeshtje që s' del në krye. Ajo s' e vlen as pjesën më të vogël të viktimavet që po thith. Englezët dhe Amerikanët nuk munt të çutiten pakë mbi konditat e jetesës q'ata gjetnë në bregdetin perëndimor të Francës : Racjonet e sendevet ushqimore, thonë ata vetë, janë më të mbdhenj se ata të Llondrës. Ata gjetnë, kudo, pastrim, drejtësi dhe rregull. Sa ndryshe qëndrojnë punët në Romë, si pas vetë lajmevet angleze! Atje plasi një zi buke, sapo me hyrjen e Anglo-amerikanevet. Ku, vallë, do të që ndryshe, në Evropë, sikur Anglo-amerikanët të ecnin përpara? Kudo që ata Shkojnë, shpijen me vehte urinë dhe bollshevizmin. Roma notoi në një det flamurësh sovjetikë, si shenjë e liris! Lojdra që po shvillon sot plutokracija anglo-amerikane në Perëndim, duhej të shihej si e humbur edhe më parë se të fillonte invadimi. Por, jo, tashti arrijti, per Anglo-amerikanët, çasti i padërhëruarshëm d.m.th. se orvajtja e tyne, për të pushtuar Evropën, ndonëse nuk u dërmua që në fillim, prapë mbeti, në përgjithesi, atje ku filloj, dhe ata janë ta detyruar të futin, në vepërim, pjesën më të madhë të divizionevet të tyre, të cilët do të çkrijnë, ca nga ca, në skëterrën e Kryeurës.

Londra dhe Washingtoni i sakrifikuan shtetet e kontinentit t'onë njerin pas tjetrit, vetëm e vetëm për t'i sheshuar rrugën Bolshevizmit drejt Evropës Tashti, si përfundim ato po bëjnë theror edhe vetë bijt e tyrë. Dredhija engleze, që gjer sot, ka lojtur rrol, në të gjitha luftrat e kontinenti t'onë dolli në shesh prej kohësh. Anglia nuk është as mikja as çlironjësja e Evropës, por vetëm një çkaterronjës dhe një armik i saj plot urrejtje. Lufta anglo-amerikane s'është më një luftë që bëhet për ideale të lartë, që edhë të çpërblehet me viktima të shumta. Ajo është vetëm një kasaphanë gjaku, zjarri e flake, çkaterrim dhe përvelësim i të drejtavet më elementare të jetës së njerëzvet dhe të popujvet, dhe të gjitha këto, vetëm për një qëllim : për t'a detyruar Evropën, e, më tepër, fuqinë e funtme mbrojtëse të 'saj, Reichun gjerman, të bëhet robi dhe skllavi i kapitalizmit botnor. Por Evropa e ka gjetur vetë, prej kohësh, rrugën e saj. Nënë ahe dhe mjerime, u lint një mendësi e re kontinentale, e cila do t'i kalonjë edhe stuhitë e kësaj lufte. Ushtarët e Adolf Hitlerit janë flamurtarët e revolucionit evropjanë.

Grushte të pa-ndërprerë

Më 15-VI-944 armiku humbi, në qendrën e një armate, 248 të vrarë të sigurtë, 115 të llogaritur si të tillë dhe 87 robër. Veç kësaj, u zunë morlaje, mitraljoza, 200 pushkë, 44 kuaj dhe 80 kg. eksploziv.

Fole bandash të shkatrruara

Në pjesën lindore të Fruska Gora-s (Ungari), granatierët t' anë shkatërruan disa folera bandash. Të tjerë regjimente, që muarnë pjesë nër këto operacione, shkatërruan kuartierin e një shtabi banditësh. Me këtë rast u zunë shumë armë, municion, sende ushqimore dhe uniforma.

LIRIJA E SHQIPNIS

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Enjte 29 Qershuer 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 4 - ÇMIMI 1 LEK

Zjarri mbi Llondër vashdon me "Rythm të terbuar,,

Gazetat angleze i "heqin perden,, efektit t' armës së re gjermane

Shtypi angles nuk është më në gjendje, sot, të ndjekë taktikën jo aqë të lumtur të Qeverrisë, për sa i takon efektit t' armës së re gjermane, passi zjarret e mbëdhej në Llondër dhe në lagjet e jashtme të saj, gërmadhat e shumta dhe mungesat e ndjejshme në jetën ekonomike, flasin një gjuhë mjaft të kjartë.

Gazeta "Daily Mail,, boton një artikull të korrespondentit të saj luftarak të ajrit, Colin Begnall, mbi "Armën Nr. 1 të hakmarrjes,,.

Në këtë artikull flitet mbi "një beteje kundër bombës fluturonjëse,, që paska filluar. "Është e pamundur të thuhet, flet artikulli, se sulmet gjermane me "bombë fluturonjëse,, mbi Anglì, nuk kanë rëndësi ushtarake. Gjermanet po na i dërgojnë këto bomba njërën pas tjatrës dhe, ka çaste, ku munt të flitet për një "rythmë të tërbuar,, kur një vark bombash ndjek tjetrin. Përgjithësisht, është punë e vështirë të gjeturit e njëj tjatre mënyrë mprojtjeje, me të cilën munt të luftohej, me sukses, arma e re. Prandaj Mbrojtja engleze duhej të ndryshon te krejt dhe të fillonte radhë të re.

Orvajtja, për t'a rrezuar armën e re që në ajr, nuk dha, po thua, asnjë resultat. Natën, p. sh. munt të shihet mirë «siluri» gjerman, se lëshon ay vetë dritë, gjatë fluturimit, por gjujtësit englezë të natës janë shumë të gadalshim.

Për sa u takon sulmeve të bombardonjësvet anglo-amerikanë mbi bazat e pregatitjes të kësaj arme, vërren Begnall, u provua, haptas, se Gjermanët, me ndihimen e «fshehjes më të mënçme të të gjitha kohëvet» ditën t'ua ndalojnë aeroplanëvet kundërshtarë, xbelimin e ndërtimevet tekniké.

Nje korrespondenti i «Daily Mail» bën fjalë mbi «incidente të mbëdhenj» n'Anglinë jugore, që shkakëtuan Robotët gjermane vetëm në një sekundë. Me rënjen e tyre, radhë të gjata ndërtesash u bënë rrafshë me tokën. Një nga të shpëtuarit tha, më von: «Mua m'u duk sitkur po më flakej zëmra nga goja, kur pashë një nga këta përbindsh që po sulej, me shpejtësi rrufeje, mbi banësën t'ime».

«Nënë efektet e armës se re gjermane, kshu vashdon korrespondenti, vuan shumë edhe nozullimi i ushqimevet. Rivista mjekësore engleve, «Lancet» shkruan se fakti, që një aeroplan pa pilot gjerman po sulmon Anglinë jugore, sjell, për opinionin engles, diçka të tmershme. Misteri rreth bësaj bombe dhe veçanërisht, dëmet që kjo shkakëton, bëjnë një efekt të çudit shmë.

Komunistë të vrarë, të zënë rob dhe të aratisun

Bandat komuniste patën, më 17-6, në Balkanin perëndimor, plot 300 të vrarë dhe ojë numur edhe më të matb robrish dhe t'aratisursh. U zunë një sasi e madhe mitralozash, shumë pushkë dhe depo të konsiderueshme municionit.

Në zonën e Ravno Polje një bateri antiaerero "SS,, rrëzoj një katërmotorsh amerikan.

Myslimanët shkatrrojnë çetat komuniste

Një divizion "SS,, mysliman goditi disa çeta të përparuara dhe i shkatërroj.

Në këto përpjekje, kundërshtari pati, afro 50 të vrarë dhe po kaqë robër.

U zunë rob edhe disa ndihmës çetash.

I ndjek jo vetëm pushka

por edhe mallkimi e perbuzja!

Kur kapedani komunist, Mehmet Shehu e griste, para disa javësh, Flamurin e Kuq me Shkabën dykrenore dhe e shkelte me këmbë; kur ay e plotësonte trathëtin' e tija kundrejt Atdheut, dyke shpallun "Republikën sovjetike,, në Shqipërin e Jugut, sigurisht ay bënte llogarin' e një falënderimi, nga an' e porositësvet të tij bolshevike, dhe shpresonte për një njohje të kësaj "Republike, nga an' e Llondrës. Ce foshajë s' ka marrë vesht, në Shqipëri, se Churchili dhe Roosevelti, në konferencën e Teheranit, i lanë dorë të lirë Stalinit mbi tërë Ballkanin, bashkë me Shqipërinë. E, pra, llogjikisht, a ish e mundur që të mos njihej, prej Anglis dhe Amerikës, një Republikë sovjetike e Shqipëris së Jugut,,?

Një njohje anglo-amerikane të kësaj Republikeje fantastike, Mehmet Shehu dhe shokët nuk e kufizonin vetëm në një copë kartë por ishin më se të sigurtë se tashti do të rrihte, në mbretnin e tyre marionetash, një lumë ari anglo-amerikan

Por të gjita këto pritje u shuan si vesë dhe në mënyrën më të pa-mëshirëshme: Para disa ditësh, Anglo-amerikanët hothnë fletushka, në Shqipërin e Jugut, ndër të cila thuhej se Llondra dhe Washingtoni nuk munt t' anjihnin "Republikën sovjetike,, gjer sa kjo të mos përfshinte edhe Shqipërin e Mesme dhe atë të Veriut. Shkurtë, Mehmet Shehu dhe shokët e tij nuk munt të llogaritnin për njohje, nga ana kundërshtare, vetem se atherë kur ata t'a bënin të gjithë Shqipërin bollshevike.

Por, për sa i takon kësaj e kupton edhe komunisti m' i flaktë i kësaj toke. Kurr dhe kurrë nuk do të bëhet Shqipërija bollshevike. Një popull që ka bërë sakrificat më të mëdha, për lirin e tijo kombëtare dhe për demvarësin, do të dij të mbrojtet, çdo çast dhe ca më tepë me ndihmën e armëvet gjermane, nga të gjitha përpjekjet e trathëtorëvet moskovitë.

Shqipërija do të mbetet, nga herë, një shtet' i pamvarur dhe i lirë nga çdo shtypje sovjetike. Këlë e dinë, më së miri, edhe vetë Mehmet Shehu e shokët.

Protesta e tyne kundër fletushkavet, anglo-amerikane qe, me të vertet, qesharake: Ata i mblodhnë të gjitha fletushkat, ku mohohej njohja e Republikës së tyre sovjetike, dhe i doqnë.

Ja, pra, pas grushtit të rëndë që muarnë prej gjermanëvet, kryefarët kumnistë na i goditi edhe grushti i t' u bërit qesharak!

Kështu ra „Drvar" në duart t' ona

Bashkë më parashutistët brënda mu në shtrofkën e banditëvet

Me 6 Qerthuër komunikaia e fuqive t'armatosuna gjermane, lajmonte shkatrrimin e ktvartierit te përgjithëshëm të Josip Broz në Krocci. Në ket ndermarrje gjermane, bandat humben pëimbi 6.000 të vramë. Këtu po parakesim hollsinat e këtij veprimi, prej nji gazetarit gjerman të ballit, i cilli zbriti me parashut dhe ndodhi gjatë gjithë kohës të veprimeve luftarake.

Fusha është plot aeroplana, gati për fluturim. Një erëz' e ftohtë mëngjezi trazon flokët e një grupi parashutistësh që po rrinë rrëth komandantit të tyre. Kjo e sotmja nuk është një ndërmarrje nga ato të perditë shme: Jo, kësaj radhe do të kërcejnë brënda mu në vatrën e çetavet, brënda në një shtrofkë banditësh, të cilën bolshevikët nga pozita e saj, e kanë zjedhur si qendrën e tyne kryesore.

Me fjalë të prera, komandanti u jep urdhërat pilotëvet të tij. Bisedohet dhe komentohet çdo minutë q' i takon zbritjes në tokë, Sicilido tashti e njeh mirë detyrën' e tija. Çdo gjë është e kjartë, maqinat munt të nisen,

Në pakë, kohë, arrihet një lartëri 2500 metra. Djathtas dhe majtas, maqina, njëra për krah tjetrës. Njëri vark pas tjetrit. Për mbi në, ushëtijnë aeroplanët e betejës, të cilët do të na udhëheqin në këtë valle shëterre. Parashutistët fluturojnë, në rradhë të gjera, përpara nesh. Ata do të kërcajnë poshtë, pas sulmit të aeroplanëvet luftarakë. Fluturimi, mbi zonën e operacionit, mban rrafsh një orë. Banditët kanë xgjedhur një vent të mirë përqendrën e tyre: male që cikin retë, u dalin përpara aerorëvet t' anë. Thellë, përposh, ckërka dhe pyje shekullore, folë ideale banditësh. Sicilido prej nesh e di edhe minutën e arritjes s' onë mbi zonën e vepërimit. Sytë t' anë lëvizin, pa pushim, nga ora e dorës drejt tatëpjetë, mbi pyjet ndën në. E përqëndrojmë vehten ndër minutat e arthme. Ndën në, poshtë në një rripë, del tym nga gërmadhat e folës së banditëvet, që sapo i muarnë përshëndetjet e para nga bombardonjësit t' anë. Që lark, nuk çquhet gjë dhe aqë mirë, pastaj s'ka as kohë. Casli vendimtar arrijti. Piloti ynë e çmreh maqinën nga ajo me motor q' e heq pas. Dyke uleritur, bomnardonjësi, furret tatëpjetë, si ndonjë zok i liruar nga kafazi, për të marrë pjesë nër luftimet e tokës, Pas tij,

Goditje të rënda Komunistëvet

Nga Kumtësa e K. P. të F. t' Armatosura, datë 26 qershor

Njëjësi të trupavet të Ballkanit, që janë nënë komandën e përgjithëshme të Major-Gjeneralit Loehr, brënda tri javësh luftimesh të rreptë nër malet e Shqipëris së jugës, çkatërruan një vark çetash komuniste.

Armiku humbi 3000 të vrarë, shum robër, shumë armë lloji të ndryshmë dhe depo të mbëdha municioni dhe materiali tjetër.

4 bombardonjës armik rrezuar në Shqiperi

Dita 23 qershor, në të cilën si pas kumtësës së K. P. të F. t' Armatosura, u rrëzuan mbi tokat e Reichut 119 aeropllanë terroristë amerikanë, i pruri kundërshtarit edhe humbjen e 4 bombardonjësve mbi Shqipëri. Njëri nga këta u përplas më ora 12.30 në veri të Librazhdit. Nëntë veta nga personeli u hothnë me parashuta dhe u zunë rob.

Më ora 13.05 një bombardonjës u rrëzue 8 km. në jugë të Leshit dhe u doq. 6 veta nga personeli u zunë rob. Afër orës 18 një tjetër bombardonjës u rrëzua në det, në gjirin e Valdinos. Personeli përkatës, që përbëhej prej 3 oficerësh dhe 6 gradualësh, u nxuar në tokë, me barka gome, dhe u muar rob. I' zunë rob edhe 6 veta të tjerë nga personeli i një bombardonjësi të rrëzuar në veri-perëndim të Prizrenit.

lëshohemi, me vrrull, edhe në. Toka shket, nënë këmbët 'tona, me një prirje 60 gradësh.

C'ngjet më pas, shvillohet me një shpejtësi sekondash. Me siguri habitëse, alianti ynë zë shesh, mbi një tokë shumë të vështirë. «Të gjithë jasht! ulërit komandanti ynë. Brënda një çasti, e lemë maqinën. Për fat të lumtur, në kemi rrastisur mbi një arë gruri, që na jep mundësi mbulimi nga të gjitha anët. Se nn bijen nga të gjithë drejtmet dhe plumbat na vërshëllejnë mbi kokë pa pushim. Maqina jonë tingëllon nga goditjet Rreth e rrotull folës së çetavet, janë ulur aliantë. Me të hyrë të fshatit, parashulistët po luftojnë,shtëpi më shtëpi.

Grupet e ushtarëvet të xbritun nga aeroplanët transportonjës marrin pjesë në luftime, dyke ecur nga dalë përpara, në rrugën e katundit. Prapa qepenash tregëtoresh të mbyllura, të çara e të copëtuara nga bombardimet, na pret një zjarr i rrëptë, aqë sa detyrohmi t' i dalim që prapa këtij kundërshimi. Pas një kohe të shkurtër, të gjithë grupet e xbritur në tokë janë gati për një sulm të përbashkët.

Nga bodrumet, nga kambanaritë dhe prej dritoresh, armiku mpron tërheqjen e forcavet të tija kryesore. Mitraljozat t' anë 42 rrahin rrugën dhe s' lenë as gjë të pëptinjë. Brenda pakë kohe, katundi është në duart t'ona' Nga të gjitha anët grumbullonen robër. Vërtet skpëtoj pjesa m' e madhe e shtabit të banditëvet, por armiku nuk mundi të ndalonte që në të kapnin një sasi të pazëvëndësuarskme materiali'

Por, me gjithë humbjet e rënda, e dimë dhe në vetë që armiku nuk do të na lerë pa na sulmuar. Në zëmë vënt, në një vorrezë, dhe kërkojmë aeroplanë luftimi. Kanë kaluar katër ore që kur kemi xbritur.

Valë të ra parashutistësh

Afër drekës, për mbi majrat e malevet ja, çfaqen grupe aerorësh luftimi. Hidhen poshtë parashula, që sjellin municion dhe tc tjerë sende. Ndërsa bolshevikët mbahen në vënt, nga zjarri i aeraplanëvet të luftimit, prej një larësije të vogël, kërcejnë poshtë valë të ra parashutistësh, të pritur me brohorifje prej shokëvët të tyre keq të shtrënguar. E çprapsim armikun mjaft lark dhe kësktu marrim frymë. Por në e dimë të gjithë se ky është vetëm një çast i shkurtër pushimi, përpara luftës së rreptë që po na ruhet. Ne jemi vetëm, të rrethuar dhe pa asnjë nderlidhje me prapavijat. Por në e dimë që edhe vetë armiku po rrethohet, nga njësitë t'ona që po afrohen nga çdo anë.

Duhet të durojmë sa të jetë' e mundur dhe të kursejmëmunicion. Më parë gjetëm kufomat e shokëves që kishim rënë të gjallë, në duart e banditëset. Në ballë u kiskin shtypur, me kehur të nxehtë' nga një yll sovjetik; Njerit i kishin këputu's krahët. E dinim, pra, se ç'donte të thoshte dorëzim nër 'ta.

Mbrëmanet, me anë shënjash, mblidhemi të gjithë tok,Nga ora 10 fillon prapë vailja Fashti komunistat afrohen dhe përd rin bomba dore. Në ngushtohem gjëthënje më tepër. Me sy të xgurdulluar, grananatierët t'anë ruajnë murin e varrezës dhe shtijen me mitraljo.

Një çast me qetësi. Pastaj armiku sulmon prapë dhe na shkakëton humbje. Ay mundohet te kapërcenjë murin, por prapë shtyhet, Në s'mejtojmë gjë tjetër, veç se të mbrohemi dhe të marrim shpagë për shokët t'anë mbytur në gjak.

Kalojnë shtatë orë. Kur lint djelli, prapë qetësi, por në me zi mësohemi me 'te.

Dita e re do të jetë vendimtare. Dhe ashtu ngjet: Sapo hapet dita mirë, ja, dëgjohët së largu, shurma e një motori: Mos marrja fajnë nga në dhe resultati i shqyrtimevet ajrore e kishin treguar mjaft kjartë gjenëja'onë te vështirë,

Fytyrat t'ona sakëlqejnë, kur na flufuron mbi kokë një aeroplan xbulimimi. Dritra jeshile u tregojnë bombardonjësvet drejtimin ku është fshehur armiku. Bombat bijen pa pushim mbi pozitat kundërshtare dhe bëjnë kërdine.

Shpejt arrijnë robër të rinj, armë dhe lëndë tjatër. Afër orës 10, dëgjohet zhurmë nër la tësirat, përpara nesh, dhe në e kuptojmë ë repartet e motorizuar kane mundur të kalojnë, më von, duken tankset e pare.

Parashutistët e kryen detyrën e tyre- Ata e arrifën qëllimin: Në më shumë se 24 orë luftimi të rreptë, ata çkatërruan një armik në numur dhe në armë shumë më të fortë. Kërcimi brënda në vatrën e banditëvet një ndërmarrje që munt t'a kryejnë vetëm burra me kuarjo e me vendime çpërndau shtabin armik nga të katër anët. Aj pësoj humbjet më të rënda në të vrar'e të plagosur dhe në shtimë, në dorë. sasira të mbëdha armësh dhe materiali: Ky që përfundimi i ndërmarrjes s'onë.



Avjatoret gjarman përpara pllanit që paraqet zonën e operacionit. Nga një studim i imtë dhe një stërvitje e kujdesçme fitohet siguria e sulmevet të natës. Ata duhet t' a kenë gjithënjë para syvet pamjen e objektivit.

Bullgarija besnike e nderit te saj

„Mobilizmi' i përgjithëshëm" asht përgjegjja e Sofjes kanosjeve të Moskës

Kanë kalue tri javë prëj ditës «t' ultmatum-it» bombastik anglo-ruso-amerikan, që u dha Finlandis, Bullgaris, Rumanisë Ungaris. Qeveritë përkatëse. as që kane çâ kokën, për me i u përejegj pretendimeve qesharake anmike, që të dorzojnë armët. tue u çkputë prej aleatës së madhe Gjermanis.

Për këtë pa-sukses, që i përket kjartas inisjativës së Moskës, ma i zemruemi i të tre shokve tregohët Stalini, i cili, detyrohet me vue në llogarin pasive të fushatës së tij frigsuese «përgjegjen negative» të Finlandis, notës s' armëpushimit, indiferencën me të cilën i priti Rumanija kanosjet e tija, dhe mënyrën me të cilën Amirali Horthy me ushtritë gjermane përfundoi problemin ungarez,

Tue u pasë trokitun gjithë këtyne dyerve pa dobi, Moska po i troket me furi portës bullgare. Fushata e kanosjeve, e përkdl:eljeve, kundrejt popullit bullgar po shtohet e ashprohet dita e ditës. Çdo gja asht vue në veprim për me nxitë popullin nëkryengritje kundra qeveris tue fillue prej lajmeve të rrejshme (p. sh. ultimitum-i i Mokës prei 24 orësh, i dhanun Sofjes për prishjen e menjiherëshme të marrëdhanjeve me Aksin, që kapërceu javën) e deri në frigsime, në shpifje ma të turpshme, e në psemtime ma të bukura. Por të gjitha janë të kota, se popullt Bullgar i ndigjon të gjitha këto me qetësin më të madhe tue i konsiderue si nji «bluff» propagandestik, e vazhdon udhën e vet tue i ndejë besnike, fjalës së dhanun,

Kremlimi e ka humbë pusullen. Provën e ep numri i fundit i fletores "Pravda,, me nji koment të gjatë, i kushtuem Bullgaris ku ndër të tjera thotë dhe sa vijon:

Kanë kalue 15 ditë prej datës së vrejtes që u kanë drejtue kombet e bashkueme, shteteve satelit të Gjermanis, Gjatë ksaj kohe, qeveritë e Ungaris, Rumanis, të Finandis e të Bulgaris, nuk kanë çfaqë ndoj dëshirë për të ndigjue zanin e arsyes, që të marrin nji qendrim në luftën kundra rebelve që shtypin vendin e tyne. Përkundrazi gjatë ktyne 15 ditve të fundit,ata kanë dhanë nji provë të shqëlqyeshme të dishirës së tyne të pa-tundun, për të vazhdue rrugën e tyne në marshimin e përbashkë me Gjermanin hitlerjane, tue lanë mbas dore krejtësisht interesat e vendeve të tyne;..»

Mbas gjithë këtyne vargjeve kuptimplotë "Pravda merr,, në shqyrtim qendrimin e qeveris bullgare e cila, në bazë të nji seris së gjatë të rrenave, quhet si «provokuese dhe kokëfortë «. . . Artikulli i fletores sovjetike përfundon tue i u drejtue popullit bullgar. prej qëndrimit të cilit varet fati i vendit të tyne, tue e pa të kotë që të merret ma me qeverrin bullgare, e cila, si përgjegje të qortimit që i u ba prej aleatve, bani mobiliztmin e përgjithëshëm të fuqive t' armatosuna të saja.

Sigurisht, shoku Molotof nuk mund të jetë i knaqun për nji përgjegje të till, e cila, në vetvehte nuk asht tjetër veçsë nji përgjegje e njerzishme e Sofjes, e, zemrimi i tij si edhe i Stalinit asht ma tepër se i kuptueshëm. N' anë tjetër, duhet theksue e Bullgarija — Qeverija — populli e ushtrija — mbeten të qetë e vazhdojnë, më ftyrë të këthjellët e gjak ftohtësi vendimin e rrugës së marrun, e cila asht ajo e interesit dhe e nderit kombëtar.

Në fidhje me këto ngjarje u banë edhe ndryshime të randësishme në komandat e nalta ushtarake bullgare. Kryetar' i shtatmadhoris, gjenerali Lukas, u zavendsue prej gjeneralit t' armatës Trifonoff, i emnue in spektor' i përgjithëshëm i ushtris. Gjeneral divizionit Bojdeff, komandant' i garnizoni të Shkupit. mbas dishirës së çfaqun prej tij u vue në pushim, dhe u zavendësue prej gjeneralit Stojanoff,

Kryetar' i ri i shtatmadhoris gjeneral Trifonoff, u interesue me njëherë në mënyrë të veçantë për m' e përballue gjendjen.

Luftvaffe sulmon përqendrime bandash

Në Sloveni, në krahinën e Daruvar-it, arma aerore sulmoi, me sukses, përqëndrime bandash. U numuruan 30 armiq të vrar. Në një sulm spastrimi, po në zonën e sipër përmendun, u vranë edhe 24 pjesëtarë çetash të tjerë dhe u zunë rob një pjesë prej tyne. Në Kroacinë veri-perëndimore, aeroplanët gjermane të luftimit shkatërruan dy topa.

Ndërsa trupat gjermane dhe vetë trupat kroate po i ndjekin komunistët këmba këmbës, dyke u shkakëtuar atyre gjithënjë humbje të rënda, ata velë e paguajnë shumë shtrenjtë çdo orvatje për t' i shpëtuar sulmit të grupevel gjermane. Vetëm në një orvajtje të tillë, bandat humbën 200 të vrarë- Veç kësaj, u zunë edhe 40 besnikë të tyre.

M' a hodhe, t' a hodha!

Nastradin i na vajti një ditë në hamam, por i zoti nuk para e priti dhe aqë mirë: i dha një peshqir të ashpër, një përparje të grisur dhe s' ia vura më veshin. Hoxha i shkretë s' bëri shamatë, u la dhe, në të ikur, lëshoj 10 grosh mbi sofat. Hamamxhiu u çudit me këtë ovardhallëk të math dhe i bëri një temena gjer në funt të këmbëvet.

Radhën tjatër, koe mos, u prit me një mij' e një nderime: peshqir të butë, peshtemall nga më të mirët, e fërkuan paq dhe ia plotësuan të gjitha dëshirat. Efendiu i pranoj, në heshtje, të gjithë ikramet dhe, kur mbaroj së lari, lëshoj mbi sofat, vetëm një grosh. Hamamxhiu q'e mori, vari buzët, mblodhi vetullat dhe e pyeti, në për dhëmbë, pse kësaj radhe pagoj aqë pakë.

"Është hesaj tamam,, u përgjiq hoxha, pa gjë të keq, "të hollat që po paguanj sot janë për banjën e radhës që shkoj, ato që pagova athere, vlejnë për të sotmen...! dhe kshu beri temenan' e iku.

Nji përfundim i shkelqyeshëm i amnestisë kroate:

30.000 u Këthyen deri tash prej maleve

Mbas amnestis të dhanun prej poglavnikut kroat, kryetär i shtetit, e cila u zgjat edhe deri me 1 Korrik 1944, për gjithe ata që dishrojnë me u kthye nder vendet e tyne, si mbas statistikave të ministris kroate rezulton: Deri kah fundi i Majit janë paraqitë perpara auktoriteteve kroote 21343 partizan prej maleve, Ksaj çifre i shtohen edhe atâ qi a janë dorëzue fuqive ushtarake kroate gjatë operacjoneve, kështu që shuma e përgjithëshme kapë 30.000 shpirtë. e cila h tohet dita e ditës.

Të rikthyemit tregojnë me keqardhje ma të madhe mizorinat që kanë pâ me sy gjatë kohës që ishin ndër partizan, dhë shumë prej atyne po kerkojnë të shkojnë vullnetarë së bashkut me ushtrin kombëtare të luftojnë kundra ashtu të qujtunve kameratët e djeshëm. Ata tregojnë se shumica e atyne qjanë ende ndëe male dishrojnë e presin rastin e parë që të ikin prej atij ferri, pra masat e randa lerroristike që marrin komandat e partizanve nuk i u lenë mundësinë që të çkputen lehtazi prej thojve të bishave të malit.

Pyetje e një oficeri të marinës engleze

LIRIJA E SHQIPNIS

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Hënë 3 Korrik 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 5 - ÇMIMI 1 LEK

Arma e re Gjermane i kalon shënjat e gjertanishme të qitjes

Hollësira mbi armën e re - Efekti i plasjes m'i math se ay i bombavet më të rënda aeroplani

Hollësira mbi armen e re gjermane, jep korrespondenti ushtarak i agjensisë DNB, Martin Hallensleben, dhe këtë e bën në lidhje me faktin se, bombat fluturonjëse kanë plot 14 ditë që po e rrahin, pa puskim, Anglinë jugore dhe rrethin a Londrës, dyke i mbuluar me zjarr e flakë. Hallensleben shkruan:

„Në të vertet, heshtin rrethet zyrtarë gjermane, si më parë ashtu dhe tash ti, dhe nuk tregojnë hollësira, por, me gjith këtë, nga qarqe të mirë informuar, munt të merret vesh diçka. Si pas këtyre, munt t'a arabitim armën e re me një aeropplan të vogël pa pilot dhe që drejtohet së largu.

Një kombinim spacial raketash i jep mjetit më të ri luftarak gjerman shpejtësin'e lartër. Madhësija e këti kombinimi raketash caktohet si pas largësis që duhet të arrinjë goditja. Munt të thuhet, me siguri, se arma e re gjermane i kalon, dhe shumë, të gjitha qitjet e larkme që njihen gjer sot. Efekti, edhe i një qitjeje të vetëme të kesaj arme, është enorm. Ky nuk munt të krahësohet as me atë të gjylers së dalë nga gryka e topit më të math për largësi, as me atë të bombavet ajrore kalibrit më të math.

Si pas informatash të besuarshme, bomba vetë është veshur me lëndë të ndryshme plasëse dhe djegëse. Sa për këtë, munt të pranoben si të vërteta edhe lajmet që japin anglezët, të cisët thonë se „Bomba fluturonjëse" shkakëton, në vëndin ku bije, edhe plasje edhe djegje. Por ka, si duket, edhe bomba të tjera të këti lloji, përmbajtja e të cilavet është një përzjerje lëndësh djegëse dhe plasëse. Si dhe ç'far pëzjerjë është, nuk dihet asgje.

Po kësisoj, nuk dihet as gjë edhe mbi vëndin ku gjenden, os e ku notojnë, bazat e kësaj Arme. Nuk është vërtetuar edhe në se, arsenalët, të sigurtë nga bombat, që prodhojnë këtë armë, gjenden në bregdetin e Manshit, apo n tokën franceze.

Edhe për sa i takon shpejtësisë, nuk ka njoftime të saktë. Vetëm është vertetuar se as gjujtësit më të shpejtë englezë nuk munt të konkurrojnë me shpejtësin'e Armës së re. Lartisija e fluturimit caktohet, si duket, si pas nevojës. Kjo caktohet si pas efektit që duhet të bënjë dhe si pas objektivit, d. m. th në se bomba duhet të vejë shkrazi, apo të bjerë drejt tatëpjetë.

Goditjet e Anglisë jugore bëhen si pas një plani të saktë. Si duket, ka tri mënyra goditjeje të objektivit: 1 bombat hidhen të veçuara, 2 hidhen vark njëra pas tjetrës, ose, si i thonë në gjuhen ushtarake, në rrëke zjarri, 3 hidhen në shumicë, por me ndërprerje. Por, mbi gjitha, gjëja kryesore është që në përdorimin e kësaj arme misterioze nuk lozin as një rrol kondilat atmosferike, kurse mundësitë e mbrojtjes armike pengohen tepër nga retë, nga mjergulla dhe nga shiu, dhe këto pengesa çfrylëzohen, si jo më mirë, prej Komandës gjermane.

Nër planet e objeketivavet, pranë komandës së armës së re, janë shënuar, qysh tash, një sasi kryqesh të zes. Këta tregojnë se ku kanë plasur bombat e hedhura, gjer sot, mbi Anglinë jugore dhe ku ato kanë çkatërruar çdo gjë. Një ekspert që ka lidhje me komandën e Armës tregon se, gjer tashti, është vënë në përdorim vetëm serija e parë. Për së shpejti do të urdhërohet një përdorim i plotë. Në të vëretet, zjarri i deritashme munt të merret vetëm si „hyrje" e hakmarrjes. Ka edhe të tjera armë gati, q'e kalojnë së tepërmi atë që kundërshtari ka pësuar, gjer sot, nga Arma e re. Flitet édhe se eksperiencat që komanda po bën me armën e re, po çfrytëzohen për një përmirësim të përgjithëshme të vargut t' armëvet të hakenarrjes.

Zjarr i rëndë hakmarrjeje per mbi Llonder

Nga Kuartieri i P. i Fuehrerit,2 qershor Komanda e F. t'Arm. njofton:

Në orët e drekës së ditës së djeshme armiku i filloj përsëri orvajtjet e tija për të çpuar vijat t'ona në jugëperëndim të Caen,pas si e rrahu zonën me zjarr shumë të rëndë artilerije. Si atje,ashtu dhe në verilindje të S. Lo,të gjithë sulmet kundërshtare u çprapsnë. Aeropllanët e betejës muarnë pjesë me sukses ,edhe dije, nër luftimet e tokës.

Natën,fuqi ajrore t'nat sulmuan grumbullime anijesh armike përpara Kryeurës. U vunë re të mbëdha.

Nër disa ndërmarrje spastrimi,në token franceze, u likuiduan 80 terroristë.

Zjarr tepër i rëndë hakmarrjeje për mbi Londër.

N'Itali, pika kryesore e sulmevet t'armikut që në zonën jugëperëndimore të bregdetit dhe zonën jugëlindje të Volterras. Trupat t'ona, nënë pressionin e forte armik, u vendosnë në sektorin Cecina. Edhe në jugëlindje të Volterra,s armiku mundi të fitonte toke nga veriu. Në krahinën e Siena-s dhe në perëndim të Liqeni Trasimeno, divisionet t'ane trima i shtynë të gjithë sulmet armiq'me lumbje shumë të rënda për kundërshtarin. Një bataljon armik dhe 29 tankse u asgjësuan.

Në ballin e mesme të lindjes, divisionet t'anë u qëndruan të gjithë sulmevet me fuqi shumë të mbëdha të Ruservet. Në zonën e Slusk-ut, pas luftimesh të rreptë, Bolshevikët fituan tokë. Ky vënt u lirua.

Nër Ossipowitschi, trupat t'ona i ruajtën pozicionet e tyre kundër të gjithë sulmevet armiq. Grupet që luftonin në sektorin e Bobruisk-ut u iashkuan me me fuqitë t'ona kryesore. Në Bresinërn e mesme vashdojnë luftime të rreptë kundër sulmevet të paprerër të Sovjetëvet. Në perëndim të Polosk-ut, presioni armik vashdon. Nër jugëperëndim dhe në jugë të Polozk-ut, u shtynë sulme të fortë armiq ose u rrethuan. Aeropplanë të shumtë beteje muarnë pjesë, nër luftimet e tokës, dhe i shkakëtuan kundërshtarit humbje të rënda.

Në verin e sipërmë, në sektorin Pandalaschka, u shtynë shumë sulme armiq, të ndihmuar nga artileri e fortë ruse. Luftmet u shvilluan nër pyje dhe kundërshtari pati humbje të rënda.

Natën e kaluar, aeroplanë të veçuar englezë hodhën bomba në krahinën e Renanisë dhe të Westfalisë.

Angli, të erdhi dita e llogaris!

700 armiq të vrarë në një ditë

Në Bosnjën e mesme, një njëjësi e fortë çetash po perpelitet, e dëshpëruar ti shpetonjë rrethimit dhe asgjësimit prej trupavet gjermane, por më kot, se ajo humbi më se 60 të vrarë dhe 20 të robër e të arratisur. Armiku vuan tepër edhe për ushqim. Në një operacion shumëditësh prej një reparti policor në krahinën e Agrimit, çetat patën 254 të vrarë dhe shumë të plagosur. Shumë armë, 10 automobila, ashtu dhe 29 kuaj dhe disa krerë të tjerë bagëtish, ranë në dorën e Gjermanevet. Numuri i përgjithëshmë i humjevet të çetaveë, në Ballkanin veri' perëndimor, vetëm në ditën 23 qershor arrijti më se 700 të vrarë dhe 37 të zënë e të arratisur.

Një lodër e bukur e një baterije gjermane!

Në zonën Caen, një baterie kundëraerore gjermane i lojti armikut një lojdër të bukur: E ndihmuar nga padukshmënija e tokës, baterija në fjalë mundi të arrinte gjer në periferin'e nje fushe avjacioni. Me goditje të drejta dhe të befasishme, ajo çkatërroi, në tokë, 16 gjujtës armiq, u vuri zjarrin tunelevet dhe hangarëvet dhe hodhi në erë depon e municionit. Nër luftime me gjujtës kundërshtarë që kthehëshin në bazë bateria e sipërme rrëzoj edhe 7 aeropllanë të tjerë, kësisoj ajo u kthye në vënt pas si çkatërroj gjithsej 23 gjujtës anglo-amerikanë.

"Të kaluara dhe të plakura„

Nga lajmet e fundit mbi përdorimin e armës së re gjermane kundër Anglise jugore, është një zë që del nga Montreal-i ay që vlen të thëksohet; Si pas «Montreal Gazete», ministri kanades i municionevet, Hove, dyke çfaqur mejtimin e tij, mbi armën e re, ka thanë se ka mundësi q'ajo të sjellë një revulucion në të gjithë systemin luftarak. Ajo ndofta shënon fillimin e asaj kohe, për të cilën flotat aerore aleate të sotme do të quhen si "të kaluara dhe të plakura", pas si teknika, për të sunduar hapësirën, me këtë çpikje, mbështetet nër baza të reja.

Si qëndron puna ndër çetat Komuniste

"Kryetarët e çetave janë të frikshmë ner luftimet,,

Thotë një i zënë rob - "Rrojtje të mirë vetëm për Kryetarët,,

Që çetat gjendden me nevojë tepër të madhe ushqimi, nuk është më nonjë gjë e re. Munt të thuej, pra, se ato do të shkoniu pakë më mirë vetëm atje ku popullsija i simpathizon. Por edhe kjo nuk ngjet, se nër të tilla krahina ato janë të ndaluara të „rekuizojnë"; për veç kësaj, as populli nuk i ka aqë miq, sa t'ua japë, me dëshirë, diçka nga e pakta q'i ka mbetur.

Puna qëndron shumë më mirë për 'to nër ato krahina, ku ato bredhin pikërrisht si banditë të vërtetë. Këtu „rrëmbehet" pa një pa dy, çdo gjë që gjendet, pa lënë as therrime. Ko është jeta e drejte e banditëvet. Për oficerat dhe komisarët, natyrisht është një soj, ku do që ndodhen. Për krëta ka gjithënjë ushqim të mirër dhe, në rrast se nonjë nga të çetës s'e mban dot vehten, por bën non një vërrejtje mbi këtë gjë, të nesërmen nuk ngdhihet më i gjallë, e përpi nata! Kjo është Drejtësija ne Komunistët. Këto i thonë robërr të zënë, të cilët bënin pjes në të 17 divisionet komuniste dhe që më fillim të majit u dorërzusan nër trupat gjermane, në Bosnjën lindore.

Shëmbull guxim dhe trimërije ?

Si janë, vallë, në të vërtet, kryetarët e çetavet dhe komisarët, të cilët i futin të mjerët e rekrutuar me pahir, në zjarrin e trupavet gjermane? Natyrisht, këta duhet të jenë shëmbëll trimërije dhe kuximi. E mirë, pra, në të vertet, si thonë robërit, puna qëndron krejt ndryshe. Ja se ç'thotë, për shëmmbëll, një nga pjesëtart e Brigatës së V Vojvodina, i cili u zu rob, në funt të majit, në Bosnjën lindore: „Kryetarët, në pjesën e tyre më të madhe, janë frikacakë. Shumica syresh janë pijanecë. Ofecerët çmohen fare pakë prej ushtarërvet. Kryerarët nuk dalin kurrë në ballë, por rrinë nga herë prapa. Sër ketejmi i shtyjnë çetat në luftim dhe, kur është rrasti për t'u tërhequr, ata e kanë fare lehtë punën që të çduken. Kryetarët e kanë ushqimin të mirë dhe vishen mirë, kurse pjesa m'e madhe e anëtarëvet bredhin nrë lecka."

Kjo është vetëm një „shaka" nga ato që tergojnë robërrit mbi kryetarët e tyre.

Frikë nga bombat e veta

Bukarest. Pohimi i anglo-amerikanve se bambarduësat e tyne vetëm objektiva ushtarake gjuejnë, gjen përgënjeshtrimin e vet ma të mirë në sjelljen e robve amerikan të plagosun pë gjinden tash në tokë Rumune. Në nji spital të madh sikurse njofton gazeta Poporul pilotët amerikan qi gjindeshin atje pr mjekim gjatë mësymjes së mbrame terroristike t'ajrorve anglo-amerikan porsa digjuen zhurmën e sirenave u hodhën me vrull të egërt prej shtrentënve dhe kërkuan të çqetësuem nji strehim për mbroje. Me gjith se drejtori i spitalit me ironi u tërhoqi vërrejtjen tue u thanë se ata po gjinden në nji ndërtesë që ka siprit shenjat e kryqit të kuq e pra mund të dallohet mirë se asht spital kështu qi mbas sigurimevet të dhana prej kumandërs aleate nuk asht nonje objektivë ushtarake prap amerikanët nuk kanë qënë të kënaqun me këtë përgjegje se nuk e ndjenin vehten e tyne aspak të sigurt.

Trupat kroate u shkaktuan, në një ndërmarrje spastrimi, në zonën Daravar, shumë humbje të ra komunistëvet në ikje e sipër. Kështu u numuruan, vetëm në sektorin e një njëjësije, 65 armiq të vrarë dhe u zunë 9 mitraljoza dhe 28 pushkë.

Humbjet e numuruara të çetavet komoniste

Humbjet e çetavet komuniste, me rrastin e operacionit gjarman në Shqipërin e Jugës, për veç atyre të permëndura në kumtesën e dates 26 qershor, d, m. th, 3000 të vranë dhe 1098 robër, brënda tri javësh, janë edhe këto : u zunë 2 topa antitanks, 22 mortaje, dhe mitraljoza antitaksa, 2800 mitraljoza automatikë dhe pushkë, 2000 mina. Këtyre hnmbjeve u shtohen edhe ato të përmendurat në 14 qershor, që ishin 1100 kg. eksploriv, një ambulancë komplete me 30 shtretën, dhe depo shumë të mbëdha municioni.



Armë të rënda dhe skumë të rënda, të marra nga bombardonjës armig të rrëzuar. Këto do t'i bënin të pa prekshim ajroret Kundershtarë, por, si e shihni, ja, mbaruan në dorën e mbrojtjes gjermane!



Bomba? Jo, se s'munt të jenë kagë të shëndoshe ushtarët e shërbimit, sa t'i mbajnë mbi sup. Janë vetëm enë benzine për aeroplanë të rinj

Kapje të mbëdha municioni në Shqipëri

Në Sloveninë perëndimore u dërmuan, d. m. th. u asgjësuan, shume çeta të mbëdha armike, dyke lënë 40 të vrarë dhe sasira të konsiderueshme ushqimi dhe municioni. U zunë dhë shumë robër. Në Sloveni, çetat e shtërnguara keq, humbnë përsëri 50 të vrarë. Humbjet armike, në spastrimin e zonës Jelovar ngjiten gjer më 180 të vrarë. Në Sloveninë lindore, trupat gjermane të sigurimit shpërndanë një çetë të madhe, ku u numuruan soje 80 të vdekur dhe 815 pushkë të zëna. Në Shqipëri u zunë depo ët mbëdha municioni. Në Malin e Zi tru pa gjermane të sigurimit u shtynë përpara në krahinën e Bielopolje. Armiku humbi 55 të vrarë dhe shumë pushkë këmbësorije. Humbjet e çetavet arrijtën, më 26-IV në Ballkanin veri-perëndimor, në 560 të vrarë, dhe 50 robër, u zunë dhë 18 mitraljoza, më tepër se 100 pushkë dhe sasira të mbëdha municioni. Armiku humbi, brënda kohës 18 gjer 24 qershor, 2853 të vrarë, 150 robër dhe shumë të arratisun. Nër plaçkat e zëna u gjetnë 10 autoqerre me material mjekimi, një aparat radio trasmetues, 27 kuaj dhe 20 kafshë heqëse. Numri i armëve dhe sasija e municionit të kapur, brënda kësaj kohe, është me të vertet i rëndësishëm. Pesë aeropllanë armiq u përplasnë mbi Ballkanin eri-perëndimor.

Bombardohet dhe San Marino

Bombardonjës anglo-amerikanë kanë hedhur bomba të rënda dhe shumë të rënda mbi Republikën San Marino. Si dihet, kjo Republikë e vogël gëzon neutralitet, por anglo-amerikanët s'çajnë kokën për këso gjëra, kur se Gjermanët, as që i kanë cikur kufit' e Republikës.

Senatori i Shtetevet të Bashkuar, Tack, e thotë, hapur se Shteti amerikan po lufton në këtë luftë, vetëm për interesat e tija dhe jo për demokraci ose per lirin e besë, lidhurvet të tij.

Nje Llogari me Anglezët

Athene. — Gazeta «Proia» shkruan përsa vijon: kur na luftonim nër malet e Shqipnis të mbushuna me borë nuk kemi pam ndonji ushtar anglez ose pilot që të luftonte atje me ne veçse nër lokalet e dansit e nër kabaret e Athinës. Na i njofim ata nër lokalet e errëta të qytetit limanur e Piresë dhe i njoftëm sidomos atëher, kur me ardhjen e ushtarve gjerman ata filluen t'u jepnin kambëve. E kur gjatë dimnit tragjik të 1940-1941 me mijra prej gre këve vdiqën urrije, ata fundosën edhe barkën ma të vogël të dërgueme prej të tjerve me ushqime për kryeqytetin Na i kemi njofë ata nërsa arma ajrore e tyne shkatrroj Pirenë tue heth sa e sa nana e motra në vajtim e tue lanë sa e sa fëmijë jetima dhe gra të vah. A nuk jeni ju ata pyet gazeta që shkaktuat në vendin t' onë përçarjen dhe që krijuet bandat grabit-qara komuniste tue i ftue këto bënda të plaçkisin, të vrasin e të kryejnë barbarina të tjera e tue i sigurue bandat me përkrahjen t' uaj. A nuk keni qenë ju pra qi i inkurjauet bandat për vrasje, për plaçkitje dhe për çfarosjen e grekve të ndershëm sikur t' ishin këta bagëti. Na u njofim mirë dhe e dijmë, juve pa asnji të drejtë por me gjithë fuqi atdheun t'onë ia keni lanë në dorë kmunistave

Hapnit syt e vesht ju qorra e ju shurdha!

A e dini se, pa u mbushë tri javë që nga fillimi i pushtimit në loken françeze, kan gjetë vdekjen ma se 30.000, shpirtë vetem prej popullsis civile?

A e dini se, ma se dy të tretat e qyteteve ku bahet lufta janë ba gërmalla?

A e dini se, kush mshehet mbrapa skenës së tmerrshme të luftës? Me gjithë se jam i sigurt se e dini fare mirë po ju, a kujtoj edhë nji herër që të mos harroni se janë çifutnit!

A e dni se çka e shtyni Amerikën me i hye ksaj valle, tue sakrifikue qindra mija njerzish? T'i sjellin Francës qytetnim? Jo, se ajo nuk ka nevojë!

Lirin, vllaznimin e barabarsin? jo se jo, se, populli srançez e ka pasë „motto-n" e famshme: „Libertè, egalitè, fraternitè!"

Ku asht prà qellimi i vertetë i ksaj ndermarrje?

Liri, vllazni, drejtsi, e barazim ; thonë bombave të pà-rreshtuna, e, plumbave si si breshen që po lëshojnë gangstert e Amerikës, mbi popullsina civile pà mbrojtje; dhunimin e vashave të reja që i marrin me zor ndër kabarèt, që të defrejnë katilat e zgedhun; zhdukjen e sà e sà monumentave të kulturës së vjeter që sot nuk mund të zavendsohen ma, etj. etj. etj.?!

Besojmë se edhë qorri mund të shofin dhe shurdhni të ndigjojë, se qellimi asht krejt i kundert. Asht shkatrrimi i Europës, që të ngulin thojt njiherë e mirë. Asht filimi i komunizmit dhei çifutnizmit, të cillt po ferkojnë duert mbrapa skenës së tmerrshme!

Atà e androjnë me nji ander shumë të kandshme, por grushti i fortë që po i prel do t'ua qesin për hundëch, dhe koha u erdhi.

Lajme të ndryshmë

Në një mbledhje të "Nasjonal Samling, ministri norvegjes, Fuglelang, e përcaktoj si një nga detyrat më me randësi të Partisë, ndalimin e luftës dhe të bolshëvizmit në token norvegjeze,

Për t'i mbrojtur nga coprat e kundërajrorëvet të tyre, tashti do t'u çpërndahen, n'Angli edhe bujqëvet helme çelniku.

Qysh prej shpalljes se shtetit indipendent' janë çelur, në Kroati, 143 shkolla profesioni për rininë mashkullore dhe femënore.

Një zyrtar i lartër englez tha, si përgjigje të një korrespondenti svedes, se është një gjë e gabuar dhe e rrezikshme t'a përgënjeshtrosh elektin e armës ase re gjermane. Në të vërtetë, gjer tashti, nuk është gjetur një mjet luftimi kundër saj, dhe efekti moral, q'ajo bën në popullsin engleze, është i dukshëm.

Anglia ka sot vetëm aqë fëmijë sa kish edhe më 1876, kur numuri i popullsisë ishte gjysma e ati të sotmit.

Ja edhe „bonbons" të farmakosura !

Kohën e fundit, avja'orët anglo-amerikanë hothnë, mbi Serbi, kalem për të ngjyr buzët me fuqi të madhe plasëse, por pa i shkaktuar ndonjë dëm popullsisë. Kjo ua ka «marrë erën» peshqësheve të tilta. Tashti po përpiqen "liridashësit„ e njerëzimit të vrasin fëmijë të palajshëm, dykë hedhur bonbons më helm, kuklla të mbushura me eksplosiv, pena stillografike dhe sahatë po me lëndë lartësisht plasëse,

Për të qeshë

8 ditë me radhë në kino.

Agimi s' e kishte pà shokun e vet Sazanin nji javë me rradhë, dhe së fundit e takon dhe i thotë: - Ku je morë që së të kam pà kaq kohë?

Sazani: - Në kino.

- Çdo mbramje në kino?
- Po.
- Po at film?
- Po.
- Nuk u merzite?
- Jo ishte një film shumë interesant. Ishte nji liqë i bukur, në ranishten e tij po çvesheshe nji vajzë e bukur. Shì n' at moment që po çveshte pjesen e fundit të robave, kaloi nji tren, dhe vajza nuk shifeshe ma. Mbassi kaloi treni, vajza u pà rishtas, por mbrenda n' ujët.
- Sa për kaq or Sazan nuk kishe nevojë m' e pà filmin 8 ditë më rradhë.
- Sa kokë trashë që je, un prita që të vonoheshe treni disà minuta, por për fat të keq . . . . aj dreq vinte pikrisht po n' at sekond.

LIRIJA E SHQIPNIS

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Ejte 6 Korrik 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 6 - ÇMIMI 1 LEK

Përgjigje ulërimës engleze

për hakmarrje kundër Armës së re "V 1,,

Pas si efekti dërmonjës i armës gjermane "V. 1.,, nuk po fshihet dot më gjithë orvajtjet dhe ndalimin e përhapjës së lajmevet përkatës nga qeverrija e Llondrës. dhe pasi madhësija e shkatërrimevet po bëlet gjithënjë m'e njohtun. shtypi engles nxjër një ulërimë hakmarrjeje kundër përdorimit të kësaj armaje gjermane. Këta artikuj, që janë aqë pa vënt, sa munt të thuhet se janë shkrojtur prej të marrësh. nuk meritojnë përgjigje të veçantë. Pikëpamja gjermane në këtë pytje vendimtare është e kjartë; Pyetjes në se duhet të konsiderohe. si objttva nshtarake. edhe Kishat, spitalet, banesat civile dhe. në se duhet të goditen, si të tillë, edhe objektet artistikë dhe kështjellat. Englezët iu përgjiqnë me "po,, me luftën e tyre ajrore jo vetëm kundër Gjermanisë, por edhe kundër Evropës së terë.

Ministri engles i ajrit dhe ay i Shtetevet ë Bashkuar e kanë thënë hapatzi që duan 'a "shajnë,, popullin gjerman. Ditë për ditë bëhen sulme ajrore mbi qytete të mbedhenj evropjanë q'e vërtetjnë këtë pikëpamje. Edhe vetë në Francë po të flasim me „Manchester Guardian" të datës 16 qershor avjatorët anglo-amerikanë qëlluan ndërtesat më të famshme dhe i bënë hi krahina të tëra benimesh punëtorësh;

Pikërisht kjo mënyrë luftimi do të përdoret tashti edhe kundër Anglisë.

Anglezët janë, pa dyshim. populli më brutal i botës. Në luftë, ata nuk njohin as një sentimentalit. por vetem atë, si e thonë vetë, „dërrmim je rrufesh me". Po këti dërmimi munt t'i përgjigjemi vëtëm me dermim.

Gjermanija nuk e ka dashur luftën ajrore kundër popullsisë civile. Por ngjau ndryshe. E tërë Evropa është një dëshmonjës i tmershme i asaj që Englezët kuptojnë për humanitet. Edhe sikurse tërë Anglija jugore të ktheqej në hi e pluhur, si përgjitje, prapë hakmarrja do të që e butë. Por „plaçka" e Vansittard-it do të paguhet po me një monedha si ajo e tija: kjo është përgjigja. Në se Anglezët ullërijnë, aqë i bën Gjermanisë. Qeverrija gjermane nuk dëgjon ulërimat engleze, por ikujen e e gravet dhe të femijëvet, që i kanë humbr të gjitha nga poshtërsitë engleze. Ajo nok interesahet për çfryrje inati kundër Englezëvet. por vetëm për zëmërimin e drejtë të popullit gjerman.



Prodhimi gjerman për Tankse
s'ka qënë kurrë m'i math se sot

Trupat e invadimit kanë humbur 195 000 veta

Gjendja e përgjithëshme e luftës, pas katër javësh invadimi - Reservat strategjike gjermane krejt të pacënuara

Gjendja e përgjithëshme evropjane e luftës, në fillim të javës së pestë t' invadimit dhe në mbarim e sipër të javës së dytë t' ofensivës së Lindjes, shënohet nga ngjarje, të cilat do të jenë të njëj rëndësije të madhe për sa i takon shvillimit t' arthshmë të konfliktit ushtarak: E para, katër javë invadim nuk muntnë të përbënin. në perëndim, një front të dytë të efektshim kundër Reich-ut. Kjo gjë bëhet e kjartë, po të mejtojmë se në ç' pozitë gjendej Komanda eprore gjermane, në verë të 1917. dhe se si do të ishin gjykuar athere fatet e Reich-ut, po të kish patur, si front, jo vijën që nga Svicra gjer në Detin e Veriut, por vetëm ngastrën e ngushtë të frontit anglo-amerikan në bregdetin normandës. Katër javë invadim i kanë kushtuar Montgomery-t, në të vrarë. të plagosur dhe të zënë rob, afro 195000 vetë, që janë më tepër se gjashte divisione këmbësorije ose të motorizuar. tre divizione parashutistësh ohe më se dy divizione panzer. Kësaj humbjeje i shtohet akoma edhe një tlotë e tërë Kryqëzorësh. Kundërtorpitonjës dhe anijesh transporti që, të grumbulluara në funt të kanalit, tregnjnë një sakrificë. fitimi i së cilës, në krahasim me gjen ljen, është krejt problema. tik. aqë më tepër, kur dihet se, nga ana gjermane, është bërë mbrojlja. gjer sot, pa pjesmarrjen e asnjëj bataljoni të vetëm nga rezervat luftaruke të Rundstedt-it.

Vetëm nga ky fakt munt të përfundohej që, gjer tashti, xhvillimi i betejës s'invadimii nuk ka kaluar. as një metro, m'at'anë vijës s'efektit t' artileris detare anglo-amerikane. Ky xhvillim le të hapura një vark pyetjesh që do të donin përgjigje, po të donim t'a quanim ndërmarrjen si të kryar. Përkundrazi, ajo, gjer t'ashti, ka dështuar krejt. Kjo munt të konstatohet me gjith pregatitjen për vepërim të afërme të armatës "Patton,, që ndërkohë po imbarkohë n'Anglinë jugë-lindore. Rëndësinë e keti konstantimi do t'a tregonjë faza e dytë e invadimit, e cila është në fillim e sipër.

Ofensiva sovjetike e verës. me një epër' si trupash dhe materiali. ka patur pa dyshim, disa fitime toksore, të cilët, sigurisht, meritojnë të ndiqen me kujdes. Por është e ditur prej të gjithve se komanda gjermane, nga vështirësija momentane e gjendjes në ballin e mesme të Lindjes, nuk i largohet as pak planit të saj të përgjithëshmë dhe se ajo, me ç' humbet andej këtej në vijat e jashtme, forcon themelin e mbrojtjes lindore. Se, në luftë, nuk vendos kurrë shumica, por aftësija; veç kësaj, duhet të merren parasysh edhe cilat mundësi do t'i jepen Gjermanisë. me përdorimin përkatës armësh, të cilat armiku i saj ëdhe nuk i njeh

Katër ditë e katër javë

Lufta për Cherbourë-un, që, për Anglo-amerikanet, një ecje drejt thertores, gjer nër sekundërn e fundit. Beteja në sinisinë Cotentin u kushtoj, kundërshtarrvet të Gjermanis, shumë më tepër njerës dhe material, nga sa kishte parashikuar Montgomery nër llogarit'e tija. Kurse sot njër gazetë amerkane pohon se sudhesa e Cherbourg-ut është vorreza e rinisë amerikane, d. m. th. atje përtej kanë filluar t'a Kuptojnë se sa po u kushton ndërmarrja e invadimit.

Si pas dokumentavet të rënë duart e Gjermanevet, provohet haptazi se Montgomery donte t'a pushtonte sinisinë Cotentin dhe Cherbourg-un n ër4 ditë. Ay i gjikonte fare të mjaftuarshmë 10 divisione pr këtë pushtim. Por çingjau në të vërtet? Humbjet e rënda që i shkakëtuan armikut trupat gjermane, në këtë luftim, e shtrënguan kundërshtarin të futnjr, në fushën e luftës, reserra gjithënjë më tepër. Montgomery që i detyeuar t'i hithte, në luftë, të gjithë grupet e ushtëris sër tij, midis këtyre edhe ttrupat e xgjedhura, të cilat ishin paracaktuar për qellime krejt të tjerr. Dhe këto pësuan humbje të pallogaritëshme.

Le të merret parasysh kjo: shumë nga këto njëjësi, që përbëjnë më të mirën e ç'ka kish në dispozicion Komanda armike për invasionin, qenë të shtrëngura, nga humbjet e rënda, të tërhiqëshm për t'u plotësuar, por edhe reservat e tyre u harxhuan. Dhe të gjit ha këto ngjanë nër luftime, të cilët ana gjermane i sish shënuar, që në fillim, vetëm si hyrje të betejës së madhe decisive të mëvonëshme. Ky harxhim conrm dhe kreiit i paparashikuar fuqish armike, do të ndjehet, në tërë peshën e tija, athere Kur Gjermanët do t'i përvishen luftës deci sive.

E ç'fitoj, vallë, kundërshtari me humbjet e tija kaqë të përgjakëshme? Një skelë të rrënuar gjer në themel, së cilës i mungon çdo gje e dobishme që armiku do t'a nevojitte për vashdimin e planevet të tij. Rindrejja e hëpërhëshme e kësaj skele kushton prapë shumë humbje kohe. Por pikërisht koha është ajo q'i mungon më tepër Montgomery-t. Afatet e premtuar Stalini-t nuk u vertetuan në as një vënt. Kësisoj u shkakëtua vonimi i ofensivës verore sovjetike. Planet që caktonin kohët nër vepërimet e kundërshtarëvet, tashti janë bërë lesh e li.

E tëra kjo rrodhi nga fuqija shëmbëllore luftarake e trupavet gjermane në sinisinë Cherbourg. Por ky vepërim i këtyre trupave është vetëm fillimi i asaj që armiqtë do të shijojnë akoma në Evropën perëndimore. Për popullin gjerman, për kundrazi, rrjedhimet e luftimevet të Cherbourg-ut janë një vertetim i ri epërsisë ushtarake të tij, e cila do të siguronjë fitimn.

Mjaft me vllavrasje!

Shqiptarët e lir i apin shqelm zgjedhjes bolshevike!

Mbas grushtit të fortë që paten çetat bolshevike të Mehmet Shehut në Shqipnìn e jugut prej trupave gjermane, shqipëtarët lirìdashës kan së fundit rastin, me u çkëputë prej prangave bolshevike të trathëtarve t'Atdheut.

Nji kryetàr çete shqiptàr prej Frashërit, kaperceu me 10 veta me gjithë armë n'anen e gjermanve. Perveç ksaj priten n'Ersekë edhè 75 veta të tjerë po të këtij grupi. Edhè Riza Kodheli dishron të kapercejë nder radhët e luftëtarve të ndershëm të liris së Shqipnis me 300 veta.

Atà që duen Atdhèn e vet Shqipnìn u zgjuen tashma. Shqipëtarët e kuptuen se janë të rrejtun prej propagandave t'axhentave anglo-amerikan, sovjetik e ato të trathtarve të Badoglios, që i mbajten në rrugë të gabueme nder malet me muej. Tash kan kuptue edhè atà se, miqt e vertetë të Shqipnis janë vetem ushtarët gjerman.

Koha asht e aferme, në të cilen shqipëtarët e ndershëm do të lirohen prej marris nderkombëtare. Atà do të luftojnë së bashku me fuqit e armatosuna gjermane per bashkimin e lumtënin e Shqipnis. Gjithë ushtarët gjerman kan per t'i pritë e për t'i pershndetë vllaznisht, se atà e dinë se. shqipëtarët janë terheqë vetem me forcë nder çetat bolshevike.

Ndiqni shembëllen e vllazenve t'uej në Frasher e n' Ersekë! Prindt, gràt e fmijtë e juej presin pà durim që vllàvrasja të marr fund pa tjeter.

Avjatorë amerikanë vriten nga partizanët

Para disa ditësh, një Bosnjak, i rekrutuar me pa hir nga Partizanët në krahinën Tuzla, mundi të arrëtisej syresh midis Sarajevos dhe focas.

Nder të tjerat, ay thotë se, më 6 mars 1944, pesë avajtorë amerikanë u hothnë në jugë të focas. nga maqina e tyre e dëmtuar. Ata ranë në duart e divisionit të 17 komunist. i cili i mori rob. Pas si çfaqnë dëshirën të dorëzohëshin ne Draza Mihajlovic, me urdherin e një komisari politik. u puhkatuan që të pesë

Trupat gjerman po u japin bandavet gjithënjë grushte të rëndë. Kësisoj, në krahinën e Bosnjës lindore, me rastin e nje ndërmarrjeje të vetëm e spastrimi, armiku humbi 1630 të vrarë sigurisht dhe 1100 të llogaritun si të tillë.

Të zënit rob thotë se armiku përpiqet t'i mbulojnë humbjet e tija të rënda, dyke i ërhequr të vrarët e të plagosurit.

Luftë ndër malet e Shqipëris së Jugut

Një grusht i rëndë çetavet komuniste të Mehmet Shehut - Vlefta e granatierve dhe alpinistëve

Më 16 qershuer, zyra gjermane e lajmevet njoftonte vetem disa episode nga një ndërmarrje e madhe gjermane kundër çetavet komuniste në Shqipërin' e Jugës.

Tashti K. e N. e F. I' Armatosuna njofton përfundimin se, brënda tri javësh luftimesh të rëndë, cetat komuniste u çkatërruan. Armiku, përvec shumë robrish, armësh, municionit dhe depo ushqimi, humbi edhe më tepar se 3000 të vrarë. "LIRIJA E SHQIPNIS,, po boton këtu poshtë, përshkrimin e një korrespondenti luftarak, i cili mor pjesë nër luffimet e përmendur.

Nër malet madhështore të Shqipëris, ashtu dhe në zonën limitrofe të tokës greke, ishin përqëndruar çeta komuniste, të udhëhequra prej Mehmet Shehut. Të ndërsyera nga agjentë englezë, të paguara me ar e argjent, kundër atdheut shqiptar dhe interesavet të keti, të fornizuara me armë, me material dhe me sende ushqimore nga burrimi i huaj, këto çeta patën proklamuar edhe një "Republikë sovjetike në Shqipërin e Jugut,, dhe Mehmet Shehu nuk ish ndrojtur t' a shkelte boterisht, Flamurin e Skënderbeut me shkaben dykrenore dhe t' a zavëndësonte atë me shënjat e Moskës.

Forcat nacionaliste dhe fuqit qevëritare nuk mund t'i bënin dot ballë kësaj lëvizjeje, prandaj ndërhymë në.

Brënda, atje midis Shqipëris së Jugut ngrihet, sundonjës, Tomori plak Ky përbën një vark të gjatë, maja m' e larlër e të cilit arrin në 2480 metro,

Në rrathë të ngushtë e të gjerë, mali vështillet prej grupesh luftimi të një divizioni me qender në Shqipërin e Jugut, dhe ziren grykat. Për këtë, u bënë edhe përpjekje, por, kudo, këta grupe luftimi, me goditje të shpejta e të rënda, e hapnë rrugën. Armiku dukej vetëm nër sulme të papandehur dhe i largohej luftës së hapur dhe serioze. Por që në fillim, e tregoj ashpërsinë dhe zëmërimin e tij. Pikërisht kjo u pëlqeu edhe trupavet t' ona që, në dridhje nga sa po zhvillohej në frontin e invadimit, donte të çfrynte, njëkohësisht, edhe tërë urrejtjen e saj, dhe si duhej, kundër Bollshevizmit dhe rrogtarvet të saj trathëtorë.

Në krahët dhe midis grupevet gjermanë, mernin pjesë, me kënaqësi dhe krenare edhe ugi qeveritare e nacionaliste, për të udhëhequr e për sigurim. Këto forca luftuan trmërisht. Bataljoni shëtitës i Korçës solli, që ditët e para, disa qindra robër dhe t'arratisur.

Po t'a përmbledhim, shkurtër, shvillimin e kësaj ndërmarrje, na jepet ky përfundim :

1) Nëdrmarrja tregoj gjallërinë e iniciativës gjermane në Ballkan.

Sapo pas grushtit, plot sukses, që iu dha, në Bosnjë, "Kuartierit të D." të Kryekomandantit Josif Broz, ja edhe një goditje e forte Mehmet Shehut, këtij të shituri nër Bolshevikët dhe ndër Englezët. Përqëndrimi i çetavet në Shqipërin' e jugës u shpartallua.

2) Luftimet e verës, nër malet e Ballkanit, provuan së ushtari gjerman i trëmbet aqë pakë "Gjeneralit Behar,, sa iu trëmp' edhe "Gjeneralit dimër,,

3) Sasija a humbjevet të çetavet komuniste përbën, për 'to, një dobësim të ndjeshmë nër luftëtarë, në armë dhe në material tjetër. U çkatërruan depo dhe qendra të shumta. Organizata e çetavet dhe ndërlidhja e tyne me agjentë të huaj u këput dhe të paktën për kohësisht, u çkatërrua.

4) Bashkëpunimi ynë me forcat nacionale shqiptare u krye në mënyrë të kënaqeshme. Ky bashkëpunim do t'i japë funt përçarjes politike të popullit shqiptar dhe kundërshtimevet të kota, që arrijnë, afro gjer në kaos ashtu si shtyhen dhe yshqehen prej agjentëvet të fuqivet armike. Bashkëpunimi ushtarak gjer mano-shqiptar për lirin e Shqipëris dhe për spastrimin e Evropës, nga fuqi jo evropjane, do të këtë një efekt të frutshëm dhë do t'u japë kurajo dhe hof Shqiptarëvet të vertetë dhe q'e duan Atdhaun e tyne me gjith shpirt.

590 kalori në ditë

Urrija n'Italin e Jugut

Përmbi gjendjen e vërtetë që sundon n'Italin e Jugut të pushtueme prej anglezve dhe amerikanve njofton nji korrespondent i gadetës së Londonit Dayly Telegraf. Në këtë njoftin thuhen nërst të tjert kërto: Prej kamioneve aleatë me mjira tonelata gjanash ushqimore vidhen prej italianve dhe shiten në tregun e zi me 10 deri me 70 fiskin e çmimit të tyne normal. Vetëm në Napoli ndodh përdita që 80 rasa të tilla të paraqiten në gjyd sado që numri i të akuzuemve asht shum ma i madh. Natyrisht kjo gja shkaktohet për shkak të mungesës së gjanave ushqimore n'Italin e Jugut, munges që rjedh edhe prej vështirsive të transportimit. Racioni ditor që marin banorët e Italis së Jugut në buk asht 28,5 gram bukë. Dy herë i u asht ndah atyne voj më muajin Dhetuer e Mars. Ata marin për çdo 10 dit nga 8 gram sheqer, 8 gram mish dhe 3,5 gram bizele. Kështu sasija ushqimore që u takon kap 590 kalori në ditë. D. m. th. me 1000 kalori ma pak se sa nevojitet për jetesë. Përpara pushtimit t'Italis së jugut populli merie nji sasi ushqimore prej 1378 kalori në ditë. Masi në London e në Washington besonin se n'Italin e jugut populli në bazë të bujqësis ka mundësi t'ushqejë yeht-vehten, autoritet ush tarake të administratës kishin marë udhëzime që të vinin dorë sa ma tepër mbi mjetet ushqimore t'importueme. Mirpo gruni i prodhuem n'Italin e Jugut nuk mjaftoj për ushqimni e popullsis civile kaq sa gjatë vitit të kaluem u pa nji deficit prej 30-deri në 50 mijë tonelata grunë. E po të marim parasysh mungesërn në mjete të transportit atëher qytetet nuk kanë sesi të furnizohen me pemë e me zarzavate. Edhe për punër të ndarjes së miellit për racionin ditor të bukës paraqiten vështirsina të ndryshme. Dhe këto vështirsi shtohen edhe kaq ma tepër sepse bujqët e shumtë prodhimet e tyme i mbajnë për me i shit në tregun e zi. Kërshtu këta në tregun e ki shesin nji liter voj për deri në 720 lireta në vend që t'a shesin këtë tek autoritetet e administratës civile për 30 lire, po ashtu kanë ma tepër dërshirë ta shesin kilogramin e grunit për 200 lira sesa për 3.— Çmimet kanë hyp kaqë nalt sa nji puntuer për ushqimin e çdo pjestari të familjes së vet duhet të ketë së paku 50 lira për ditë.



Përpara përfaqesonjesvet të shtypit galicianë t'arratisur tregojnë tmerin dhe zinë çfi solli bolshevizmi vendit të tyre

Ndërmarrje spastrimi prej repartesh kozakë

Në Bosnjën lindore, trupat e thyera të të Divizionit të parë proletar u sulmuan dhe u çpërndanë me humbje fort të përgjakëshme. Disa grupe të vegjël, në krahinën Bojnica u shtrënguan të luftojnë, por humbën 80 të vrarë, shumë robër dhe t'arratisur. Reparte kozakësh, gjatë një vargu ndërmarrjesh spastrimi, u shkatuan çetavet, fort të goditura që më parë, edhe të tjera humbje të mbëdha. Kësisoj, vetëm më 27-6 - komunistët patën 108 të vrarë. U zunë 7 mitraljoza dhe shumë pushkë Ndërmarrjet e spastrimit, në Malin e Zi veçanërsisht në luginën Lim, vashdojnë me sukses dhe çetat u thyn keq, dyke humbur më se 40 të vrare. U zunë shumë armë dhe municion: Bandat humbën më 27 6 në Ballkanin veri-perendimor, 235 të vrarë dhe 30 robër e t'arratisur. U zunë shumë mitraljoza dhe një numur i math pushkësh.

Për të qeshë

Majori me ordinancin

Majori : - Petrit, nesër do të mbsem herët, mos harro të më zgjosh n' orën 4 nëmëngjes.

Ordinanci : - Si urdhënon, zotni major, mjafton t' i bini zylës e do të ju zgjoj menjiherë.

Preokupime ujë wisky

Paralajmimet e vazhdueshme të burravet të shtetit dhe të ushtarakve të naltë amerikanë, në lidhje me invadimin që shtetevet e Bashkume do t'u kostojë të paktën në 500 000 veta dhe se në 1 milion familje do të vendoset zija, kanë shqetsue shumë gratë, nënat dhe të fejuemet e ushtarëve të invadiimt. Me qindra e mijra nga këto gra të preokupume i kanë drejtue letra të shoqes së gjeneralit t'invadimit Eisenhover. Të gjitha këto muaren nji përgjigje nër gazetë në të cilën ftohen të kenë shpresrë e besim ndërsa burrat e tyne n'Angli pregatiten për betejën ma të madhe që përmend historia. Po nër çka të besojnë? në fatin e verbët apo në t'ardhmen nërn diktaturën e nji burri i cili përpara pak vjeteve u betue se asnji ushtar amerikan nuk do të luftonje e të vdesë jashta ardheut. Në lidhje me besimin që këshillohen të kenë të tjerërt tregohet nji anekdotë që qarkullon tash për tash në Washington dhe të cilën gazetari Don Iddon e publikoi në gazetën „Dayly Mail". Kjo anekdotë i drejtohet Roosveltit, që asht kaq i pa besushëm e frikac, sa, kur udhton, mer ujër me vehte për të pim. Ai ka frik se mos e helmojnë, sado që asht rethue prej nji grupi dedektivësh që e përcjellin me qerre t'armarosuna dhe t'armatosun deri në dhambë. Prej këtij uji që mban me vehte i ofroi Roosvelti edhe Churchillit në Teheran. Mirpo Churchilli refuzoi të pijë ujë se ujët për të nuk asht pije, ai pi vetëm Whisky.

Besnikërija e Finlandës

Kryeministri finlandes, Linkomies, mbajti një fjalim në radio, në të cilinin ay theksoj, veçanërisht, se Finlandija u gjent përpara dilemit a të pranonte kapitulimin, që do t'a hithte vëndin tërësisht në prehërin e armiqvet për vdekje, a të qëndronte me anën gjermane gjer në fitoren. Ky vendim i fundit që velvetiu i kupturarshmë për popullin krenar finlandes. „Esht'e natyrës shme" vashdoj Linkomies, që né, dyke pranuar ndihmën gjermane, të mos merremi njëkohësisht edhe me mejtimin e mbarimit të luftës. Këtë e ndalon kryekëput, nderi, të cilin populli finlandes ka ditur t'a ruanjë ndofta m shum se çfo popull tjetër në botë.

Lajme të ndryeshme

Lumi "L I M,, varri i Komunistëvet

Me gjith përmbytjen e Limit, q'é vështirësoj ndërmarrjen t'onë për spastrim, ndjekja e çetavet, të godiutra rëndë që më parë, u vashdua si pas planit. Shumë cetaushtrënguan aqë teàër, sa umbytnë gjer në vetën e fundit.

Episkopi i Spalatos kundër Komunistëvet

Në një fjalim të mbajtur me radio, Pishkopi i Spalatos, Dr. Kelemns Theodor Bonifacis, ua hoqi maskën nga fytyra gjakpiërsvet komunistë, që shitëshin si nacionalistë. Vetëm në Dioqezën e Spalatos, tha Pishkopi, janë vrarë 19 fetarë katholikë prej Komunistëvet.

Çetat komuniste në shpërndarje e sipër

Gjendja tepër e vështirër, në të cilën ndodhen çetat komuniste në Ballkanin veriperëndimor, po shkakëton çpërndarjen e shumë grupeve syresh.

I kapuri rob Jovan R. prej B i n g u l a (Bosnja veriore) që thotë këto, shton edhe se desertimet e përditëshmë në divisionin e tij janë barazi me çpërndarjne e vetë çetës.

Muhamedanët kundër terroristëvet komunistë

Komunisti i kapur Petar N. nga S e m l i n, thekson, në tregimet e tij, kundërshtimin gjithënjë më të fortë që vëndet myslimanë u bëjnë sulmevet komunistë, dyke mos u trëmbur edhe athere, kur çetat përsiqen t'a shuajnë, me mënyrat më të përgjakëshme këtë dëshirë vetsundimi të Muhamedanëvet.

L ënda e humbur nga çetat e Shqipëris Jugu

Gjendja e çetavet komuniste, në Shqipërin'e jugës, është vështirësuar, së tepërmi, nga humbjet e rënda në material dhe municion, mungesë kjo t'e ndjen é tërë organizata. Humbjen më të rëndë çetat e pësuan në kapjen e katër depove municioni me 40000 fyshekë infanterije dhe në atë të njëj depoje me veshmabthje.

Prej viseve të pushtueme prej Sovjetve Gjuetija mbi vajza!

Në katundet e pushtueme prej sovjetve në Rumani, Badeni e Feradau (në relhet e Jassy), ushtarët e dejun sovjetik u lëshuen lirishtë mbi vajzat e reja, tue i shnderue perdhunisht. Të katër vajzat të katundarit të quitun Gheorghe Ungureanu prej Badenit prej moshës 17-22, u vranë mizorisht pre sovjetve për shkak se u kundershtuen vepres shtazore të tyne. Të katër kufomat u lanë në kopshtin e shtëpis të katundarit, së bashku me tre derra e nji viç të citet ushtarët i kishin vra prej inatit.

Ankime të këtij rastit na vijnë prej vise-se të shumta ku shkel kamba vdekjepuese e sovjetve.

Dekorime marinarësh japonezë në një bazë kineze.

LIRIJA E SHQIPNIS

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Hënë 10 Korrik 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 7 - ÇMIMI 1 LEK

Teknika e Gjermanis do t' a benjë punën e saj

Konstatimet e Fuehrerit mbi revolucionin e teknikës ushtarake

Shtypi gjerman mban akoma në dukje fjalimin e Fuehrerit me rrasti e mbledhjes së ekspertëvet gjermane të armetimit. Shtypi në fjalë thekson m tepr rënëdsin'e posaçme të fjalëvet të'tija për sa i takon revolucionit të shkakëtuat, në teknikën luftarake, me hyrjen në vepërim të armës s re „V 1". Konstantimi i Fuehrerit që aftësija çpikëse gjermane është gati t'a rivendosnjë përsëri btllancimin teknik dhe kshu të krijonjë kushtet, për t'a Kthyer, një her'e mirë, timonin e luftës, përbën pikën kryesore të konsultimevet. Gjer sa të arrihet kjo pikë, populli gjerman do të duronjë me këmbëngulje, dyke luftuar dhe duke krijuar. Aftësisë luftarake të ushtarëvet të tij dhe aftë sisë çpikëse të teknisienëvet të tij, ay u vë për krah besimin në çeshtjen e tija të drejtë dhe besimin në drejtësin e „sethënës". Nga thellësija e këti burimi i vjen fuqija të matnjë çdo ditë, të kryenjë çdo detyrë dhe të bënjë çdo sakrificë. Po nër këto ditë, kur Anglija është plot grrindje mbi armën e re gjermane „V 1". dhe kur ekspertë ushtarake englezë duhet të pohojnë se edhe armët e tjera gjermene të vëna në përdorim kundër armatës s'invadimit janë më të mira se ato anglo-amerikanet, Fuehreri u foli shefavet t'armatimit gjerman. Ay s'i vuri fort kujdes peshës së fatit të luftës gjermane, por e pohoj si të vetkuptuarshme që Gjermanët nuk do të kapitulojnë përpara asnjë vështyirësije dhe shprehu sigurimin e tij pa Kushte të mbeshtetur në fuqinë shpirtërore dhe nër planet e tyre, se ata do t'a kalojnë këtë kohë dhe se më së fundi do t'a fitojnë luftën. Dyke u marrë me pohimin e kondëradmiralit amerikan Batsh, si pas të cilit Gjermanët kanë çpikur një mënyrë të re luftimi, ku nuk përdoren më njerës, por vetëm material, dhe se Gjermanët, me përdorimin e një tanksi të vogël automat, kanë bërë përparime të dukëshmë në teknikën luftara ke, një gazetë shënon se fjalimi i Fuererit koincidon me nj pikë kthimi në teknikën e luftës. Me vumjen në përdorim të armës së re „V 1" u hoth çapi i parë. Gjatë vitit 1944 gjendja teknike e luftës së Gjermanis do të vejë gjithënjë dyke u përmirësuar dhe avantagi teknik, që tashti gjenget në anën gjermane, të cilin nuk e mohon dot asnjeri, do të arrinjë vleftën e tija të plotë.

Moska kerkon çpallje lufte

Fletoret moskovite kërkojnë, prej Shtetevet të Bashkuar, si rrjedhim të fundit të prerjevet të marrëdhenjevet diplomatike me Finlandinë, edhe një çpallje lufte. Nuk mjaftuaka, kurrsesi, që amabshadori amerikan në Finlandi t'a quanjë këtë vënt si armik dhe që Shtetet e Bashkuar t'i presin marrëdhenjet e tyre me Finlandinë. Jo, Amerikanët duhet t'ë luftojnë Finlandëme „armë në dorë".

Mbrojta e njëj të akuzuari

Deklarata e Churchill-it, mbi armën gjermanë «V. 1.», i ngjet «përpelitjes» së kotë të njëj të akuzuari të zënë ngushtë përpara gjykatësvet të tij. Edhe afati t «mëshirshmë» prej dy ditësh, që iu akordue prej Dhomës së Komunevelt, për deklaratën e tij të caktuar per të martën, nuk i mjaftuan, Krzeministri englez, për të paraqitur diçka të re në «fushën e gjerë të diskutimevet», si e tha ëdhe vetë,

Që karakter stik për gjendjen shpirtënore t' irrituar të populltit englez, mundimi i Kryeministrit t' a mbronte, me një thes fjalësh, taktikën e tij të heshtjes dhe të fshehjes të së vërtetës, per sa i takonte efektit të armës së re gjermane, passi, vetëm të martën, kish pritur Eden-i, po në Dhomën e Komunevet, sa e sa rromuze dhe akuza për Churchill-in. në lidhje me këtë heshtje dhe fshehtësi,

Munt të imagjinohet lehtë se sa keq duhet të ketë mbetur Churchilt-i dyke pohuar mos-suksesin e mundimevet britanikë, të cilët kishin për qëllim te asgjasonin, me bomba, bazat e pandehshme t' armës «V. 1.» Por, pas si ay u ndoth, më përpara këtyre pohimeve, s' kish ç' të bënte tjatër, veç se të thosh, me një frymë, se mundimet e përmëndur kishin kushtuar humbje të mbëdha, Kjo nuk që nonjë gjë e re për Gjermanët, se ata i dinë, me saktësi, dëmëri kolosale t' Aoglo-amerikanëvet në aeroplanë dhe personel fluturimi, Por ç' far efekti do të ketë bërë, vallë, ky pohim ndaj popullin englez, i mbajtur në siguri me anë përphkrimesh të papërgjegjëshmë dhe me lojdra kriminale numurash,

Për të kapërxyer vështirsin' e gjendjes së tija, Churchill-i xgjodhi, si rrugë shpëtimi gënjeshtrën e turpshme se, gjoja, pa sulmet terroriste mbi Gjermaninë dhë Francën, zjarr i armës së re gjermane, mbi Angli, do të kish filluar që më parë. Nga anë të rëndësishme gjermane është theksuar, dëndur, se një shpagë, për sulmet terroriste anglo-amerikanë, nuk yshqehej prei nonjë ndjenje gjakmarrjeje, por masat që po merreshin, do të vireshin në përdorim në çastin që do të sillte një decision të luftës. Dhe ky rrast u dha, kur invadimi n'Evropën lindore, qënë shvillim të plotë. Me këto genjeshtra të, Churchill-it, për vonimin e përdorimit të armës "V. 1", nuk duhet të ngjallet një qetësim për Englezët, se, si po merret vesh, ka akoma edhe mjaft kohë për të plotësuar ç'u fillua, më 16 qershor, me përdorimin e kësaj arme

Pohimet e Çhurchill-it munt të shënohen si të vlefshme, vetëm se këtu bëhet fjalë për një çështje që ka mundësi të nxgjatnjë edhe shumë kohë.

Në mënyrë krejt të veçantë, që karakterisitk theksimi i Churchill-it mbi pamjaftësin'e gjertashme të masavet mbrojtëse për populsinë engleze, të cilën ay deshi t'a justifikonte dyke thënë se, për masat në fjalë, nuk duhej të pësonin vepërimet luftarakë në Normandi dhe sulmet terroristë mbi Gjermanine,

Në se ay deshi t'a mohonte efektin dërmonjës të armës "V. 1" mbi objektivat ushtarake rëndësijë të jashtëzakonëshme, qytetet plot me lëndë fornizimi n'Anglin jugore, dhe Londrën e kthyer në arsenal, shvillimi i paskëtajmë i ngjarjevet do të na mesonjë se në ç'këmbë të dobëta mbeshteten pohimet dhe planet e tij. Tashti nuk është koha e fjalëvet dhe e dredhivet, tashti vepërohet. Dhe, që këtë radhë Gjermanija vepëron me themel, duhet t'i mbushet koka Anglisë.



Bombahedhës gjernan me bazë tankësi

Luftëdashesit per qark Churchill-it u gabuan

Koha e fituar me Kredharakët, çfrytësohet nga teknika gjermane

Vetëm një karhasim i jashtmë midis marines luftarake gjermane dhe flotës anloamerikane munt të mos merret parasysh Se, për sa u takon luftimevet në det, Anglezët kishin besuar, qysh në shtator 1939, se do t' a mënjanonin shpejt flotën e vogël gjermane, e cila ishte në fillimin e formimit të saj dhe, për mungesë kohë ndërtimi, nuk munt të nxirte në shesh anije të mbëdha beteje. Por mbi këtë gjë, luftëdashësit që rrethojnë Churchill-in u gabuan trashë, Fuqija detare engleze u shtrëngua si mbi -s përfaqje ashtu dhe nënë ujë, agë lepër nga marina detare gjermane, shumë herë m' e vogël, sa arrijti krizën më të rëndë Amea pësuar Anglija. Në gjendjen e saj të që k tirë, Anglija u detyrua t' ua lëshonjëvështrikanëvet supremacinë e saj detare, për të mos e rifituar kurrë më. N' Angli dhe në Shtetet e Bashkuar u përdor një pjesë çuditërisht e madhe e produktit luftarak dhe e punimevet teknikë për të plotësuar materialin e nevojshëm në ndërmarrjen e invadimit të kërkuar prej Bollshevikëvet. Kjo kohë e fituar për në qysh nga 1939, prej Nëndetsevet ashtu dhe anijevet të sipërfaqjes të çdo klase, me suksesset e fundosjevet, është e një rëndësije të konsiderueshme për përfundimin e kësaj lufte. Përqëndrimi fuqirash detare armike përpara kryeurës s' invadimit, është një provë e dukëshme e llogaritjes së kohës, me të cilën armiqtë e filluan në të gjitha fushat, sulmin e përbashkët kundër ushtërisë gjermane dhe aleatëvet të saje. Ata dëshërojnë t' a mposhtin mbrojtjen e gjallë ndër kufit e Evropës me sulmin e vdekur të lëndës, por do të gabohen, ashtu si u gabuan edhe me efektet e sulmevet të tyre teroristë kundër Atdheut gjerman. Populli Gjerman u tregua mjaft i fortë, sa të mos i përulet as një shtypjeje materiali armik. Prodhimi i armës së re «V. 1» është një provë e kjartë se teknika luftarake gjermane di t' a çfrytëzonjë çdo kohë të fituar,

Akuzë e rëndë kundër kriminalitetit ebreo-bolshevik

Një libër i bardhë gjerman mbi krimin e Winnizas

Si dihet, para një viti, u xbulua në Winniza të Ukrainës, një gropë e përbashkët 10000 kufomash. Eksaminimi i këtyre kufomave nxori në shesh mënyrën më barbare dhe më të panjerëzishme, me të cilën ish kryer vepra ; nër ata që s'kishin vdekur me plumbin në gropën e xverkut, dukeshin, kjartë, shënjat e vrasjes me tytën e pushkës : por nuk mungonin edhe të groposurit të gjallë.

Në këtë xbullim, që të ngjeth mishtë edhe vetëm dyke e kujtuar, u duk, edhe një herë, syslemi bollshevik për të «likuiduar», ata që s' i bëjnë, dhe, nër syt' e mbetur të hapur të viktimavet, pasqyrohej edhe fytyra kriminele e çifutit gjakpirës.

Ndonëse nuk mbeti, asi kohë, as një pikë dyshimi mbi auktorët e këti masakrimi të tmerrshmë. Ministrija e Reich-ut për tokat e pushtuara të Lindjas botoj, tashti së fundi, një libër të bardhë, i citi përmban një seri të pasur dokumentash dhe provash të pakundërshtuarshme q e detyrojnë të famshmen GPU. t' a mbyllnjë gojën një her'e mirë.

Me këtë libër i jepet botës së qytetëruar një provë shkencore mbi etjen për gjak të ebreo-boilshevikëvet, Nër të provohet edhe se ; rrolin kryesor në këtë krim të pashoqtë e kanë lojtur çifutët, dhe se : në pjesën më të madhe, viktimat kanë qenë nga klasa punëtore, veçënërisht bujqër

Humbjet e çetave komuniste brenda një jave: 3170 veta

Përfundimet e luftimeve në qarkun e një armate në Ballkanin perendimor

Në zonën bregdetare të Kroacisë, fuqit'e sigurimit gjerman asgjësuan dy kolona fornizimi të çetavet. Me rastin e një spastrimi të një krahine të liruar nga grupe të mbëdhenj komunistësh në L i k a, ranë në duar të reparteve gjermane të spastrimit dy depo municioni. U numuruan, me saktësi, më tepër se 50000 fyshekë fanterije. Një çetë e aratisun në një nisi dalmatine u asgjësua. Grupe bombardonjës anglo-amerikanë më 2 korrik sulmuan përseri qytetin B r o d, i sulmuar dhe sa e sa herë më parë. Edhe ky sulm i kushtoj popullsisë shumë të vrarë e të plagasur. Në Kroacinë perëndimore, fuqi të sigurimit gjerman asgjësuan një grup të math banditësh që humbi shumë të vrarë. U shkatërrua një depo eksplosivi dhe u zunë shumë armë.

Ndërsa në Shqipëri dhe në Herzogovinë, çeta të shpartalluara dhe të rrahura fort u goditën, në një varg luftimesh të vegjël, fuqi të sigurimit gjerman u shtynë, në Malin e Zi, në një qendër komuniste dhe i shkaktuan armikut humbje në njerëz dhe në material. Më 2 korrik, çetat humbën, në Ballkanin veri-prendimor, 760 të vrarë dhe 20 robër. U zunë sasira të mbëdha armësh këmbësorije, një depo eksplozivi u asgjesua dhe një e tillë municjoni u sigurua. Brënda kohës 25 qershor gjer 1 korrik çetat humbën, në qarkun e një armate 2628 të vrarë, 464 të zënë dhe 78 të desertuar. Sasija e armëvet të këmbsoris dhe municjoni të ndryshmë është e rëndësishme.

Ç' gjë kuptojnë për "liri,, komunistët

« Huarat » e nënshkruara me gjak prej çetavet komuniste, në Ballkanin veri-perndimor, po shtohen në mënyrë gjithënjr me të dukëshme. Nga B i h a c njoftohet një tjatër vepër e turpshme e rrogtarëvet të Josif Brozit. Para disa ditësh u paraqitën, nër komandat gjermane dhe kroate në Beligrad, 850 katundarë nga krahinat e Slumjecetinje-grad dhe Magenac, krejt të xhvevhurdhe si skëlet, të cilët ishin rjepur pa mëshirë prej çetavet komuniste dhe ishin përzënë nga fermat e tyre. Këto viktima të krimit komunist ishin akoma nën shtypjen e aventuravet të tyre të tmershme. Më parë se ata të mernin rrugën e vojtjevet të tyre për në Bihac, me urdhër të komisarëvet politikë, të gjithë të sëmurët dhe pleqtë, si pas modelit bollshevik u "qruan,, me nga një plumb pas xverku. Gjatë marshimit nër krahinat e liruara, gra dhe fëmijë vdiqnë urije dhe vojtjesh.

Ndihmë dhe ndihmë

Pohimet të Churchill-it që përgënjeshtroh prej grekvet

Gjermanija po mundohet brenda mundësive të përmirësojë jetesën e të pakësoj vuejtjet e popullit grek. Këtë gja e dishmon ma së miri ndërhyrja energjike e bame prej Dr. Neubacher ministër e përftqësuës fuqi plotë i ministrisë së jashtme gjermane për Jug-Lindjen. Përpjekjet e Dr. Neubacher-it sunojnë ç'dukjen e spekullimeve me mjetet e ushqimit si dhe thyemjen e çmimit në treguin e devizave deri në 50 Prozent, Njikohësisht dhe uljen e çmimeve të gjanave ushqimore deri në 30 Prozent. Mund të pritet një përmirësim i gjendjes ekonomike në bazë të caktimit të çmimeve të tregut në nji mënyrë llogjike.

Ndërsa Churchilli u dërgon bandavet komuniste armë dhe municion tue nxit këta njikohësisht për nji vëlla-vrasje të tmershme Gjermanija dërgon sheqer mjete ushqimi, qymyr, barna e tjera me gjith vështirësit e trasportimit. Në mënyrë të veçantë asht i porositun ministri Dr. Neubacher si përfaqësues fuqiplotë i ministris së jashtme gjermane për Europën Jug-Lindore që me shtabin e tij të shkathët të jetë në mënyrë të veçantë n'anë të greqis tue ndihmue këtë. Kështu me anë të masave të marruna prej këtij gjendja e përgjithëshme në greqi asht përmirësue në mënyrë të dukeshme kaq sa le jojnë edhe rrethanat në nji gjendje të lufts. Natyrisht kjo ndihme do te ishte edhe ma e gjanë në qoftë se nuk do të pengohej prej komunistave të armatosun prej Churchilli-t të cilët prej radios së Londonit e të Kairos flohen gjithmon të kryejnë akte sabotimi dhe vëlla-vrasje.

Shtet që nuk asht krijuem prej ndërhyrjes së huaj

Presburg. Përpara përfaqësuësash të gardës Hlinka në Sillein mbajti nji fjalim ministri i brendshëm Sllovak Aleksander Machk që asht njikohësisht edhe kryekomandant i gardës Hlinka. Në këtë bisedë ai mueri qëndrim kundra agitacionit armrik që thotë se shteti Sllovak u krijue nënë presionin e huej. Ministri Mach theksoj se pa ndihmën e huej dhe pa përkrahjen e nonjë fuqije të madhe as nji shtet i vogël ka mundësi të mbahet. Shteti Sllovak u mbështet në të drejtat e veta të natyrshme dhe u krijue me ndihmën e Reichut të Madh gjerman.

Mitraljim kundër grash dhe fëmijsh që lahen

Pas bombardimit të rëndë terroristësh anglo-amerikan që pësoj, përsëri të djelën, Firenca, lajmerohen sulme të tjerë terroriste edhe kundër Modena, Mantua, Cremona dhe Empoli. Të gjithë këta sulme dite kanë shkakëtuar dëme të rëndë në vënde banimi dhe humbje të mbëdha në popullsinë civile. Ayjatorët terroristë që bombarduan Cremona-n, fluturuan, më pas, gjatë buzës së lumit Po dhe, nga një lartësi e vogël, mbuluan me plumba mitraljozi gra dhe fëmijë që lahëshin. Midis këtyre plasi një panik i math dhe gjer tashti, édhe nuk është caktuar numuri i viktimavet.

Gazeta „Olebito" që botohet në Angola, lajmëron se mungesa e kininës në Afrikën perëndimore të Pottogalisë po shkakëton katastrofa. Kinina, më parë, sillej nga Amerika e veriut dhe ajo e Jugës. Por pasi aleatët tashti kanë nevojë për vehte e kanë ndalue eksportimin e saj në Afrikë, me gjith protestimet dhe luftjet e popullsis koloniale, që s'ka asnjë mundësi luftimit kundër malarjes.

Konfuzion

Ngjarjet n'Italin e Jugut jane shenja të një konfuzioni që sundon në anë të aleatve jo vetëm në pikpamje ushtarake por sidomos në pikpamjen politike. Ç'ka kishinx me dasht me krijue këtu? Nji qeveri mbretnore nominale të mvarrur prej komunizmit Rus. Nji komitet ekzekutiv i përbamë prej gjashtë partive anti-fashiste që vendosën menjanimin e Dinastis por të cilët iu nënshtruenë diktatit të Moskës. Nji komision ushtarak që vendin po vazhdon t'a konsiderojë si vend armiku. Nji komitet këshillimi të përbam prej Anglezësh, Amerikanësh, Rusësh, Francezësh, Grekësh dhe Jugoslavësh . Nji ambasadë sovjetike pranë „mbretit t'Italis" dhe pranë këtij disa High komisionarë t'Anglis dhe t'Amerikës mbasi të dyja këto fuqi me mbretnin Italiane në kundërshtim me Rusinë nuk kanëlidh page por vetëm armë pushim me Italinë. Mandej aparati administrativ i kontrollit i përbamë prej mijra nënpunësish me origjinë Anglo-Amerikane dhe aleatve të tyne të cilët në rjedhim të veprimtaris së tyne bajnë të dalin në shesh gjithfarë kundërshtimesh e gjithfarë mos pajtime mendimesh e idesh.

E kur armiqve nuk po iu del në nji çep të vogël t'Europs të krijojnë rendin e mirëqenien atëher ç'ka mund të pritet prej tyne në punë të rregullimit e të zbërthimit të çashtjeve të vshtira t'Europës o edhe të gjith botës. Këtë mund t'a shenjojmë vetëm me nji fjalë: konfuzion, d. m. th. moçal prej të cilit dalin rét e frazave dhe mjegulla e vendimeve që nuk do të sjellin pagen por konflikte e lufta të rej për njerzinë.

Pulat në gjumë

„Sikur të krahasojmë politikën sovjetike, në jugë lindje të Europës, me atë që sovjetët kanë zbatue në vëndet baltik dhe sidomos, po të krahasojmë metodat e kësaj politike" deklaroj, këto ditë, drejtori i Irë i përgjithëshëm i administratës lokale Estone Dr. Mae gjatë nji bisedimi atëher në këtë do të shtfim formën e përsosun të mashtrimit. Sjellja sovjetike në shtetet e Baltikut qysh në fillim u duk me krejt brutalitetin e vet açik. Mirpo përkundrazi me këtë sjellje popujvet të Europës jugë lindore po u vjen vërdall politika sovjetike me gjithfarë premtime lajkatare. Bolshevizmi don që ata t'i bjenë në dorë me të mirë që kështu në çastin oportune t'ia u përdredhë zverkun. Kështu bolshevizmi tash pr tash po zbaton metodën e katundarit i cili i mer pulat nërsa ato janë tue fjet me kokë nër krahë për t'i therur.

Korren si grur' i pjekur

"Ngastra më e shtrenjtë toke franceze,, është titulli i një përshkrimi të "Daily Herald,, marrë nga korrespondent' i saj nga Franca veriore. Korrespondenti shkruan: « Në jemi në buzë të një grope të madhe antitanksë, në një ngastër bregdeti të liruar, në atë ngastër, mbi të cilën të parët Amerikanë yunë kambë mbi tokë. Kjo copë bukur e Europës, e zëdeti kushtoj më tepër gjak se çdo vënt tjetër në bregdetin e invaduar. Tri ditë vazhduan luftimet këtu. Por, sa u kushoj Amerikanëvët vetëm kjo copë, akoma nuk mund të publikohet », Korrespondenti mori hollsira të tjera edhe nga një mjek q' u plagos atje : "Gjermanët kishin vendosur nër lartësirat për qark, shumë, mitraljoza dhë, prapa këtyre, morlaje dhe topa. Amerikanet xbrisnin nga barkat e tyre, por zjarri gjerman i korrte si grurin e pjekur. Ajte u shvilluan skena mbi të cilat njeriu nuk dëshiron të mejtohet I tërë bregdeti që, letrarisht, një skëterë, sa edhe barkat bëhëshin cop'e thërrime ". Korispondenti thekson se iu desh mjaft mjështëri, gjer sa ata bënte doktorin të fliste.

Franca falënderon ushtarët gjermanë

Autoritetet francezë u shprehën falënderimin e tyre trupavet gjermane, për ndihmën e vlefshme dhe të pa kursyer që ato dhanë në punimet e shpetimit dhe të spastrimit në në kryeqytetin e Normandisë, Rouen.

Ushtarët gjarmanë ndihmun, në mënyrë të veçantë, në shuarjen e zjarrit të Kathedralit. Nuk u kursyen as nër punime spastrimi. Ushtërija gjermane vuri në dispozicion automjete për trasportimin e të plagosurvet dhe të refugjatëvet nër vende sigurimi dhe për të sjellë ushqime për popollsinë e mbetur në vënt.

Ç' të jshehta tregojnë, vallë, këta sy të bukur ?

Lajme të ndryshme

Në të gjashtë muajt e parë të këti viti, janë rrzëzuar, në sulmet mbi tokën e Reich-ut dhe mbi tokat e pushtura, 8164 aeropplanë armiq, prej të cilëvet 6407 kanë qënë bombardonjës katër motorësh.

Gjendja ushqimore në Romë u keqësua edhe më tepër nga nevojat e trupavet të pushtimit. Hë për hë nuk munt të pritet as nj përmirësim, pohon shtypi engles.

Në Moskë u krijua një „Ministri për çështje kishëtare". Për të arritur kulmin e kësaj ironije, u caktua, si titullar, një çifut, i cili më parë ka gënë një nga anëtarët më me rëndësi të lëvizjes „s'ka Zot".

Mbi deklaratat zyrtare të qeverrisë japoneze, për sa i takon po[illegible]s me Kinën, të cilat u njoftuan këto dite, zëdhënësi Ukazaki theksoj përpara shtypit: -aponija nuk i konsideron si armiq as popullin kines as fucitë luftonjëse të Tschiang-kiaschekut. Lufta u bëhet vetëm Engleztvet dhe Amerikanëvet, të cilët përpiqen t'a heqin Kinën drejt qëllimevet të tyre luftarakë dhe të ndalojnë, kësisoj, çlirimin e Asisë lindore. Vetëm me mënjanë-



Vullnetari japones fluturon i shoqëruar prej bekimit të mëmë

simin e influencës anglo-amerikane munt të arrihet t'u jepet, populjvet të Asisë lindore, paqja, qetësija dhe rregulli.

Populli francez është, njëzëri, kundër „Çlironjësvet" tij. Ja, këtë arritën, gjer tashti, Anglo-amerikanët, reklaroj një prefekt normandes.

Lufta e bombavet kundër qytetesh francezë nuk është e denjë për Fuqi të Mbëdha.

Shtypi japones e quan si një provë t'efektit të armës „V 1" kërkesën engleze për të kufizuar daljen jashtë Anglis të personavet neutralë.

Gjatë tri javësh ofensive sovjetike, në grykën e Karelisë, janë çkatërruar, gjer tashti, më tepër se 600 tankse bollshevikë.

Me rrastin e një debate mbi kanosjen e papunësisë, në kohen pas lufte, Ministri engles i Punës pohoj se disa shtete autoriterë e kishin treguar, që përpara luftës, rrugen që do të ndiqej, në lidhje me këtë problem.

Shkallët e nalta ushtarake franceze çpallën një thirrje kundër trathëtarëvet, nga faji i t cilëvet Franca humbi kolonitë dhe flotën e saj e që tashti ata po kontribuojnë që të derdhet gjak i pafajshmë frances. Në këtë thirrje gjene ralët franceze përsëritin edhe nj herë bindjen e tyre ndaj kryetarin e Shtetit, Mareshalin Pétain.

Për të qeshë

Nji javë mbas dasme burri niset për punë jashtë shtetit. Nusja e rë qi e donte burrin shumë, i ban telegramin qi vijon:

«Mos harro se je martue rishtas»

Dhandri i ri e merr telegramin pikërisht në kohën e dëfrimit në Tabarë, dhe i përgjigjet telegramit: "Për fat, telegrami ka mbrritë vone,,.

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Martë 25 Korrik 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 12 - ÇMIMI 1 LEK

Ne dridhemi dyke mejtuar se ç'gje e pret Londren

Veprimet t'ona për hakmarrje së janë në mbarim, por në fillim. Dr. Goebbels njofton të tjera armë të rënda

"Pyetja e Hakmarrjes„ është titulli i njëj artikulli të ri të Ministrit të Reichut, Dr. Gobbels, në të përjavëshmen "Das Reich„. Dr. Gobbeles merret me faktin që, tashti së fundi, gazetat engleze u përpoqnë t'a xvogëlonin efektin ezjarrit të rëndë të hakmarrjes. Pastaj ato u hodhë në extremin tjetër, në dramatizimin e ngjarjevet me një ton sentimental, dyke dashur kësisoj, të xgjonin keqardhjen e botës. Dr. Gobbels kujton se do qé jo keq të përmëndëshin, edhe një herë, fjalët e lavdërimit që, vetëm para pak muajsh, u kushtohëshin, m'a t'anë Kanalit sulmevet terroriste dhe brutalë anglo-amerikanë kundër qytetesh gjermanë dhe popullsisë civilë. Kur Gjermanija e quante si barbare një luftë e tillë, nga Llondra i përgjigjëshin me një të qeshur satanik dhe tallës. Sidoqoftë, tashti Anglisë i shkoj shija e të qeshurit. Edhe vetë Kryeministri, që është, zakonisht, i gatëshëm për shaka cynike, në fjalimin e tij të fundit , në Dhomën e Komunevet, për mbi themën V. I. nuk dinte si të fliste dhe i mbahej goja.

Në Gjermani nuk bënë asnjë përshtypje, në se në Llondër përpiqen t'ia mohojnë armës "V. 1.„ saktësin' e qtjes dhe vleftën ushtarake, të cilavet, sulmet britanikë mbi Gjermanin, ua paskan arrijtur më së miri. Sa për këtë të fundit, mjafton të shihen qytetet e bombarduar gjermanë, që të bindesh për krejt të kundërtën.

Pikëpamja tjatër englezet ajo më e reja, se arma gjermane "V. I.„ është një krim i poshtër, se ajo nuk shërbehet prej njerëzish, por vret njerës, rrëzohet vet-vetiu, po të mejtojmë se si bombardonjësit britake xgiedhin, për t'u mbrojtur, retë dhe qjellin e vrënjtur kur gjuajtësit gjermanë nuk munt të ngrihen për t'u bërë ballë. Gjermanëvet as q'u shkon ndër mënt t'a shëndetojnë me një qeshje djallzore dhe cinike përdorimin e armës së tyre të parë të hakmarrjes. Po të kish patur mnudësi, përmënt Ministri i Rechiut, të bëhesh lufta tokësore dhe lufta ajrore më humane dhe më kalorëse,Gjermanija do të kish qënë sigurisht e para për një gjë të tillë. Por këtë qenë pikërisht Englezët ata që s'e deshnë. Me gjith që né do të kishim plotësisht të drejtë, prapë nuk kënaqemi as pak mbi ç'gjë shkakton në Llondër zjarri i armës s'onë. Në përdorimin e saj, né shohim vetëm një masë të ligjëshme ushtarake. Ne dridhemi, kur mejtojmë se ç'ka akoma për të pritur Llondra nga armët t'ona të ra e të rënda që do të viren në përdorim. Se vepërimi ynë i hakmarrjes nuk është në mbarimin e tij, por në fillim. Kritikët ushtarakë të anës kundërshtare e kanë pohuar, me një zë, që arma jonë "V. I.„ përbën një revolucion në të gjithë systemin luftarak. Ç'do të thonë, vallë kur të dalin në shesh armët t'ona të tjera, që as munt të barabiten fare me të parën!

Mos pandehnë, në Llondër, që né do a duronim dhe do t'a linim të kalonte ashtu në heshtje, sulmi terrorist anglo-amerikan, dhe t' i unjim kokën, pa marrë asnjë kundërmasë? Një kohë të gjatë, munt të kenë qëndruar në krye cpikësit kundërshtarë, por edhe në këtë rrast, dyke pasur për bazë përfundimet e kërkimevet dhe të përpjekjevet gjermane. Tashti e kanë fjalën Institutet dhe Klinikat t'ona. Armët t'ona po i nënështrohen edhe një prove fare të shkurtër, në pjesën më ë vogël, se pjesa e tyre m'e madhe është në mbarim të plotë. Ne jemi absolutisht të sigurtë në punën t'onë.

Mësyemje ajrore e rande mbi Devoll

Humbje të randa në popullsin shqipëtare.

N'orët e drekes të datës 23. 7. 44. nji grup bombarduesash anglo-amerikan kanë ba nji mësyemje të rreptë në rrethin vojguruër të Devollit. U shkaktucn dame të mdha si nder instalime teknike, ashtu edhe nder ndertesat e banimit të popullsis shqipëtare me viktima të shumta.

Hollsinat mbi këte poshtersi të madhe kundra popullsis shqipëtare nuk janë të vertetueme endë. Nji gja vetem mund të themi sot: Se llogarija e borxheve t' anglo-amerikanve në Shqipni asht ngritun persri. Me qinda burrash, grâsh e fëmish, kan rà therorë të terrorit të poshter anglo-amerikan. Gjaku i shumë shqipëtarve të pâ fajshëm ngrihet në qill. Bombat e katilave u hodhen prej nji naltësije të madhe, kështu që permbi objektiva nuk mund të flitet.

Shka fituen gangstert e ajrit me ket poshtersi të rë? Prodhimi i puseve vojgurore, siç dihet janë për nevojat e popullit shqipëtarë, për landë djegse. Me qenë se Shqipnija si tokë pâ udhë hekurit, gjithë pshtetjen e ka vetem në Devoll, me ket veper i asht dhanë nji grusht i fortë kujdesit të transportit të gjanave ushqimore. Prodhimi i Devollit asht nderprè për nji kohë të gjatë Perfurdimi asht nji pengim i jashtëzakonshëm i transporteve prej Kosovës të gjanave të nevojshme që dergohen për Shqipnin e mesme, dhe të jugut.

Vendin e luftës burrnore nder ballnat e betejës, anglo-amerikant e zavendsojnë me poshtersina kundra grave e fëmive dhe kundra pasunive të popujve të pa fajshëm. Shqipnija nuk duhet t'i harrojë këto poshtersina, dhe viktimat e dhimbëshme.

"Francezë, nè jemi miqtë t'uaj„

Caen përgjigjet: "Flakini jasht, nuk i duam!„

Në buzët e lumit Orne, qytet liqeni dhe skelë, por, njëkohësisht i pajisur edhe me shijën e qytetevet tokësore normandezë, i ful'tur në një fushë të bleruë e lulëzonjëse, ish Caen, një qytet i pasur dhe i bukur, i dashruar prej banorëvet të tij, i admiruar prej vizitorëvet dhe i ra harruar prej asnjerziu q'e shihte. E, mbi këtë qytet, u fut th breshëri i bombavet t'invadonjësvet. Skela digjej, kishat rezohëshin, cat'drat e tuara delnin, të llahatarishme, mbi tógjet e gërmadhavet, rrugët mbyllëshin prej barrikadash ckatë r'mi dhe mbi fytyrën e qeshur të qytetit binte një pluhur i zi e i rëndë valë, valë.

Në shastisje të tmeruar, pyesnin banorët njeri tjetrin "Për ç' arrësye na bombardojnë? Në se ata kërkojnë Gjermanët, pse na qëllojnë né ?" Dhe fillo arratisja e lebetilëshme e popullsisë: me biçikleta, me qerre dore, me karro dhe më këmbë, kështu u nisnë për në fushën e jashtme, gra plaka me leshrat e bardha, burra që çalonin, fëmijë, të cilëvet mëmat u kishin vënë nga një helmetë mbi kokë, dhe ato vetë të ngarkuara me çarçafë dhe kanistra, me sendet më të nevojshme; u nisnë, me ecjen e gadalëshme të dëshpërimit, drejt fushës e malit, dhe ngulëshinë tokë, sa herë që hijet e errëta të aeroplanëvet kalonin mbi kokën e tyre, në fluturm të unjët, tulitëshin në tokë dhe dëgjonin, më çkoqur, tmerin e luftës që po i afrohej më tepër qytetit në flakë.

Kur gjermanët u vendosën rreth qytetit, tankse englezë qëlluan lagjet e para dhe Caen u kthye në qytet fronti. As njeri, për spastrim, dhe qyteti mbeti ashtu si ish, i çkatërruar, gërmadhë rënkonjës, dhe telat varëshin në rrugë, si penjë merimage. Të mbytur në hi e në pluhur, jetonin banorët e mbetur në vatrat e tyne: vajza me pantallona të llangosura me baltë, me helmetën e çelniktë mbi kacurelet e tyre, me maskën kundër gazit në qafë; burra që qëndronin nër qoshet e rrugëvet për të drejtuar qarkullimin, qarkullimin e shpejtë, plot angth, të njerëzvet të tmeruar, qarkullimin e veturavet, që mbanin flamurin e paprekshim të Kryqit të Kuq dhe që prandaj ciknin edhe zonat e luftimit.

Përpara tregtorevet të pakta édhe të hapura, njerëzit rrinë të hutuar. Rrinë të heshtur dhe presin e na shikojnë, kur ne u kalojmë pranë. Asnjë qeshje në fytyrën e tyre, asnjë gëzim, dhe në beben e tyre një tmer i vrënjtur, ajo mpirja e fortë që të bën të dukesh si i botës tjatër, ndonse ata njerës kanë veshur rrobat e tyre më të bukurat dhe po rrinë në djellë. Për mbi gërmadhat, kalojnë ekivolë arkivolë pa lule, afro pa përcjellës, të shoqëruar vetëm prej lotëve të far' e fisit. Né pamë shumë që i vërshtillnin të vdekurit e tyre me velënxa të leshta, hapnin një gropë, në vëndin më pranë, dhe i mbulonin.

E ç'do të thonë, pra këta njerës, mbi invadimin? Ushtarët englezë sjellin fletushka me vehte, radha e parë e të cilavet është; „Francezë! Né jemi miq tuaj„ A ka, vallë, ironi më therëse? Kur kalonin robërit e parë, për mes Can-it, djem të gjatë e të shëndoshë, me cingare në gojë dhe me buhë në gas, se kështu e kanë zaken t'a shprehim mospërfilljen e tyre, midis popullit ngrihej një kanosje, një kanosje e heshtur që lint nga dëshpërimi dhe nga inati. As ujë nuk u jepni të zenvet rob. Por né pamë varre ushtarësh gjermanë që po ay populli stoliste me lule, me të njëjtën ndjenjë që lint nga i njëjti fat. Në qytet nuk ndodhej asnj ushtar gjerman, por, tre net në von, qyteti bombardohet rishtas.Pse, pyesin banorët e Caen-it. Gjyle engleze bijen mbi qytet por popullsija që ka mbetur, i duron, afro apathike, sikur të kish sigurimin e heshtur q'ato gjyle nuk hidhësin për 'të!

Dhe kësisoj, né kalojmë nga një pamje tmeri nek tjatra, nga ara të lëruara prej gjylesh, nër ndërtesa të rrëzuara nga bombat. Po, Caen-i tregon se invasioni nuk po marrshon mbi qerren e triumfit, se ay s'ka të bëjë as pak me çlirimin e Europës, dhe se mbi tokë ka xbritur vetëm pamëshirësija që po e rreh Evropën prej kohësh: Caen-i tregon se gratë, foshnjat dhe pleqtë e të gjithë qytetevet bregdetar francezë nuk kanë gjë tjatër në gojë, veç se thirrjen: "Flakini jasht! Né nuk i duam!„

Kryetari i shtabit, Guderian, i flet popullit

Me cilësinë e tij si Kryetar i Shtabit, Kolonelgjenerali Gyderian lëçiti, përpara mikrofonit gjerman, urdhërin e ditës të Fuehrerit, drejtuar ushtëris më 22 korrik, dhe, në lidhje me atë, mbajti, në emrin e Ushtëris gjermane, këtë fjalim:

vDisa oficerë të paktë, pjesërisht të nxjerë jasht shërbimit, e kishin humbur kurajon dhe, nga frika e dobësija, kishin preferuear rrugën e turpit përpara rrugës së nderit dhe të detyrës q'i ka hije njëj ushtari të denjë.

Vetë ushtërija spastroj vet-vehten dhe i shtyjti elementet e dobët. Nër të gjihtë frontet e luftës, ashtu dhe brënda në Atdhe, po punohet për fitimin me të gjithë zellin dhe me të gjithë fuqitë. Zopulli dhe ushtërija janë lidhur shtërnguat pas Fuehrerit.

Armiku u gabua, duke besuar se llogarië në dobin' e tija me një çpërnëarje midis gjeneralëvet t' ushtëris.

Unë e garantonj Fuehrerin the popullin gjerman për kompaktësin e gjeneralëvet të trupit t' oficeravet dhe të ushtëris, me të vetëmin qëllim për fitoren e fundit, dyke përsëritur fjalët e mbëdha të të nderuarit Feldmarshal vën Hindenburg "Besnikërija është pulca e nderit!„

Rrëftë Gjermanija dhe Fuehreri ynë! Dhe tashti: Popull. rrëmbe pushkën!

Anglija po i hap varrin vet-vehtes

Kritikë e fortë engleze kundër politikës gjakatare të Churchill-it

Kryeredaktori i Rivistës së përmuajshme engleze "Nineteenth Century„, publicisti i njohur Federic Voigt, në një artisull të gjatë në rivistën e tija, ngulmon se Anglija duhet të bënjë çdo sakrificë, për t'a mbajtur Rusinë sovjetike jasht kontinentit evropjan.

"Pa Evropë, vazhdon Voigt nuk do të ketë paqë liri dhe mirëqënje, jo vetëm për Englezët e sotme, por as për fëmijët e tyre. Pa Evropë, Anglija as që mund të jetonte. Ajo fuqi, ose koalicon fuqish, që sundon Evropën, sundon, njëkohësisht edhe nisinë britanike. Po t'a fitonte Gjermanija këtë luftë, Anglija do të qé e varfër. Por jeta kryesore, jeta e vërtetë e Anglisë, varet nga sigurimi ndërlidhjevet me posedimet e saj të jashtmë tejdetarë dhe me Commonwealth-in. Sigurimi i kësaj ndërlidhjeje është pika nevralgjike për jetën e popullit english. Shtetet e Bashkuar, Franca, Rusija sovjetike dhe Gjermanija munt t'a ka-

lonin çdo mundje edhe sikur këto të humbisnin toka të gjera nga të tyret, po Anglija s'ka se si dhe nuk mun t'i bënjë ballë as njëj mundjeje.

Një gjë duhet të mësohet nga historija, veçanërishtë nga historija englede: Kjo është e vërteta e pa kundërshtuarshme se midis kombevet nuk munt të ketë miqësira të përjetëshme dhe se aleatët e sotëm, nesër munt të jenë armiq, dhe armiqt' e sotmë, nesër aleatë.

Asnjeri nuk munt t'a kundërshtonjë që Rusija sovjetike, në rrast të një fitimi të aleatëvet, do të jetë zotëronjëse që prej detit artik gjer në detin Egje. Por zotëronjësi i Ballkanit, është nëëkohësisht, edhe zotëronjësi i Mesdheut lindor.

N' Angli flifet shumë dëndur mbi mos pasjen nevojë për Shtete të vegjël evropjanë, por Anglia do të kish nevojë për këta, të paktën për sigurimin e saj. Pa një Danimarkë indipendente, pa Hollandë dhe Belgjikë ujrat e Atdheut britanik do të sundoheshin prej fuqisë së madhe më të afërme kontinentale. Kë sisoj duhej të eksistonte një miqësi e përherëshme me Francën dhe kjo të përbënte pikën kryesore të politikës së jashtme engleze. Po të mos i arrihej kësaj, athere Franca do të bashkëpunonte me Gjermaninë dhe, të dyja këto, paraqesin, për Anglinë, një koalicion jasht masës të fortë.

Sikur Shtetet Ballkanikë të mos jenë të pamvarur dhe sikur këta t'i shtrohen infuencës sovjetike, prapë nuk do të ketë siguri, për Anglinë, në pjesën lindore të mesdheut.

Por Anglija ka nevojë për Evropën jo vetëm për arrësye politike, por edhe nga pikëpamja ekonomike. Gjatë kësaj lufte, ajo i sakrifikoj, po thua, të gjitha pasurit' e saj tej detit, gjithëksijoj, edhe ç'kish në Lindjen e Larkme. Është më se e dyshimtë që Anglija t'i marrë përsëri këto të fundit.

Veç kësaj, n'Angli harrohet, dëndur, se kjo luftë nuk bëhet vetëm për eksistencën e saj, por edhe për disa par me, prandaj si janë punët sot, në rrast fitimi të Aleatëvet, shumë shtete evropjanë do të skllavërohëshin. Sot po dëgjohen sa e sa argumente me të cilët duan t'a bindin botën se kv ose ay komb s'ka asnjë të drejtë të jetë i lirë, ose që duhet t'i merret gjysma e tokës së tij.

Shumica e këtyre argumenteve merren nga librat e historisë.Por e meta e historianëvet është pikërisht ajo që ata nuk jetoinë të tashmen as të arthmen por vetëm të kalutrën; ata mejtojnë prapa, jo përpara. Prandaj argumentat për xhdukjen e disa shteteve janë sa të gabuar aqë dhe të ndërçmë.

Provat me armën e re gjermane „V. 1.„ po duken të kjarta

Në lidhje me lajmet prej burrimesh angleze, mbas së cilave gjuejtet me armën e ré gjermane vijën prej nji drejtimi tjetër, njoftohet nga ana gjermane se vëndet prej kah gjuhet janë tash brenda në tokë larg brigjeve. Ky transportim u ba i mundëshëm me shfrytzimin e mundësive teknike që jep vetë arma "V. I." pa vështirsira Prandaj e mira të kësaj pune qëndrojnë aty se tash e mbrapa ana gjermane do të disponojë mbi l'aza më të gjna të mësimjes' njikohësisht me këtë jepet mundësija edhe të mimetizuemit e të mbrojtjes kundra mësymjes ajrore angleze shum ma tepër se sa atëher kur installimet e kësaj arme ishin afër bregut. Prova e fitume qysh prej të vumit sefte në veprim të armës së ré "V. I." kan shkaktue shtimin e numurit të qëllesave dhe nji kontrollim ma të saktë të vijës së fluturimit të bombës fluturuëse në një largësi shum ma të madhe.

Lajmet sensasjonale që jepen prej anës së armikut mbi lëshimin e bombave fluturuëse mbi kryeurën e zbarkimit, në Berlin i rregjistrojnë pa konfirmue prej ndonjë ane vumjen në veprim të kësaj arme në frontin tokësuer të luftës. Përgjithësisht mund të thuhet se problema e armës së ré gjermane VI që ash gjithënji në zgjanim e sipër po mer nji randësi gjithmon ma të madhe dhe po gjindet përpara nji zhvlilimi gjithmon ma të math sidomos për sa i përket gjutjes së objektivave të shënueme dhe të qëllesave të plota.

Humbje të rënda çetash komuniste

Në Kroacinë veri perëndimore u luftua rreptë edhe ditët e fundit dhe çetat komuniste paten humbje të rënda. Katundet RADOVICE dhe RASICE, të pushtuar prej çetavet, u liruan përsëri. Një çetë e shtrënguar për luftim, në krahinën BJELOVAR, dhe e çpartalluar, në ikje e sipër, a arrijt përsëri, në krahinën VIROVITICA dhe pati të tjera humbje të mbëdha në njerës dhe në material. Në POZEGA, njëjesi kosakësh e vazhduan ndjekjen e bandavet që tërhiqeshin nga veriu. Në VIROVITICA u rrëzua një katermotor amerikan. Reparte Domobranësh i luftuan, me sukses të mirë, mbeturinat e çetavet të aratisuna nër pyje, nga lugina e lumit Krbaua. Pjesë të divisionit malsor SS e defyruan për luftim një çetë komuniste, në jugë të Gorazdes dhe e shpartalluan. Në krahinën VODICE, pjesë të divisionit të 17 kundërshtar u shtrënguan ort dhe u goditën rëndë. Forca gjermanet të sigurimit e vazhduan spastrimin në krahinën PLEVJA. Qyteti shkiptar, Peshkopija, i pushtuar prej komunistësh në kalim e sipër, u muar përsëri. Më 15 korrik çetat humbën, në Ballkanin perëndimor, 219 të vrarë sigurisht dhe për mbi 50 të gjykuar si të tillë, ashtu dhe sasira të mbëdha armësh këmbësorlje. U zunë 33 kuaj dhe kafshë heqëse, dhe u shkatërruan, ose u zunë, shumë depo materiali dhë ushqimi

Në krahinën BJELOVAR, reparte gjermanë dhe kroatë të spastrimit e vazhduan me sukses, ndjekjen e bandavet të shpartalluara dhe të aratisura në drejtim të lindjes. Në Sloveni u rrëzuan dy aeroplanë armiq nga baterite kundraaerore dhe nga zjarri i mitraljozavet t'anë. U rrëzua edhe një bombardonjës armik me katër motorë. Reparte të sigurimit gjerman u shkakëtuan çetavet të grumbulluare nër zona bregdetare humbje të tjera të mbëdha. Një tjetër bombardonjës amerikan me katër motorë u rrëzua mbi nisinë Rab. Alpinistë SS ë plotësuan spastrimin e krahinës LIVNO-SUJCA dhe ZERCCK, prej një çete që mbrohej me rreptësi në zonën GORAZDE. Në krahinën BUNCIC reparte Domobranësh e defyruan një çetë për luftim dhe e çkatërruan. Një sulm bandash komuniste kundër qytetit PRIBOJ u shtyjt. Bandat pësuan humbje të rënda njerëzish Në krahinën NEVESINJE u vazhdua, me sukses, lufta kundër disa grupeve komuniste. Reparte gjermane të sigurimit e spastruan rrethin e Beratit. Në jugë të BIJELOPOLJE-s bandat u shtynë përtej lumit Lim.

Ndërmarrjet e spastrimit, ne rrethin e BJELOVAR-it, mbaruan me sukses, pas shpartallimit të çetavet që po iknin në drejtim të lindjes. Humbjet e bandavet, në njerës dhe material, janë të rënda. Reparte kozakësh çpërndanë përqëndrime në grykën POZEÇA. Luftimi i çetavet të grumbullunra në bregdetin kroat u vazhdua si pas planit. Një tentativë çlirimi i pjesëvet të divisionit 19 komunist, të shtrënguara në rrethin e PRIBIRSKO, dështoj plotësisht. Në redhin PRBAVSKO POLJE, reparte Ustache vazhduan ndjekjen e bandavet të çpërndara në luginën e PRBAVA-s dhe të arratisura në për pyjet. Katundi PRIJEBOY i pushtuar përkohësisht, u lirua përsëri. Me rastin e një spastrimi në rethin e SOKOLOVAC-it, reparte të divizionit SS malësor, i defyruan për luftim disa pjesë të Brigadës XXI dhe i çkatërruan. U muarnë disa bregore të mbrojtura rreptësisht prej banditëvet. Në Malin e Zi dhe pikërisht në rrethin e PRIJEPOLJE-s bandat e vazhduan edhe orvajtjen e tyre për t'i shpëtuar një sulmi të fuqivet gjermane të sigurimit. Në luginën e lumit BISTRICA u shtynë, ose u asgjësuan, grupe bandash vrojtimi. Spastrimi i rrethit të PESHKOPISË u vazhdua me një kundështim të dobët armik. Në jugë të BERATIT u shtynë sulme banditësh. Humbjet e Bandavet, në Ballkanin perëndimor, arrijtën, më 18 korrik 196 të vrarë të sigurtë dhe për mbi 50 të pandehur si të tillë. U zunë shumë robër dhe shumë dezertorë.

Prej datës 16 gjer më 12 korrik bandat humbën, në Ballkanin perëndimor, 1510 të vrarë të numuruar dhe 1000 të kujtuar si të tillë, ashtu dhe plot 250 robër dhe të desertuar. U zunë sasira të mbëdha armësh dhe municioni, disa aparatë radio dhe shumë kafshë mbartëse. U rrëzuen dy katërmotorësh armiq.

Nga të gjitha anët e Francës vinë lajme mbi bombardimet dhe mitralimet e avjatorëvet terroristë anglo-amerikan kundër popullsis civile në për katunde dhe në për ara.

Ne do t' a zotërojmë gjendjen

Generalfeldmarshall von Kluge mbi luftën për jetë a për vdekje të Perëndimit

"Në ditët e arthme, né presim sulme ë rëndë, nga an' e armikut, por né do t'a presim atë ashtu si i meriton dhe do t'i japim të atillë grushte, që ay t'i mbanjë mënt tërë jetën "theksoj Kryekomandanti i ri i ushtëris gjermane në Perëndim Generalfeldmarschall Hans Guenther von Kluge, në një pritje q'u bëri korrespondentëve luftarakë gjermanë në Kuartierin e tij të përgjithëshmë. "Gjendja, vashdoj Feldmarschali, është, pa dyshim, e vështirë, por ajo është për t'u drequn dhe do të ndreqet,,. Nga fytyra e tij e freskët dhe e pjekur nga djelli, nga fytyra e tij qint për qint ushtarake, dalin rrëzë të ngrohta sinqeritëti, kur ay flet mbi bashkëluftëtarin e tij të vjetër dhe besnik, mbi Feldmarshalin Rommel. "Është e kjartë se ne të dy, Rommeli edhe unë, nuk do të lemë gjë pa bërë, për t'i qruar llogaritë, një her'e mirë, me kundërshtarët t'anë, me të cilët patëm të bënim, së bashku, edhe në luftën e parë botnore, edhe në pjesën e parë të kësaj lufte,,.

Feldmarshali i përcjell fjalët e tija me një lëvizje kuptimplotë duarsh, e cila tregon më mirë vështirësin' e barrës që ju besua prej Fuehrerit. Përshtipjen kryesore, nga personaliteti i tij i fortë, e bën shkaftësija e tij e dukëshme dhe kurrë e fjetur, e bën vitaliteti i tij që munt tëquhet afro djaloshar. Është gati mallëngjenjës zëri i tij, kur ay flet mbi infantiristët gjermanë, të cilët - me fjalët e tija - kanë kryer vepra aqë kolosale, saqë nuk munt të lavdërohen kurrë mjaft dhe si meritojnë...

"Lufta, në frontin e invadimit thotë Feldmarshali, "është një luftë për jetë a për vdekje për Perëndimë këtë, prandaj ushtari dhe Komandanti do të bëjnë të panumurën. Né e prisnim invadimin dhe në sé përpjekja është e ashpër ose munt të bëhet edhe m' eashpër, né prapë e shpdeorimë, se ajo na jep rrastin të mateni me armikun në luftë kalorëse Ne shpresojmë, theksoj Komandanti, që lufta të mbetet kalorëse.

Methodha e armikut të shtyhet përpara vetëm dyke u përkrahur nga një superioritet materiali dhe me para fort të sigurtë, nuk! përbën nonjë problem për Komandën gjermane, pas si po pritet që mobilizimi gjerman do të sjellë shpejt një barazim materiali.

Mbrojtja Norvegjeze ë shtë gati. Bodrumet prej çemen toje janë plot gjylesh të rënda që presin rrastin e nevojshmë

Lajme të ndryshmë

Shtypi i Oslos boton me gërma të mbëdha lajmet e ndryshme mbi atentatin e Fuehrerit. Gazeta "Frit Folk,, përmënt se tashti populli gjerman do ta vazhdonjë me fuqi të dyfishuara luftën e tij decisive për shpëtimin e Gjermanis dhe t'Evropës. Me vendim të prerë dhe me armë të ra, nënë udhëheqjen e Fuehrerit, Gjermanija do t'i përvishet luftës së fundit dhe do t'a fitonjë. Gazeta e bujqërvet. "Nationen,, thotë se fati e mbrojti dhe e bekoj përsëri Fuehrerin dhe veprën e tija. Norvegjezët që shohin në personin e Fuehrerit mbrojtjen më të fuqishme kundër Bollshevizmit, janë të lumtur për shpëtimin e tij.

Krimet e tmershmë, të kryer këto kohët e fundit, prej gjakpirësvet sovjetikë kundër katundarëvet finlandezë, përbëjnë një akuzë të rëndë në të gjithë shtypin e vendit. Në ka njeri që beson edhe se Bollshevikët nuk paraqitin nonjë rrezik për popujt e vegjël, do të bindet plotësisht për të kundërtën, edhe vetëm me lajmet mbi ngjarjet e Finlandës. Edhe në se propaganda sovjetike e ka ndryshuar, këto ditët e fundit zërin e saj, nga kanosja në një farë përkëdheljeje si duket nga kundërshtimi i fortë finlandes, edhe sikur të ishin të sinqerta këto përkëdhelje, prapë ato arrijtën shumë von. Vrasjet e fundit e bintnë edhe të fundit Finlandes mbi tmerin e mbi krimet sovjetikë. Kurrë nuk munt t'u dorëzohet i gjalle nonjë finlandes këtyre bandave gjakatare, ose t'i lejonjë të ryjnë në tokën e tij. Krimeti kundër grash dhe fëmijësh të pafajshmë e vënë nënë hije të gjitha gjakderdhjet e deritashme, edhe vetë bomcardimet ajrorë.

Atentati kundër Fuehrerit nuk munt t'a tronditnjë as pak bashkimin e ushtëris gjermane dhe besimin e popullit ndaj ati shkruan gazeta italjane "Corriere della sera". Populli italjan i parashtron Fuehrerit urimet më të nxehtë për shpëtimin e tij. Atakimi i një Kryetarit të një Shteti në luftë është një trathti kundër Atdheut, që nuk munt të falet për asnjë arsye. Asnjeri nuk munt të ketë të drejtë t'i dorëzonjë armikut një ushtëri të pamundur dhe të fuqishme. Atentati kriminel nuk tregon, në asnjë mënyrë, nonjë farë pengese në marshimin kolosal të fuqivet gjermane, por që vetëm mejtimi i disa të paktëve pa ndërgjegje dhe pa asnjeri pas.

Pas si t'a këndosh këtë gazetë, jepe më tej. Do të të jenë mirënjohjtës veçanërisht shokët e tu ndër male.

Kryetari i Shtetit sërp, Kolonelgjenerali Nediç i bëri një vizitë Kryekomandantit ushtarak të Jugëlindjes dhe Ministrit Gjerman në Beligrad, për t'u parashtruar, në emrin e qeverisë dhe të popullit sërp, urimet për shpëtimin e Fuehrerit nga atentati i shëmtuar.

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Ejte 27 Korrik 944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 13 - ÇMIMI 1 LEK

Hija e Moskës mbi Amerikën Qendrore

Si duket në New-Jork po vrasin mënden mbi shkaqet e traziravet të vazhduarshme në Republikat e Amerikës Qendrore. Ministri i P. të jashtme amerikan, Cordell Hull, shkaktoj me të shpejt, një konferencë me shpresë që të xbulonte nga të fashësniësit diplomatik të të gjashtë shtetevet t'Amerikës Qendrore kranaskenat e lëvizjevet revolucionere nër vëndet e tyne. Zyrtarisht, ruhet heshtje e plotë mbi përmbajtjen e bisedimevet, nër të cilët muarnë pjesë edhe një përfaqësonjës i Moskos dhe një Diplomat i Amerikës së Jugut. Vizita e Ministrit të P. të jashtme meksikan, Padilla në Wazhington, i cili, si pas thënjesh zyrtare paska biseduar gjoja me Hullin mbi "probleme industriale,, dhe mbi "çështje barazimi demokratik të shteteve ibero-amerikanë,, mund të mrrej si një tjatër provë mbi çqetësimin që mbretron në Washington nr eth shvillimit të fundit t' Amerikës Qendrore. Shtetet e Bashkuara si duket pak nga pak, po çqetësohen se cerga e ngritur prej tyne nër shtetet e Amerikës së Mesme, po u rrëmbehet nga dora prej Moskës.

Kështu besohet se dihet më mirë në Meksiko mbi ngjarjet e Amerikës Qendrore, se sa në Wazhington. Në Meksiko e ashtuquajtura "Lidhja demokratike e Amerikës qendrore e përkrahur hapazi nga Qeverrija mbajti një mbledhje, nër të cilën muarnë pjesë edhe elemente marxistë vëndesh evropjanë. Nër fjalimet e mbajtur, u kërkua xhdukja e "Diktaturavet,, dhe ngritja e kufivet midis shtevet të ndryshme i ero amerikanë. Këta fjalime nxuarnë në shesh, në mënyrë të dukëshme, rrymat komuniste, të yshqyera prej ambasadorit sovjetik në Meksiko, Umanskij. Po në këtë kohë, gazetat veriamerikanë flasin hapur, mbi falimentimin politik të Cardell Hullit n' Amerikën Llatine.

Një ftesë q'i bëri Ministri meksikan i Mar nës achéut et r sovjetik ë Washington, vlen si provë se sa shumë interesohet Moska për çështjet e Amerikës Qendrore.

Nji urdhen i ri i Fuehrerit

Për bashkimin e të gjitha fuqive në Gjermani, për nji "luftë totale,, që asht e çpallun prej kohe, Fuehreri krijoi nji zyrë të ré me emnin "Zyra fuqiplotë e Reichut për fushina luftarake totale", tue emnue Dr. Goebelsin si kryetar i saj. I emnuemi fuqiplot do të përkujdeset që të gjitha çeshtjet publike të ken për qellim luftën totale tue vu në dispozicion t'ushtris për qëllimin e përbashkët të gjitha mjetet që nevojiten. Partija asht e ngarkueme me i përkrah këto masat që do të merren prej të ngarkuemit fuqiplot prej Fuehrerit.

Ginjeshtra engleze mbi përdorimi e robërve të luftës

Gjermanija i refuzon thënjet e Edenit, mbi ngjarje nër fush përqendrimi robrish

Qeverija e Rreichut i drejtoj Anglisë, me anën e Svicrës, një notë shpjegimesh në lidhje me ngajrjet në rdisa fusha përqëndrimi robërish lufte në Gjermani, nga të cilat, në marsë 1944, u arratisë një sasi e madhe robër englezë. Nota ka lidhje me fjalimin e Ministrit të jashtmë britanik, Anthony Eden, të 23 qershorit, në të cilën ay tha se robërit në fjalë u vranë në Gjermani. Nota gjermane ka këtë përmbajtje:

"Ministri i jashtmë englez bëri një deklaratë, më 23 qershor, mbi ngjarjet në fjalë, pa pritur përfundimin e hetimevet gjermanë, të cilën Qeverrija e Reichut e përginjshtron kategorisht. Ministrit të jashtmë të një shteti që filloi luftën e bombavet kundër popullsisë civile, që ka vrarë me mijra gra dhe fëmijë gjermanë në për banesat, spitalet dhe institutet kulturalë, nuk nër sylonesh terroristë, që në "Handbook of modern irregular warfare,, botuar, zyrtarisht, për "His Majestls Service,, u urdhërohet ushtarëvet englezë në mënyrë të pr me, të përdorin methodhat e gangsterëvet, si p. sh. t'u nxjerrin sytë kundershtarëvet të plagosur të shtrirë në tokë dhe t'ua shtypin kokën me gurë ministrit të jashtmë të një shteti të tillë, pra, i duhet mohuar e drejta morale të merret me në çështje kësodore dhe, agë më tepër të ankohet kundër të tjerësh. Dyke u ndodhur pëpara një pohimi kaqë të pavënt të Ministrit të jashtmë engles, Qeverrija e Reichut nuk e sheh të nevojshme të japë të tjerë shpjegime për sa i takon ngjarjes

Së laimërohet nga ara gjermane, me rrastin e masavet të rikapjes së robërvet t'arratisur, dolli në shesh dështimi i një tentativë të pregatitur me ngeh, dhe në ldhje me një fuqi të jashtme. Në rikapjen e të arratisunvet nga një fushë përqëndrimi, fuqitë e sigurimit gjerman, për arsye kundërshtimi ose orvatje ikjeje, nga ana e robërvet, u detyruan të përdorin armë. Kësisoj u vranë disa nga këta robër lufte. Mbi këtë ngjarje Qeverija e Reichut e vuri në dije Qeverrinë engleze, me anën e Svicrës.

Asgjë nuk e ndalon dot armën "V. 1.,,

Sekretarja parlamentare e shtetit në Ministrin e P. të Brëndëshme, Ellen Wilkinson, në një fjalim që mbajti në Manchester, iu drejtua veçanrisht Veriut t'Anglisë. Ajo **nuk kish ndërmënt të** përhapte tmer, me fjalët e saj, po rngulmoj të thosh se bomba fluruese gjermane ndodhen në fillim të veprimit të saj. Nuk dihet se c'rregë mund të bënjë "V. I." Ajo vetë e ka parë bombën **në** fluturim e sipër. Bomba e vazhdon rrugën e saj pa gabim dhe kur njeriu **e** sheh këtë e ndien, shpejt, se s'ka asgjë që mund t'a ndalonjë këtë armë. Atje ku ajo pëlcet, s'ka, veç se vdekje dhe çkatërrim. Gjendja në L'ondër është serioze dhe e vështirë. Fuqitë mbrojtëse dhe popullsia po kalojnë, nër Londë, prova fort të rënda. Gjatë ditës seicili i mban veshët ngrehur dhe na'ën nuk munt të dijë asnjeri i qetë. Kjo s'thuhet vetëm për Llondrën, por edhe për disa vënde të caktuara në Kontenë Kent dhe të tjera Kontë t' Angli ë Jugut, nër të cilat popullsija është gjithënjë në rrezik, qysh prej fillimi të Bombës "V. I."

A ka Anglia të drejtë t' ankohet?

N' Angli po mundohen t'a quajnë armën t'onë të Hakmarrjes «V. 1.» si një armë terrori. Atje thuhet se me këtë armë nuk muat të qëllohet me saktësi dhe këtë e provon fakti q' ajo s'është vënë në përdorim në frontin e invadimit dhe n'ate të Lindjes. Ne themi se «V. 1.» është një armë largësije dhe përdoret kundër objektivave ushtarake.

Por, në përdorimin e një arme me rrëzë efekti aqë të gjërë, s'ka mundësi që të mos preken edhe objektiva civilë. Më së fundi janë pikërisht Englezët ata që s'kanë asnjë të drejtë të ankohen për terror, se ata vetë kanë muaj që po e sbatojnë terrorin kundër popullsisë civile, si një nga ligjet kryesore të luftës së tyre.

Mbi këtë shkruan edhe gazeta provinciale svedeze "Upsala,, duke thënë se Englezët pas sulmevet të tyre terroristë kundër Gjermanisë, s'kanë, tashti as një të drejtë të zemërohen mbi armën gjermane të hakmarrjes. Ka më tepër se dy vjet që bëhen sulme terrori kundër popullsisë civile gjermane, me lloj lloje mjetesh të rafinuar, si hedhje në shumicë bombash me fosfor. Veç kësaj, s'ka njeri që t'a mohonjë se anglo-amerikanët nuk do të përtonin asnjë çast të përdornin një armë të këtillë, po t'a kishin.

Edhe vetë bregdeti lindor amerikan nuk munt të quhet i sigurtë nga përdorimi i këtaj bombe vdekjeprurëse, fantastikon "Philadelphia Inquirer,,.

SHTYLLA E LIRË

Marrim e botojm:

Për popull e shtet, a po për xhep të vet?

Ash për të vajtue ditë e natë mbi fatkeqësin që po rrethon popullin t'onë, dhe mbi rrezikun që po e çon me hov të pandalueshëm në shkatrrimin e plotë! Populli shqiptarë permbi të gjitha vuejtjet e së kaluemes, po merr edhè grushte të pà mëshirshme mbi kurrizin e tij plot plagë!

Jo zotnì jemi në zgrip të vorrit, e duhet të flasim kjartas. Fajin nuk na e ka kush tjeter vetem se na vetë, se kerkojmë t'i qesim syt njeni tje trit; të perfitojmë në kurriz të popullit tue çue ujtë sejcili në mullì të vet, pa marrë parasysh as mjedimin e popullit dhe as interesin e Atdheut! Vendin e kombësìs e ka xanë interesi, intriga, shpifja e sà e sà të zeza të tjera që po ia pregatisin vorrin ksaj Shqipnije të shkretë, aq sà nuk durohet ma e duhet t'i shpervilemi punës me nji operacjon kirurgik të ngutshëm tue prè gishtat, doren, e së fundit edhè krahun që të pshtojmë trupin prej kangrenës.

Kush e prunì Shqipnin në ket katastrofë?

Shqiptarët me dy lugë në brez: Shqiptarët intrigata, e shqiptarët spekuluesa! Le të spjegohemi:

Me dy lugë në brez, kemi ata burra asbtu të quitun atdhetarë që presin bah të dalë sahani me pershesh (ju ngectë në fyt),

Intigranta, kemi disà tekahyllë të fyshkun si mumjet e Misirit, që nuk duen të punojnë se nuk iu vjen per duersh asnji pumë, dhe na kaperdisen si në kohen e Sulltanit, tue ia qà ballin ksaj Shqipnije che arnaut mileit, me lot të kokodrillit.

Spekuluesa, janë prej atyne që presin gjithnji tym e njegull, për me gjriejtë peshk n'ujët e turbullt.

Këto tri kategorì janë që e kan mjelë ket vendin e shkretë; që i kan shtue gjithnji benzinë zjarrit që po pervlon vendin e popullin e pafajshëm; kto tri kategori mikrobësh mund të themi haptas e kan shterngue djelmënin idealiste të kapin malet, e vjete me radhë të sakrifikojë jetën e njomë rëpër ferra e shpella me sakrifica ma ekstreme, tue iu vue edhe vulën në ballë se janë komunista, se ashtu u leverdis.

Ndërsa kta zotni kaperdisen nëpër vende ma luksoze, me birra të ftofta, e ushqime ma të zgjedhuna, tue luejtë pecker e bakara me flori, popullsija e jugut dhe vendeve të ndryshme e goditun prej fatkeqësis të luftës po shtin dorën për nji kashatë bukë! Ndersa kta zotni shtrihen mbi kulltuk me duhan e muhebet, grat e fmit e vendeve të mjerueme janë grumbullue në Bashki për të kërkue ndihmen ma kryesore, bukën!

Ndërsa kta zotni flejshin me kalorifer dimnin e kaluem, të mjeruemit ishin grumbullue nëpër dhomat pa xham të shkollave ra zjarr e mloje!

Ndërsa kta zotni han pin e ngopen me l'oj lloj gjellnash, popullit përgjithësisht i vjen mendja vërdall që të sigurojë bukën e that!

Kta çje, kta sot kta mot. Mjaftë ma, nuk durohet që për nji gisht të kalbet trupi i ksaj Shqipnije shumë të vuejtun!

Djelmëni shqipëtare! Koha asht që të bashkohesh prej kah do që jesh tue lanë çdo ideollogji të huejen, dhe nën hijen e Flamurit kombëtarë, me qellime thjeshtë kombëtare, të vish në ndihmë kombit tand, në rrezik të fundit. Tregoju ktyne zonive se vula që t'a kan vue në bali se ashtu u leverdisë, nuk ka vend në shpirtin tand therori, dhe n' idealin tand thjeshtë kombëtarë. Mos u terhiq prej hundësh prej njerzve të shitun. Ktheu në prehrin e Atdheut, spastroje prej mikrobeve.

Robrit Italian të luftës kthehen në punëtorë të lirë

Bisedimi midis Fuhrerit dhe Duçes në Kuartierin e P. të Führerit

Nër ditët 16 gjer 20 korrik, Duçe-ja bëri një udhëtim shqyrtimi ndaj Divisionet italjane që po shërviten në Gjermani. Duçja u dorëzoj Regjimentevet italjane, flamurët përkatës, u drejtoj trupavet një fjalim dhe u prit kudo me manifestime të mbëdha dhe me enthuziazmë. Në mbarim të udhëtimit të tij, Duçja vizitoj Fuehrerin në Kuartierin e përgjithshmë Bashkëfjalimet midis të dyve u xhvilluan me përzemërsinë më të madhe. Fuehreri dhe Duçja muarnë në shqyrtim gjendjen dhe biseduan, midis të tjerash, mbi çështjen e robërvet italjanë të luftës U caktuan vijat kryesore për zgjidhjen e këtì problemi, me kuptimin e interesavet morale dhe materiale të të dy vendevet. Kjo zgjidhje parashikon që robërit luftarakë italjanë të kthehen në gjendjen e punëtorëvet të lirë, ose të përdoren si fuqi ndihmëse në veprimet e Wehrmachtit gjerman.

Nër bisedimet e Kuartierit të përgjithëshmë muarnë pjesë edha marshali i Reichut Herman von Göring, ministri i P. të jashtme von Ribbentrop dhe gjeneralifeldmarshalli Keitel. Nga ana italjane marnin pjesë Marshall Graziani dhe Nënsekretari i Shtetit për P. e jashtme, Konte Mazzolini. Ambasadort gjerman n'Itali, Rohn, dhe ambasadori italjan në Berlin, Anfuso, e shoqëronin Duçen n'udhëtimin e tij.

Sherbetorët e Moskës në Ballkan

LISBONË, Qershuer. — Për fletorarni amerikan Ray Brock, — i cili tue qenë korrespondent i "International News Service. në Kajro, ka mujtë me vërejtë lodrën e Moskës në Ballkan, qi ndihmohesh prej Anglis. — qëllimi i politikës sovjetike në jug-lindje t' Europës esht i kjartë: Fushtim nga ana e Armatës sovjetike, plebishiti theatral i popujve dhe vendosja e të gjitha vendeve të Ballkanit nën bashkimin e Shteteve Sovjetike. Në nji grup fletorësh amerikane, si edhe në "New York Journal American,, fletorari i sipërm boton zbulime sensacjonale mbi mënyrën se si Anglija i rdihmon bolshevizimit të kësaj pjese s'Europës me politikën e vet të lajmeve. Censura britanike e lajmeve ne Kajro, së cilës i duel boja me cungimin e lajmeve të konferencave të Kajros dhe të Teheranit, len me kalue lajme mbi ngjarjet në Ballkan, qi janë të dobishme vetëm për bolshevikët.

Cdo kritikë, qi mund t'i bahet në ket mes politikës së jashtme të Londonit të Washingtonit, nuk lejohet. Brock shkruen tekstualisht: "Në veprimtarin t'eme si korrespondent i "International News Service., në Ballkan, në Turki dhe në Kajro i kam lexue dhe dëgjuem ndalimet dhe udhëzimet e Londonit e të Washingtonit, qi janë dhanë si me shkrim ashtu dhe me gojë. Censura në Kajro, jo vetëm qi mshefë të gjitha lajmet qi janë në dobi të Mihajloviçit, por edhe kërkon me hapë lajme të rreme per mbi kryetarin e Bolshevikëve Titon, me që llim qi me e perkdhelë. Stalini qysh prej vjetit 1942 kerkoj prej Anglis e prej Shteteve të Bashkueme qi mos t'i epej asnji ndihmë Mihajloviçit. Këtë gja mujta me e konstatue prej burimesh të sakta si edhe prej atyne të spiunazhit anglez. Agjentat e paguem prej Moskës, si p. sh, njifarë Louis Adamic, janë tue ba për Titon reklama n'Amerikë. Asht për t'u çuditë se si opinioni publik amerikan ka muejtë me i besue kësajë dredhije. T'ashtuqujtunat komunikata gjoja të sukseseve të Titos janë krejtësisht të rreme dhe t'ujdisuna me dinakëri. Radio qi i përhapë këto lajme nuk gjindet në Jugosllavi e as në Ballkan, por në Tiflis, e cila asht në sherbim të Bolshevikëve. Me gjith se këto fakte i njofin mirë redaksinat e gazetave amerikane e angleze, i botojnë këto lajme të rreme sepse janë të detyruame prej Zyrës së Jashtme të Washingtonit e të Londonit.

Në lidhje me këtë gja Brock ban nji kritikë dermuese mbi politikën e jashtme t'Anglis: "Për oportunizëm politik Anglija i lëshon pë metodave të presjonit bolshevik në Ballkan për me muejtë me pasë nji farë ndikimi n'Europën prendimore, n'Afganistan e nder vendet arabe. Ky qëndrim i ndryshuem i Anglis në politikë, të gjithë ata, qi kerkuen ndihmë n'Angli, i ka lanë si pula të lagëta. Fjalimi i Chmrchillit me 22 Fruer dishmon kjartë se Londoni i asht nenshtrue Moskës në të gjitha kërkesat e Ballkanit. Rezultati i këtij dredh mi anglez ka qenë ndërpremja e bashkëfjalimeve të Shtabit Madhuer anglo-turk. Askush nuk mund t'ua marri për të keq Turqëve në qoftë se ata nuk duen t'i binden vullnetarisht falit qi e pësuen si Polonija e Jugosllavija mbassi ata vetë e panë trathtinë anglo-amerikane kundrejt të besëlidhunve të tyne,.. Pjesa ma e madhe e shtypit anglo-amerikan asht ba mbas urdhnit të Sherbimeve Zyrtare t'Informatave të Londonit e të Washingtonit, sherbëtorja e kësajë politike sovjetike. Cdo dackë e dhanun prej Moske pranohet me përulje.

PUSHTET PA HIR

Në kufijt lindorë të kontinentit t'onë u paraqit "gura gjigande e „Çekistave„ **bollshevik. Kjo ndoqi armatat sovjetike** nga vo ga tue ardhë nëpër Dnjeperin deri te Dnjepr Petrovsk. Vërë cizmën e këtij gjiganti **të gjitha krijesat e dobishme, njerëzore e shkelën atë që administrata gjerndor prapë ka fillue të bëtasë po njashtu** mane qe mundue me i bam ato pronë në dobi të popujve të lindjes. Mjerimi në krahinat që p o hen nën pushtetin e lisikurse në kohën e vdhve të katastrofës së madhe. Disa veshëve europjanë këto britma u tingëllojnë të forta e prandaj lisuin me dëshirue me u mbyll përpara këtyne britmave, por nuk ka shpëtim prej tinguive dhe bija e "çekas,, asht tue ra gianësishtë mbi krejt kontinentin. Gjinden europjanë të cilët terrorin bollshevik në Ukrainë, në Rusi dhe në Ruthenin e bardhë e kqyrin sikur t'ishin nji falimentim i madh i sundimit sovjetik 25 vjeçar në jerevin e botës së qytetnueme. Por sikur t'aludojmë përmbi hijen e "Çekas,, dhe t'u thomi se Komisarët sovjetik kërbaçin, revolverin e mjete të tjera të terrorit nuk i lëshojnë prej dore as në Budapest, në Berlin, në Paris, në Zurich, në Stokholmë e gjetkë atëhere ata bajnë nji përqeshje të pagjishme me ato të vëllazënve Karamazov tue mos e besue se Rusët përgjithësisht edhe popuj të tjerë të lindjes kanë nji shpirtë sadizmi dhe mund të thuhet se edhe vetë Dostojevski ka të njëjtat karakte i tika shpirtnore edhe kryetarët e mëdhenj të G. P. U. sikurse Dzershinski Jagoda dhe Manuilski. Këta naivë të përjetëshëm besojnë se me meditacjonet të moramjes mund të kuptohet fryma e sistemës bolshevike. Ata konfundojnë krejtësisht karakterin e vërtët dhe qëllimin politik të masakrës së turmave, të cilën çifutënit e plot fuqishëm të Kremlinit e kanë kultivue deri në nji sistem të përsosun, dhe e cila mundë të niehe në radhën e atyne mieteve që përdoren për mbajtjen e pushtetit bolshevik sikurse po përdoren drejtimet staliniane në propagandë dhe në politikën agrare të ekonomis së Kolkozeve.

Terrori bolshevik i ngjan asaj urreitjeje të përmendun në dhiatën e vjetër që kishte populli cifut kundra botës jo çifute. Por ky terror i ngjëtun në shkallën e nji instrumenti politik mjerisht për shpirin Europjan asht ende i pa kuptuar dhe i pa llogaritun në krejt peshën e vet. Sovjetët në ç'do kraihnë që ata ripushojnë vijnë me xhepa të mbushura me plane ku mandej pushteti i tyne mer trajtat e zakonëshme për me tërheq të gjitha taksat që ata dëshirojnë. Sikurse kërkohet p. sh. prei Komisarit të hekurudhave pregatitja e nji sasie lokomotivash e vagonash sikurse të ngarkuemit me punën e bujqësis i kërkohet të prodhojë nji sasi të caktuem prej patatesh, misri ose gruni e sikurse p. sh. kërkohet prej të ngarkumit me mbi kqyrjen e industrive të vaqojë ci cas mijrave të mamalt'me ni' ashtu kërkohet edhe prej shefit të G.P.U. prezatitja e nji liste të atyne që duhen vra, dhe prezatitja e nji liste të atyne të cilët duhen deportue kah Siberija.

Kush pandeh n' Europë se terrori bolshevik ash'të nji mjet shës i keq e kush presupozon se "Çekisti,, nuk e ndjek ushtarin bolshvik ai ashtë nji vrrejtës i keq i praktikës bolshevike i asaj praktike që tash prap mbas disa muejësh të gjatë u partoit në krahinat kufitare t' Europës lindore. **Shpesh nuk kalojnë ma tepër se 24 orë dhe aparati i kontrollit** dhe i likundimeve të G.P.U.-s. lyn në veprim dhe **mortja fillon të korrë, njeriu sikurse i ka vërrejt vetë me sy këto ngjarje shkruësi i këtyne radhëve bahet si** një plaçkë. Për Europën perëndimore GPU. **sigurisht qysh tash i ka pregatit listat e atyne që i ka në sy për të likuiduar. Europjanët e perëndimit le të jenë të sigurtë se Moska këtë listë e ka shum** ma të gjatë për në perëndim të kontinentit se sa në lindje.

Bolshevizmi asht nji pushtet pa mëshirë, ai s'ka mësue gja në Rusi prej Dostojevskit. **Sigurisht nuk ka me u influencue aspak prej shpirtit të populit të europës. Kështu as në Svicer s'ka me u bam besnik i traditave as edhe liberalizmit** në Suedi s'ka me e respektue. Në **Francë nuk do të ketë asnji kuptim për idetë e 1789-ës** dhe as edhe idet angleze të Whigve e të Toriesve nuk kanë me e shmang prej drejtimit të vet.

Kombet që s'kan nonjë karakter të dalluar natyrisht mund të llogarisnin në miqësinë thelbësore të bolshevizmit **por të gjithë popujtë e tjerë të cilët kanë** nij karakter të veçantë do të pësonin ndrydhie në: nji kolektivitet që përbahet prej qytetarësh të nji llojit e të pa personalitet të dallum që formon idealin e Moskës.

Njerzit e kontinentit t'onë, të cilët shekuj me radhë janë mësue t'a kqyrin botën në format e zakonshme, janë të aftë për me besue se asnji fuqi mundet të fshijë prej shpirtit të tyne shenjat dalluëse të europjanit. Por këta naivë të kohës s'onë të mos e besojnë se qendrat e punës së detvruëshme që kanë krijue sovjetët nji ditë mund të mbyllen për shkak se ndonjë herë mund të tej mbushen.

Disa europianë besojnë se ndofta në rasën ma serioze me bindje e me sjellje të mirë përkundrejt terrorit bolshevik, ky terror mund të ndrojë mbassi studiuesit e drejtësisë janë tue mësue qysh prej shekuish se asnjeri nuk mund të ndiqet pa u givkue. Këtyne naivëve u rekomandoimë të këndoinë givkimet e dhana prej givkatoreve bolshevike, të cilat në vitin 1941 në Le'oni janë shqiptue për vrasien e nji numuri të madh qytetarësh. Mund të shkruhei një libër me ato fjalë të thata të cilat përmbajnë givkimet e kota që formonin bazë për të shue jetë njerzish.

Ja p. sh. "pushkatohet X sepse i urren puntorët,, Në nji vënd tjetër mund të kën doimë: "Likuidohet me konop se ka kënduar kangë kombëtare letone.. Nji givkim me vdekje përban këto fjalë: Duhet pushkatue se ka frymë kundra komunizmit. Shumë jurista europianë tue i lëxue këto givkime e vendime do të cuditeshin sepse ata kanë harxhue nji kohë të gjatë për me studiue drejtësi në universitet. E ndofta do të gjindet nonië këshilltar kuqore n'Angli i cili do të bante propozimin që kjo procedurë e hjeshtë sovjetike të shtohej edhe në Angli. Mbasi asht kaq e thjeshtë sa mbas dy tre pyetjesh mjaftohet për me e gjet shkakun me të cilën të dënohet me vdekje nji njeri i fuzem i cili në të vërtetë nuk ka ba kurgja. Nji procedurë e tillë natyrisht nuk jep asnjë mund.

Masakra e masave si nji mjet politik dishmon se nën sundimin e sovjetëve e drejta asht shfronësue. Ku sundon pushtetisovjetik, ajte kodet nuk pijnë ma ujë, ato janë vetëm letra të mykuna. Bolshevizmi vetëm nji të dre'te njeh d. m. th. atë të cifutëve. Kontinenti i onë nuk duhet aspak të gënjehet prej mimetizimeve të bolshevizmit por ai e ka kuptojë kjartë në qënjen e vet këtë rrezik dhe ka marrë të përëndrunme të krejt kontinentit që përmban po thuaj 400 milion njerës, ti bjerë e t'a shpartallojë.

Pas si t'a këndosh këtë gazetë, jepe më tej. Do të të jenë mirënjohjtës veçanërisht shokët e tu ndër male.

Reakcion i pa pritur

Si pas thënjevet të robërvet, komandat e punës dhe seksionet e Partisë komuniste të nisisë Lisa, pushtuar prej Komunistëvet, vendosnë të çpallnin grevë, në shënjë proteste për bombardimin e Spalatos. U xhvilluan zihje të përgjakëshme midis komunistëvet dhe Englezëvet. Shumë komunistë u vranë. Komandat e punës, si pas thënjevet të robërvet, janë gati t'a fillojnë përsëri punën, në rast se anglo-amerikanët japin fjalën të mos e bombardojnë më qytetin e Spalatos.

Në Ballkan xbulohen dhe asgjësohen ceta të ndryshme komuniste

Në Malin e Zi, fuqitë e sigurimit gjermane e vazhduan, me sukses, ndjekjen e çetavet të goditura rëndë në krahinën e Andrijevicas. U pushtuan disa bregore të mbrojtura rreptësisht. Pjesë të divisionit 37 komunist, që shtyhëshin përpara, prej krahinës Plevje, u çprapsnë me humbje të rënda. Në lindje të Ostarit shumë grupe u sulmuan dhe u asgjësuan. Reparte gjermano-kroatë shtrënguan, së bashku, një grup banditësh, që ishin tërhequr nër malet Mostar, dhe e shpartalluan. Në Bosnjën qendrore u vazhdua ndjekja e bandavet, që tërhiqëshin drejt lindjes, prej njësish të divisionit alpinist, kësisoj u ndoqën edhe pjesë të bregadës së XX. Reparte Ustachinë veri të Bihac, sulmuan, në befasi, një çetë që ndodhej gjithënjë në ikje, dhe e shpartalluan. Numuri i desertonjësvet të kapur në krahinën Cazin u shtua, në njëditë, edhe 70 të tjerë, dyke arijtur terës-ishl në 300 veta.

Lajme të ndryeshme

Ambasadori i Shtetevet të Bashkuar pranë Vatikanit i dorëzoj Papës një letër personale të Rooscwellit, me të cilin Presidenti amerikan i lutet Atit të Shënjtë t'a presë, me rastin e vizitës që ay do të bënjë në Evropë. Kjo tregon se çfar vlefte u jep Roosewelti votavet të Katolikëvet të Shtetevet të Bashkuar me rrastin e zgjedhjevet të afërme presidenciale.

Si pas tregimevet që bëjnë robër anglo-amerikanë, repartet aleatë u godiën aqë rëndë në rrethin e Caen, sa që humbën, ose patën jashtpërdorimit gjer më 60 për qint të forcavet të tyre.

Nër qarqet diplomatikë të Llondrës llogaritet me një vizitë të shpejtë të Roosveltit n' Angli.

Nga shkaku i zjarrit të "V. 1.. n'Anglinë jugore nuk ka ma birrë, njoftoa "Daily Express,. Gratë dhe të vegjlit që punonin nër fabrikat e birrës u larguan shpejt nga Anglija jugore.

Ministri i Jashtmë i Sh. të Bashkuar, Hull, njoftoj se në Washington, do të mbahen, në gusht, "Mbledhje preliminare mbi Organizimin e një autoriteti sigurimi botnor". Ay shtoj — dhe kjo është fort karakterisfike — se në këto mbledhje nuk do të marrin pjesë përfaqësonjës sovjetikë dhe të Tschungkingut.

Ambasadori i ri ungares në Finlandë, Franz von Morasy, i cili, gjer tashti përfaqësonte vendin e tij në Kroaci, arrijti në Helsinski. Ay u deklaroj përfaqesonjësvet të shtypit se n' Ungari është vendosur, nënë udhëheqjen e Regjentit Herthy të luftohet gjer në fitimin kundër Bolshevizmit, krah për krah me Gjermaninë. Ay e bëri udhëtimin e tij për mes Gjermanisë dhe Danimarkës dhe kësisoj pati rrastin të bindet plotësisht, për qëndrimin e fortë dhe të sigurtë të popullit gjerman në luftën e tashme decisive.

Çetat "përkrahin,, popullsinë civile

Dragen N. ish komisar politik i Komp. së parë të Bat. të parë të Brigatës së XII-pas si shpëtoj nga bandat, tha, midis të tjeravet: "Si komisar politik, unë u ngarkova me "përkrahjen,, politike, dhe kulturale të popullsisë civile dhe të luftëtarëvet, Por as që munt të flitej për një përkrahje të vërtetë pas si mua, për këtë, nuk m' u dhanë mjetet e nevojshme. I jepej rëndësi e veçantë mbajtjes në t' errët të popullsisë civile mbi karakterin komunist të "Ushtëris çlirimtare të popujvet".

Për të qeshë

Me grà fjalë të shkurta

"Besa besë grave duhet me ia u prè shkurt. Dje isha në pllazh, dhe i futa një alamet shpute një princesës."

"Po pse?,,

"Pse më rrejti. Ajo nuk ishte princeshë?,,

Në mes dy grave

E para: "Marshallà sa foshnje e kandëshme! Le pa i gjaska krejt babës së vet, Ftyra e tij në vend!"

E dyta. "Ah e lumja un po të jetë ashtu, se foshnja asht e nji shoqes t' emë!"

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Hënë 31 Korrik 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 14 - ÇMIMI 1 LEK

Shqipnija Ethnike Ideali Kombëtar

Kryeministri DINE përpara Parlamentit. "Mbi gjithshka qëndron ideali kombëtar.,, Vllaznimi shqiptar n' emnin e Atdheut.,, "Shteti shqiptar duhet të qendrojë me çdo kusht e me çdo sakrificë.,, Qeverija do të përpiqet për shërimin e plagëvet morale dhe materiale të popullit.

Këlë javë u ba mbledhja e Parlamentit Shqiptar për me i dhënë Qeverisë Dine votë besimin. Me këtë rast në Parlament ishin mbledhë nji grumbull i madh autoritetesh e personalitetesh të nalta shtetnore. Lloxhat anës dhe në fund si dhe galerija e Parlamentit ishin plot. Çquheshin ndër këto autoritete të nalta si nga ana e Këshillit të Nallë ashtu edhe të Qeverisë. Qenë prezent komandanti i Mbrotjes Kombëtare me gjeneralë të tjerë, gjeneralat e ushtris gjërmane në Shqipni, ministri i Gjermanis, trupi Diplomatik dhe Konsullor, autoritete fetare të tri besimeve. Pikërisht n' orën 18 Kryetari i Parlamentit i pasuem prej kryetarit të Qeveris së re Shkelqesës Fiqri Dine, bashkë me shokët e tij hynë në dhomë të pritun me duar trokitje të nxehta.

Shkëlqesija Mihal Zallari i dha pastaj fjalën kryetarit të Qevesisë i cili ligjëroj programin e Qeveris së ré ; ja pikat kryesotë programit :

Zotni të Ndershem.

Përpara se t'u futem me më dhanë votëbesimin, me lejoni të parashtroj, në vija të përgjithëshme, mendimet themeltare që do të udhëzojnë veprimet t'ona ne lidhje me mundësitë e dhaauna prej gjendjes së t'esaj lufte që gjigantët po vhvillojnë në mes të tyne e që drejtazi e tërthorazi kanë prekë thellësisht edhe vendin t'onë sa në sheshin landuer, aq n'atë shpirtnuer.

Mbi gjithshka, Zotni deputetë, qëndron ideali kombtar: Kombi Shqiptar, tansija ethnike shqiptare, vllaznimi shqiptar n'emnin e Atdheut, rendi publik dhe përparimi.

Asht detyrë e gjithsecilit prej nesh dhe e të gjithëve së bashku t'i a përshtasim metodikisht veprimet t'ona këtij ideali të përbashkët që për ne asht Shqipnija ethnike.

Tue pasë gjithnjë këtë qëllim, neve do të qëndrojmë besnikë vehtes t'onë e njani tjetrit, e thërthorazi do të qëndrojmë besnikë kushteve të pushteteve të mbëdhaja ndërluftuese dhe do të jemi korektë me fqinjët t'onë.

Zotni deputet.

Shteti Shqiptar, i dalun më 14 Shtatuer 1943 mbas tragjedisë së 7 Prillit 1939, asht një shtet asnjanës.

Ndodhja e trupave gjermane në Shqipni qysh me kapitullimin e Italisë më 8 Shtatuer 1943, ka karakter të përkohëshëm të caktuem nga kushtet e luftës. Këtë fakt do t'a shikojmë në dritën e mikpritjes dhe të parimevë tradisjonale shqiptare, parimë e ndjenja këto të forcueme edhe ma nga ndihma shpirtnore e landore të paçmueshme që populli gjerman ka dhanë për vendin t'onë në rrethana të ndryshme.

Do të jetë kujdesi i Qeverisë me ba çmos me mënjanue çdo keqkuptim e çdo ndërlikim në këtë drejtim. Qeverija ka me ba çmos me ndriçue e me apelue opinjonin e jashtëm mbi sa ma sipër për me muejt me i kursye kështu vendit t'onë nji shkretnim e nji shembje ma të madhe nga ajo që kemi pa deri sot.

Në anë tjeter besojmë se do të kenë formue bindje edhe Aleatët, se kontributi i gjekut e i sakrificave që ka bamë populli shqiptar asht tepër i math e se nuk do të kërkohet prej nesh shembja edhe e themeleve të fundit.

Cdoshqiptar e shqiptare për hirin e Atdheut duhet t'i muejnë ato pasjone që na sjellin mosmarëveshtje e grindje. Apelin ja sjellim kryesisht intelektualëve, të cilët janë velëdijtës dhe e kanë për detyrë me shue e jo me huell benzinë në zjarm. Në mes të intelektualve na shofim në radhën e parë rininë t'onë, e cilla qendron në krye të idealizimit e të ndjenjave. Një apel të veçantë i sjellim prandej kësaj rini kur i kujtojmë se në lamën politike duhet të shohim realisht e jo të verbohemi nga sentimentet.

Zotni deputet.

Fatbardhësisht ma se 90 për qind të popullit shqiptar ka vetëm vetëdijen e ruejtjes dhe mbrojtjes së Atdheut ndër kufit ethnike.

Zotni të ndershëm.

Cdo tendencë politike me marrë me forcë pushtetin shtetnuer o me pregatitë një ndërmarje të tillë, dhe kur them kështu mendoj në radhë të parë partinë terroriste, asht një atentat kundra Atdheut, sepse provon mungesën e idealit kombëtar.

Kësaj ryme, Qeverija me të gjitha mjetet e saja do të mundohet t'ia presi hovin.

Qeverija, do të marí masat ma të mira për mbajtjen dhe zhvillimin e Autoritetit Shtenuer.

Shteti Shqiptar i pështetun në idealet kombëtare, duhet të qëndrojë me çdo kusht e me çdo sakrificë.

Ballë një ekonomisë së kufizueme e që vorfnohet për dilë e ma shumë, qeverija do të mundohet me çdo mjet të paksoj gjendjen e shpenzimeve e të përmirësoj gjendjen e të ardhunave..,

Në mbarim të fjalimit të Kryeministrit moren fjalën deputetët, Kacimbra Lefter Kosova dhe Xhelal Mitrovica, fjalimin e këti të fundit po e botojmë tekstualisht në një shtyllë tjetër.

Mbas fjalimit të zotit Xhelal Mitrovica Kryetari i Dhomës Shkelqesa Mihal Zallari deklaroj se Qeverisë të kryesueme prej Shkëlqesës Fiqri Dine i jepet votë besimi me unanimitet. Mbas kësaj Shkelqesa Kryeministri mbajti një fjalim të shkurtër tue falënderue Dhomën për besimin q'i u dha dhe kërkoj ndihmën dhe përkrahjen e intelektualëve dhe të popullit shqiptar.

Fuehreri është në dorën e Zotit

Ministri i Reichut, Dr. Goebbels zbulon origjinen e atentatit kundër Fuehrerit. "Mosplotsimi i dëshirave t' armiqvet t' anë. "Masa themelore dhe armë të ra sigurojnë fitimin e fundit,,

Ministri i Reichut, Dr. Goebbels, i dha me anën e radios, popullit gjerman dhe botës, shpjegime mbi atentatin kundër Fuehrerit dhe nxori në dritë rrjedhimet përkatës.

"M'u desh të prisnja disa çaste, tha Ministri Goebbels.., gjer sa të xbulohej e gjithë origjina dhe rrethanat e veprës kriminelë. Tashti është rrasti, S'ka gjë për të fshehur ose për të kursyer. Vetë ngjarjet flasin fare kjartë.

Kur m'u njoftua krimi i poshtër me anë telefoni nga Kuartieri i P. i Fuehrerit, më ngjau pikërisht ashtu si i ngjau më von të gjithë popullit gjerman. M'u duk sikur po më ikte toka nga këmbët. Por pastaj zemra ime u mbush me një mirënjohjtje afro fetare, sublime. Unë e kisha ndjerë shumë herë, por kurrë jo kaqë sa këtë radhë, që Fuhreri po e plotëson veprën e tij nëse mbrojtjen e Zotit dhe që asnjë poshtërsi nuk munt t'a ndalonjë e t'a pengonjë. E ndjeva edhe një herë, më shumë se kurrë, se që një paralajmërim hyjnor që vepra do të kryhet, me gjith vështirësit e mbëdha që takon; ajo do të kryhet, se duhet të kryhet, ajo do të kryhet, se munt të kryhet dhe prandaj ajo do të kryhet.

Sa po pas atentatit .

Klika trathëtare filloj, ashtu si e prisnim, t'i shtrinte penjët e saj. Atentatori, nje kont Stauffenberg, kish arrijtur, nder kohë, në Berlin, me një aeroplan të posaçme, dhe kish perhapur lajmin e rremë se Fuehreri kish rënë viktimë e atentatit. Me pretekstin që të mbronin drejtimin politik të shtetit, trathëtarët i dhanë urdhër Bataljonit të Rojës së Berlinit të rrethonte Kuartierin qeverritar.

Bataljoni i rojës në krye të detyrës

Ata kishin harruar se Bataljoni i rojës, ashtu si të gjithë repartet e tjerë t'ushtrisë përbëhej prej Nacionalsocialistësh fanatikë dhe se Komandanti i tij, Majori Remer nuk bëri gjë tjatër, veç të vinte sa më shpejt nek unë, për të marrë udhëzimet dhe spjer gimet për mbi ngjarjen. Majori Remer u lith shpejt me telefon me Fuehrerin, që nga tryeza ime e punës dhe mori direkt prej atij urdhëra të prera e të çkoqë. Këta urdhëra thoshin që të shtyp[illegible] me shpejtësi klika e trathetarevet dhe këta të kapeshin.

Brënda pakë minutash, Bataljoni i rojës grumbullohet në Kuartierin qeverritar. Unë sulmohem nga të gjitha anët, për të mos ia lënë nonjëj reparti tjatër nderin e larjes së turpit me gjakun e trathëtarvet. Ndërkohë paraqiten komandantët e repartevet të ndryshëm të Berlinit dhe të Qarkut dhe sicilido përpiqet si e si t'a marrë vetë barrën për xbulimin dhe çfarosjen e folesë së trathëtorvet. Me këtë barre ngarkohet Bataljoni i Rojës. Përnjëherësh ziren banesat e trathëtarvet, pa u shtënë as edhe një pushkë e vetëme. Ata çarmatosen shpejt dhe tashti janë strukur në një zyrë, dhe mundohen, të dëshpëruar të paraqiten si Qeverri. Një gjyq i posaçmë, i formuar aty për aty, i dënon fajtorët e padyshuarshmë me vdekje, ndërsa të tjerët arrestohen. Trathëtarët shkelës të betimit pësojnë, në obor, vdekjen e merituar, dhe kshu mer funt e tërë çështja

Asnjë ushtar nuk u trondit

Kursemëni nga hollësira të tjera. Nuk duhet t'a ndjenjë për turp asnjë ushtar, dyke mbajtur po atë uniformë që mbanin edhe anëtarët e klikës së poshtër, ose që s'kishin të denjë t'a mbanin. Uniforma e ushtërisë gjermanë përfaqesohet nga qindra mijra ushtarë gjermenë të cilët me të, gjetën një vdekje heroike për Fuehrerin dhe për popullin, ajo përfaqësohet nga milionat të tjerë që ndë dhe dë të qëndrojnë në front, gati për të dhënë jetën e tyre për kombin, dhe jo nga këta embiciozë të poshtër. Asnjë ushtar si në ballën e luftës ashtu dhe brënda në tokën e Atdheut, nuk u trondit asnjë çast, gjatë këtyre ditëve kritike, në besnikërin e tij kundrejt Fuehrerit, kundrejt Regjimit dhe kundrejt popullit gjerman.

Marifeti i kundërshtarëvet

Mua më kish rënë në sy, prej muajsh që shtypi kundërshtar rënvizonte, me ndërprerje të rregullisht me, se armiqtë kishin në dorë edhe një tjetër "marifet,, për sa i përket zhvillimit të luftës. Në Londër, Washinglon dhe në Moskë ngulmohej thënë se, ne Gjermeni, një [illegible] Oficeravet të nallë, mbretënonte një farë opozite, dhe gjithenjë përmendeshin emra të saktë, të cilët dualinë në shesh tashti me rrastin e tentativës kryengritëse të 20 korrikut. Por nuk është kjo e vetëmja provë që kriminelët ishin, në bashkëpunim me armikun dhe vepëruan për llogari të tij. Fakti se në atentatin kundër Fuehrerit u përdor eksplosiv origjine engleze, se atentatori kish lidhje të ngushta me aristokracinë e lartë angleze, se shtypi Londrës, pas lajmërimit të atentatit, kish çfaqur shpresën se ngjarjet e 20 korrikut do të sillnin shpejt, përmbysjen e Reichut, nuk le pikë dyshimi mbi origjinën e krimit, qoftë edhe se u gjetën vegla që mbanin emrin gjerman, për ta kryer. Por ata u gabuan të gjithë në llogarit e tyre. U gabuan në vlerësinë e popullit gjerman, të ushtarit gjerman e, mbi të gjitha, në vlerësinë e lëvizjes nacional-socialiste. Ata u gabuan se me ne, fundja, nuk munt të lohet po ajo leder q'u lejt me Badoglion. Dhe, për sa i takon Fuehrerit, ay është në doren e Zotit.

Në vendin e ngjarjes

Unë tashti sa po kthehem nga një vizitë e disa ditëshme në Kuartierin e Fuehrerit. I dëgjova të gjithë tregimet e dëshmitarëvet të ngjarjes, pashë me syë e mij, vëndin ku u xhvillua atentati, dhe munt t'ju them që, në qoftë se shpëtimi i Fuehrerit, nga një rrezik aq' i math, nuk çë një mrekulli, atherë nuk ka mrekullira.

Atentatori që dërguar, prej njërit nga gjeneralët e arrestuar, gjoja si për raport të përditshëm mbi gjendjen. Ay e kish futur lëndën eksplosive në çamlën e aktevet dhe e kish marrë me vehte në dhomën e raportit. Dyke bërë sikur donte t'a lëshonte për dhe, në një çest që s'e vuri re njeri, ia lëshoj Fuehrerit pikërisht përpara këmbëvet. Kolonel gjenerali Korten, që

Fuehreri është në dorën e Zotit

ndodhej ngjitur prapa Fuehrerit u plagos rëndë dhe më von vdiq nga plagët e marra. Pjestarët e tjerë që ishin në raport nga forca e plasjes u flakën disa metro lark jashtë drithërevet dhe uniformat e tyne u bënë fije-fije. Në të gjithë dhomën e bërë rrëmujë nga detonacioni, s' mbeti asnjë vënt tjetër i pa ciku, vetëm se aty ku ndodhej Fuehreri në tryezën e shkëmitit. Edhe kjo vetë u përplas pas murevet, por Fuehreri nuk pësoj gjë, veç se disa gërvishtje të vogla lëkure dhe di sa të djegura të lehta.

Asnjë kufizim dhe asnjë kursim

Ministri i Reichut, Dr. Goebbels, theksoj pasojat që duhen nxjerr nga këto ngjarje. "Ne jemi të shtërnguar të halojmë kundërshtime, mundime dhe rreziqe skëterre, më parë se t' arrijmë përsëri në fundin e rrugës dhe më parë se të marrim frymë lirisht. Është vet-vetiu e kuptuarshme që né nuk do të kursejmë, në këtë luftë për falin t' onë, as gje prej gjëje. Përkundrazi, ne do t'i përdorim të gjitha ç' kemi dhe në masën më të gjërë që na mundet. Këtë e do edhe i tërë populli Ne kemi, n' Atdhe, një fuqi të pafunt forcash, që nuk munt të shteroj-në kursesi. Fuehreri ngarkoj Ministrin e Reichut. Himmler, me drejtimin e ushtris rezerve dhe kështu do të krijohen e do të stërviten sa e sa divizione të rinj për t'u dërguar në front. Zgjidhjes së këtij problemi do t' i përvishemi me energjinë nacional-socialiste.

Ministri i Reichut për armatimin dhe prodhimin luftarak, Speer, e shtoj në një masë të habitëshme, prodhimin e armatimit gjermanë, me punën e tija të pa lodhur dhe me një plan genial th[illegible]imi. Sulmet ajrore kundërshta-[illegible]kanë shkaktuar nonjë dëm [illegible]me prodhimit t'onë luftarak, [illegible]ata as që kanë mundur t'a [illegible] prodhimin t'onë në armë dhe municion, kshtu që ky është shtuar muaj për muaj. Ky proces dëndësimi vashdon gjithënjë dhe është akoma lark nga pika e tij e kulmit.

Lufta totale është urdhëri i ditës

Lufta totale do të ketë, si për ballin e luftës ashtu dhe për prodhimin e armatimit, aqë fuqi, saqë nuk do të jetë shumë e vështirë për né, të bëhemi zotëronjës, në një mënyrë sovrane, të të gjitha vështirësivet që do të paraqitnjë gjendja e luftës.

Ata na bënë të lëvizim

Sa arsye ka armiku të triumfonjë, do t'a tregojnë muajt e arthmë. Gjendja në frontet e ndryshmë, veçanrisht ajo e ballit të Lindjes, me masat e pacashikuara, do të ndryshohet shpejt dhe do të kthehet ne dobinë t'onë Lufta do të marrë një pamje tjatër dhe thirjet e triumfit do t'u ngëcin në fyt kundërshtarëvet t' anë. Ata besuan se do të na jepnin grushtin e fundit me krimin e 20 korrikut, por, përkundrazi ata na bënë më të lëvisçim.

Po vjen edhe diçka tjatër

Ne e kemi marrë vesh prej kohësh se kundërshtarin nuk munt t'a mundim dyke ia kaluar nër armatimet e tij, por vetëm dyke krijuar mundësira teknike të reja në vashdimin e luftës. Nuk ish fjala për t'ia arrijtur armikut, por, më tepër për t'a kaluar atë. Dhe kjo gjë u arrijt. gjatë dy vjeteve të fundit, nër të gjitha degët e ndryshme. Përfundimet do të bëhen gjithënjë më të dukeshmë në fushat e luftës. Vumja në vepërim e armës s'onë «V. I.» është vetëm hyrja. Pika kryesore është që çpikjet t'ona t'a vënë armikun përpara një fakti krejt të ri dhe kshtu t'a gjejnë krejt të pa pregatitur. Kur opinioni britanik thërret për mjete mbrojtës kundër armës «V. I.» kuptohet që ay e bën këtë. jo se privilegji i bombës qëndron në të fluturuarit pa pilot, por më tepër se i ka përmbysur të gjithë systemin e mbrojtjes.

Armë të ra në përdorim e sipër

Po kësisoj do jetë edhe me armët t'ona të tjera, që ne do të përdorim, së afërmi, nër degët e ndryshme. Përfundimet e 'xhvillimit t'onë teknik janë, vetëm në një pjesë të tyre të vogël, në gjendje eksperimenti, në pjesën e tyne më të madhe, ata janë gati për përdorim. Genija çpikëse gjermane i ka dhënë provat esaj me kohë. Ana kundërshtare nuk ka arrijtur në majën e malit si e pohojnë për ditë udhëheqësit e saj, por ajo qëndron akoma nër rrëzët e 'tij. Këtë do ta tregojnë përsëri xhvillimet e javëvet dhe të muajvet të arthmë.

Unë besonj, tha Dr. Goebbels, në mbarim të fjalës së tij, se ka më tepër populli gjerman arsye të jetë i kënaqur nga bilanci i pergjithëshmë i 20 korrikut, se sa armiqt e tij. Fuehreri e mban, si gjithënjë timonin e shtetit t'one dhe e drejton kombin me një dorë të sigurtë për mes të gjitha stuhivet dhe furtunavet të kësaj lufte. Populli gjerman ë[illegible]të i kuximshim, trim dhe punëtor dhe ka vetëm një gjë ndërmënt, të luftonjë, dhe të punonjë, që fitimi të jetë yni. Ay i është mirënjohtës Zotit q'e mori Fuehrerin nën mbrojtjen e Tij dhe i lutet që këtë mbrojtje të mos ia kursenjë edhe paskëtaj.

Mioësi e dyshimtë

Oysh prej nërmarrjes të një spastrimi të math, të kryer me sukses, në fund të qershorit, në pjesët e Shqisëris së Jugut, marrëdhënjet midis komunistëve të atjeshëm dhe agjentëvet englezë venë gjithënjë dyke u ashpëruar dhe tregojnë një farë mosbesimi. Për t'u shënuar është një letër që u zu prej Gjermanëvet. të cilën ia dërgonte një farë Ferik Hada, nga shtabi i zonës së parë operative. të quajturit Krahes, komandant t zonës së shtabit të Shqipëris Jugore. Midis të tjeravet, letra përmban, fjalë për fjalë, edhe këto : Njoftohet. me anën e kësaj se. për veç komandantit dhe komiserit politik të shtabit, asnjeri tjetër nuk duhet të vinjë në kontakt me përfaqësonjësit aleatë dhe as të bisedonjë me 'ta mbi çeshtje karakteri luftarak ose politik.»

Arsyet e këtij qëndrimi jepen në një vënd tjetër të letrës në fjalë : "Është vërtet detyrë t'i ndimosh, personalisht, aleatët por miqësija nuk duhet t' arrinjë aq lark, saqë ata të gjykojnë edhe mbi pregatitjet t'ona luftarake dhe politike.

"Zëmra e Shqipnis ethnike është Tirana,,

Fjalimi i Deputetit Zotni Xhelal Mitrovica

Shkëlqesa, Zotnij Përfaqësuesa të populllit !

Programi që shkëlqesa Fiqri Dine pati mirësinë me aqë kjartësi me na paraqitë asht nji përmbledhje besnike dhe nji pasqyrë e kjartë e preventiviti të nji Qeverije që ka marë përsipër barrën e randë të drejtimit të vendit t'onë në çaste kaq të rrezikëshme për jelën t'onë kombëtare.

Ndërsa ne tlasim, Shqipnija, në pjesën ma të madhe asht në zjarmë dhe tlaka ka tendenca, po qe se fuqinat t'ona kombëtare nuk bashkohen në nji vullnet të vetëm të çelniktë e të pathyeshëm, me u zgjanue tue vue në rrezik qenjën fizike të races s'onë.

Programi asht naltësisht patriotik, i bazume në nji mendësi të gjanë bashkpunimi politik. por do t'ishte letër e vdekun, për né, po të mos kishim bindjen e plotë [illegible] personalitetin politik të Shkëlqesës Fiqri Dine i cilli, në saje të karakterit të tij fisnikisht shqiptar, në gjendjen e tanishme përfaqëson nji shtyllë të fortë bashkimi dhe bashkpunimi të të gjitha partinave politike shqiptare.

Qeverinat fatkeqësisht, për natyrën e tyne të përkohëshme, kanë nji kufi kohe për zbatimin e programit të tyne: preventivet dhe konsuntivet duhet t'i llogarisin në frymën e këtij faktori, tue mos u nxit, të trëmbyem nga pasjonet e çastit, në gjykime të gabueme.

Sod Dhoma duhet t'i pranojë preventivet, tue shpresue se konsuntivet nesër do të jenë në mos të barabarta, t'afta me e kënaq pritjen t'onë të përpërgjithëshme.

Qeverija e kryesueme prej Shkelqesës Fiqri Dine, siç' e dijmë të gjithë, a-ht nji kompleks koalitive që, në rastin e tanishëm, në mes të flakës dhe të zjarmit të vllavrasjes, do të mundohet me i kalue të gjitha vështirësinat për t'i a mbrrijtë qëllimit kryesuer: shpëtimit të Shqipnis. Dërmimi i të gjitha tendencave ideologjike që kërkojnë themelimin e supremacisë politike me anë të fuqisë brutale asht nji pikë që ne do të përkrahim me të gjitha fuqinat t'ona për t'i sigurue populllit shqiptar nji të nesërme ku çdo grindje politike apo regjimore do të resultohet me anen e vullnetit direkt të populllt.

Si deputet kosovar falenderojë nxehtësisht Shkelqesën Dine për këte politikë t'urtë dhe të matun, tue u përgëzue veçanrisht për deklaratën solemne se ruejtja e kufijve ethnike asht bazë kryesore e politikës së Qeveris së tij.

Gjej rastin me ba nji konstatim t'idhtë por të nevojshëm; para kësaj Dhome ku problemet e populfit shqiptar, prej Prishtine deri në Konispol, duhet të rrahen me nji sinkronizëm mendimi dhe veprimi dhe me nji guxim që vet mandati populluer na garanton.

Ky konstatim asht se pjesëmarrja e grupit kosovar asht shum e pakët në relacjon me randësinë e çastit dhe në lidhje me sakrificat e kryeme nga Kosova, në mos tjetër, prej dltës s'Asambles Kushtetuese të Shtatorit 1943 e deri sod.

Rreth kësaj çeshtje diçka na ka thanë kumtesa zyrtare. Diçka na kanë ndigjue veshtë. Por diçka që na ka prek thellësisht, ne kosovarve. asht përshpërtitë këtu-atyt autonomizem, separatizem. Personat që i kanë përhapë këto fjalë sigurishl nuk janë miqët e popullit shkiptar apo ma keq janë në shërbim t anmiqve t' onë tradicjonalë.

Asht e nevojshme pra, për hirë të ndërgjegjës s'onë kombëtare të pastërt dhe për hirë të gjakut të derdhun nga kovovarët për bashkimin e Kosovës me Shqipni, të deklarojmë solemnisht para kësaj Dhome se Kosova nuk ka mendue, nuk mendon, dhe nuk do të lejojë që të mendohet, për asnji çast, në nji rindamje të sajë nga Nana Shqipni.

Zemra e Shqipnisë Ethnike për ne esht Tirana.

Vetëm Zoti i plotfuqishëm mund të na ndaj, njerzit dhe anmiqtë kurrë !

Këte për të qenë të drejtë, për t' i nda përgjegjësinat dhe për të vue në dukje vlerën naltësisht morale të populit kosovar.

Shkelqesa! Zotnij Deputetë!

Ne besojmë se çdo gja të rregullohet. Shpresojmë veçanërisht se vullneti i Kosovës do të respektohet ashtu si ç' asht parashtrue. E këto shpresa dhe bindje na vijnë nga fakti që Kosova asht nji realitet politik, demografik, ekonomjk dhe racjal dhe në saje 700. 000 banorve ka të drejten e sajë me qenë e pranishme në çdo kombinacjon qeveritar. Kosova, zotnij të ndërshëm, esht nji faktor ndertimtar dhe beson vetëm në fuqinë e Shtetit e këtë besim e ka tregue në rastet e rrezikut kombëtar me fuqinë e vullnetit të sajë.

Grupi kosovar ka ardhë në Asamblen Kushtetuese të Tiranës me 150 përfaqsuësa të vendosun me çdo kusht m'e rithemelue Shtetin Shqiptar e m'e shtypë çdo tendencë që kërkonte shkatrrimin dhe rrenimin e autoritetit shtetnuer. e prandaj, nuk asht e drejtë që t' akuzohet si shkaktar dasinash apo grindjesh sepse, me plotë të drejtë, nuk ka pranue me hye si aktor i dorës së tretë në skenën e madhe shqiptare ku luhet sod fati i krejt Kombit Shqiptar.

Janë përgjegjësina tepër të randa këto, për t'u marrë nga grupi kosovar, ndersa çdo personë asht i lirë me veprue ashtu si ma mirë i-a ha mendja. e si ma mirë i pelqen.

Mungesa e nji përfaqsije të plot kosovare në Qeverì asht nji e metë që shpresojmë do të plotsohet për së shpejti, sepse rasti i kundërt do t'i linte vend interpretimeve të shumta, të cilat mund të mërrijnë deri në dyshime serioze të nji natyre politike ndërkombëtare që mund të vrasin dhe cenojnë tepër larg. Këto dyshime për né kosovarët nuk janë tjetër veç se fryma e nji shpirite mohimtare të të drejtave, t'ona ma fillestare me jetue si komb dhe si Shtet.

Zotni të ndershëm

Pamvarësisht aga këto konsideracjone, Qeverija e zotit Dine duhet përkrahë, sepse mandati na asht besue nga populli, i cili sod asht i kërcënuem me vdekje nga vala pansllaviste nën formën genjështare të komunizmit. vetëm e vetëm për t'i bashkue fuqinat në mbroje të racës shqiptare, të jetës, të nderit dhe të pasunisë së qytetarit.

Dëshmija ma e kjartë e këti vullneti asht zani i shqiptárizmës së krahinës që, un kam nderin m'e përfaqsue këtu, za i cilli po buçet i fuqishëm atje në fushën e burravet, atje ku luftohet dhe vdiqet për Shqipni, për bashkim.

Përfaqsuesave të Kosovës, intelektualë apo prodhimtarë, iu përket me u këthye atje dhe m'e u bashkue me bujkun t'onë për t' derdhë bashkarisht gjakun që të sigurohet jeta dhe lirija politike e krejt populit shqiptar.

Në këte rast asht për mue nji gëzim i math me i parashtrue Qeverisë së Shkelqesës Fiqri Dine urimet e mija ma të nxehta për nji punë të mbarë dhe nji sukses të plotë, tue e përsëritë para përfaqsuesave të populit dhe para botës mike dhe anmike fjalën t'onë tradicjonale kosovare:

"Të bashkuem me vllaznit t'onë deri në vdekje,,

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Ejte 3 Gusht 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 15 - ÇMIMI 1 LEK

Kercnime të pavend

Nacjonalizma shqiptare kerkon prej Qeveris

FIQRI DINE

Axhentat e Londrës, prej Radio-Barit, i drejtuen mbramë Qeveris së Fiqri Dines nji kercnim grotesk tue i thanë në mes të tjerave: 'Gjermanija e ka humbun luftën. Para-ardhësi i juej Rexhep Mitrovica pat qenë lajmërue disa herë prej Aleatëve për mos me bashkëpunue me Gjermanin dhe veçanrisht për mos me rekrutue fuqina shqiptare.,, Mbasi kërkon me evitue edhe vlla-vrasjen në Shqipni, shton: "Si kryeministri Churchill ashtu edhe Komandanti i Përgjithshem i Mesdheut kanë ba para-lajmërime se të gjitha ato Qeverina që do të bashkëpunojnë me Gjermanin kanë me u konsiderue si armiqë të popujve alentë tash edhe mbas lufte."

Përpara këtyne deklaratave kërcënuese të Radio-Barit, i themi Qeverisë Dine: asgja s'duhet të ju ndalojë në realizimin e programit t'uej qeveritar për sa i përket sigurimit të qetësis.

Me çdo kusht populli shqiptar kërkon qetësimin e vendit.

Veprimet e çetave duhen shtypë, shtypë pa mëshirë për dy arsyena krejtësisht kombëtare.

E para: kundrejt veprimeve kriminale të çetave që po zhvillohen nëpër katunde e qytete, nuk kemi interesë me lanë operacjonet ndër duertë e ushtris gjermane e cila, tue mos njoftë se kush mund të jenë fajtorët e vërtetë, merr në qafë mbarë popullin e pafajshem.

E dyta: duem qetësi e qetësi absolute, per me muejtë me u organizue si nji shtet i fort që nesër të muejmë me i mbrojtë me sukses kufijt e atdheut t'onë të kercënuem.

Ndonse na shqiptarët jemi për nji bashkim e vllaznim ballkanik, nuk mund t'injorojmë se ndër fqinjt t'onë ka mija e mija elementa shoven që me padurim presin çastin për me shkelë e me coptue vendin t'onë..

Disa kanë besim se mbas luftës do të na vijnë fuqit aleate për me na mbrojtë! Ky asht nji gabim; por edhe në qoftë se ky besim asht i vërtetë, për deri sa ushtarët anglo-amerikanë të mbërrijnë ndër kufijt t'onë të gjanë e të largët nga brigjet detare, na tue mos qenë t'organizuem mirë — me qëllimet e mënin që kanë shovenët serbë dhe grekë kundra nesh — jemi në rrezik me u masakrue e me u zhduk fare.

Duem pra prej Qeveris Dine, sigurimin e qetësis kndra bandave që po vejnë në rrezik ekzistencën t'onë kombëtare — qoftë kjo edhe me ndihmën e Gjermanis.

Po, e kuptojmë dhe e dijmë se kjo fjalë e fundit nuk ka me i pëlqye lordave dhe axhentave të Londrës, por s'kemi se ç't'i bëjmë ligjës së natyrës: "dy duer për nji krye...

Ka edhe ma: në qoftë se ne shqiptarët do të bashkëpunojmë me gjermanë kundra veprimeve të brigadave komuniste për sigurimin e avenirit të vendit t'onë, asht e padrejt me na quejt vetëm për këtë si aleatë lufte të Gjernanis.

Për sa i përket marrëdhanjeve të Shqipnis me Gjermanin shtojmë edhe: nacjonalizma shqiptare e quen vehten si të poshtnueme për faktin që populli shqiptar s'ka muejtë me u dekllarue si aleat i Gjermanis ashtu si do të na kishte hije.

Tue folë si nacjonalista të ndërgjegjëshëm, ne kuptojmë se fati i Shhipnis asht lidhë ngushtësisht me atë të Gjermanis. Tue lanë më njanë ndjenjat e mira qi kanë pasë kurdoherë gjermanët kundrejt nesh, me fitimin e tyne, na shqiptarët jemi të sigurtë se do të kemi nji Shqipni të përbame prej të gjitha viseve ku ka shqiptarë, kurse me fitimin e aleatëve nuk e dijmë se ç'fat do të kemi. Bile, shumë veta janë të sigurtë se Shqipnija do të dali përsëri e gjymtueme mbasi deri më sot Ingliterra i ka mbajtë popujt e vegjël si plaçka shkëmbimi për qëllimet e saja imperjalistike.

Tue kujtue këtë të vërtetë shqiptarëve u përket me luftue krah për krah me ushtarin gjerman e këta jo vetëm në Shqipni por edhe gjetiu, kudo. Me gjith këtë, na, vetëm pse jemi nji popull fort i vogël dhe i pa organizuem, kemi deklarue asnjanësin e shtetit t'onë. Kjo asnjanësi asht nji urti nga ana e jonë, por, zotnij inglizë, me qenë të pa anëshëm nuk don me thanë me dalë kundra Gjermanis e me e ba vendin t'onë shesh lufte e gjakderdhjeje për interesat t'ueja.

Pyesim Londrën: oficerat inglizë çka duen në Shqipni ?

Vlla-vrasjen që gjoja don me evitue Radio-Bari, nuk e ban Qeverija shqiptare e cila për interesat e nalta kombëtare don qetësi e paqë - por e bajnë pikërisht oficerat inglizë të cilët tue përfitue nga virtytet e mikpritjes së popullit shqiptar shkojnë katund në katund e mal në mal tue nxitë popullin e shkretë kundra Gjermanis.

Inglizët thonë se kanë ardhë në Shqipni me na shpëtue nga okupatori gjerman. Kjo s'asht e vertetë.

Zotni Inglizë, kjo luftë asht e jueja dhe lufta e popujve të vegjël për liri e indipendencë do të fillojë vetëm mbasi të ketë mbarue kjo lufte e jueja, duem me thanë, kur ju të mëdhejt t'uleni në tavolinën e paqës. Veçanërisht Shqipnis çfarë independence i pregatitni, kurse prej ngacmimeve t'uejа i tanë vendi i jonë po digjet e burat po masakrohen ?

Na shqiptarët, sot për sot, nuk kemi të qarë prej gjermanëve, dhe në qoftë se ju keni interesë që Gjermanija mos të ndodhet këtu, urdhnoni atëherë dhe hapni edhe nji front në Shqipni për me luftue burrnisht si i ka hije popujve të mëdhej e jo me veprime miskine me e marrë në qafë nji popull të vogël si asht populli shqiptar.

Tiranë, më 20 Korrik 1944

BEKIR WALTER

Zbarkim në Shqipni ?

Nji provë e rrezikëshme — Pranë fuqive t'armatosura gjermane, ordron edhe nji anmik i rrezikëshëm vdekjeprues

Pyetja, nëse trupat anglo-amerikane, do të bajnë nji provë zbarkimi në gadishullin e Ballkanit, asht ba çashtje e bisedimeve të përditëshme të disa njerzve që mendojnë thell. Disa besojnë se, simbas bisedimeve të konferencës të Teheranit, Stalini e ka rezervue Ballkanin krejt për vehte dhe nuk do të pranojë ndonji ndërhymje zbarkimi të trupave anglo-amerikane. Disa të tjerë thonë të kundërtën, se, anglo-amerikanët me zbarkimin e tyne në Ballkan, mund të ndalojshin rrezikun e përhapjes të komunizmit. N'anë tjetër po të marrim parasysh se në ç'anë bregdetare do të kryhej ky zbarkim, duhet të shkoqitet pyetja se çë mund të ngjanjë para e mbas zbarkimit.

Shqipnija do t'ishte vendi ma i përshtatshëm për nji zbarkim, për arsye se, mbartja e mjeteve me anën e detit asht ma e let si nga pikpamja limaneve, si edhe nga ajo e largësis së paktë, tue qenë se anijet mund të lundrojnë n'Adriatik në nji kohë të bukur, fare lehtas, dhe ngarkimi i tyne prej anës tjetër nuk ka asnji pengim. Ndërsa për nji ndërmarrje të till kah ndoj drejtim tjetër bregdetar, duhet marrë parasysh largsija e disa kilometrave në theilsin toksore; ku nevojitet edhe numri ma i math i trupave mbas zbarkimit. Kjo parashifet si ma me fryt për disa miqt e Anglis të cilve iu shtohet shpresa e nji përfundimi të frytshëm.

Të jet aq i favorshëm zbarkimi, si e mendojnë këta përfaqësues të mendimeve të përmenduna, jo vetëm që gabohen, por nuk e njofin sa duhet vendin e tyne, as historin e tij. Limanet e Shqipnis, janë të njoftuna si ma të rrezikshme si vise malarike t'Europës, ndër të cilat asht çfaqë shpesh herë edhe malaria tropikale. Ushtrit që kan qenë të shtenguerme me luftue, kan pasë humbje të mbëdha e munt të themi janë dhjetue prej kosës së malarjes, veçanrisht kur kan luftue vetëm pa pasë me vedi ushtarë vendas. Në 1918, divisionet austriake si edhe italjane kanë pas nji humbje aq të madhe prej malarjes, sa kan qenë të paralizueme krejtësisht, tue qenë të shtenguc-me m'e lanë luftën.

Ushtarët që kan xanë vend në mbrendin e vendit, kan mjete ma të forta të mbrohen prej malarjes, por trupat zbarkuese, nuk kan asnji mjet mbrojtjeje, dhe do farosen pa mshirë prej malarjes. Anglo-amerikanët e dijnë ket punë fare mirë, se, vjete me rradh, mjekt amerikan e kan luftue malarjen në Shqipni. Ata do të jen budallej në qoftë se do provojnë nji zbarkim në Shqipni. Ata 'qe presin në nji zbarkim englez në Shqipni, pshteten në nji shtyllë të kalbët.

SHTYLLA E LIRË

Posta e popullit

Lajmojmë lexuesit e fletores "Lirija e Shqipnis,, se, shtylla e lirë e kësaj fetoreje asht në dispozicjon të popullit për çdo pyetje, (natyrisht me përjashtim të çashtjeve personale) që ka lidhje me jetën e popullit.

Deri më sot na kan ardhë pyetjet që vijojnë:

1) Ku gjindet komisjoni i derguem prej Qeverris për të marrun studentat e shqiptarët e ndryeshëm që mbetën n'Itali mbas kapitullimit?

2) Pse janë mbushë burgjet t'ona, dhe a ka kush t' ua qajë hallin?

3) Kur do të hapet nozullimi për ushqime e vesh-mbathj ?

Njoftojmë publikun se, gjithë këtyne pyetjeve do t'u përgjegjemi në numrin tjetër. Përgjigja do të bëhet me anën e fletores nga mungesa e pullave.

Në afersi' e qytetit Shkup, në fushë të lirë, u sulmuan, prej avjatorësh terroriste amerikane, gra fëmijë dhe u qëlluan me mitraljoz. Mbetën 20 veta të vrarë.

Ministrija engleze e nozullimit njofton se nuk mund të zëvëndsohen më sendet ushqimore të çkatërruar prej armës gjermane "V. 1"

"Republika sovjetike armene,, ka bërë hapa për krijimin e konsullatavet të saj në Jerusalem, në Damask dhe në Bejrut.

Opinioni brazilian është i çqetësuar për masat që po marrin Shtetet e Bashkuar nër ato pika të bregdetit që Brasilija ua ka lënë atyre si pika mbështetjeje avjacioni. Qeverrija e pa të rastii të deklaronte se pushtimi i përhershmë i këtyre pikave do të quhej si cënim i sovranitetit brazilijan dhe se Brazilija nuk munt t'a duronte një kanosje të këtillë.

Si pas mendimesh portogjezë, përdorimit t' armës «V. 1.» i jepet rëndësi e madhe në xhvillmin e arthmë të luftës. Munt të thuhet se më këtë armë, Gjermanija e fitoj, qysh tash një të tretën e rrjedhjes së luftës.

Papa i dërgoj Kryepiskopit të Rouen-it 80.000 franga për të lehtësuar mjerimin e fëmijëvet të goditur nga bombardimi anglo-amerikanë. Suma u përdor për veshmbathje.

Në botën e fantazisë!

Vetëm ata që jetojnë në botën e fantazisë, në mes të luleve dhe të dritave të përhershme, kanë dhuratën hynjore t'i konsiderojnë çashtjet e kësaj bote landore me pa-anësi të plotë dhe me frymë që asht kullue nga mbeturinat e pasjoneve, interesave dhe lakminave vetjake; të tjerët, mortarë si çdo gja që jeton nën kupën e qiellit, i kanë interesat e tyne, lakminat e tyne dhe pasjonet e përdifshme që, në sinthezë, formojnë njeriun si individ apo si entitet prodhues shoqnuer i një kolektiviteti.

Bazë kryesore për çdo gjykim të fjalve që i drejtohen popullit shqiptar nga Gjenerala, Kolonela dhe personalitete inglize asht ky realitet që thamë ma nalt, realitet i cili fatkeqësisht bazohet në një seri faktesh dhe ngjarjesh që i përgënjeshtrojnë kategorikisht fjalët e bukura të thanuna me anë të Radiove.

Zoti Hill-i, Kolonel i Armatës inglize, e këshillon popullin shqiptar, atë pjesë të qetë dhe puntore të këtij vendi, që të bashkonet dhe të lejë me një anë grindjet dhe dasinat ideologjike për t'u ba një bilok i vetëm granitë me qëllim që të shpëtohet Shqipnija.

Fjalë e matun! Fjalë miku do t'ishte në realitet një këshillë i këtillë, por fatkeqësisht, dardha e ka bishtin mrapa, dhe fjala miqsore e Kolonelit Hill ka një bisht dhe asht që shqiptarët të bashkohen dhe të vllaznohen nën flamurin e Mehmet Shehut.

S' ka nevojë për komente

Në Napoli është, tashti, një gjë krejt e zakonëshme shoqërimi i gravet të bardhia me Zezakët. Këta vjedhin me të dy duart, për të gjumbulluar të 6000 liretat e nesojshme. Edhe vajza nga familjet më të mira shihen dendur me të Zestë. Familje të tëra rrojnë me të ardhurat e gravet e të vajzavet të tyre dhe xhvillohet një fregëti e vërtetë me djem e me vajza të mitura Englezët dhe Zezakët interesohen më tepër për djem, ndërsa Amerikanët parapëlqejnë vajzat. Komanda amerikane po mejton tërheqjen e trupavet të saj nga Napoli për shkak të shtimit të sëmundjeve veneriane. Prostitucioni dhe krimi po shtohen kudo.

Koloneli Hill mund të jetë mik i popullit shqiptar në shpirtë, por shpirti në botën "bussinës ist bussinës„ asht një korelacion direkt me interesin e popullit ingliz i cili, me anë t' Armatës së tij po e ndihmon komunizmin me të gjitha mjetet e mundshme për t' a shkatrrue Shqipninë e për t' i asgjasue shqiptarët.

Por Koloneli Hill mund t'na objektojë se nacional-shkatrrimtarja po luftón e për këte arsye Anglija, nanë e popujve të robnuem, po e ndimon këte për t' a shkatrrue Shqipninë. Këtu ne jemi të detyruem t' i bajmë një objeksjon Kolonelit Hill: "Pse vallë, këshilla të këtilla nuk u bahen komunistave, të cilët siç asht e dijtun nuk luftojnë asnji çast për Shqipni por vetëm e vetëm për panslavizmin e Titos, komunist rrenacak?„

Kërkojnë inglizët shpëtimin e Shqipnis: atherë pse i apin ndihma materjale komunistave për t' a shkatrrue Shqipninë? Apo beson i ndershmi zoti Kolonel se ne jemi aqë budallej sa që të besojmë se këto ndihma i shërbejnë çashtjes së tyne.

Asht mirë që të përsëritet njimij herë, se për ndryshe personat inteligjentë nuk mund t' a kuptojnë, komunizmi nuk asht shprehje e popullit shqiptare. Asht dhe mbetet vetëm një mendyre moderne e luftës racjalë që i bëhet popullit shqiptar.

Grindjet, vllavrasja, dasinat e ndryshme politike do të mbarojnë atherë kur do t'i mbushet mendja zotit Hill se komunismi asht një element rrenues i popullit shqiptar e kur do të ketë mirsinë me e këshillue komandën e e Naltë që t' ia presë ndihmat partisë të terrorit dhe të shkatrrimit.

Ky do t'ishte një qendrim miqsuer, tue bisedue në botën e realitetit, ndërsa fjalët e Kolonelit Hill mbesin një shprehje e botës së fantazisë, që në fjalë ma të kuptueshme do të thotë: "Ajo që më pelqën mue asht e drejtë!„

Tue dashtë me ironizue fjala e Kolonelit Hill na shëmbëllën shum n'afé të të famëshmit Padre Zappata që "fliste mirë, por vepronte shum keq„.

Mund të parashikohej se propaganda anmike, një ngjarje kaq të randësishme sikurse qe atentati kundra jetës së Hitlerit, do t'a çfrytëzonte tue perhapë gënjeshtra. Ka qenë gjithashtu e kjartë se këto gënjeshtra kanë pasë për qellim me ia mbushë mendjen botës mbi një dobësi të mbrendëshme të Gjermanis, gja qi nuk ekziston. Me gjith këtë mënyra me të cilën këto gënjeshtra u shperndanë, asht kaq e trashë sa vetëm idjotët mund t'i besojnë.

Le të fillojmë me një shembull gënjeshtre të përhapun prej anmikut sidomos sepse kjo na prekë s'afërmi, sepse i përket Ballkanit. Agjensija "Reuter„ lajmëron se një numur oficerash të naltë gjermanë nuk pranuen me iu bindë kryekomandantit të fuqive t'armatosuna gjermane në Ballkan, gjeneralit feldmarshall Von Weichs, mbasi ky i paraqiti deklaratën e besnikëris Adolf Hitlerit. Si rrjedhim i kësajë qe se Cetina, ku, simbas Agjensis «Reuter», gjindet Kuartieri i Pergjithshem gjerman i trupave vepruese në Ballkan, u pushtue prej trupave SS të cilat vranë me këtë rasë 46 oficera dhe ushtarë gjermanë. Një gënjeshtër të tillë guxon agjensija «Reuter» të përhapë, kurse çdo fëmi në Malin e Zi e në Shqipni mund t'a provojë se Kuartieri i Pergjithshem i Gjeneralit feldmarshal Von Weichs n'asnjí mënyrë nuk gjindet në Cetinë. Sido qoftë ky lajm si në Cetinë ashtu edhe në krejt Malin e Zi ka shkaktue që njerzit të qeshin.

Po ashtu flluska sapuni janë edhe ato lajme që qendrat e ndryshme të propagandës armike përhapin përmbi ngjarje të ndryshme në Gjermani. Në qarqet kompetente gjermane këto ditë kanë pasë rasë tue u dëfrye, ndërsa përfaqësuesave të Shlypit të huej ato gënjeshtra jashtzakonisht në kundërshtim njena me tjetrën në këtë lamë. Vetëm qeshja qe përgjegjia qi dhanë këta gazetarë, të cilët jetojnë në mev të ngjarjeve dhe për shkak të profesjonit të tyne syt i mbajnë çelë mirë.

Folësi i Ministris së Propagandës në Berlin lezoi "një visar„ lajmesh të disa udhëtarëve suedezë përpara gazetarëve të huej qi gjoja paskan qenë në Gjermani të cilët ndërkohë, jo vetëm në Berlin, por edhe në krejt Reichun e kishin pa me syt e vet gjendjen. Natyrisht paraqitja e këtyne lajmeve shkaktoi një qeshje. Po ashtu u tha se në Prusin Lindore regjimente të tana u u çuen peshë, të cilët ma në fund pjesërisht u çfarosën deri në njerin e mbram. Ngjarje me një karakter të tillë sikur të kishin ndodhun sigurisht nuk do të kishin mbetun pa u diktue në Prusinë Lindore përpara askujt. Por atje askush nuk din ndonji ndodhje të tillë, bile as edhe ndonji peshperitje me këtë karakter nuk asht dëgjue. Cdo banuer i Berlinit dhe çdo korrespondent i huej qi jeton në Berlin ka muejtë me sjellë bindje në këto ditë se në Metropolin gjerman jeta po vazhdon me ritmin e sajë normal. Me gjithë këtë asht për t'u çuditë se një nga këta udhtarët qi gjoja paska qenë në Gjermani, paska pamë shtet-rrethimin në Berlin, gja qi as për pesë minuta nuk ka qenë i vendosun në Berlin.

Sikurse ro shihet prej këtyne shembullave armiku i Europës, gënjeshtrat sikurse deri tashti edhe në lamë ushtarake po i banë me lehtësi. Forca e mbrendëshme e Gjermanis nuk mund të trandet prej këtyne flluskave sapuni me ngjyra të ndryshme qi janë destinue me pelcitë në vend, po ashtu sikurse nuk mund të thyhet fuqija ushtarake e Reichut prej vëprimit të përbashkët t' anmikut në Perendim, në Lindje e në jugë të kontinentit.

Flluska sapunit në lidhje me atentatin e bam kunder Fuehrerit

Grusht komunizmit, mohues i vlerave ma të bukëra shqiptare, pastaj bashkim e vllaznim! Ky asht zani i popullit shqiptar.

Na vjen shum keq, por për syet e bukëra të panslavistit Tito dhe të sherbëtorve të tij shqiptarë, nuk mund t'a shkatrrojmë këte Shqipnj që asht vatra e jonë, nuk mund të cenojmë parimet e bolës për një ideologjí që vetë inglizët e kanë sha dhe po e shajnë.

Populli ingliz, i madh, i fuqishëm, i mençëm t'a pranojë ay komunizmin pastaj vijnë popujtë e vegjël!

Prioritetin duhet t'a kenë gjithëmon, si mbas zakonit shqiptar, të mëdhajt pastaj vijnë kalamajt.

A nuk asht kështu i ndritëshmi zoti Kolonel Hill?

Behuni ju komunist, lini kolonitë, epni lirí Indisë dhe rrokullisni City-n, pastaj dhe ne do t' i-u ndjekim pa mendue shum!

Presim përgjigje me fakte e jo me fjalë!!!!

Tmer mbi Londër

Anglija qëndron në pamundësi mbrojtjeje kundrejt armës gjermane të hakmarrjes

Si pas lajmërimit të Komandës së Naltë gjermane, ka javë që Anglija jugore dhe veçanërisht Lagjet e Llondrës ndodhen nënë zjarrin e armës «V. I.», vetëm me disa ndërprerje të shkutra.

Se si është efekti i kësaj arme të re gjermane, duket kjartë nga një korrespondencë e një korrespondenti luftarak engles i cili midis të tjeravet thotë: "Asnjeri nuk e di, sot, n' Anglinë jugore, ku duhet të tshihet dhe ku e ndjen vehten të sigurtë. Kurrë nuk do të harrohet ky çqelësim i tmerrshme, kur çfaqet, mbi Kanal, me një zhurme tmeronjëse dhe si një Komet, Arma «V. I.» Asgjëkundi nuk janë njerëzit të sigurtë prej eksplozivëvet misterioze gjermane që bijen nga Qjelli. Një nga këta trupra eksplozivë goditi një tren municioni në një vënt t' Anglisë jugore. Nga fuqija plasëse e tij u shkakëtuan çgalërime të mbëdha dhe u prishnë dy stabilimente gazi të vëndit.

Ndërkohë, si pas njoftimesh nga ana gjermane, zjarri vete gjithënjë dyke u dëndësuar. Bombardimi shtohet pa pushim. Deputeti engles Vernon Barlett thotë se bombat pa pilot sulmojnë me një shpejtësi të tmerëshme. Njeriu e ndjen se është i pafuqishmë kundrejt kësaj arme misteriozse gjermane. Dhe me shtimin e efektit të kësaj arme, shtohet në Llondër edhe nervoziteti, shkruan gazeta svedeze «Aftonbladet».

N' Angli po kërkohen pa pushim mjete mbrojtjeje, por nuk gjenden. Në Ministrin e Ajrit arrijnë, ditë për ditë, letra me propozime mënyrash luftimi të kësaj arme, por më kot.

Ministri kanades i Prodhimevet deklaroj mbi "V. I." se kjo ndofta shënon ditën, prej së cilës flota aerore aleate e sotme duhet të quhet si e kaluar dhe e plakur.

Kështu, pra, n' Angli qëndrojnë duar lidhur përpara efektit të tmershmë të "V. I." Dhe pikërisht tashti që mbi Anglinë bijen, bombat misterioze gjermane, u bije ndër mënt edhe Englezëvet fjala "humanitet„.

Pikërisht ajo Angli që kreu, vjete me radhë, sulme terrori mbi Gjermaninë, që deshi të çkatërronte kulturën evropjane me bombat e saj të hedhura kuturu, që goditi me aeroplanët e saj fëmijë dhe gra të pafajshme, ajo Angli na del tashti me fjalët "poshtërsi„ dhe "barbarizmë„. Dhe sbtypi engles bën, përnjëhersh, sikur t'i kish harruar britmat e tij enthusiaste, me të cilët ay dhe vet Ministrat britanikë përcillnin, vjete me rradhë, sulmet kriminelë të ajrit që kryhëshin kundër Gjermanisë dhe Evropës. Vetë Ministri engles i Informacionit deklaroj, një ditë, se plani i Anglisë është bombardimi dhe përvëlimi i popullit gjerman.

Gjenerali i Shtetevet të Bashkuar, Arnold tha një herë se në Gjermani munt të ryhej që nga çatija më lehtë. Pas kësaj recepte të Arnoldit po i futet edhe Gjermanija Anglisë nga çatija, dhe po godit me armën "V. I." arsenalin luftarak, Anglinë Jugore.

Lajme të ndryeshme

Përsëri dy bombardonjës katërmotorësh të rrëzuar

Anglo-amerikanët munt t'i shtojnë listës së tyre "humbje të heshtura„, edhe dy katërmotorsha të tjerë. Si njoftohet, në rrethet e Cetinjës, në Malin e Zi dhe në Shqipërin e Mesme, prapa malit të Dajtit, janë rrëzuar keto ditët e fundit, edhe dy maqina të tjera, ndërsa flufuronin, në formacion, për në Italin e jugës. Personeli prej dhjetë vetash i ajrorit të rrëzuar në Shqipëri u zu rob prej fuqish nacionaliste shqipëtare.

Një gazetë amerikane njofton se Cifutët evropjanë t' emigruar në Shtetet e Bashkuar përdoren aqë mirë saqë dëshërojnë të të mbeten atje. Kjo sjellje e mirë e Shtetevet të Bashkuara kundër Cifutëvet qënka një meritë personale e Roosevelfit.

Rumanija "e lirueme„

Keshtu synojnë bolshevikët mbi kufit e Europës

Trupat rumune çjatë ripushtimit të një katundi në Besarabi, gjeten një afish të ngjitur nder muret, në të cilën popullsija urdhërohej të përmbushte porosinat e posht-shenueme:

1) të gjithë banorët janë të detyruem me dorzue çdo pare të thatë që kapërcen shumën e 4000 Leive.

2) Me përjashtim të një pakice gjanash ushqimore për 3-4 ditë, çdo sasi tjetër ushqimimi duhet të dorëzohet.

3) çdo plaçkë veshmbathjeje e çdo këpucë duhet dorzue e duhen mbajtë vetëm për përdorim personal një palë këpucë e një palë rroba.

4) popullsija e dy sekseve me një moshë prej 10-16 vjeç duhet të paraqitet për me u shti në punë.

Shqiptarë, qe kështu po duken masat qi marrin bolshevikët «çliruesa». Të «çliruem» prej gjithkahit qi kanë fitue me punë e me duert e tyne, të «çliruem» edhe prej vetë ajrit të katundit të tyne këta të «çliruem» të gjorë po enden drejt një fati t' errtë. Skllavërimi dhe puna angarije asht fati i tyne ndër krahina e ndër vënde të panjohuna.

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Hënë 7 Gusht 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 16 - ÇMIMI 1 LEK

Tragjedi Poloneze

Vdekje Polonezvet të mergimit

Nër luftimet e zhvilluar, për pushtimin e skelës italjane Ancona, ranë, në dorën gjermane, shumë robër polonezë. Ata ishin fort të dërmuar dhe treguan, me një zë, se trupi i ekspeditës poloneze, këto kohët e fundit, pësoj humbje jashtzakonisht të rënda në bregdetin italjan. «Njëjësit polonezë» deklaruan robërit, «u çkrinë gjer në pikën e fundit». Dyke kafshuar buzën në gjak, nga zëmërimi, oficerat polonezë thoshin se Komanda aleate u reservonte repartevet polonezë ata sektorë, nër të cilët zjarri gjerman ish më i përgjakëshmë. Pesha e luftimit dhe viktimat më të shumta ruhëshin gjithënjë për ushtarët polonezë, si prej Englezëvet ashtu edhe prej Amerikanëvet.

Ne e kuptojmë më së miri zëmërimin e thellë të këtyne viktimave të gabuara poloneze. Ndërsa Londra i fut Polonezët në vijën e parë dhe i çkrin, afje, për dobin' e saj, Churchill-i ia shet Moskës vendin e tyre. Stalini i bën sehir këtë lojdër frikanace dhe [illegible] duart. Se, sa më shumë Polo[illegible] më [illegible] ydesin, aq më [illegible] shtrëngon ay në dorën e tij Komitetin polonez të çlirimit në Moskë. Me regëtiljen e fundit të të fundit merçenar polonez, vdes edhe e ashtuquajtura «Qeveri poloneze e mërgimit» në Londër, dhe kshu është' e lirë rruga për një Sovjet polonez, pa përzjerjen e Londrës. Por edhe Churchill-i fërkon duart përpara njëj çfarosjeje të Legjonarëvet polonez n'Itali. Se, a nuk që një nga kolëçarjet e fija më të mbëdha pyetja se ç'duhej të bënte me Polonezët e mërgimit, të cilëvet, më parë se të lihte miqësinë me Stalinin, u kish premtuar lugë të florinjtë? Si një hije e kobëshme rëndonte, kjo farë «Qeverri e mërgimit» midis tij dhe «mikut» të ri në Moskë. Tashti ay ka gjetur një system të ninë si t'a heqë qafe: I bën merçenarët e saj të çkrihen, gjer në pikën e fundit, nër betejat e Italisë. Kshu e trajton Churchill-i problemin polones, për të cilin, gjoja, Anglija u fut në luftë, para pesë vjetësh.

Palaçua i Stalinit

Deputeti Mc. Govern, gjatë njëj diskutimi në Dhomën e Komunevet, deklaroj: "Churchill-i u tregua një mjeshtër i mbaruar në të ngrënit e fjalës. Të gjitha fjalët e mbëdha të 1939 sot u harruan, dhe të gjitha pikëpamjet e tija idealiste, u hodhë në shportë. Ay u shpreh në mënyrën më përbuzëse, rreth detyrimevet që muarmë at-here kundrejt kombësivet të ndryshme.

Churchill-i tashti është bërë palaçua i Stalinit.

Kjo luftë është tej për tej imperialiste. Në sikur hymë në luftë gjoja për çështjen e korridorit polones, por tashti po e shohim se, jo vetëm çështja e korridorit, por po rrëzohet edhe i tërë kështjelli n' ajr.

Churchill-i u bë mbrojtësi i krimevet të kësaj lufte

Churchilli n'kundërshtim me Radio-Bari

Anglija ka frike nga te tjera surpriza armesh te ra gjermane

Në Parlamentin e Britanisë së Madhe Churchilli, me daten 2-8-55, bani këtë daklaratë:

«Dinamit-metheora» gjermane kanë tfuturue 5400 herë mbi Anglin. Ato kanë shkaktue vdekjen e 4700 personave dhe plagosjen e 14.000 të tjerëve. Janë damtue krejtësisht 17.000 shtëpi, prej të cillavet 80.000 ndodhen jashtë përdorimit. Një milion njerës janë largue prej Londrës me shpenzimet e shtetit dhe një miljon të tjerë me shpenzimet e tyne vetiake.

Churchilli vazhdoj në bisedimin e tij, mbi t' ardhmen, si vijon:

«Nuk asht larg mendjes, që nëndetsat gjermane përsëri të hyjnë në lëvizjen luftarake. Po flitet se gjermanët, nëndetsat e tyne, kanë mundun t'i bajnë të pa cenueshme. Asnjë herë nuk asht mirë, qi këto sende të përçmohen. Po asnju mund të thuhet se gjermanija mund të ketë qëllime për luftën ajrore. Për këtë arësye, na duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe nuk duhet të tradhëtojmë veliten tue lanë mjetet t'ona të luftës të drejtohen në kanale të tjera. Na jemi të shtërnguem të rimë të pregatitun për kundrejt ngjarjevet të pa dituna që mund të ndryshojnë t'ardhmen.»

Shqiptarë! A kujtoheni në lajmet e radios të Barit e të Londrës, se çfarë gënjeshtrash folën ata mbi këto «dinamit metheora?» A nuk thuhesh se këto «dinamit-metheora» nuk kanë efekt luftarak dhe nuk janë tjetër veçse trillimet e propagandës gjermane? Tani po e vërtetoj vetë Churchilli se, seicila bombë fluturuese ka renue tre shtëpi kolosale të Londrës dhe ka ba të pa banueshme edhe 14 të tjera. Radio Londra lajmëron me 4-8-44 se zjarri i bombavet fluturuese gjermane [illegible] janë akom[illegible] dhe me të turishëm se [illegible]përherë. Çfarë mund të ngjante sikur këto bomba të vazhdonin në futurizm? Në këtë rasë, sa njerës dhe sa shtëpira do të fluturojnë n'ajr? Në fillim "dinamit-meteorat" V. 1. kanë qenë të perdorun si provë. Ahmarrja e vërtetë fillon tani. Dhe për këtë arësye Churchilli, Roosevelti dhe Stalini po i nxisin ushtarët e tyne në vdekje. Sepse ata kërkojnë të fitojnë luftën, para se t'u bjnë nokokë shpikjet e reja gjermane. Asnji konkurs vdekjeje; por [illegible] do t'i kapi në fyt aleatët.

Rrembim femijesh edhe ne Rumani

Bollshevikët e "çlirojnë,, populsinë civile nga fëmijët e tyre

Si në Italin e jugës, ku fëmijë italjanë imbarkohen, për dite, me drejtim Rusi sovjetike, ngjet edhe në krahinat e Rumanisë, të pushtuara prej Bollshevikëvet: edhe këtu rrëmbehen fëmijë dhe xhduken. Ushtrija gjermane që e vetëmja ajo që, në marshimin e saj në Rusinë sovjetike, u kujdesua për fëmijt spanjollë që ishin rrëmbyer prej të Kuqvet, me rrastin e luftës civile spanjolle 1936-39. Prej këtyre foshnjave të rreckosun dhe krejt të neveritur, u mësua diçka mbi fatin e të rrëmbyervet të mjerë.

Viktimat e njoma evropiane të Bollshevizmit, si pas një systemi të caktuar, u çpërndanë nër vënde të ndryshmë të Unionit sovjetik. Këtu ata iu dorëzuan fatit të tyre, midis sa e sa qindra mijrash fëmijë jetime rusë. Uria i sfërviti në vjedhje dhe vjedhja solli me vete krimin dhe vrasjen. Kështu vërtitej, në për rrugët e Unionit sovjetik, kjo tufë e neveritur fëmijësh të mjerë spanjollë, e përzjer me lloj lloj fëmijësh rusë, shokë vojtjesh dhe fatkeqësije, dhe lipte, e sëmurë e me duar të ngrira, gati për çdo krim që munt t'ia lehtësonte pak mjerimin. Dhe kjo ngjiste në paqën më të plotë.

Nderkohë Bollshevizmi ka përvetësuar mijra fëmijësh italijanë dhe nga Polonija lindore. Këtyre po u venë pas ata të Rumanisë veriore. Le t'a marrim me mënt se ç'farë fati i pret, këta të shkretë, në Rusinë sovjetike, tashti që ajo ka tre vjet që po çkrihet në një luftë të rëndë e të përgjakëshme. Por munt të merret me mënt edhe se ç'far rrezikù të tmershmë paraqet Bollshevizmi për të gjithë fëmijët evropjanë.

SHTYLLA E LIRË

POSTA E POPULLIT

Përgjegjet e tri pyetjeve të numrit 15 Datë 3 Gusht 1944.

I. Komisjoni n' Itali: Mbas informatave që kemi, Z. Omer Fortuzi gjindet në Svicer, dhe z. Dhimitër Berati, në Romë. Të hollat e dergueme prej prindve të studentave, nuk janë dorxue, gja që e verteton nji leter e ardhun prej studentit Qafmolla, në Padova.

II. Mbushja e burgjeve: Marrim vesht se u formue nji komisjon prej Ministris kompetente për të shqyrtue gjendjen e të burgosunve.

III. Nozullimi i ushqimit: Asht nji shpresë e madhe se zyra kompetente do të kujdeset sa ma parë, për të rregullue ket nevojë kryesore.

3700 të humbur 'në

Dëme të pësuar prej kon

Ndërmarrjet e sp[illegible] midis Hercegovinës [illegible]rore të Malit të Z[illegible] pas plani[illegible] viç (Bo[illegible] musli[illegible] [illegible] nisht 04[illegible] 1000 të [illegible] sasira të[illegible] je dhe [illegible] asi. bëdhia ushqimi e pesë

Më 30 korrik, çetat [illegible]tën, në Ballkanin veri-perë të vrarë dhe shumë të zënë e sertuar. Prej datës 23 korrik gjer 29, humbjet e çetavet, po në atë zo[illegible] arrijtën në 1858 të vrarë të sigurt dhe 1700 të kujtuar të tillë, ashtu dhe 150 robër e të desertuar. Po në këtë kohë, u zunë sasira të mbëdha municioni dhe armësh.

Shumë kurora dafine për Amerikanët!

Gazetat engleze mbi gjendjen në Normandi

"Times:,, Përdorimi, në shumic, i forkserve britanikë, në krahinën Caen, u bë shumë shpejt. Ofensiva, me forca të korracuara, shkoj mirë, në fillim. Por pastaj ajo u qëndrua në vënt, prej vijavet gjermane të mbrojtjes, të pajisura mirë me artileri. Gjermanët, jo vetëm që bënë një qëndrim jashtë masës të fortë, por edhe kundërsulmuan me një rreptësi fanatike.

"Reuter:,, Në buzën e lindjes të Orne, Gjermanët marshuan përsëri, me forca të mbëdha, në May-sur-Orne. Gjendja është pikërisht si ajo në Tilly la-Campange, në të cilën në rymë vërtet brënda, por, nënë zjarrin e rreptë gjerman, që na mbuloj me valë të paprera, u detyruam të delnim përsëri jasht.

"Times:,, Fjala depertim, e cila u përdor në njoftimet e Edenit, lipset të përdoret me mjatt kufi, Se nuk iu arrijt thyerjes s' armatës gjermane rreth Caen-it, Edhe ofensivës amerikane, kur ajo ndodhej edhe në fazën e fillimit, iu kushtuan tepër kurora dafine. U duartrokit, por fitimi s'u duk.

"Daily Herald,,: Në kohën e fundit, rreptësija e zjarrit "V. 1,, u shtua akoma. «Dynamit-Meteorat,, vinë rga drejtimet më të ndryshmë dhe, për t'u çuditur, ato qëllojnë njëkohësisht dhe me saktësinë më të madhe

ështjellime në Londër

ësit e huaja vendosen në për krahinat e Anglisë

olm. Si pasojë e veprimit gjithnji në shtim t' armës mane V. 1, në Anglinë Ju- London po luhen për dita a bcsueshme. Para së gji- mos ndër ndërtesat publike, onet e policis dhe ndër nimi janë tue mdodhë inci- nda. Po sundon nji dizor- lotë në punë të zbrazjes t prej fëmijve. Në lidhje htje gazeta "Dailly Tele- fton për shëmbëll se asht in me i grumbullue fëmijët parapame për t' i mble- humë fëmijë bajnë pako la sa rëndon edhe krejt Shumë nga këta kanë u që nuk qe e mundun se cilit grup ata i për- hore e t- pë na raë ej- ë-

ruese „ në krahinat jasht Londonit. Inisiativën për këtë gja e mori sikurse njofton agjensija "Associated Press„ Ambasatori i Argjentinës i cili javën e kalueme iku me familjen e vet për në një krahinë t' Anglisë. Ambasadori i Brasilisë shkoj e u vendos me familjen e vet né Skoci dhe njikohsisht këshilloj mësheftas edhe bashkëpunëtorët e tij të largohen prej Londonit. Edhe Ambasandori i Mexikut dhe ministri fuqi-plotë i Uruguayt u larguën prej Londonit.

Të dy diplomatët deri sot kanë qenë të shtërnguem me fjet ndër strehimet kundra ajrore. Po ashtu lajmohet se edhe ministri fuqi-plotë i Cuba s dhe i Ngarkuemi me punë i Perût nuk ndodhen ma në kryqytetin englez.

Frika prej ngjarjeve të tjara të luftës sikurse thëksohet në shtypin angles ka shkaktue një demoralizim të madh në radhët e forcave armate britanike. Në lidhje me këtë në mënyrë të veçantë hedh dritë mbi këtë çashtje deklarata e një gjykatësi në Manchester mbas të cilit bigamija asht tue u përhapë shumë në ushtrinë angleze.

*

Fletorja Svenska Dagbladen shkruan prej Stokholmit:

Në Londër nuk ndodhen ma dritare. Këto nuk dalin vetëm nga vendi, por prej presionit ajror, coptohen. Në shumë vende edhe njerzit nuk munden të shpëtojnë, sepse coprat e xhameve hyjnë shumë thellë në trupin e njeriut.

Katastrofë anijesh kundërsh e në gjirin e Seinit

Edhe në luftëu detare, mjete të rinj gjermanë

Mjete të rinj luftimi të marinës gjermane patën, më 3 gusht, një sukses të math në gjirin e lumit Seine. Si pas lajmevet të gjertanishmë, midis anijevet të fundosura ndodhen një Kryqësor prej 8000 tonelatash, një Kundërtorpilonjës prej 1870 tonesh dhe një anije transporti prej të paktën, 7000 tonesh.

Kryqësori u torpilua në mëngjes më ora 5.42, dyke u qëlluar mu në "pa- ca më dysh dhe u braktis prej

rikane dhe u qëllua më ora 4.43; ajo u ça më dysh dhe u fundos midis flakësh të mbëdha.

Si pas lajmesh të tjerë, u fundosnë edhe një tjeter Kundërtorpillonjës korveta të ndryshme dhe një anije e madhe ngarkese prej 5000 tonesh. Këta lajme nuk i përfshijnë të gjitha fundosjet. Pas si sulmi u bë i përmbledhur dhe në befasi, detonacionet u dëgjunn brënda 30 minutash, pakë pas orës 2 dhe këto i vashduan të tjera, me ndërprerje të shkurtra, midis orës 5 e 6.

Si pas një lajmi, nga një vënt shqyrtimi i bregdetit u pa, më ora 2.30, në drejtim Veri-perëndim, një

mit, nuk u pa më. Një nga fitimtarët e kthyer, mundi të shihte, prej një largësije 700 metrash, torpillimin e një kundërtorpilonjësi të math dhe fundosjen e këtij, goditur nga shoku më ora 3.40.

Qysh tash munt të thuhet se Aleatët pësuan, brënda pakë minutash të natës 3 gusht, katastrofën më të rëndë që kur se ka filluar invadimi.

revolver prej tanksit

në luejtjen kundra tanksavef armiq në frontin e invadimit

jtja kundra mesymjevet të randa të et anglo-amerikane që po bahet çdo ditë gjatë gjashtë javëve të be- invadimit, ka korur deri sot sukse- lqiqyeshme.

tanksa angleze të depertuem ka' shpejtësi në pozitat e luftimit të ijoni granadierë të korracuem në nën-togeri B. si komandant i nji r përsipër me dy gjuejtarë tanksash. e këtyne tanksave t'armikut Porsa prej llogores së tij dhe mrijti në nja njiqind metra larg përballë ks anglez që ishte gati me shtimë oz kundra pozitavet të luftimit të gjerman. U qëllua tanksi dhe go- rë ra mbi kazanin e benzinës s'tij. tanksi filloj me qitë tym Mbas ë dytë mori zjar. Në të njajtën y gjuejtarët e togut të tanksavet B, dhe nën oficeri O. prej nji letëdhjet metrash shkatrruenë me tanks armik të tipit "Sherman„ jarr për një herë. Mirë po luftimi e trelë paraqiti nji ngjarje shu- ese për nën togerin B.

pritmas pranë tanksit të shkat- rej gardhi duel nji tanks tjetër u ba kundra tij nuk ja mbrijti dërsa mbas qëllesës së gabueme tym dhe pluhun, tanksi u afrue hjetë metra Ndër kohë filloi tanksit armik të shtinte, por të gjith afërsinë e jashtzakonshme imin shenjës mbassi në çastin e clari u ndesh në nji pemë. Por edhe tanksi s'ka pas fat. Mbasi tanksi a rrijti në nji afersi të madhe me gjuetarin gjerman, fash filloi nji çast dramatik i ndeshjes. Filloi nji duel me revolver ndërmjet ekuipazhit të tanksit armik dhe të nën-togerit B. Ky ka qënë ma i zoti në të shtimet me revolver e kështu e plagosi komandantin anglez sipër syrit. Nji bombë dore të cilën donte nën-togeri B. me e hjedhe mbrenda në frëngjinë e tanksit, nuk ja mbrijti qëllimit. Kështu pjesëtarët e tjerë të ekuipazhit të tanksit u shtrënguenë prej nën-togerit B. të luftonin. Por ata ju shmangën këtij luftimi dhe mbassi u ftuenë të dorëzohen ata ju bindën dhe u dorëzuan. Ndërsa anglezët po dilnin jashtë prej gjigantit të tyne të çelniktë, ardhi nji tanks tjetër për ndihmë të tyne porse mbas disa qëllesash të pakta u shkatrue edhe ky.

Kështu ra në dorë të gjermanëvet një tanks i pa dëmtuem por i paralizuem në veprimin e vet prej infanteristëve. E ndërsa armiku pati nji bjerje prej katër vetash dhe një oficer dhe dhjetë veta u zunë rob, ana gjermane nuk pati veç një harxh prej nand granatash.

Arratisja nga qendrat e banditëvet

Nër katundet rreth qytetit sërb Bihaç, katundarët u ngritnë kundër terrorit komunist dhe, në rrejdhje të kësaj, filloj një arratisje e vërtetë prej kuartjerit të përgjithëshëm të bandavet. Gjer tashti, kanë kaluar, në vijat gjermane, 333 veta. Një sasi e madhe armësh dhe municjoni ra në dorën gjermane.

Një grua fluturoj bashkë me "Dynamit-Meteorën„

Ndërmarrja heroike e një piloteje gjermane

E famëshmja bombë fluturonjëse gjermane, që tashti po bën kërdinë mbi Llondër dhe mbi Anglinë jugore, bombe »V. 1.« u provua, në një fushë përkatëse gjermae, që në Nëntor 1942. Gjatë këtyre provave, një vark i tërë bombash fluturonjëse ranë mbi tokë edhe vetëm pas një fluturimi prej 50 metrash, se krahët e tyre thyhëshin nënë shtypjen e rëndë të shpejtësis së madhe. Nër uzinat e armës së re gjermane, nuk po e gjenin dot shkakun e kësaj së mete. Ü vu, prandaj, ngarkesa eksplozive jashtë bombës dhe, në brëndësin' e 'saj të lirë, u vendos të futej një pilot, i cili, me anën e verrejtjejes së tij, të caktonte shkakun e së metës.

. Midis numurit të math të vullnetarëvet, q' u çfaqnë për këtë ndërmarrje drejt vdekjes, që edhe një grua, pilotja gjermane Hanna Reitsch. Kjo u zgjodh, se, e para, e duron shumë shtypjen ajrore dhe, e dyta, se peshon vetëm 49 kg. Hanna Reitsch fluturoj me disa «Dinamit-Meteorë» të fillë, pa timon, pa mundësi ndalimi dhe midis rreziqesh që shkakton fuqija dhe shpejtësija e një gjyleje. E shtrirë në barkun e bombës, pilotja kuximtare vërtente, me një Periskop, se ç' ngjiste me krahët, gjatë fluturimit. Në një provë të këtillë, ajo u plagos rëndë.

Për këtë vetmohim të pashoq, Fuehreri i dha Hanna Reitsch, si gruas së parë gjermane, Kryqin e Hekurt të klasit të parë. Më tepër se një mot, nuk duhej të mësonte Gjermanija, nuk duhej të mësonte bota, gjë prej gjëje, rreth veprës heroike të kësaj gruaje. Vetëm tashti, që kur se arma e tmershme dhe misterioze gjermane po e vazhdon rrugën e saj vdekjeprurëse, kundrejt Anglisë jugore, me saktësinë e një treni dhe pa ndërprerje, mësohet se ç'far qe e zonja të kryente gruaja e vogël delikate, Hanna Reitsch.

Në Sinisinë Cotentin janë caktuar fusha përqëndrimi për punë të detyrueshme për Francezët që nuk viren, me vullnetin e tyre, në dispozicion t' autoriteteve anglo-amerikane.

*

Brënda 7 javësh pushtimi anglo-amerikanë, në Romë u dyfishua numuri i Çifutëvet.

Stalini na u beka fetar!

"Qellimi justifikon mjetin„

Stalini, që kërkon t' a xhduknjë kishën me çfardo mjeti, ay që deklaron më 1928: "në bëjmë një propagandë kundër besimesh fetarë dhe në do t' a vazhdojmë këtë propagandë... Ay Stalin na hiqet tashti si njeri besimtar. E pse vallë kjo? Jo se ay u bë krisfjan por se, nënë masken e lirisë fetare, ay beson t' i kapnjë njerzit më lehtë për vehten e tij. Që, ay ka mbetur i pa zot, e dëshmoj, më së miri, fati i Kishavet nër vendet e pushtuar përsëri prej Sovjetëvet. Këtu filloj një ndjekje kundër të Krishtërëvet që s' ka ndodhur kurrë nonjë herë tjatër, që kur se eksistojnë Kishë. Kisha mbaroj së qëni. S' ka më mesim besimi për të vegjlit, fetarët ndiqen dhe dërgohen në Siberi. Të gjitha gazetat me përmbajtje fetare, edhe vetë librat fetarë janë të ndaluar.

Dhe ndërsa ne Lindje ushtërija gjermane mbron Evropën nga ordhit e kuqe, ndërsa Krishtianizmi dhe Islamizmi luftojnë kundër të pa perëndishmvet, ngrihen njerës në Shqipëri dhe rrëmbejnë armët kundër mbrojtësvet t' Evropës, njerës që ndonëse në shapkën e tyne kanë yllin e kuq, në gjoksin e tyre kanë varur fytyrën e nonjë Shënjti. Ngrihen gra dhe rrëmbejnë pushkën, të cilat, nër xhepat e tyre, ndofta kanë edhe tespihet e faljes! O popull i verbuar! Ti po lufton për Bollshevizmin, i cilli, po [illegible] do të t' i hedhë në prush të [illegible] e tua fetare dhe ç' gjë ti [illegible] nilë, ti nuk do të dish [illegible] drejtim, ne qoftë se ne [illegible] tojmë qytetërimin kristian...

Grusht çetavet greke

Në Greqinë Jugore dhe veçanërisht në Poloponesël, si në muejin e kaluem, ashtu edhe në këtë muej janë zhvillue luftime të fitimshme kundra çetavet. Prej banditëvet mbetën 791 të vramë 175 të plagosun dhe 218 të zanun rob.

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Ejte 10 Gusht 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 17 - ÇMIMI 1 LEK

"Unë qendroj i patundur si Flamurtar,,

Führeri u foli Zyrtarvet të naltë të Reichut mbi atentatin

Fuehreri i Reichut të Math gjerman, Adolf Hitleri, priti, në Kuartierin e tij të Përgjithëshmë, Drejtonjës të ndryshmë të Partisë (Reichsleiter dhe Gauleiter) dhe u ndriçoj atyre shkakun e atentatit të 20 korrikut.

Ay shpjegoj, hollësisht, se si prej ati rrethi trathëtar, çfaqej gjithënjë një kundërshtim i paprerë kundër të gjitha masavet që merte Qeverija, gjer sa me së fundi, dolli në shesh si trathëti e hapur, kundrejt trupavet luftonjëse, e u shtua gjer në sabotimin e furnizimit të frontit.

Turpi do të kthehet në bekim

Shumica dërmonjëse e, midis kësaj, mijra oficerë trima, s' kanë pasur asgjë të përbashkët me këtë klikë dhe e shohin me përbuzje e me ndohtë. Fuehreri e ndjen si një hir të Zotit dhe si një lehtësi personale xbulimin dhe kapjen e klikës kriminele, bashke me të cilën cduket edhe çfardo kundërshtim i brëndeshmë. Tashti është rrasti të nxiren përfundimet përkatës nga ngjarja e hidhur. Më së fundi duhet t' a pranojmë se kjo vepër e poshtër ndofta që ajo me fatbardha për të gjithë të arthmen gjermane.

Do t'i zotërojmë të gjitha vështirësitë

Unë nuk i trëmbem as pak luftës kundër armiqvet të jashtmë, deklaroj Fuehreri. Me ata né, sido që të jetë, më së fundi do t'i dalim në krye. Unë dua vetëm të kem bindje të plotë se, nga pas, mbretëron siguri absolute dhe bashkëpunim e besim i plotë. Kjo është kondita e domosdoshme. Né nuk do t'a kishim filluar dot mobilizimin e të gjitha forcavet të popullit, ashtu si po ngjet sot, sikur të kish duruar akoma vepërimi kriminel i sabotonjësvet, tash më të xhdukur për gjithmonë. Me pjesëmarrjen e të gjitha fuqivet ushtarake dhe të brëndëshme, ne do t'i zoterojmë të gjitha vështirësitë.

Un i jam mirënjohjtës fatit

Në mbarim, Fuehreri deklaroj: Un i jam mirënjohjtës fatit jo se më s' pëtoj jetën, por se që un do të munt t'a vashdoj luftën: se unë besoj që jam i nevojshmë për Kombin. Unë besonj se kombi ka nevojë për një burrë që nuk kapitullon në asnjë mënyrë, por që e mban lartër flamurin e besimit dhe të vendosjes: unë besonj se një punë të tillë nuk do t'a bënte as njeri tjetër më mirë se unë. Çfardo grushte të na sjellë fati, unë do të qindroj gjithënjë si Flamurtar i pa trëmbur. Më 20 korrik, unë u binda për këtë, më shumë se kurrë herë tjatër, prandaj, më së fundi, ne do t'a fitojmë këtë luftë.

Kriminelët u eksekutuan

Atentatorët e paguan trathëtin e tyre

Gjyqi i posaçëm, në Berlin, gjykoj pjesëmarrësit në pregatitjen e atetantit kundër Fuehrerit. Nga të 12 të akuzuarit, 8 u dënun me vdekje në litar. Vendimi u eksekutua. Në këtë mënyrë, pësoj dënimin e merituar një krim q'i kanosej jo vetëm jetës së Fuehrerit, por dhe tërë Evropës.

Kuartieri i P. engles i ajrit ikën nga Llondra

Mareshalli Harris, "Babaj i luftës terroriste,, fshihet nënë tokë

Sulmi me armën e re gjermane «V, 1.» i shkakëtoj Anglisë, në të pestin vit të luftës, përsëri rrëmujë të befasishme. Punëtorët englezë ankohen pa pushim kundër Qeverisë, se ajo e ka lënë popullsinë pa asnjë mbrojtje nga arma hakmarrëse, ndonse ajo, si e tha vetë Churchilli kish dijë mbi pregatitjet gjermane. Churchilli e la popullsinë civile engleze në furin e zjarrit gjerman dhe s'i mori parasysh humbjet e saj, të cilat janë shumë më të mbëdha e më të rënda se sa i kishin pritur Englezët përgjegjës.

Propaganda engleze se gjoja do të bëhen rapresalje kundër armës «V, 1.» dyshohet tepër edhe në rrethet parlamentarë. Në Kuartierin e përgjithëshmë të Eisenhowerit janë të mendimit, si pas lajmevet t'agjensivet amerikane, se bomba fluturonjëse do të influenconjë së tepërmi të gjithë systemin e luftës së arthme. Midis bisedimevet të tyrë fjesht teknikë për mbi armën në fjalë, folësvet të Kuartierit të përgjithëshëm u çfaqëshin përpara syvet grushtet që pëson Anglija jugore, dhe, ca më tepër, lajmi i gazetës «Times» si pàs të cilit, një nga bombat e tmershme ka qëlluar kazerma veri-amerikane dhe ka vrarë shumë ushtar të Shletevet të Bashkuar.

Marshalli i ajrit, Harris, i cili ish mësuar, gjer sot, t'i dërgonte bomba popullsisë evropjane e pa vehten të shtrënguar t'a largonjë kuartierin e tij nga Llondra dhe t'a fshehnjë kush e di se ku, nënë tokë. Mbi Anglinë jugore nuk pushon aspak arfilerija kundërajrore, se nuk pushon as pak edhe ulërima e "V. 1." Rrugët janë të zëna nga tanket dhe nga kolona automjetesh, që xvarrisen drejt skelavet për të fornizuar, rishtas, me njerës dhe material, "mullirin., e pangopur të Normandisë. Artilerija kundërajrore harxhoj, këto javët e fundit, açë shumë municion kundër armës «V. 1.» sa u porosit fjalër në Shtetet e Bashkuar, në kundërshtim me llogarit e bëra.

Abuzim me Kryqin e Kuq

Në jugë-perëndim të Sh. Lo, fuqi këmbësorije amerikane të goditura rëndë, u lutën për pushim zjarri që të ngrinin të plagosurit. Ato sillnin mbi një tanks një flamur të Kryqit të Kuq dhe filluan të kërkonin në për fushën e betejës. Pas si ngrien nj'a dhjetë të plagosur, e hoqën Flamurin e K. të Kuq e hapnë zjarr, pa pandehur.

30.000 Refugjatë

Ja se si po „çlirohen,, Francezet

Reshtat e refugjatëve, qi vijnë sidomos nga krahinat e damtueme nga shkatërrimet e shkaktueme prej anglo-amerikanëve në Normandi, shtohen pa pushim në drejtim t'udhëve të mbrendëshme të Francës. Shumë syresh janë të shoqnuem edhe prej baktive, qi asht e vefmja pasuni e çmueshme e tyne. Por shumica nuk ka mund me marrë me vehte veçse gjanat ma të nevojshme mbi qerre, mbi karroca dore dhe mbi karroca fëmijsh. Pranë pleqve, plakave dhe nanave shifen nuse të reja me foshnje para duerësh qi svaren nëpër anët e rrugëve prej tmerit të vazhdueshëm t'avjatorëve mitraljuesa anglo-amerikane, të cilët bajnë viktima në popullsin civile nepër rrugat. Vetëm në një qytet të Normandis, qi gjindej në një kryqëzim udhësh, mbrenda 15 diteve, janë numrue 30 000 refugjatë normandezë, të cilëve organet zyrtare franceze u kanë tregue vendet e ndihmave në mbrendin e vendit, ku mund të drejtohen. T'ikunit e krahinave t'afërme t'okupueme nga anglo-amerikanet njoftojnë se si anglezët dhe amerikanët kanë sekuestrue pa marrë asgja para sysh, një sasi bagëtish dhe sendesh ushqimore për me i transportue n'Angli. Këto masa edhe friga e madhe për një zi të shpejtë bùke i kanë nxitë këta njerëz me përballue të gjitha rreziqet qi ka kalimi i zonave t'operacjonit për me mundë me ikë. Nëpër ambulancat gjermane, infermjere dhe ndihmëtare të Kryqit të Kuq Francez, paraqiten për dilë e ma tepër për me u dhanë kujdesel e tyne të plagosunve. Njena prej këtyne ka deklarue: «Nuk kam dishir me dhanë vetëm një ndihmë modeste, por do të dishrojsha me kontribue me të tana forcat e mija për me lehtësue mjerimet dhe vuejtjet e shkaktueme nga invazjoni i anglo-amerikanëve në vendin t'onë.»

Rrëfim Amerikan

Hopkins-i tregon dallaveret

Harry Hopkins, bashkëpuntori ma i përhershëm i Rooseveltit, në të përkohëshmen „Amerikan Magazine", shkruan sa vijon: „Pikë së pari, ne nuk duhet të kemi asnji frikë prej bashkëpunimit me popuj të tjerë e, para së gjithash, s'duhet të kemi frikë të bashkëpunojmë me Bolshevikët, mbasi me këta mund të bahen allish-verishe tregëtare ma të majme".

Allish verishe tregtije në kurriz t'Europës — në kurrizin t'onë.

U flakën përseri në det

Korzula u spastrua prej armikut

Në agimin e dites 2 Gusht, u zbarkuën fuqina luftarake t' anmikut në anën jugllindore të uj. hesës Gorzula të ishujvet Adria. Por, me gjithë mbrojtjen dekrete të tyne, me kundër-sulmin e fuqinavet gjermane të ujdhesës, anmiku, mbrenda disa c'ive u nxuër jashtë ujdhesës dhe u hodhë në det.

Edhe vetë buka e pamjaftuarshme

Zëra të besuarshme nga Qendrat e Partizanvet

Një pamje të kjartë mbi gjendjen e vërtetë nër brigatat e ndryshme të Partizanëvet na e apin të desertuarit ose të zënit rop. Këta flasin të gjithë një soj: dëgjojini ç' thonë;

I kapuri Dr. Vladimir N. mjek në Brigadën Majovice thotë; " Në Brigadën t'onë kish rënë tepër morali për lufim, se shumica e shokëvet ishin të kapitur së tufluari ",

Nji i kapur nga të Brigatës së V divizioni 36 Vojvodina, thotë; " Të rekrutuarit nuk duan të luftojnë. Unë besonj se ata, me rrastin e volitëshmë do të dorëzohen të gjithë. Ushqimi është i pamjaftë, Mish jepet vetëm fare rallë por edhe buka vetë nuk na delte."

Banditi i kapur, Jovanka P., anëtar i Komp. së I të Bat. IIItë i së IV Brigate të Divizionit të 7 sulmonjës treqon: Në kohën e furdit, ushqimi u bë fort i keq. S' ka më, veç se fasule dhe patate dhe çorbë misri. Në çdo 14 ditë me zi jepet një copë mish. Morali i shokëvet nuk qëndron mirë. Shumica e tyne janë rekrutuar me pa hir dhe nuk u pëlqen jeta e banditëvet."

I kapuri Sfjepan L., ish Komisar i Komp. së parë i Brigatës Turopoljaska Posnvska, thotë: « Morali i banditëvet nuk qëndron më dhe aqë mirë Sikur ata të mos ishin nënë kontrol të rreptë, sigurisht pjesa m' e madhe do të ikte.»

I desertuari Namik T. deklaroj; « Banditët nuk e ndalojnë asgjëkundi shërbesën fetare. Por luftëtarëvet u shënohet si faj tepër, i rendë të vajturit në faltore. Banditët mundohen gjithnji të detyrojnë Fetarët për të mbajtur fjalime në dobi të partizanëvet. Ndonjë që kundërshton, shduket shpejt e shpejt. Nga teshat dhe kundrat e hedhura prej Englezëvet, Partizanët e zakonëshëm nuk marrin gjë. Të gjitha ndahen midis shtabit të lartër. Shtabet e unjtur (Brigata dhe Bataljone) marrin vetëm fare pakë. Sa m' i lartër të jetë shtabi aqë më shumë mer, aqë m' i privilegjur është.«

Rroftë Ushtërija çlirimtare e popullit« "Parajsa e Komisarëvet", Varri i Partizanëvet të gabuar.»

Përse çuditet Turqija?

Ankaraja zgjuhet tepër vonë nga gjumi

Prenja e marrëdhanjevet miqsore gjermano-turke nga ana e Ankaras, nuk u konsiderue si ndonji ngjarje e pa pritun. Asht për t'u çudit se Turqija, për përfundimet e aferme të hapit të saj të fundit, filloi vetë të çuditet.

Mundësija e vizitavet miqësore të flotavet aleate në Bosfor dhe në Dardanelat shkakëtojnë shqetësime n'Ankara. Vallë nga çanë do të vijnë këto "Flota miqsore,.? Këtë e din seicili se sa qindra vjete e këndej mundohet Rusija për zotnimin e ngushticavet. Prej lajmevet që qarkullojnë kuptohet se ngushticat duhet të vihen nën kontrollin ndërkombëtar. Por, me nji Angli të dobësueme dhe me Shtetet e Bashkueme të pa interesuem në këtë çështje, natyrisht, se si përgjegje nuk mund të mendohet tjetër, veçse kontrolli i Rusis në Dardanelat dhe në nji kohë të favorshme, këmbimi i këtij kontrolli në zotnimin e saj. A ka pritun gja tjetër Turqija? A mund të priste gja tjetër?

Përveç kësaj Ankara-ja po çqetësohet mbi ardhjen e nji misjoni ushtarak në çetat Greke. Për se vallë? A kujtonte Turqija se Moska do të kënaqej vetëm me influencën e saj përkundrejt Tito-s? Moskës i interesojnë çetat jo për shpresat edhe për dëshirat e tyne, por, aq ma tepër, për vendet e tyne, ku ata veprojnë. Po t'i japish gjishtin e vogël, ay të merr krejt dorën. Ngushticat detare të Turqis Moska qysh tashti ka rregjistrue si fitime të saja, mbassi me këputjen e mardhanjevet me gjermanin, Ankara-ja dha të kuptojë bolës se ajo nuk asht gati të luftojë për t'i mbajtun ato në pronë të saj. Tash Moska interesohet prapë për ndonji kafshalë tjeter, d.m.th. për brigjet kundrejt ngushticavet detare të Turqis: për Greqin dhe për ujdhesat e Egjeut, Ankara-ja këtë përpjekje e konsideron kërcënuese, shka asht edhe e vërtetë. Po pse çuditet për këtë? Turqija i ngjan nji njeriut, i cili nuk e ka kuptue se po të hyjsh në shpellën e luanjvet atëhere je në rrezik të shklyhesh prej tyne. Kush i hyn nji aventure të tillë, ai s'duhet të çuditet në qoftë se i vjen shkatrrimi.

Kanibale prej Sh. të Bashkuara

Përdhunim kufomash japoneze

Shprehësi i Qeveris japoneze njoftoj, në konferencën e shtypit të huaj se ushtarët amerikanë, si duket me lejimin e oficerëvet të tyre, kanë përdhunuar edhe kufomat. Po të luftonim kundër Kanibalëvet osc gjahtarëve kokash, një gjë e këtillë munt të kuptohej, deklaroj shprehësi japones. Gjuha njerzore nuk ka fjalë për të treguar tmerin dhe ndohtësirën që ndjen populli japonez. Një ushtar amerikan bëri një lelër-prerës prej fyellit të krahut të njëj japonezi të vrarë dhe ia dërgoj, si dhuratë, Presidenti Roosevelt.

Dihen shumë rraste që ushtarët amerikanë kanë mbledhur kafka dhe kocka ushtarësh japonezë dhe i kanë dërguar, për kujtim, në vëndin e tyre.

Ky eshtë rregulli i "çlironjësv et,, aleate

Methodha gangsterësh n'Europën e okupuar

Anija Spital gjermane «Tuebingen», gjatë një udhëtimi përpara bregdetit dalmat, u qëndrua prej dy kundërtropilonjës engleze dhe u shoqërua për në Bari, për një kontrollim të imtë. Me gjith kërkimin e tyne të kujdesçëm, që ësht' ndaluar si pas konventës së Gjenevës, autaritetet englese nuk gjetën gjë as në bodrumet, as në kazanet as instalimet e Radios. Pas nisjes nga Bari, personeli i anijes vuri re se nga anija mungonin një vark sendesh.

Gjithmonë dhe perherë duken metodat e gangsterëve amerikanë në punë të luftës! Në Gjenevë e organizuen, me çmime të nalta, Kryqin e Kuq, per me lehtësue fatin e randë t'ushtarëve të plagosun e të sëmundë të të gjithë kombeve. Kurse anglo-amerikanët, plaçkisin nji vaporr të Kryqit të Kuq qi ka pasun qellime humanitare.

Prej këtij shembulli dhe prej rasave, qindra herë të ngjashme me këtë, del në shesh gënjeshtra e frazave të rreme anglo-amerikane. Londra dhe Washingtoni pohojnë se bota ka dalë prej rendit dhe se kombet e tyne janë të shenueme për të sjellë boten përsëri në rregull. Rasa e plaçkitjes të vaporrit të Kryqit të Kuq gjerman "Tuebingen,, formon nji shembull kuptim-plotë, se ç'kuptojnë, n'anen e aleatëve, me kët rend, qi nuk osht ai qi na paraqesin me frazat e tyne.

Një minë në kopshtet e Vatikanit

Në kopshtet e Vatikanit plasi një minë, prej se cilës u dëmtua një pjesë e pallatit të Shërbimevet të shënjtë dhe disa dritore të Shen Pjetrit. Një Murg q'e xbuloj minën më parë dhe që desh t'a çngarkonte, u vra. Për qarqet politikë t'Italis Veriore, ky atentat viret në lidhje me vepërimin e levizjes së të "pa-Perëndishmvet,, e cila, s'ka shumë kohë q'u ngjall edhe në Romë dhe që, në një thir rje të saj, e fkonte popullsinë për atentate kundër Kishës katholike.

Krimineli si Rektor Universiteti

Autoritetet anglo-amerikanë në Romë emëruan Profesorin Garonia si Rektor t'Universitetit. Profesor Garonia, më 1925, u pushua nga detyra që kish si Primar i Klinikës së lindjevet, se kish përvetuar të holla nga administrimi i Institutit dhe se ish akuzuar për disa vrasje 5oshnjash, me anë injekcionesh, për të bërë eksperimente në dobin' e tij. Ay u lirua nga burgu më 1927, me një Dekret fajeje nga an'e Duces.

Sovjetët shtijen edhe mbi të mbytunit

Një anije lufte e vogël gjermane, që ndodhej në gjinin e Viborgut, u qëllua prej nji anije të shpejt Ruse. Marinarët gjermanë, që ndodheshin ende gjallë u kapën, u pushkatuen dhe u hodhën në det.

Marinarët e një anije gjermane, që ishte mbytun prej torpedinierve Rus, deshtën të shpëtojnë vehten tue ba not. Rusët, me anijet e shpejta të tyne, i qëlluan këta në ujrat e detit dhe i vranë. Njanit prej marinarvet gjerman, që patën zanë gjallë në anije, i dhanë nji mitralioz, që t'i qëllojë ai vetë trupat e vdekuna të shokëve të tij në sipërfaqen e detit. Mbassi ay e kundërshtoi, u vra po me këtë mitralioz prej Rusvet.

Humbje të rënda në Ballkanin veriperëndimor

Sulmet gjermane të spastrimit vazhdojnë me sukses

Në krahinën e Bijelo Poljes (Mal i Zi) sulmi gjerman u veshdua, me gjith kundërshtimin e meplë nga ana kundërshtare. Në Lika, në krahinën e Bunic-it çetat u çprapsnë prej fuqish të shumta Ustakish. Vrbovsko (Kroacija veriperndore) u muar përsëri. Për këta luftime, çetat patën 100 të vrarë. Në Bosnjën qendrore, në krahinën Drvar, sulmet e çetavet u thyen me sukses.. Armiku pati më tepër se 70 të vdekur. Çetat humbën, më 5 gusht në Ballkanin veri-perëndimor, 385 të vrarë të sigurtë dhe 200 të pandehur si të till ë, ashtu dhe 18 robër dhe të desertuar.. 8 Mitraljoza, 17 mitraljoza antitanks, 280 pushkë dhe 250 kg. sendesh u sihqimore u kapnë prej trupavet gjermane.

Në rrethet e Prijepoljes (Mal i Zi) sulmet kundërshtarë u ndaluan prej trupavet gjermane dhe çetat u çprapsnë me kunërsulme të shpejtë. Armiku pati humbje të rënda. Në veri të liqenit të Shkodrës, sulmi i trupave t'ona vashdon me sukses. Në Sanxhak po skvillohen luftime. Trupat gjermane e detyruan për luftim fuqinë kryesore t'armikut. Nër të tjerë sektorë të kësaj zone luftimi, sulmet kundërshtarë u thyen. Në rrethet e Drnis (Dalmaci) çetat u shtynë nga veriu, prej trupavet t'ona, me gjith kundërshtimin e tyre të rreptë. Sulme të fortë kundërshtarë në Vrbovsko (Kroaci veriperëndimore) nuk patën sukses. Ata u thyen me kundërsulme. Në Ballkanin Veriperëndimor, çetat humbën, në një nga difet e fundit, 114 të vrarë me siguri dhe 100 të pandehur si të tillë.

Terror mbi Ballkan

Me mitraljos kundër popullsisë civile

Ajrorë anglo-amerikanë, sulmuan me mitraljoz në fluturim të unjtër, në rrugën Grdelica- Shkup një tren civil, 11 udhëtar, midis tyre gra dhe fëmijë, mbetën të vrarë, 35 të plagosur rëndë dhe 30 të plagosun lehtë. Midis Grdelica dhe Cupris, në një tren civil, u plagosnë dy fëmijë prej mitraljozash anglo-amerikan.

Gjatë rrugës Jagodina-Cuprija, ajrorë, në fluturim të unjtër, sulmuan disa katundarë që shkonin në arat e tyre. Tre të plagosur rëndë dhe disa të plagosur lehtë, mbetën të shtrirë midis rrugës. Ajrorë anglo-amerikan, me bazë në Unionin sovjetik, sulmuan me mitraljos shumë katunde rumunë në krahinën Muntenien dhe shkakëtuan dëme dhe viktima midis katundarëvet që punonin nër ara.

Kështu janë, në të vërtet, "Clironjësit aleatë,,

Roosevelti gjuan vota

Grindje në konventin e partisë demokrate

Një pjesë e shtypit të Shteteve të Bashkueme gjithmonë e ma tepër po meret me themën: «Faji i Rooseveltit në punë te lufta».

Në lidhje me këtë themë e përkohshmja "New York Sunday" boton një artikull në të cilin pohohet se Roosevelti premtimin e tij për mos dërgimin e rinisë amerikane për në luftë, nuk e mbajti.

Fletorja e përmëndur sipër e quan prallë edhe t'ashtuquajturën pikë kryesore te atij fjalimi të Rooseveltit që ky mbajti në Boston dhe që u rreklamue së tepërmi prej pjesëtarëve t'organizatës "New-Deal" mbas së cilës qëndrimi i Amerikës jasht luftës vetëm atëherë mund të ndodhë në qoftë se Amerika nuk mësyhet. Kjo asht nji histori e gënjeshtër pse në të vërtetë Roosevelti nuk ka ba ndonji shtim të tillë në fjalimin e tij. Fletorja zbulon lojën e dyfishtë të Rooseveltit tue pohue se Presidenti i Shteteve të Bashkueme fjalën e tij të dhanë për mos dërmgin e rinisë Amerikane për me luftue, jasht atdheut e theu, qysh më 11 të Shtatorit 1941, në nji fjalim radiofonik kur i dha urdhër flotës së Shteteve të Bashkueme të gjuajnë kundra anijeve luftarake italjane ose gjermane. Fletorja Amerikane nënvizon se ky hap i Presidentit ka qënë i bamë me vendimin e tij diktatorial e pra pa u këshillue ky me Kongresin i cili ka të drejtën si mbas statutit të shtetit ti deklarojë luftë ndokujt.

Fletorja "New York Sunday News" përfudon tue akuzue Rooseveltin si fajtor të luftës. "Roosevelti e theu premtimin e tij për mos hymjen e Amerikës në luftë me tetë muaj përpara Pearl Harbourit". Ai qysh atëherë hyri në luftën e Atllantikut dhe po priste që të provohej Amerika në luftë prej fuqive të Boshtit. Të gjilha këto ai i bani vetë pa e pyetë Kongresin dhe popullin e Amerikës.

Karta e Atlantikut u mplak

Ajo iu bë "kurban,, Kremlinit

Shtypi sviceran përmënt, me rrastin e fjalimit të Churchillit, se Estlandezët, Lituanezët dhe Leutonezët po e ndjejnë, në trupin tyre, ç'përmblodhi ay, në fjalit' e tija të shkurtra, dhe se lufta ka humbur shumë nga rëndesija e saj idhologjike: me fjalë të tjera. Karta atllantike u hoth në shportë. Kremlini po nxiton t'a shtjerë në dorë, gjer në funt të luftës, ç'ka i duhet, me do e mos, si fuqi e madhe politike.

Pishkopi norvegjer, Lofe, mbi atentatin e Fuehrerit: "I falem Zotit që Hitleri qëndron në krye të ushtris, e cila na shpëton nga asgjasimi prej Bollshevizmit.

Në vendin prej kah gjuhet me V. 1.

Njoftimet e para mbi llogoret e armës së hakmarrjes

Diku, në Francë, gjindet komanda e armës së rë gjermane «V. 1.» Thellë në tokë gjindet llogori prej kah u jepet urdhën të hyjaë në veprim ushtarëvet që gjuajnë me armën e re t'hakmarrjes. Muret e llogorit janë mbulue me harta gjeografike e me kartella, ndër të cilat sidomos hartat në masa të gjanë tregojnë Londonin me qarkun e tij, me rrugat hekur-udhore, me rrugat me instalimet industrore, me vijat hekur-udhore të nëndheshme dhe me detalje të tjera që paraqesin gjithshka të randësishme në pikpamje ushtarake.

Në nji mur janë shkrue urdhnat e veprimet e të qiljes së njisinavet të veçanta vepruese me armën e re. Kështu këndohet për shembull: qitje n'orën 20,45 qitjen n'orën 19,40 qitje n'orën 20,54 e tjera. Prej të gjithave këtyne kuptohet se popullsija e Londonit gjatë ditës së kalueme vetëm dy orë pushim e qetsi ka pasë.

Pastaj po hyj thellë ne një llogore të madhe që gjindet thellë në dhé. Komandanti veprues këtu kqyr orën e dorës dhe thotë: «mbas dy minutash» «Paula 3 ka me qënë atjë...» Na kqyrim aeroplanin pa pilot që asht gati për nisje. Bahen veprimet e mbrame, ndreqjet e vogla, ndryshimet e pakta në mekanizmën misterioze, në veglat elektrike ne mbrendsirën e këtij «metheori dinamit» të madh.

Mbrapa këtij që quhet "Paula" janë radhit në nji radh të gjanë metheorë dinamitë të tjerë, të cilët gjatë kësajë nate kanë me u nisë për në rrugën e gjatë të Londonit. Kështu ushtarët vepruesa me "V. 1." punojnë pa pushim.

Arma V. 1. ban shkatrrime dhe në Portsmouth

Një ushtar që bante pjesë në nji divizon infanterie angleze i cili në frontin e invadimit rà rob deklaroj se ai para disa ditësh kishte ardhë prej Anglije. Mbas këtij shkatrrimet e bame prej armës gjermane t'hakmarrjes edhë në qytetin limanor Portsmouth janë shumë të mëdhaja.

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Hënë 14 Gusht 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 18 - ÇMIMI 1 LEK

Propozohet xbrazja e Llondrës

Churchilli kundërshton vetvehten - "V. 1.,, e shton rrëmujën

Si njoftohet, numuri i bombavet fluturonjëse që bijen, në një ditë, mbi lagjet e qytetit, u çmua, në rrethe serioze te Llondrës, mesatarisht në 120. S'është kursyer asnji lagje e Llondrës prej armës «V. 1.» Arma e re i ka impresionuar aqë tepër disa ministra britanikë, sa këta në një mbledhje të këshillit ministror, kanë çfaqur mendimin për një xbrazje të përgjithëshme të Llondrës, veçanërisht për një decentralizim të veprimeve ushtarake me qendër në kryeqytetin britanik. Ndonse Churchilli, vashdon lajmi, nuk mundi t'i kundërshtonte arsyet për një xbrazje tërësore të Kryeqytetit prapë ay çfaqi mendim të kundert se, një hap të tillë bota do t'a quante si një kapitullim të Llon, drës. Churchilli theksojë pikëmbështetjen e tij se lufta, le të kushtonjë sa të dojë. duhet të marrë një përfundim deciziv, me fitimin e aleatëvet, me do e mos, të shumtën, gjer në tetor. Brënda kësaj kohe, duhet të hidhet në fushën e luftës çdo gjë që kanë fuqitë aleate qofshin njerës qof ë material, për t'i arrijtur përfundimit më parë se të ryjnë në përdorim nga ana gjermane, të tjëra armë të ra, dhe kështu të rynte lufta nër faza krejt të panjohura.

Systemi anglez i mbrojtes së Llondrës u përmbys më parë se sa e kishin pritur autoritetet Morison. Systemi i gjertashmë i alarmit, kundër «V.1.» me vërshëllimin e sirenavet, i cili ia arrinte qëllimit për sulme ajrore stili të vjetër, për sa i takon sulmit të «V.1.» po tregohet gjithënjë më i vjetëruar dhe më i papërshtateshmë, pas si ay system nuk u le as pak qetësi lagjevet të gjera të Llondrës dhe Anglisë Jugore, dyke i mbajtur pa pushim, në gjendje rreziku. Po në këtë mënyrë falimentoj edhe përpjekja për të të gjetur një tjatër mjet alarmi, që të përdorej vetëm në Llondër dhe vetëm për zonat e kanosura, ashtu si falimentoj, në menyrë të vajtuarshme, edhe zgjidhja e problemit të ngutëshmë për të çpikur një mënyrë të re alarmi, e cila, mundësisht, të mos çqetësonte punimet e ditës, të paktën për ato zona ku nuk çfaqet iminent rreziku i bombavet «V. 1.»

"Daily Mail,, njofton se, në të arthmen, do të pakësohet erresimi, për të lehtësuar punimet e ndihmës dhe të spastrimit. Administrata bashkjake e Llondrës e paska vendosur errësimin e lehtë të rrugëvet. Korrespondenti ajror i kësaj gazete, Colin Bednall, deklaron se qarkullojnë shumë lajme, si pas të cilëvet Gjermanët, në një kohë të shkurtër, dashkan të vënë në përdorim bomba fluturonjëse tipesh të rinj. Por, mbi këtë, mungojnë lajme nga burime zyrtarë.

Plaçkites midis gërmadhavet të qytetit

— Si rrjedhim i veprimit t'armës gjermane të hakmarrjes V. 1., në qytetin e Londonit asht tue u përhapë një veprimtari e vërtetë plaçkitjeje. Vjedhjet e plaçkitjet në kryeqytetin anglez sidomos gjetën rasë për me u shumue për shkak të gjendjes së krijueme prej zbrazjes së qytetit dhe prej shkatrrimevet që po pësON ky, kështu që në një mënyrë të lehtë po vijon plaçkitja e shtëpijavet e dyqanevet dhe e zyravet të mbylluna sidomos në ato vende që janë qëllue prej bombavet fluturuese. Shtypi i Londonit në artikuj të mëdha ankohet për këtë gjendje të pa durueshme dhe kërkon të luftohen energjikisht bandat që përgjithësisht përbahen prej të rinjsh me moshë 14-18 vjeç. Këta elementa kanë zhvilluë nji sistem të rafinueme ndërsa paraqiten nën maskën e mbledhsavet naiv copash përmendoresh e gjanash të tjera të çmueshme ose tue u paraqitë për shërbime të nxjerrjes prej gërmadhave t'atyne që gjatë shkatrrimit të ndërtesavet mbesin mbrenda. Këta kalojnë me biçikleta ndër vendet ku shpërthejnë bombat e V. 1. dhe atje ja hyjnë punës së mbledhjes e marrjes s'atyne gjanavet që u duken të vlefshme.

Edhe gratë kryejnë veprime të tilla plaçkitjeje. Këto kalojnë me karro fëmijsh ndër vendet kryesore ku janë shkaktue dame dhe marrin gjithshka gjejnë. Gazeta «Nev Chronicle» çfaq shqetësimin e vet së masat e marruna deri tashti për mbrojtje kundra këtyne veprimeve nuk do të mjaftojnë në qoftë se sulmet e bame prej gjermanëvet me V. 1, do të vazhdojnë edhe për një kohë të gjatë.

Edhe gazeta «Daily Expres» thekson se plaçkitsit e vegjël janë ba porsi një kolerë e vërtetë në London dhe në Anglinë e jugut. Me qënë se deri tash çdo masë e marrun kundra elementesh të tillë mbeti pa efekt, veprimeve t'ulta të vjedhjeve të kryeme ditën vetëm atëhere mund t'u pritet hovi kur çdo vend, në të cilën shpërthen ndonjë bombë fluturuese për një herë të rethohet dhe të ndalohet të kalojë atje kushdo që nuk ka ndonji leje të veçantë. Mandej fletorja thotë me nji dëshpërim: «kush ka sy për me pa sot në Anglinë e jugut, ai nuk don dëshmira të tjera për t'u bindë se luftimi i armës së re gjermane V. 1, i bam deri tash prej anës angleze ka qëne i kotë dhe pa efekt».

Fëmijë amerikanë te mbyllur ne kafaz pulash

Pamje tmerri në "Parajsen,, e Shtetevet të Bashkuar

Kryetari i Stetevet të Bashkuar t'Amerikës, Rooseveti, u xgjoth, një her' e një kohë, gjoja si «President popullor». Programi i tij politik u premtoj të gjithë nënshtetasvet një jetë mirëqënjeje dhe përparimi.

Por, si qëndron e vërteta, me këtë program kaqë të përzëmërt, duket nga e përkohshmja amerikane «Vomens Home Companion.» Atje lëçitim: «Si duket, mbretron kudo një neveritje e tmershme dhe një përdorim i keq i fëmivet. Në, të paktën. tre katunde të ndyshme u gjetën grupe fëmijësh, të cilët i kishin ngucur në një kafas pulash të vërshtjellë me tel në bodrumin e një shtëpije.»

Përshkrimet e së përkohëshmes amerikane nënvizohen, në mënyrën më të dukëshme, prej zyrës veriamerikane të mbrojtjes civile, si përfaqësonjëse e së cilës zonja Moss njoftoj, përpara njëj komiteti senatorial, sa vijon, mbi gjenjen e fëmijëvet në qytetin e Kaliforsisë San Fernard Balley; ajo tha: «Unë kam parë fëmijë që ishin ngarkuar n'automobila, të futur në enët e benzinës, unë kam parë të tjerë fëmijë, në San Diego, të lidhur pas karrosh heqëse. Por asnjeri nuk e ka ngritur zërin për të ndaluar këtë gjëndje të mjerueshme të fëmijëvet, e cila po keqësohet gjithënjë më tepër.»

Nga kapitujt më të errët të kujdesimit amerikan për fëmijët, është dhe numuri i math i vajzavet të ra që jepen pas kurvërimit.

Edhe n'Angli po një gjendje e tillë

Jo vetëm në Shtetet e Bashkuar, por edhe n'Angli, si pas së përkohëshmes londineze «Poeple» kriminaliteti, midis fëmijëvet, po shtohet në një mënyrë të tmershme. Gjendja ka arritur në një shkallë t'atillë, sa as që bëhet më padijë publike kundër krimesh të vegjlish dhe as që jepen më vendime dënimi, dhe kjo për të vetëmen arsye se nuk dinë se ku t'i futin të dënuarit, pas si jo vetëm që burgjet janë plot, por nuk pranojnë më, për ngushticë vendi as institutet e posaçëmë të përmirësimit.

Bomba në frontin e tyre

Një gabim fatal i avjatorëvet amerikanë

Si pas një lajmi të United Press, kuartieri i përgjithëshmë kanades bëri të njohur se bombardonjës amerikanë të të 8 trup avjator, në rrjedhje të një orientimi të gabuar i lëshuan bombat e tyre mbi një sektor kanades. Shumë ushtarë kanadezë mbeten të vrarë e të plagosur, midis tyre edhe një oficer i lartër nga të shtabit të përgjithëshmë.

Kanadaja e çqetsuar për humjet e saja

Zbrazësirat nuk munt të mbushen më

Korrepondentët amerikanë dhe englezë pranë Kuartierit t'Eisenhowerit e tregojnë tashti, haptazi, se sulmet e përgjithëshmë të Normandis, prej trupavet aleate, po shkakëtojnë humbje të rënda. Korrispondenti radiofonik Harper thotë, në lajmërimin e tij të fundit: "Po vdesin shume ushtarë amerikanë nër këta luftimet e përgjakëshmë të Normandisë,,. Në Kanada po ngjallin shqetësime te dukëshmë lajmërimet mbi humbjet e shumta të repartevet kanadezë. Në qarqet ushtarake flitetë se duhet të zgjidhet kjo çështje, me do e mos, pasi humbjet, midis repartevet kanadezë, nuk munt të mbushen më dhe pas këtaj, vetëm me vullnetarë kanadezë.

Zef Bregu

Disa të verteta

Ndoshta jemi i vetmi komb, që me realitetin e sotshëm nuk po konformohemi. Edhe sot po vazhdojmë t'a kundrojmë jetën në nji pikpamje tashma të vjetëruemе nën prizmën e koncepteve që i përkasin vetëm të kaluemes së popujvet. Ende nuk jemi në gjendje t'u përshtatemi rethanavet që ka krijue e po vazhdon të krijojë për ditë jeta e këtij shekulli me frymën e vet e sidomos me ndërmarrjet e veta qi synojnë ndërtimin e nji rendi të ri europjan, bile botnuer. Po vazhdojmë të ndjekim rrugën e dikurshme të egoizmavet mesqine, të miopis krahinare, të shërbimit vetëm të vet vehtes, të kënaqësisë s'ambicjevet personale dhe të lakmive të ulta. E mira vetjake, interesi personal, formon ende cakun e veprimevet t'ona.

Gati të tmerrojnë kontrastet e mëdha, që shef njeriu n'ambientin t'onë të vogël, që quhet Shqipni. Krejt bota në flakë, nji përleshje e tmershme po i mban në ankth shpirtnat, mija jetash shduken, mija vlera rëxohen, për me i a u lanë vendin krijimit të vleravet të reja. Flakën, zjarrin e kemi në votrat t'ona, krahinat shqiptare u bënë hi e pluhun, me mija janë shqiptarët e mbetun pa strehë, pa bukë në mëshirën e fatit dhe në nji gjendje dëshpërimi të thellë. Dhe ndërsa turmat e mbetuna pa plang e shtëpi, pa kafshatën e bukës enden të hutuem drejt errësinës, shofim të tjerë, që i kryejnë spekulimet ma të turpshëm për me sigurue interesë vetjake.

Të flasim çiltas e të kuptohemi mirë

Ndërra mjerimet e punforit, e nëpunësit, e zejtarit dhe e produktorit të vogël që formojnë boshtin e kombit kanë mbrijtun në kulm, të tjerët kanë sy e faqe të ndërtojnë pallate, të çojnë jetë luksoze, të bredhin me vetura, të vijojnë të përqëndrojnë përpjekjet e tyne për t'i shërbye shpirtit që i a kanë shitun me kohë djallit. Nuk asht

(Vijon na faqen 2)

Pohim pa veprim

E përkohëshmja angleze «Nineteenth Century and After» shkruante, në shkurt të këtij viti:

«Edhe vetëm përvetësimi i shtetevet ballfikë, i Polonis lindore, i Besarabisë dhe i Moldavisë, nga ana ruse, si e ka çfaqur Rusija qysh tash, përbëjnë një çpërngulje të mndhe pushteti, përbëjnë nënshtrimin e 22 milion njerëzve nënë sundim të huaj. Dhe, me gjithë këtë, këta aneksime janë vetëm pretendime të vegjël rusë përkundrejt Evropës. Tashti është fjala për diçka më tepër se për të arthmen poloneze, ruse, gjermane dhe engleze: tashti është fjala për të arlhmen e të gjithë Evropës.»

Atë që në Llondër e kuptojnë fare të pakët, në Gjermani e di i tërë popuili dhe për atë po lufton ushtrija gjermane prej qysk më tepër se tre vjet.

(Vijon nga faqja e 1)

puntori i këputun, bujku i zbathët, nëpunsi i unshëm dhe emigrandi i pa buk, që formojnë mizerjen shoqnore shqiptare, por janë ata, që nën maskën e një nacjonalizmi të gënjeshtërt kanë vazhdue dhe po vazhdojnë gjithnji t'i shërbejnë vehtes së tyne. Nacjonalista sot dhe nacionalista mot, vetëm sa për dukë dhe vetëm sa për të mshefun qëllimet e vërteta të nji egoizmit sa primitiv, kaq edhe të damshëm.

Nacionalizmi ka nji kuptim modern

Asht koha të përcaktojmë pak ma qartas domethanjen e nacjonalizmit. Nuk asht nacjonalist ay, që tue pà vuejtjet e mijë bashkë-atdhetarvet të vet të mos konformohet e të mos pjestohet krejtësisht me vuejtjet e me thëroritë e tyne. Koha e atij nacionalizmi qi shtynte pakicën në theroritë ma të mëdhaja për sigurimin e interesavet të shumicës ose për plotsimin e interesavet të disavet, mori fund dhe përëndoi nji herë e përgjithmonë. Sot kemi nji nacionalizëm të ri me nji kuptim ma të gjanë: atë që kërkon detyra, të drejta dhe therori të njajta për të gjithë. Ate që paraqet nji kolektivitet kompakt në vuejtjet, në hidhërimet, në disfatat, po ashtu sikurse edhe në gëzimet dhe në të mirat.

Nacjonalizmi që njeh dhe përkrah privilegje, kur masa e popullit po mbytet prej nji krize landore e shpirtnore të pa shëmbëllt në histori do t' ishle nji nacjonalizëm kriminal, i pa kuptim dhe i pa vend.

Me qinda mija kilometra jemi largue prej asaj forme të nacjonolizmit, që formonte vetëm nji mjet për me ba dallavera. Jemi në hohën e nji nacjonalizmi konkret me kufizime, të cilin duhet t'a ndjejë deri në palcë seicili që ban pjesë në kolektivitetin shqiptar qoftë, gegë o toskë, kosovar o çam, dibran o kurveleshas. Dhe nji nacjonalizëm i tillë mbështetet në nji frymë ta ré: në frymën e nji solidarësije të plotë kombëtare, në të cilën çduken privilegjet, çduken ambicjet personale dhe egoizmi. Kur njerëzit e ndjejnë vehten të detyruem pse janë nacjonalista, në këtë rast duhet të ndihmojnë shoqi shoqnë me gjithshka dhe, po të jetë nevoja edhe me jetën e tyne për me mujtë me sëndërtue konkretisht idenë kombëtare.

Të përbashkëta: lumtëri e fatkeqësi

Nji «nacjonalizëm» që mbështetet ende në nji mos barazim detyrash, të drejtash dhe therorinash, formon nji anakronizëm të shëmtuet. E ardhmja asht për ata popuj, që mbajnë vrapin në frymën e kohës. Rythmit të jetës së sotshme të kombeve në këtë përleshje, të pa asnji shembëll në histori, muna t'i bajnë ballë kombet që janë shpirtnisht të fortë. I tillë asht kombi kur pjestarët e tij, si kafshatën, ashtu edhe mundimin e kanë të përbashkët; po edhe kur, hidhërimet, vuejtjet dhe fatkeqësit i kanë të përbashkëta.

Koha e lyp t'u shtrohemi therorivet të njajta, Asht kriminel i shoqnisë ai, që vështron vetëm lëkurën e vet. Djemt ma të mirë të Shqipnisë po japin dit për dit gjakun e tyne për të mirën e këtij vendi. Nanat, motrat, fëmijët e tyne kanë mbetun rrugëvet. Vatrat e tyne janë mbyllun. Asht kriminel ai, që përpara lotvet të fëmijëvet të mija dëshmorëvet nuk zgjuhet dhe nuk kupton realitetin e sotshëm shqiptar, i cili realitet të imponon të ndajsh kafshatën e bukës dhe thërimen e fundit bashkë me ata.

Nër luftimet e hallit t' invadimit, Anglo-amerikanët kanë humbur, gjer sot 3000 tanke.

Turqia midis dy karrikave

Moska pret dy atentatorët e denuem prej gjykatës turke

Lajmërohet prej Ankaras se dy atentatorët rusë Gorgi Kornilov dhe Leoni Pavlov, të cilët asokohe banë nji atentat kundra jetës s'ambasadorit gjerman von Papen dhe të cilët u dënuen me burgim për disa vjet, u liruen tash prej burgut. Pjestarët e ambasadës sovjetike n' Ankara i pritën atentatorët e burgut me solemnitet.

Me këtë gja Moska dha provë të pjesëmarrjes së saj në heshtje në punën e atentatit sadoqi ma parë e kishte kundërshtue ashpërsisht. Njikohësisht Stalini ep shenjën se ka pushtet në dorë qi ai ka fitue mbi qeverin e Ankaras mbasi Turqija në nji mënyrë të pabesnikis preu marrëdhanjet e saja miqësore me Gjermaninë. Nuk gabojmë në qoftë se themi në lidhje me çlirimin e këtyne njerëzve të cilët kanë pasë në plan të kryenin nji vrasje se kjo asht vetëm fillimi i asajë radhe të presioneve të cilat për së shpejti jetën e qeveris s'Ankaras kanë me e ba të vështirë. Sikurse kemi thanë edhe në nji numër të maparshëm të gazetës s'onë «shif artikullin Përse çuditet Turqija me datë 10 Gusht», Stalini nuk do të gabojë t'ushtrojë në krejt Turqin nji presjon si duhet.

Nji shuplakë fytyrës

Na konstatojmë me insistim dhe n' interesë të veçantë se kjo gja ndodhë në nji formë të tillë qi cenon me doemos krenarin kombëtare të Turqis. Sepse lirimi i katilëve prej njij fuqije të huaj të cilët nji gjykalore e rregullt turke i ka dënue me të drejtë çdo turku që çmon nderin ka me iu dukë vetëm si nji shuplakë në fytyrë. Pritja me nderime e të dënuemëve në portën e burgut është prap nji fyemje e krenaris kombëtare turke të cilën si duket Moska e ka ba me qëllim.

Prej të gjitha këtyne del se Turqija me thyemjen e besës po qëndron në mes të dy karrikave gja qi nuk ka formue qëllimin e sajë. Turqija pandehu se do të mundëte me e zgjedhë me lehtësi atë parti në mbarim të luftës, qi kujtonte se ka arrijtë, simbas interesave të saja. Tashti po fillon t'a kuptojë se kjo gja ishte nji gabim. Por asht nji gja e vështirë për te, qi iu desht me e marrë vesht këtë gja nga nji anë, nga e cila vrapoi me krahë të hapun e prej së cilës priste, si duket, dobi të mëdhaja.

Asnjë vënt englez jo më i sigurtë nga bomba "V. 1,,

"Dynamit-meteora,, të rënë dhe të plasur në Skoci

Si pas lajmevet korespondentesh gazetash spanjolle në Londër. ka rënë dhe ka plasur edhe në Skoci një bombë fluturonjëse. Kësisoj, thonë lajmet, nuk ka më vënt n'Angli që të jetë i sigurtë nga arma gjermane, dhe rrëza e vepërimit të saj po tregohet m'e gjerë se sa ish kujtuar.

Skocija është 500 gjer më 600 Km. lark Gjermanisë. Ky fakt është me rëndësi të madhe. se Englezët ngulmojnë dyke thënë që një nga qëllimet e tyre kryesorë në Francë është pikërisht xhdukja e fushës. prej së cilës lëshohen «Dinamit-meteorat» gjermane. Plasja, pra, e njëj bombe fluturonjëse në mes të Skocisë, tregon se qëllmi i Englezëvet nuk munt të plotësohet.

Rrëza e vepërimit dyke u shtuar

Arma e fshehtë gjermane «V. 1.» jo vetëm që po fabrikohet vazhdimisht dhe po dërgohet pa pushim mbi Angli, por ajo edhe po përmirësohet ditë për ditë. Eksperiencat e mbëdha q'u fituan nga përdorimi i shumtë i bombës fluturonjëse brënda një kohe të shkurtër, e bëjnë të mundëshme edhe shtimin gjithënjë më tepër, të rrugës se vepërimit. kështu vëndi, prej të cilit niset «Dynamit-meteora» është vështirë të arrihet. edhe sikur armiku të pushtonjë pjesë franceze më të mbëdha nga ato që ka tashti në dorë.

Zgjerimi i luftës së nervavet

Por kjo ka edhe një dobi tjatër: Si dihet, asnjë Llondines ose banor i Anglis jugore, që mbeti pa shtëpi dhe u b. refugjat, nuk do të vendoset në Ang inë Qendrore. Të gjithë refugjatët engl eze, që arrijnë milionra, shtyhëshin dhe shtyhen akoma drejt Skocisë. ku e kujtonin vehten të sigurtë. Në rrjedhim të kësaj, Skocija duhet të jetë plot qysh tash, dhe numuri i refugjatëvet po shtohet gjithënjë. Ata që besonin t'i shpëtonin luftës së nervavet, mbi të cilën vetë Qeverija bëri propagandë, dyke vajtur në Skoci, tashti do të jenë të shtrënguer t'i përunjen, edhe atje, si në Anglinë jugore. Sido qoftë, kur numuri i bombavet fluturonjëse për mbi Skoci do të jetë bërë akoma m'i math lufa e nervave do të marrë ndofta forma të ndryshme, nga ato që munt të mejtohen sot n' Angli. Se në tokën e mbushur plot, refugjatët rrojnë në nevojë të madhe dhe shoq mbi shoq, ata kanë mbetur pa mall e pa shtëpi, e prandaj i kanë që i kanë të trondifur nervat e tyne, dhe rrjedhimet e nji jetese në mërgim bëjnë efekt shtypës.

Torturat që pësojnë të „çliruarit"

Banjë gjaku në hipodromin e Caen-it - civilat e pa mbrojtun

Gjatë ditëvet të invadimit patëm rast në përëndim të shofim disa dishmi t'atij humaniteti të shpallun e të përballun prej drejtuesavet armikë të luftës, kur pamë se ajrorë armiq në fluturim të ulët me mitralozat e tyne ranë mbi kolonat e popullsis civile të ikun tue vrà kështu grà e fëmijë franceze e tue kthye mandej prap për me mitralue mbi ata civila që kishin mbetur rrugvet dikush i plagusun randë dikush lehtë. Nuk qe nji gja e pa pritun për në kur nji kapiten kanades që rà robnë lidhje me nji bashkfjalim t' oficera, vet aleatë tha se kolonat e popullsis civile franceze në ikje mbassi pengojnë komunikacjonin, duhen qëllue e msye pa mëshirë. Në Caen aeroplana angleze të zbuliinit mbas bombardimit të parë të qytetit drejtuan ajrorë «Liberators» për tek hipodromi i qytetit ku ishin mbledhë me mijra prej popullsis civile për të mbrojtë vet-vehten mbassi ky vend dukej kjartë se nuk ishte objektivë ushtarake. Anglezët pritën deri sa të mblidheshin edhe të tjerët në hipodrom për me ia nisë mbasandaj masakrimit të turmavet me ma tepër sukses. Ata me armët e tyne nuk gjuejtën vetëm automjetet e ushtris gjermane, por gjuajtën edhe autoambulancat e Kryqit të Kuq frances, gjuejtën me bomba spitale dhe vende të tjera mjekimi, e në të njajtën natë vaporet e tyre të kryqit të kuq të ndryçuem krejt i dërgonin për në brigjet e Anglisë, mbassi e dinin se komandantat e anijeve të shpejta gjermane kurrë nuk kryejnë krimin e qëllimit me torpedo mbi nji vapor që transpoton të plagosun.

Kështu kaluen invaduesat për mbi malet e kufomavet të fëmijëvet e të gravet që qëndrojnë me mijra ndër qytetet e katundet. Cinizmi i njerzvet të tillë që e quajnë vehten e tyne «çliruesa» të Francës, me kaq nuk asht mbarue. Parashutista kanadezë, të cilët patën zbritë në qarkun e qytetit Caen shtërnguen popullsin civile, sidomos fëmijët e gratë që të rinë në pritje në anë të rrugavet të mshefun që kështu ata të fshehun edhe vetë në radhët e tyne të mundin me qëllue mbi autamjetet gjermane që kalonin aty. Parashutistat mshifeshin ndër koshere dhe ftonin katundarët tue i kërcënue që të vazhdonin punën e tyne bujqësore aty pranë që kështu ata prej pritës, të pa prekun të vazhdonin vrasjet mbas shpine.

---

shtirë ushqimore me plaçkitje tokash të pasuna dhe për të pushtuar pozita më të forta. Në Bosnjën veriore, ndërmarrja gjermane ecën përpara. U kapën disa naltësira të rëndësishme, me gjith kundërshtimin diku të rreptë nga ana armike. Për rethet Vrbovko (Kroacija Veri-perëndimore) armiku i vashdoj sulmet e tija pa sukses dhe pati 65 të vrarë. Në Syrmi reparte të Policisë zbuluan 11 shtrofka kamuniste dhe i çkatërruan; u zunë 40000 fyshekë.

Orvajtje depertimi e deshtuar

Çetat pësojnë humbje të rënda

Në kufirin serbo-shqiptar, Çetat komuniste bënë një tentativë depertimit në stil të math, por u thyen nga kundërmasat gjermane. Për luftime të rreptë që vazhduan tri ditë, u goditën rëndë dhe u shpartallaun disa nga brigatat më të zgjedhuna të armikut. Luftwaffe mori piesë, me sukses, për luftimet e tokës. Si pas lajmevet të gjertanishmë, për këta luftime armiku pati 156 të vrarë të numuruar, por humbjet e tija duhet të kenë qenë më të mbëdha, veçse ay i tërheq të vrarët, për të mbuluar dëmet që pëson. Sulmi i armikut që deshtoj plotësisht, duhet të merret si një përpjekje. nga an' e tija, për të përmirësuar gjendjen e vë-

Atentat në Jerusalem

Komisari i Naltë engles i plagosur me plumba revolveri

Si pas lajmit që jep shërbimi engles i informacionevet, Komisari i Naltë engles në Jerusalem u qëllua, në veturën e tija, prej njerëzish të pa njohur. Komisari i naltë Mac Michael mori disa plagë. ndërsa e shoqja shpetoj vetëm me një të trëmbur. Dy nga pjesëtarët e shtabit u plagosën rëndë.

Sllovakija do te luftoj

Dr. Tiso foli mbi gjendjen e sotme

Presidenti i Shetit sllovak, Dr. Tiso foli përpara pjesëtarëvet të Shoqërisë katholike në Dioqezën Banovice mbi gjendjen e tashme të luftës dhe tha këto; "Po në atë masë që armiku u afrohet kufivet t' ona, shtohet edhe detyra jonë për të mbrojtur vendin. Në kufirin sllovak, bëjnë rojë Sllovakë,,

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Ejte 17 Gusht 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 19 - ÇMIMI 1 LEK

Shtatë genjeshtra nga Bari e nga Londra

A mund të fitohet lufta me përralla? Ndigjoni dhe gjykoni vetë

Asnji herë nuk kanë rrejtë prej anës s'aleatëve në radion e Londonit e të Barit gjatë kësajë lufte të gjatë kaq sa në javën e kalueme. Riçeta asht e vjetër. Gjithmonë trillohet prej tyne ndonji budallallëk. E mbas dy ditësh thuhet mandej se paskan qenë të gabuem. Lejonani t'u tërheqim vërejtjen përmbi shtatë gënjeshtrat ma të trasha qi u thanë në kohën e fundit:

1. Nji lajm i dhanun prej Reuter-it thotë: "Bullgarija, me anë të përfaqësuesit të sajë n'Ankara, po mendohet të fillojë bisedime me aleatët".

Dy ditë ma vonë përgjegja zyrtare bullgare qe kjo: "Përfaqësuesi i Bullgaris n'Ankara kurr s'ka ba nji hap të titlë".

2. Me rasën qi presidenti i ri i Finlandës, Marshalli Mannerheim, mori në dorzim zyrën e tij të nallë, Agjencija Reuter njoftoi prej Stockholmit këto: "Mannerheim urdhnoi largimin e trupave gjermane prej Finlandis dhe ka kërkue armpushim".

Nji ditë ma vonë e njajta agjenci e rrenave tha: "Marshalli Mannerheim asht i vendosun të luftojë n'anë të Gjermanis deri në fitoren e fundit".

3. Me 8.8 Reuter shperndau këtë rrenë: "Në Vjenë u ba nji luftim i ashpër ndermjet infanterisë gjermane dhe njisinash SS. Gjashtë oficera u vranë".

Kurse në të vërtetë në të njejtën ditë qinda mija vjenezësh në të gjitha rrugat kryesore të qytetit banë nji demonstratë besnikërije ndaj Fuehrerin dhe në favor të luftës totale kundra aleatëve.

4. Agjencija amerikane "United Press., me 10.8. pohoi për sa vijon: "Ambasadori sovjetik n'Itali ka hy në bisedime me Vatikanin për me vendosë marrëdhanje diplomatike ndërmjet Vatikanit dhe Rusis Sovjetike".

Disa ditë ma vonë radio e Vatikanit bani përgënjeshtrimin energjik qi vijon: "Vatikani njofton zyrtarisht se asnji bisedim nuk asht shtillue me ndonji dërgatë sovjetike dhe asnji rasë për bisedime të tilla nuk mund të ndodhë".

5. Gënjeshtrat ma të turpëshme i përhapi Londoni përmbi Polonin e trathtueme gjatë udhtimit të "Kryeministrit polonez,, për në Moskë. Ditët e para tha: "Kryeministri Nicolajczyk u pranue prej Molotov-it e prej Stalinit. Pritet nji sukses i plotë".

Tri ditë ma vonë tha këto: "Dërgata poloneze nuk duhet t'a humbasë shansin e sajë të fundit", — E mbas kthimit të polonezëve nga Moska, mbasi vizita dështoi në qëllimet e saja, Londoni tha këto: "Polonezët duhet t'i mbajnë vetë pasojat e kryenecsis së tyne", — Kurse nji ditë ma vonë tha këto: "Po onezët u kthyen me nji fitim nga Moska për në shtëpi; ata kanë mujtë me e njoftë "Komitetin Polonez të Çlirimit,, dhe kanë pasë rasë me u njoftë me Stalinin". — A ka pa bota ndonji herë ndonji trathti të tillë qi u bahet njerëzve qi kanë dhanë gjakun e tyne për Anglin?

6. Mbas tri ditësh qi u prenë marrëdhanjet diplomatike ndërmjet Gjermanis e Turqis. Radio-Londoni njoftoi shqip: "Trupat turke pushtuen qytetin e Selenikut e njikohësisht triumfuen në përpjekjet e bame për me pushtue ishujt e Egjeut.

Udhtarët shqiptarë qi kanë ardhë deri sot prej Selenikut e dëshmojnë se asnji turk s'i ka kapërcye kufijt e Turqis dhe se gjithë kjo histori asht vetëm nji rrenë trashamane.

7. Porse Radio-Bari perhapi para disa ditësh gënjeshtrën ma të trashë qi asht ndigjue deri më sot: "Gjermanët janë gati për me lanë Shqipnin".

E kush asht aq i trashë sa t'i besojë të gjitha këto rrena kaq qesharake? Kush nuk asht në gjendje të kuptojë për nji herë se lajme të rrejshme përhapen vetem prej atyne të cilët kanë për të vetmin qëllim të mbiellin vdekjen, të shkaktojnë plaçkitjet dhe të nxisin për trazime të mbrendëshme?

"Unë isha në Gjermani...„

Tregimet e njij anglezi t'internuem

Thomas Kernan boton në «Saturday Ewening Post» dy artikuj të gjatë mbi përshtypjet e veta mbi propagandën gjermane dhe mbi efektin e propagandës aleate në popullin gjerman. Kernani asht nji specjalist në fushën e propagandës; per ma tepër ai vetë për nji vjetë rresht mujti me i vërejtë efektet e propogandës aleate në Gjermani. Kernani asht botues dhe specjalist reklamash qi ka punue për nji kohë të gjatë në Francë, dhe ka qenë i internuem për nja trembëdhjetë muej në Baden Baden. Ky u lirue me anë të shkëmbimit të robërve në pranverë të vjetit 1944 në Lisbonë.

Kernani tregon me hollësi se ai, si botues e si specjalist propagande, i ka ndjekë me, vërejtje të madhe punët e propagandës Kur u largue prej Gjermanis mujti me marrë me vehte, përveç dokumentave të tjerë, edhe 2000 copë shenime gazetash. Në Lisbonë u turr me nji herë së bashku me nji koleg të vetin mbi gazetat anglo-amerikane për me konstatue «gënjeshtrat e shumta qi bahen në Gjermani». Por u çudit për se tepërmi, kur pau se, gjithshka kishin shkrue gazetat gjermane mbi gjendjen ushtarake, ishin të vërteta. Nga ana tjetër ai konstatoj se propaganda gjermane kishte të drejtë ma të shumtën e herës. Kështu për shembull ngjarja e Katyn-it kishte ba nji efekt të tmershëm, jo vetëm në Gjermani, por edhe në të gjithë Europën dhe përshkrimi gjerman i kësajë ngjarjeje deri tash nuk ka mujtë me u përgënjeshtrue. Kur t'internuemët amerikanë u përpoqën me ua mbushë mendjen gjermanëve se nuk ekzistojnë sulme terroristike aleate e se disa prej tyne ishin ba «gabimisht» të gjitha këto pohime nuk pishin uj. Kernani ven në dukje disa shembuj bombardimesh terroristike të pamohueshme dhe tregon përmbi «Shoqnin e Katilave», përmbi të cilët në Gjermani asnjeri ka formue ende ndonji kuptim. Nji pilot i ekuipazhit qi kishte shenjë-dallimin e kësajë shoqnije, në nji fotografi të marrun prej gjermanëve sikurse shkruen Kernan, dukej me nji fytyrë t'egër sa qi dukej si nji kryqëzim ndërmjet gangësterit dhe chympanziut.

Në vitin 1942 ai bani nji udhtim tregtije për n'Amerikë dhe atje pati rasë të ndigjojë prej shumë vetave në New-York e në Washington për sa vijon: «Ah, sikur gjermanët të digjonin mesazhet t'ona edhe të dinin diçka përmbi domethanjen e Kartës s'Atlantikut dhe përmbi parimet e liris!» Mjerisht ai duhet te njoftojë se populli gjerman e di mirë domethanjen e Kartës s'Atlantikut dhe i njef mirë parimet e liris.

Një nga faljet e shumta të Myslimanëvet për shpëtimin e Fuehrerit. Një përfaqësues i Wehrmachtit gjerman i shpreh Kryefetarit falënderimet përkatëse.

T'ia lem fjalen pushkes?

Amicus Caeser, sed magis amica veritas.

Nji artikull i botuem në këtë fletore, me datën 27 Korrik me titullin «Për popull e shtet, a po për xhep të vet» hapi nji fushë të gjanë bisedimesh e interpretimesh të ndryeshme. Kurioziteti i publikut shqipëtar kishte mbrijtë kulmin, aq sa nga i gjithë botimi nuk mbeti asnji fletore për mall. Kjo vërteton se, populli shqipëtarë ka et për nji liri të shtypit me të cillën mund të rrahin mendimet për të mirën e përgjithëshme. Me anën e shtypit mund t'ia shtrojnë muhabetit me gjakftohtësi, pa ansi, tue rrahun mendimet t'ona për të nxjerrë në shesh të vërtetën.

E vërteta asht e idhun por edhe ilaçet që përdorim për shërimin e trupit janë t'idhuna por të dobishme. Thika e kirurgut asht edhe ma e dhimbshme por, shpëton jetën e njeriut.

Ndërsa çdo shtet përpiqet me u pregatitë për kohën e ardhëshme, për të mbrojtun kufit e të drejtat e veta, në Shqipnin e vogël e shum të vuejtun, mbretnon antagonizma, vllavrasja, intriga e përçarja e tmerrshme, që do të na ngulin thikën e ndryeshkun mu në mes të zemrës!

Pse të djegim jorganin për nji plesht?

Mbas perdes të çdo grupi o partije ka disa pleshta, por edhe asi gogolash që punojnë për interesin e vet, dhe këtë efendilerë kan nji hundë shumë sensible me maje të mprehtë, e sa po të ndigjojnë pak erë të keqe, rrin me valixhe në dorë e me qemer të ngjeshun për me i lanë shëndetin ksaj Shqipnije!

Gogola me frack, me kmishë të zezë e besa janë gati me veshë edhe kmishën e kuqe vetëm të shpëtojnë kokën e tyre mbasi t'i kën dhanë zjarr Atdheut!

Kush i paguen të gjitha këto? Populli, djelmënija e ata që i kan vuejtun gjithnji konseguencat e intrigavet! Ksaj i thonë «për me ruejtë trena të kalbun po ia vemë sharrën pyllit të njomë».

A kemi të drejtë? Gjykonje vetë, por vetëm edhë nji thirrje nga zemra e Atdheut para katastrofës së përgjithëshme: "T'IA LEMË FJALËN ARSYES E JO PUSHKËS„!

Lajme t'idhuna

Varen nande gjakpires

Pak ditë ma parë në mes të rrugës Kukës-Pukë, u mësye nji kolonë gjermane prej njerzve të pa njoftun, ku u damtuen dy maqina e u plagosen disa ushtarë. Disa prej njisive të divizionit SS Skanderbeg, vrapuen në vendin e ngjarjes, dhe varen 6 veta që u kapen në vendin e ngjarjes.

Në vendin ku u vranë kryetari i Bashkis e Prefekti i Kuksit, u varen tre veta të tjerë. Lajme me të vertetë t'idhuna e të shemtueta për pushken shqipëtare, që nuk e ka pasë për doke me e perdorue mbas shpindet, tue vra vllau vllân, e tue cenue gjanë ma të shejte shqipëtare, **mikëpritjen**.

"Mesues,, per Europe

Plane sovjetike për kohën pas luftë

Korrespondenca e Ligës çeko-morave kundra bolshevizmit çekë nji artikull të së përkohëshmes së Moskës «Shoqnija e studentave proletarë» të datës 15 Maj, i cili riprodhon planet qi Moska synon me i zbatue n'Europë. Artikulli ban fjalë për «Etapën e tretë të Revolucionit bolshevik». Kjo «Etapë e tretë» don me u ngarkue studentave sovjetikë barra dhe detyra të randa, sepse këta janë të thirrun me u ba mësuesit e Europës qi ka mbetë mbrapa dhe me i kthye popujt europjanë n'iden komuniste. Shoqnija e studentave sovjetikë ka për detyrë bolshevizimin shpirtnuer t'Europës dhe me luejtë rrolin e parë n'Europën e bolshevizueme. Prandej Shoqnija e studentave bolshevikë duhet të marri në dorë administrimin e ndërmarrjeve europjane si edhe ate të shkollave e t'Universiteteve e të zyrave; gjithashtu kanë për detyrë, jo vetëm me ushqye europjanët me idena komuniste, por edhe me organizue shdukjen e pamëshirëshme të nacionalizmit luftarak e «t'elementave reaksionarë».

Kafshe boshnjake per arme angleze

Si po i a pin gjakun vendit „të vet,, Jozip Broz

Si mhas pohimeve të njejta të shumë të aratisunve, janë tue u bartë me ajrorë anglo-amerikanë prej Progorit të Bosnjes shumë gja e gjallë,-gjoja qër me i dërgue në Itali të Jugut. Me këtë gja të gjallë që po i grabitet katundarit boshnjak Josip Broz asht tue pague armët, që merr prej anglo-amerikanve.

Ky lajm karakterizon mirë «disinteresën» e aleatëve: Në fillim ata ngacmojnë popullsin boshnjake kundra fuqive të armatosuna gjermane. Kështu shkaktohet vetvetiuf «nevoja» për armë. Ma së fundi këto armë duhen pague me ato pak gjana qe kanë mbet pa u grabitë prej çetave.

Çetat të goditura rëndë

Ato u shmangen trupavet gjermane

Humbjet e Cetavet, në kufirin serbo-shqiptar, arrijtën,brënda kohës 2 gje më 6 gusht në 350 të vrarë të sigurtë dhe në 400 të tjerë, që pandehen si të tillë. Në Bosnjën lindore u thye nji depertim armik me fuqira të mbëdha Me sulmet t'anë, kundërshtari u shty drejt jugës. Në ndërmarjen t'onë kundër divizionit të 6 dhe të 11 armik, (26 gje 1 gusht) banditët palën 384 të vrarë, 180 të plagosur, 78 robër dhe 31 të desertuar. U zunë prej trupave gjermane edhe një sasi e madhe armësh të ndryshme, 116 bomba dore, 20000 fyshekë këmbësorije, shumë mjete ashtu dhe 31 kuaj dhe shumë që. Në krahinën Vrbovsko armiku i goditur iu çpras sulmit gjerman. Humbjet e përgjithëshme të kundërshtarit, në Ballkanin veriperëndimor më 6 gusht arrijtën (bashkë me humbjat e pësuara në Shqipëri, me ndërmarrjen e spastrimit) në 440 të vrarë të numuruar, si dhe 319 të pandehur të tillë. Humbjet armike brënda javës 30 korrik gjer më 5 gusht, arrijtën në 2484 të vrarë të sigurtë, më tepër se 2000 të marrë si të tillë 90 robër dhe 44 të desertuar. Për veç njëj numuri të math topash dhe mitraljozash, u zunë edhe: 757 pushkë, 180 kuintal lëndë eksplozive, 233000 fyshekë infanterije një tufë dhensh, etj

Dekorat von Papen-it

Ja dorezon vete Fuehreri

Me propozimin e Ministrit të jashtmë von Ribbentrop, Fuehreri i akordoj ish ambasandorit n' Ankara, Franz von Papen, dekoratën e larët «Kryqin e Kalorësit të Kryqit me shpatë për shërbime luftë» për meritë personale dhe për shërbime të veçantë në dobi të Reichut. Fuehreri ia dorëzoj personalisht ambasandorit dekoratën e larët me rastin e një audience në Kuartierin e Përgjithëshm.

MESIM I GJERMANISHTES

Në Lyceun e Shtetit në Bulevardin e Madh, n' odën Nr. 10, jepen mësime në gjuhen gjermanishte falas prej orës 10 - 11 paradreke të Hanavet, të Mërkuravet dhe të Premtevet

Bosfori dhe Dardanelet - "e keqja m'e vogel,,

Tradheti e hapur e aleatevet kunhrejt Tyrqise

I dihet për mirë, një dipllomati amerikan, ky kallzim indiskret: Rusija sovjetike u këshillua, prej aleatëvet, të këtë më tepër dorë të lirë mbi ngushticat, që kshu ata t'a mënjanonin ngulmin e Moskës drejt gjirit persik.

Kjo është një trathëti e plotë anglo-amerikane kundrejt Tyrqisë. Këto të dy fuqi detare po i trëmbëshin, prej kohësh, përpjekjes së Sovjetevet për të fituar hyrje në det të lirë, me anën e rrugës për mes gjirit persian. Sikur ne t'i ofrojmë Stalinit ngushticat tyrke, paska vendosur Anglija dhe Amerika, si pas tregimit indiskret të diplomatit amerikan, Moska do t'a heqë veshtrimin e saj drejt gjirit persik dhe, në rrastin më të mirë, ajo fiton një hyrje për në Mesdhe që, fundja, s'është veç se një det i brëndëshmë, kurse neve na mbetet zotërimi i pa kontestuarshmë i detit të hapun dhe pasuritë vajgurore të grykës persiane.

Nga të dy të keqijat, ato xgjothnë, pra, si shprehu diplomati amerikan, atë më të voglën, shpenzimet e së cilës, më së fundi, do të paguhen, tërësisht prej Tyrqisë. Prej asaj Tyrqije, e cila besoj se, me besëthyerjen kundrejt Gjermanisë, do të fitonte fuqi dhe prestigj. Që ky qe një gabim trashanik, u vërtetua qysh tash dhe po komentohet, në Ankara, në mënyrë të ndjeshme, prej një pjese të shtypit, por që s'ka më asnjë efekt.

Therorizim i Polonis

Nji shembell i dukshem

Rruga e mjerueshme e Polonis asht e shënueme si nji fat për të gjithë popujt, të cilët shpresojshin të gjejnë shërimin e tyne prej anmiqvet të Gjermanis. Kjo duhet të bahet mësim për të gjithë ata të cilët sot i japin besimin, simbas premtimevet të Londrës, Moskës dhe klikës së mbajtun prej Schubaschiç-it, që e përmbajnë subjekte bisedimi për popujt e Ballkanit.

Me pa kujdesin e qeveris poloneze në Londër, më 1943 i ashtu quajtuni Komiteti i shlirimit të Polonis, i përfaqësuem prej të famshmes terroriste Wande Wasilewska, kishte organizuem nji ushtri shlirimtare, e cila në të vërtetën, ka qënë e formueme prej oficerave dhe prej ushtarvet sovjetik. Me këtë rasë të gjithë oficerat polonezë, në Rusi, tamam dhet nij veta, në rrethet e Katyn-ës u mbytën dhe teprica e divizionevet të ushtris poloneze që emigruen, u futën në punra të randa me qindramij prej syresh

Anglija e lë Polonin deri në minutën e fundit në besim, se ajo do t'a mbronte vetqevrimin dhe lirinë e saj, për të cilën i roki armët për të hyrë në luftë.

Tash tue pa ngjyrën robnuese të politikës sovjetike mbi Polonin, e la até brutalisht dhe si burracak në fatin e saj. Anglija vet e linte Kryeministrin Nikollajewiç të vej në Moskë dhe të bindet përkundrejt kërkesavet të Moskës.

Në këtë mes, janë miliona polonezë, që po hikin në anën e Gjermanis, mbassi vendet e tyne po shkretohen prej rusvet dhe ngjajne veprime të poshtra. Ata e dijnë se Gjermanët, në vendet e tyne kanë ba ndërtime të mrekullueshme dhe e duenë të mirën. Ndërkaq në çështëjen poloneze fjalën e fundit do t'a thotë ushtrija gjermane dhe jo armata e kuqe, Gjermanija me fuqi të përqindrueme dhe me venjen e armëvet të reja në veprim do t'a ndalojë sulmin dhe do të thyej bolshevizmin. Gjenerali Guderian, shefi i përgjithëshëm i shtabit, që njihet me natyrën e tij të njeriut që flet pak, këto ditë çfaqi këtë bindje të tij në mënyrë të qartë përpara përfaqësuesvel të shtypit.

Planet e amerikës në Normandi dështuan

Gjermanët gjithmon gati për surpriza të reja

Qëndrimi i fortë i trupave gjermane në Normandi, sikundër e pohojnë vetë gjeneralat anglo-amerikanë dhe korrespondentat luftarakë, e ka habitë marë botën. Gjithkush pyetë: «Si asht e mundun, qi populli gjerman, qi nga çdo anë po i takon të durojë prova të randa, mban nji qëndrim të drejtë e të patundshëm?» E perkohëshmja e New-Yorkut «Time» konstaton tashti me nji herë se nji ndër pikat kryesore të planeve ushtarake t'Anglis e t'Amerikës, qi asht thyemja e plotë morale e popullit gjerman me anë të bombardimeve të gjata si pregatitja e invadimit, doli si nji llogari krejt e gabueme e komandës së naltë ushtarake. Mendimi i strategëve amerikanë t'aviacionit, se Gjermanija mund të mposhtej vetëm me luftën ajrore, nuk u vërtetue prej fakteve. Në Komandën e përgjithëshme të gjeneralit Eisenhower ishin krejtësisht të sigurtë, se terrori sistematik i armës ajrore do t'a kishte dobësue së paku qëndresën gjermane aq, sa qi invadimi do të kryhesh mbrenda kohës së parapame. Por ndër këto nuk u vërtetue as njena. Në vend të tyne u çfaqën tre elementa, qi rrethet anglo-amerikane nuk i pritshin, së paku jo n'atë formë qi po duken sot. Së pari asht trimnija e morali i pathyeshëm i trupave gjermane, së dyti mirësija dhe ndër shumë rasa epërsija kualitative e armëve gjermane deri tash të njoftuna, sikundër janë tanket, hjedhësat e mitralozat dhe së treti e shtimja në veprim e mjeteve luftarake gjermane qi janë fare të reja.

Befasija e katërtë për anmiqët e Europës asht qëndrimi i patundshëm jo vetëm i popullit gjerman, por edhe i të gjitha kombeve qi u a kanë prishë hesapet anmiqëvet t' Europës. "Time,, ankohet shumë, se propaganda anglo-amerikane ka hudhë mbi Europë gadi 1.264. 500.000 manifestina, pa pasë nxjerrë nji rezultat të dukshëm të kësajë propagande.

Për sa i përket luftës «Time» thotë: «E vërteta asht, se Gjermanija nuk u përul prej luftës terroristike t'ajrit». Programi, për me thye kështjellin e Europës me anën e rrenimeve t'industrive e të qyteteve të saja, nuk u përmbush. Për arsye të humbjeve të mëdha nuk do të mund t'u mbante «hovi parapam i sulmeve ajrore kundra Europës». «Gjermanët mësuen shpejt se si me u mbrojtë me sukses», — deklaron e përkohëshmja, — ata vunë në veprim me të shpejtë taktika të reja dhe përmirësuen zjarrin kundrajruer të tyne». Humbjet kanë qenë nga nji herë aq të mëdha, sa qi nuk qe e mundun me i zavendësue.

Numri i bombardjerëve të rij, qi dorëzojnë Shtetet e Bashkueme, kanë mbetë mbrapa tetë muej mbas planit të kohës së caktueme, Humbjët e ajrorëve qi po shkojnë tue u shtue në Pacifik, dhe ne frontin luftarak t'Italis, e bajnë edhe ma të ndieshme këtë mungesë në forcat ajrore anglo-amerikane. Me fjalë të tjera: Arma kundrajrore gjermane i ka prishë në pjesën ma të madhe planet luftarake t'anglo-amerikanëve ndër muejt, para se të fillonte invadimi, me ndërhymjen e shpejtë e të fortë të sajen kundra ajrorëve terroristikë të fuqive prendimore. Kështu dhe thelbi i këtyne planeve, qi asht invadimi i kontinentit, asht hudhë në nji fazë pikënisjeje, qi nuk ishte parapam në Teheran dhe qi ka me qenë vendimtare për vashdimin e luftës në prendim.

Si qindron gjendja e Kishavet ne Gjermani?

Shteti gjerman i përkrah ato me shuma miliardash

Agjensija e shtypit katolik «Kipa» pak kohë përpara bani disa njoftime për mbi edukatën fetare në Gjermani. Mbas këtyne njoftimeve del në dritë se numri i femijve të pa pagëzuem mbas rregullave kristjane kap mezatarisht 1,81 %. Në krahasim me këtë mbas statistikave të zyrave kishtare amerikane popullsija e Shteteve të Bashkueme vetëm me 45-53 % i përket kishës kristiane; pjesa tjetër e popullsis përbahet prej jahudijsh o prej ateistash.

Vetë fakti se kurr s' asht dhanë ndonji statistikë objektive dhe e kjartë përmbi kishat në Shtetet e Bashkueme, tregon se qeverija e këtij vendi përkundrejt kishave asht krejt indiferente. Përkundra këtij fakti, në Gjermani qeverija merr prej bestarëve në dobi të kishës nji taksë që kap maksimalisht 10 % e taksës mbi t'ardhunat, por hy fakt do të thotë se qeverrija nacjonal-socjaliste gjermane në 11 vjetët e kaluem ka shpenzue miljarda marka në dobi të kishës. Mirëpo, në Shtetet e Bashkueme ku sot pohohet se duhet të shpëtojmë kishën kristjane prej kercënimeve të nacional-socjalistave, kishat s'marrin prej shtetit asnji dollar, por mbahen vetë me lëmoshat e bestarëse, kështu që priftët shpesh jetojnë në mjerimin ma të math.

Gjatë betejës së madhe në Lindje, trupat gjermanë asgjësuan ose zunë, vetëm në 4 ditë prej 6-9 gusht, 171 tota, 426 topa antitanq, 99 mortaje dhe 684 mitraljoza antitanks. Po brënda kësaj kohë u çkatërruan, vetëm prej trupavet lokësore, 507 tanksa sovjetike.

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Hënë 21 Gusht 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 20 - ÇMIMI 1 LEK

Trathti kundrejt Shqipnis!

Churchilli ia bën theror Titos Shqipërin e veriut

Lajmërohet zyrtarisht: «Me datën 12 e 13 Gusht Kryeministri Winston Churchill ka ba takime me Kryeministrin jugosllav dhe me Titon, në të cilat janë shoshitë çashtje politike dhe ushtarake në mënyrë të përzemërlë. Marshalli Tito dhe Kryeministri jugosllav kanë propozue me vijue diskutimet, të cilat janë të frymëzueme nga dishiri i të dyja palëve, me qëllim qi me dhanë kontribute të mëdhaja për të mirën e Jugosllavis.

Simbas qarqeve t'informueme mirë mësohet se bashkë fjalimet e Churchillit dhe Titos në Romë kanë pasë natyrë mbi pretendimet e këtij të fundit mbi tokat ballkanike. Tito nuk kënaqet me kufijt e Jugosllavis së paraluftës --- por ka edhe pretendime të tjera mbi tokat shqiptare e italiane.

Me qenë se gjendja ushqimore e bandave të Titos asht keqësue dëshprimisht, thuhet se Churchilli paska vendosë me u dhanë banditëve të Titos koncensjone të tjera, me qëllim qi me i pasë gjithmonë kah ana e vet.»

Greqija përgjon Shqipërin e Jugës

Veterani i politikës greke, Filip Dragumis, deputet, Ministri i Informatave dhe Nënsekretari i Shtetit për Punët e Jashtme, e hapi qartas çashtjen e aspiratave greke të mbasluftës tue thanë se Qeverija greke nuk mundej me i pranue kufijt para 1939-së. Thelbi i bisedimeve dhe i shoshitjeve ekziston ende, veçanërisht për arsye se aleatët e mëdhej nuk i kanë deklarue haptazi qëllimet e tyne të mbasluftës mbi Ballkanin, me qenë se ata janë shumë t'okupuem me aktet e fundit të luftës me Gjermanin. Situacjoni paraqet vështirësina të tjera për shkak të gjendjes të ngatërrueme të punëve greke në Kajro, ku pengimet ndërmjet Papandreut dhe Komitetit Malsuer t'EAM-it janë keqësue për shkak të ndihmave qi Papandreu ka marrë në Kajro. Me qenë se krahinat ma të pasura greke, Maqedhonija dhe Trakija, gjinden ende nën robni, Dragumis ka deklarue se asht e nevojëshme me sigurue kufijt veriorë të Greqis kundra njij mësymjeje t'ardhëshme bullgere, Prusija ballkanike. Ministri ka vu veçanërisht në dukje gjendjen e ishullit Tasos, i cili ndodhet vetëm tri kilometra ndërmjet Bullgaris dhe detit Egjè. «Si mund të jemi të sigurtë në nji pozitë të tillë?» ka pyetë Dragumis. Dragumis ka qenë shumë i kënaqun qi Turqija ka pre marrëdhanjet me Gjermanin. Fati i Greqis asht i lidhun ngushtësisht me ato të Turqis, dhe të dy vendet i kanë lanë mbas dore aspiratat dhe revendikimet tokësore.

Dragumis ka ekzaminue edhe çashtje të tjera të randësishme, të cilët i përkasin veçanërisht fatit të Dodekanezit e të Shqipnis.

Kthimi i Dodekanezit Greqis vërehet prej grekëve si nji çashtje e përfundueme dhe, simbas mendimit t' atyne qarqeve, vështirësinat e ardhëshmë do të jenë të lehtësueme nga marrëveshtja ndërmjet qeveris greke e turke për sa i përket çashtjeve të strategjis tokësore. Por Shqipnija asht nji problem ma i math. Dragumis nuk i ka kursye as fjalët qi vijojnë: Shqipnija duhet të pushojë së qenuni nji kryeurë pushtimi i Greqis nga ana e italjanëve dhe duhet me sigurue gjithashtu tokat jugore të sajë qi gjinden në Veri t' Epirit, si garanci. Shqipnija nuk mund t' eksistojë pa mbështetjen e nji fudije të huej. " Dragumis nuk ka dyshue kurr se do t' i mungojnë ndihmat nga ana e qeveris britanike, me qëllim qi qevesija greke të marri pësëri fuqin e përparëshme dhe të mkamet si shtet i fortë.

Falnderojm Greqin, por s'na duhet Protektorat e saj!

Të gjithë shqiptarët e kanë pa nji herë lojën e mbrapësht të trathtis angleze në ket vend. Në vjetin 1913 në konferancën e Londrës t'Ambasadorve të Anglis, të Francës, t'Italis bashkë me ato të Rusis e t'Austro-Hungaris në deklaratën e pamvarsis së Shqipnis. Dy vjet ma vonë po ai ministër i jashtëm i Anglis, me porosinë e asaj qeverije, në të cilën luente asokohe nji rrol kryesor edhe Churchilli, ua shiti Shqipnin serbëve, italjanëve dhe grekëve në marrëveshjen e mshefët e të poshtër e cila do të jetë gjithmonë një njollë e keqe për historin e Anglis.

Sot përsëri po luhet në kurriz të Shqipnis po ajo lodër. Ndërsa Attlee, Eden dhe Hull kërkojnë paturpësisht prej shqiptarëve vetvrasjen tuj u thauë qi t'u nënshtrohen urdive sllave të Broz Tito-s në luftë kundra gjermanëve, Churchilli po e trathon tashma Shqipnin tue ia lanë në dorë Titos. Churchilli dhe Tito-ja u takuan në Romë me 13 të Gushtit. Qeverija britanike dha lajmin përkatës zyrtar qi në ketë fletore po riprodhojmë. Churchilli e din se çetat e Titos janë tue vdekë urije. Sulmet e pareshtuna të gjermanëve dhe të vullnetarëve kroatë e muslimanë nuk janë tue i lanë të qetë. Depozitat e tyne ushqimore janë sosë. Qytetet janë prishë e rrenue prej bombarduesve amerikanë, tokat kanë mbet djerr për shkak të rekrutimit të përdhunshëm të bujqëve, gjaja e gjallë asht therë e ngranë. Krahina pjellore e Kosovës, ku bujku shqiptar punon në qetësi, e josh Titon dhe çetat e tija, prandaj Churchilli i ka premtue Tito-s, jo vetëm Kosovën e pasun, por edhe gjithë Shqipnin e Veriut. Kështu Shqipnija asht ba preja e tyne. Mendoni gërmadhat e katundeve të shumtaj të cilat në vjetin 1922 i dogjën grekët! Vetëm nji fuqi e madhe i ka njoftë deri më sot kufijt e Shqipnis. Kjo fuqi e madhe asht Gjermanija. Dhe po Gjermanija asht ajo qi pajisi divizionin «Skanderbeg» me armë dhe me instruktorë. Sikur mos t'ishte divizioni «Skanderbeg» urdit e Tito-s ç'prej kohësh do t'a kishin grabitë krahinën e pasun të Kosovës. Dhe kështu Shqipnija e Mesme dhe e Jugut do të kishin mbetë pa bukë. Kujtoni zinë e tmerëshme të bukës në mbarim të luftës së parë botnore. A doni qi të përsëritet mjerimi i asajë kohe prap për fëmijtë t'uej? Vetëm nji shpëtim ka për Shqipnin: kurrnji bashkëpunim me anmiqet e sajë. Asgjasimi i komunistave, sepse ata punojnë për Tito-n dhe bashkimi e gatishmenija për therori e të gjithë shqiptarëve kundra gjaksorëve, të cilët për ditë po ju bombardojnë e njikohësisht po ju dorzojnë anmiqëve shekullorë.

Në vjetin 1915 në London u trathtue për të parën herë Shqipnija. Në vjetin 1944 kjo trathti u përsërit në Romë prej Churchillit. Kush asht aq i trashë sa mos të nxjerrë nji mësim prej kësaj trathtije? Bashkohuni kundra trathtis. Bashkohuni me Kosovën e me trimat e divizjonit «Skanderbeg». Nuk kanë me ju shpëtue as pallavrat e kofa, as batakçillëqet, as kulltuqet, as edhe allishverishet. Vetëm veprimi me armë në dorë kundra trathtis anglokomuniste ka me ju shpëtue!

Studim në zëmrën e Evropës

Si shkojnë studentat shqiptarë në Gjermani?

S'ka shumë kohë q'u muarr kjo fotografi përpara Hotel Dajtit, e, me gjithë këtë, studentat shqiptarë në Gjermani po kalojnë kohët më të mira dhe disa syresh po shohin, në vëndin e studimevet të tyne, një Atdhe të dytë.

Studentat shqiptarë përpara hotel Dajtit dyke u nisur për në Gjermani

Kohët e fundit, i vizituan studentat shqiptarë edhe Pater Harapi dhe Ministri i Brendëshmë Deva. Të dy personalitetet e nalta qëndruan midis bashkatdhetarvet të tyre të rinj dhe u dhanë atyre përshëndetjet e Atdheut, dyke u interesuar për nevojat dhe dëshirat e cilitdo.

Kanë arrijtur shumë letra nga Gjermanija. Nër të gjitha shprehet gëzimi i math q'u ngjall studentëvet shqiptasë jeta e re dhe interesante në Gjermaninë krijonjëse në të 5 vit të luftës. Disa çfaqin enthusiazmin e tyre të vçantë që palën rrasl të ndodhen pikërisht në zëmrën e Evropës, në qendrën e punës së palodhëshme për mbrojtjen e kontinentit dhe t'a kuptojnë më mirë, rëndësinë dhe qëllimin e kësaj lufte.

Tito-ja e deshti të bombardohej Peja

Shqiptarë, bombardimi i shemtuet i qytetit ma të bukur të Shqipnis veriore, të Pejës' asht krye mbas dishirit të Titos. Kosovarët trima, qi aq mirë dijtën me e mbrojtë vendin e vet prej sulmit sllav, u bombarduen nga ajri po prej atyne anglezëve e amerikanëve të cilët kërkuen prej jush qi të bashkoheshit me çetat e Titos, të Mehmet Shehut, etj.

Njikohësisht e ngren zanin e vet nga Kajro edhe Ministri grek Dragumis. Ky nuk kërkon as ma pak as ma shum veçse protektoratin grek mbi krejt Shqipnin. Agjencija angleze e lajmeve e çpalli ketë ké kesë greke në të gjithë botën qi t'a ndigjojnë se shqiptarët gjoja janë të pazotët për të qeverisë vet-vehten dhe se duhet qi në jugë të qeverisen prej grekëve e në veri prej serbëve. Ju e dini se çdo ma thanë kjo. A i keni harrue masakrat e bame në vjetin 1878 dhe ato të bame prej vjetit 1908 deri në 1912 në Kosovë dhe në Shqipnin e Veriut?

E vërteta e kulluar

A. S. Duncan-Jones, Dean Chichester, në "Free Europa", Gusht 1944:

"Politikanët e Britanis i shikojnë popujt e vegjël vetëm si Helot-ët e popujvet të mëdhenj.,,

Nga njëherë edhe një anglez flet të vërtetën e kulluar!

Në tellall!

"Ja, unë jam ay, krimet dhe turpet e të cilit s'kanë an'e fund. Isha një kryetar çete dhe tashti po i vjellë të gjitha ç'bëra. Mëkatë që mbaron, kësisoj, një "kapedan,, me flete!

Ah, t'a dinit ju se ç' isha unë!.. Ç'do gjë që të bëni, nuk është mjaft!

Të dhjet "liritë,, e aleatëvet

Një program që të shpije drejt një skllavërimi të plotë

Në dhjetë pika i përmbledhin aleatët «çlironjës» premtimet e tyre për popujt e Evropës. Pika e parë është: «Liri për politikën e jashtëme.,, Këtë na e pasqyroj Badoglio. Ay ua la Italin e jugës në dispozicion «çlironjësvet« si fushë lufte dhe po i le qytetet dhe katundet e tij të çkatërohen prej maqinës luftarake anglo-amerikane.

Pika e dytë premton «liri në politikën e brëndëshme.» Edhe për këtë kemi prova të kjarta në Estland, në Letland në Lituani, në Poloninë lindore dhe në Besarabi, ku vriten të gjithë ata që nuk betohen për «babain e vogël» Stalin.

Pika e tretë është: «Liri administrative.» Urija n' Italin e jugës, n' Afrikën veriore dhe n' Indi tregojnë se ç'kuptim kanë këta premtime; ngorth nga urija dhe gëzo «liri administrative.»

Veçanërisht e bukur është pika e katërt: Ajo thot: «liri nga çdo frikë». Bujku shqiptar, që qëllohet prej mitraljozavet të njëj ajrori engles, ndërsa ay vazhdon punën e qetë nër arat e tija, munt të mejtohet mbi këtë pikë, i shtrir nga p'agët e marra.

«Liri vendimi» quhet pika e pestë. N' Evropën lindore kjo është vërtetuar: «Ay që s'është për mua, është kundër meje» thotë Stalini, dhe keshtu e spastron «vetvendosësin«.

Pika e gjashtë premton «liri ushtarake.,, Mjafton të jesh ushtar nënë urdhërin e «Çlironjësvet» dhe të vdeç për ata, dhe kshtu ia arrin asaj plotësisht.

Natyrisht duhet të ketë edhe «liri ekonomike». Për këtë flet pika e shtatë. Pas njëj fitimi të aleatëvet, munt të blemë ne, si pas dëshirës, maqina amerikane. Por, fatkeqësisht, nuk na thuhet me se. Se për prodhimet t'anë ekonomikë s'ka Amerika asnjë interes, passi ajo i ka vetë të gjitha.

Ç kuptim ka «lirija sociale» e pikës së tetë e tregojnë qendrat e punës me përdhunë të Unionit Sovjetik. Në këtë mënyrë, pas luftës, nuk do të ketë asnjë të papunëshmë. Në qendër pune me përdhunë do të ketë kurdoherë diçka për t'u bërë, qoftë edhe sikur të mbushim përsëri, të martën, gropën që hapëm të hënën.

«Liri mendimi» kërkon të quhet pika e nëntë. Kjo nuk ka nevojë të diskutohet. Ay që shkon pas direktivave të zyrës informative sovjetike dhe i dërgon Stalinit falënderime «spontane», munt të thotë e të shkruajnë, kurdoherë, ç'gjë dëshëron të dëgjonjë Moska. Por mjer ay, në qoftë se...!

Familjarët e saj iu dërguan në Siberi.

Pika e dhjetë është e mendimit se "lirija religjoze., nuk është, edhe mjaftësisht e dukëshme në vëndin t'onë. Prandaj ajo premton një të tillë. Ajo do të arrihet plotësisht vetëm at'here kur të gjitha xhamitë dhe kishat t'ona të jenë kthyer në fabrika ujë minerali, në rafineri vajrash dhe në cinema me hyrje gratis.

Një program i «bukur» për të cilin ne nuk na mer malli. Se, për ndryshe, ne do të binim në një skllavëri të tillë, në të cilën, edhe vetëm fjala «liri» do të shkakëtonte dënim me vdekje.

Dhe, a nuk është pikërisht ky qëllimi i fshehtë i «Çlironjësvet?» Ata e dinë pse flasin aqë shumë. Ay që flet shumë, ka shumë për të heshtur. Dhe ç'gjë ata s'e thonë, ne besojmë t'a dimë!

Këtë kishë ruse Sovjetet e kthyen në një uzinë reparimi ajrorësh.

Pjeter Saliko

Ideja e Shtetit

Nji shoqni e organizueme quhet shtet. Shteti asht nji shprehje e dëshirës së kolektivitetit për me jetue në kushte normale. Kush flet për shtet, ai flet për ligjë, ai ndien, qoft për nji organizim të forcave të përbashkëta. Ku s'ka organizim, atje s'ka shtet, qoftë edhe të jenë ligjë. Me dhanjen e ligjëve nuk asht dhanë nji herit edhe organizimi. Ligjt janë vetëm nji kusht i organizimit të shtetit. Ligjët janë shprel je vullneti për me qenë i organizuem, kurse vetë organizimi, si veprim, asht sbatimi i vullnetit Ideja e ligjës, ajo e organizimit pak-a-shumë jeton edhe në popujt primitivë në nji formë embrionale. E sepse kjo ide asht e dhanun ke njeriu, prandaj themi se kjo asht nji qenje morale, me dispozita për moralitet.

Asht forca e vullnetit qi e ban njeriun nji qenje morale të plotë, dhe nji qënje shtetnore. Sa ma fort të sundoj në njerzit forca e vullnetit, kaq ma tepër mund të sendertojnë iden e shtetit, iden qi shpreh dëshirën e kolektivitetit për me jetue ne kushte sa ma të mira, morale, shoqnore, kulturore dhe landore.

Ideja e shtetit shvillohet paralelisht me perparimin e njerëzve. Kështu tjetër kuptim kanë pasë mbi shtetin në kohën e mesme edhe tjetër po ka bota e qytetnueme në shekullin t'onë.

Ç' farë ideje kemi na mbi shtetin?

Asht e vërtetë se dehe na kemi shtet, kemi nji farë ideje shtetnore, por këtë shtet e kemi në saje të njij pakice qi ka mbërrijtë në shkallë sa të kuptojë kthjellët se çdo komb, i math o i vogël qoftë, ka nji misjon përpara. Në qoftë se ideja e shtetit asht e gjallë në trunin e shumicës, atëherë shteti, në vend qi të jetë nji skelet i thatë ligjësh, statutesh e zyrash, merr trajtën e njij qenjeje të gjallë t'organizueme qi synon përmbushjen e njij misjoni. Kështu i organizuem asht nji shtet, kur vullneti i shumicës, tue përdorë shtetin si mjet, kërkon të përmbushë misjonin e vet, t'ua mbërrijë qëllimeve të paracaktueme.

Ku nuk çmohen vlerat, idealet, atje çdo përpjekje organizimi shtetnuer deshton.

Shumica e popullit t'onë ka nji kuptim t çuditshëm përmbi shtetin e konsideron si mjet pasunimi, ose si fuqi qi duhet të shtypë, të shkelë, të marrë taksë e xhelep. Ka edhe të tillë qi shtetin e konsiderojnë si nji «institut bamirës.» Për disa shteti asht nji mjet për dallaverë, përspekullime, për mbrojtje interesash private, etj. Në fantazin e disave shteti rron porsi nji përbrindësh qi kërkon të thithi gjakun e turmës. Disa në shtetin shofin funksjonin e policit, disa funksonin e tagrambledhësit, e prap të tjerë pandehin se shteti krijohet me qëllim qigjithkujt t'i apë bukë, punë dhe defrim.

Të gjitha këto nuk përbajnë kuptimin e shtetit. Shteti s'asht as xhandar as tagrambledhës, as edhe mjet për me u pasanue. Shteti para te gjithash asht nji fuqi organizuese e tanësis, frymëzuse idealesh, nxitëse energjinash, përcaktuese normash e vlerash, sendertuese misjonesh n'interpretim të së drejtës të vullnetit përgjithshme. Shteti gatuen vullnetin e njëjtë të turmave, armonizon njejsin me shumsin. Cfrytëzon energjit e njëjsit në dobi të shumicës dhe ato të shumicës në dobi të njëjsist. Krijon kushte jetese, kushtë përparimi për të gjithë dhe krijon hierarkin e vlerave. Koordinon forcat e kombit në dobi te njëjsit po ashtu sikurse edhe në dobi të shumsit, tue pasë gjithmonë para sysh t'arthmen e kombit. Pra shteti, para se të jet ligjë, qeveri, parlament, minister, xhandar, gjykatës, etj., asht nji fuqi e gjallë organizuese. Prandaj ku ka organizim, ka shtet; e ku s'ka organizim, atje s'ka shtet. Ligjët e burokracija janë të kota deri sa mungon fryma e organizimit.

Peja rrafshë me tokën

Fatkeqësitë, sot, na bëjnë më të fortë

SHQIPTARË,

Peja, një nga qytetet t'anë më të bukur dhe një djep i sa e sa heronjve të mbëdhenj, nuk është më: 28 bombardonjës të fuqivet "çlirimtarë., vollën, mbi'të, pardije, vrerin e tyre çkatrrimtar dhe e bënë hi. Mijra të pafajshmëfoshnja dhe gra, lanë jetën e tyre në, në gërmadha e tij. Mijra frymë fluturuan në qjell, për të protestuar kundër njëj akti sa të pa drejtë aqë dhe panjerëzor. Por mos u dëshpëroni, o Shqiptarë: atë që smundën t'a bënin dot çetat dhe bataljonet komunisto-imperialist Tito-Mihajloviç, se gjokse Oso Kukësh u prisnin rrugën, ju, e bëri një skuadrilje aerorësh e atyre Fuqive të Mbëdha q'u trumbetojnë popujvet të vegjël jetë dhe liri.



Ja si e trajtojnë Ballkanin anglo-amerikanët

O ironi e hidhur e ditëvet të sotme, o ti poshtërsi e pashoqtë e xhambaxëvet për mish njeriu, çpate, vallë, kudër një mij e ca të pafajshmësh? A mos pe, ndër'ta, nonjë gjë që pengonte rrugën t'ënde drejt liris së përgjithëshme? A mos e bëre atë masakër, se ato viktimat e mjera nuk deshnë të të lejonin veprën t'ënde në të mirën e popujvet? Ç'kini me ne, or "Liridashës,, dhe pse nuk jini aqë të sinqertë dhe burra, sa të thoni që ju e shuat Pejën t'onë, se ashtu e kërkoj interesi juaj meskin dhe se për ju s'ka vleftë asgjë që nuk është në dobinë t'uaj?

Por, edhe sikur këto të kenë qënë shkaku i kësaj vepre kriminale, a kujtoni, or ju, q'i kini dalë zot botës së tërëj se ia arritë qëllimit t'uaj, me vrasjen s mijra vetave të pafajshmë? Moj Angli e Madhe dhe ti Amerika Popullore! Të na e paske bërë këtë «b a b a j» i këlyshëvet që s'lenë r r a s t pa u përpjekur të na katshojnë, ndofta nuk do të na kish ardhur dhe aqë keq. Por ne po derdhim lot të hidhur, se po konstatojmë që edhe ju, pseudo-flamurtarë të drejtash e lirish, qënki gati t'i harroni, në çast, parimett'uaj, kur e do nevoja t'u bëni qejfin veglavet t'uaja qorre. Por ata le të mos mburren dhe aqë fort e le të mos çkujdesen se, me çkatërrimin e një qyteti e me vrasjen e disa mijra vetave, ia arrijtën qëllimit. Një gjë të mos harroni: Shqiptarët janë, sot, gati, t'u nxjerrin atyne gjoksin përpara dhe juve t'jua perplasin syvet paturpësinë dhe terrorizmin t'uaj, pas si ata vetëm një herë kanë lindur dhe prandaj vetëm një herë munt të vdesin e, më të ëmbël se sot, s'ka patur vdekje kurrë!

q. p.

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Ejte 24 Gusht 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 21 - ÇMIMI 1 LEK

Ujku ndron qimen e jo lekurën!

Komunizmi në Ballkan paraqitet në petkun e nacjonalizmit

Disa manevra t' ulta janë tue perdorë anmiqët e Europës per me ia mbush mendjen botës mbi sinqeritetin e tyne. Ndodhjet e ditëve të fundit dishmojnë se propaganda mashtruese e vume prej tyne në veprim synon çarmatimin shpirtnuer të popujve, orvatet t' i bajë popujt të besojnë me sy mbyll në' ta.

Kjo propagandë helmuese e muer në qafë Turqin, prandaj duhet qi shqiptarët t' i kenë mendët në krye, të mos bien viktima të sajë.

Çka bani Turqija ?

Turqija, pa kurrnji arsye, braktisi miqësin e vjeter me Gjermanin dhe këputi marrëdhanjet diplomatike me Reichun. Ajo e bani ket hap të marr tue kujtue se kercnimit bolshevik mbi Dardanelat ka me i bamë ball me ndihmen angleze. Anglezët ia premtuen vertet ketë ndihmë sa me mujtë me e shti në kurthë. Sovjetët po vazdojnë me kerkesat e tyne mbi Dardanelat po ashtu sikurse përpara. Si guxojnë vallë të vashdojnë ende në këto kërkesa? Bolshevikët e dijnë se Anglija kaq ndihmë ka me i dhanë Turqis për me u mbrojtë kundra kërcnimit bolshevik sa i ka dhanë edhe Polonis.

"Unioni pansllav,, i Ballkanit

Konti Sforza, Minister i Jashtem italjan, këto kohët e fundit ka ba nji deklaratë shumë interesante. Ai tha se sllavët e jugut duhet të bajnë nji "unione,, d. m. th. bullgarët, serbët, malazezët, kroatët, sllovenët e boshnjakët duhet të formojnë nji "union,, nën mvarsin e nën udhëheqjen e sovjetëve.

Sovjetët prej anës së tyne si intriganta dhe kospiratorë të vjetër qi janë tash së fundi i dhanë urdhën organizatës komuniste greke "EAM,, të bashkëpunojë me qeverin e Papandreut. Po në ketë kohë u dha urdhën Titoja dipendentëve të tij në Bosnje e në Kroaci të heqin yllin, të mos përshendesin ma me grushta dhe të sillen njerzishëm me klerin.

Përse ky ndërrim në pikëpamjet, në parimet e në qellimet? Kush asht kaq i verbët sa mos t' a shofi këtu manevrën e mashtrimit në krejt lakuriqësin e sajë?

Mehmet Shehu prap me flamur të Skenderbeut në dorë

Shqiptarë kini mendjen, çilni mirë syt! Sigurisht edhe Mehmet Shehu qi me 11 Prill 1944 me urdhën të Titos dhunoi flamurin e Skenderbeut tue hjedhë ket në baltë, sot prap po me urdhën të Titos ka me heq yllin sovjetik qi asht për të sigurisht nji gja ma e shejtë se flamuri shqiptar dhe ai hipokritisht ka me e puthë flamurin shqiptar përpara popullit. Perse? A thoni sepse ky flamur asht ideali i tij i vertetë? Jo aspak, ai ka me ba ketë për me u vumë ju në gjum, për me e fitue davanë me nji dhelpni të poshtme. Ideali i tij jet se jet ylli sovjetik dhe flamuri i kuq me drapen e çekiç. Ai asht dhe ka me mbetë sa të ketë frymë në shërbim të Titos e të Stalinit të cilët kërkojnë me kaperdi Shqipnin e krejt Ballkanin. Shqipnija sigurisht ka me qenë kafshata e parë për' ta. Nuk duhet pra n' asnji mënyrë me harrue se ujku ndërron vetem qimen.

"Njerzët ma të mjerë në lagjet e mjerimit,,

Një gjykim amerikan mbi gjendjen në Bashkimin Sovjetik

Knickerbocker, "mbreti i reporterëve, dhe fletorari anti-gjerman ma i njoftuni i Shtetevet të Bashkueme, i cili fitoi nji nam edhe n'Europë me librat e veta, bani deklarata mbi alealin sovjetik në "New York Sun,, dhe në "New York Evening Post,, me nji objektivitet të çuditshem.

Qytetarët sovjetikë janë sigurisht ata 200.000.000 njerzë fatzezë, qi kanë jetue nji herë nën nji flamur, në nji radhe lagjesh dhe barakash të pa fund, të cilët mbulojnë nji të gjashtën e sypërfaqes së tokës e qi shtrihet prej delit të ngrim deri në detin e Zi dhe prej delit Ochotskit deri në detin e Lindjes. Përfytyronie këtë vend të gjanë me popullin e math të tijin e mandej kujtoni njiherë se nga nji skaj deri në skaj tjetër të kësajë hapsine nuk gjindet asnji jetë familjare. (tue mos marrë parasysh jetën e nëpunsavet të naltë sovjetikë, atë të artistavet të paktë të gazetarve dhe të klasavet të privilegjueme qe nuk përbajnë veçse disa mijra nga popullsija sovjetike që asht 200.000.000) që të disponojë ato mjete të veshjes, t'ushqimit e të komoditetit, të cilat i ka në Shtetet e Bashkueme pothuejse çdo familje puntore.

Bujqit jetojnë në kolkozet në nji shkallë të tillë që qëndron shumë poshtë ne krahasim me gjendjen e çdo grupi të vogël o të math të njerzvet të racës së bardhë. Jeta e bujkut sovjetik në thelbin e saj asht jeta e nji rajasë. Gjendja e tij përkundrejt kolkozit asht e barabartë me gjendjen e rajasë përkundrejt zotnisë; në kohën e carëve rajan mund t' a ndëshkonte zotnija; sot rajanë sovjetik mund t' a ndëshkojë pa ceremonira të giata organizata NKVD. Mirë po dersa në kohën e Carve feudalët nuk kishin fuqi për me vendos mbi jetën e mbi vdekjen e rajave të tyne, sot organizata NKVD ka fuqi të vendosë mbi jetën o mbi vdekjen, jo vetëm te bujqvet, por edhe të çdo qenjeje tjetër njerëzore të Bashkimin Sovjetik.

System i urrejtjes për vdekje

Në Bashkimin Sovjetik thuhej në fillim se duheshin vra njerzit për me e spastrue shoqnin, prej atyne klasavet, të cilët kishin ndjenja anmiqësore përkundrejt nji bote socialiste, që kështu të krijohej vendi për nji jetë ma të lumtun. Kështu, proletariati dhe klasa katundare i a nisën mënis në mbështetje me parimet e komunizmit kundra carvet, kundra bejlerëvet, kundra pronarëvet të bankavet, të industrivet, të fabrikavet, kundra klasës së ingjineravet, mësuesvet, mjekëvet, sipërmarrësvet, avokatëvet, priftëvet dhe policëvet, d.m.th. kundra të gjith atyne, të cilët kishin nga nji pozitë të dukshme në shoqni.

Ata kanë pasë nevojë për ohet vjet për deri sa të gjith këta njerëz i vranë e mandej i a nisën punës me i vra dhe me i mëni katundarët që ishin në gjendje të mirë. Unë kam qenë në Moskë kur u ba flijimi i grupit të parë, e mandej kur u çfaros grupi i dytë, dhe kur u çdukën anmiqt e identifikuem të fundit të bolshevizmit ndër budrumet e GPU-s ose ndër stepet e Siberis, pyesim njëri tjetrin në Moskë se çka do të bajë kjo turmë mënijuese kur nuk do të ketë ma ndonji klasë tjetër për me u mëni.

Arma "V. 1.,, nxtret nga bodrumi i siguruar prej bombavët dhe pregatitet për nisje, që kryhet me anë presioni ajror

Anglia pret me frik V. 2.!

Supozime mbi armen e re

Winston Churchilli në bisedimet e tij të fundit e ka sqarue se Anglija duhet të bahet gati për «bomba fluturuese» dhe për «dinamita — metheora» që deri më sot ende nuk kanë hye në përdorim. Këto paralajmërime të Churchilit dhe rrëfimet e qeveris, që deri me sot nuk ka gjetur mënyrën dhe mjetin e mbrojtjes kundra «bombavet fluturuese» kanë shkaktue në krejt Anglinë nji frigë të madhe përpara ngjarjeve t' ardhme. E gjith jeta shoqrore ndodhet nën përshtypjen e këtij mendimi dhe krejt Anglija e din, se lajmërimet e gjermanvet dhe fjala e ministrit të Reichut Dr. Goebbels, zemra e të cilit ka qënë e qetë në shëkimin e veprimit të armës së re, do të vendosen dhe do të plotësohen.

Gjithashtu Agjensia Reuter, sqarimet e së cilës do të përhapen në gjithë botën, nevojitet të flasi mbi themën «V. 2.» Ashtë për t'u shenue se vet Reuter-i duhet të dij, që «V. 2.» paraqet një armë të re, që duhet me u marrë me përdorimin e sajë. Në sqarimet e Reuter-it, në mes të tjerave thuhet: «Ajo dihet se gjermanët kanë ndërtuar instalacione të mrekullueshme, me të cilat ata nuk masin drejtimin e zjarrit të bombave fluturuese, mbi të cilin drejtim mund të gjykohet se këto instalacione vlejnë për grupa ende ma të randa dhe me fuqin renuese ma të madhe. Tregimet angleze dëshmojnë peshën e randë të armës së re. Prej komunikatavet kuptohet se lajmërimet gjermane në Angli nuk mund të quhen të kotë.

Prej gazit - ne lote

Veprimi i deritashëm i V 1

Gjatë tetë javëve që arma gjermane e hakmarrjes asht në veprim kundra Londonit dhe Anglisë Jugore, janë hedhun 11000 meteora dynamit, d.m.th. nji sasi ditore prej 200.

Ambasadori britanik në Shtetet e Bashkueme pas këthimit të tij prej Londre deklaroj se mesatarisht 700 shfëpi janë damtue në çdo orë në Angli prej zjarrit gjerman të hakmarrjes. Prej kësaj mund të nxjerrim se çdo bombë fluturuese damton 50.

Harland-i, kryetari i shoqnis angleze të puntorve të ndërtimit në nji apel që i drejtoi qeverisë, kërkoi me urgjencë t'i akordohet puntorisë së ndërtimit ma tepër leje pushimi. Lordi Chetwode, kryetari i Kryqit të Kuq anglez shkroi në gazetën «Times» se puntorët anglez të ndërtimit po kërcnohen prej krize nervash.

Gazeta «Evening Standart» kërkon që mbas nji fitorjeje të aleatëve, kërkimet shkencore gjermane në lamë të teknikës të vihen nën kontroll, pse përparimi i këtyne asht tepër i math.

Pjesëtarët e nji ekuipazhit të nji vaporit anglez deklaruen në nji skelë europjane në brigjet e Atlantikut se Londoni randësin e vet si skelë pothuajse e ka humbun. Pjesa ma e madhe e komunikacionit detar duhet të kalojë nga ana e Liverpoolit.

Peja e kisha anglikane

Organi i kishës anglikane "Church of England,, ka pasë shkruejt në muejin Maj të vitit të kaluem:

"Asht nji gjykim përvers i krishtenimit me mendue se civilat nuk duhet të vriten.,,

Shumë shqiptarë n' atë kohë, kur këto po shkruheshin, e tundshin kokën në shenjë mosbesimi dhe ndofta edhe diçka tjetër murmurojshin prej "propagandës,, gjermane. Sot, qi po tymosen gërmadhat e Pejës, seicili shqiptar e din se, mosbesimi në këto pika, nuk asht me vend.



«Torpedua gjermane me një njeri» drejtohet prej ushtarësh trima dhe i ka shkakëtuar flotës s'invazjonit armik humbje të rënda. Kësisoj mer pjesë, në luftën detare, edhe çdo ushtar i veçantë.

Kështu duket skllavëria moderne

Badoglio pranoj kushte djallore të armëpushimit

N' Italin e Veriut u arrestue nji gazetar i njij vendi neutral, i cili kishte për detyrë të nxirte kontrabandë prej kufijve t'Italis tekstin e kushteve t'armëpushimit, të cilat Badoglio u shtrengue me i pranue në vjeshtën e vitit të kaluem.

Pranë shumë kushtesh të randa të tjera të "kontratës,, shifet në ket dokument, edhe nji paragraf me të vertetë djalluer. Në ket paragraf thuhet se 2 miljon puntorë duhet të dërgohen me përdhun jashtë Italis. Kjo, në të vërtetë, nuk do të thotë gja tjetër veçse rivendosjen e skllavris. Sasija qi do t'u bjerë prej këtyne robëve modernë, shteteve fituese asht e përcaktueme plotësisht. Bashkimi Sovjetik qindron në krye të këtyne shteteve, tue kërkue 800.000 punëtorë industrish.

Nderkohë paragrafi satanik, sikurse na e kemi marrë vesh prej kohësh, u [illegible] në sbatim. Vapor mbas vapori [illegible] Italis për me i çue [illegible] robë modern ndër skelat sovjetike. Edhe Afrika e Jugut, Australija Shtetet e Bashkueme dhe Brazilija kanë marrë sejcila nga 200.000 prej këtyne robëve moderne. Sikur të llogarisim edhe vaporret e panjehuna të mbushun me fëmij italjanë qi janë largue prej Italis për mos me u kthye ma kurr at'herë ky akt i çpikun dhe i zbatuem prej aleatëve merr formën e nji shitjeje të krejt Italis së Jugut. Kjo masë formon nji gja të tmerëshme qi duhet t'u tërheqë vërejtjen gjithë popujve t'Europës, se fregon në mënyrë të plotë gjanësin e rrezikut që kërcnon kontinentin europjan, në rasë të nji fitoreje të «çliruesave».

Vdekje foshnjash n' Itali

Numri i të vdekuevet dyfishohet

N' Italin e jugës dhe të mesme, nga shkaku i ushqimit të pamjaftë, numuri i vdekjevet të foshnjavet u dyfishua. Nga 1000 foshnja në sisë, si pas lajmesh të një agjencije amerikane, vdiqën plot 300 motakë, kurse më parë vdisnin vetëm 100 gjer 130. Në Rome është aq, i keq ushqimi i mëmavet, sa që foshnjat mbeten, përgjithësisht, pa pirë fare.

Rumunet duan të shkojn në front

Shtimi i radhëvet vullnetare

Si konstaton gazeta "Curentul,, rryma e vullnetarvet Rumunë për në frontin e luftës, po shtohet çdo muaj, gjatë tre vjetëvet, qysh prej vitit 1941.

Marshal Antoneskut i dërgohen letra, jo vetëm prej atyre klasave që edhe s'kanë arrijtur moshën e caktuar, për shërbim të detyruashmë, por edhe prej reservistash të cilët, për arsye të ndryshme, nuk janë thirrun nënë armë, dhe prej burrash q'e kanë kaluar moshën e shërbimit, dhe të gjithë i luten t'i pranojë në radhët vullnetare, veçanërisht pas hyrjes se Sovjetvet në krahinat lindore rumune.

Dr. Neubacher në Athinë

Ay foli mbi atentatin kundër Fuehrerit

Perfaqësonjësi i plotfuqishmë i Ministris së jashtme për Jug-lindjen, i ngarkuari me punë Dr. Neubacher, arrijti në Athinë. Ay i deklaroj Kryeredaktorit të gazetës "Deutsche Nachrichten in Griechenland,, (Lajme gjermane në Greqi) se u ndoth në Kuartierin e përgjithëshmë të Fuehrerit pakë orë pas atentatit, dhe theksoj se Fuehreri gëzon shëndet të plotë dhe se atentati nuk e ndaloj nga puna e tij e përditëshme as një orë.

Humbje të randa bandavet në njerz e material

Ndërmarje pastrimi gjerman dhe fuqia luftarake e sigurimit

Bandat shqiptare, që ndodheshin në luftë në pjesën perëndimore të malevet Kara-Orman provuan të largohen në drejtim të perëndimit e të verilindjes dhe me këtë mënyrë deshtën të lëshojnë rrugën. Në lindje të Bosnjës, në qarkun e Foce-s, provat e bandavet për kalimin e vijës së luftimit, u dërmuen më luftime të përgjakshme. Në bashkëveprim luftarak muerën pjesë edhe njisinat Ustaschi pranë SL-vet të malevet. Në qarkun e Sekovicit divizioni SS «xhandar» të muslimanvet të Bosnjës e mbërthyenë nji grup banditësh, tue i shkaktue humbje njerzish dhe material lufte. Njisit e Ustaschavet muerën në nji luginë njiqind vagone drithë të pa bluem, të cilët ishin grabitur katundarvet.

Trupat e sigurimit Gjerman banë pastrimin e bandave që ndodheshin ne malet e Kara-Ormanit në Shqipni, ku banditët kërkojshin të gjejnë rrugen e kthimit.

Në kohën kur çetat e ndodhuna në kufinin e Herzegovinës e të Malit të Zi, me të msyemet e natës u shtynë në luftime të përgjakshme në drejtim të Bilesa-s, u dërmuen nga ana e SS të malevet në Bosnjën lindore, që afër Foca-s shkojshin si të dyshuem, në drejtim të jugës, u kthyen në perëndim. — Në ndalimin e furnizimit të dytë të çetavet në brigjet e Dalmacis u mbyten 60 banditë — Mbas nji orëvajtjeje të pa dobishme të bandavet komuniste të unshëm për me zotnue prodhimet në luginën e Krbava, u mbrojtën këto prodhime prej njisive të Ustascha-vet.

Rrethim në Malin e Zi

Pushtohen qendra komuniste

Njisina t' ushtëris dhe të vullnetarëve SS u ranë grupeve të bandave të cilët kanë dashtë prej Perëndimit e prej Jugut, të hyjnë në Shqipni. Trupat gjermane u përkrahen në kët veprim të tyne fuqimisht prej vullnetarësh të vendit e prej organizatash nacjonaliste të vetë-mbrojtjes të cilat kanë ba po thue se nji konkurencë në të luftuemit kundra anmikut komunist mbasi hekurudha dhe rruga në luginën e Ibar-it u çliruen mbas luftimesh prej disa grupe bandash, ia nisën gjermanët bashkë me trupat aleate për me i mësy grupet e ndryshem të mëdha të bandave ndërmjet Ibar-it dhe lumit Morava në nji anë dhe n' anë tjetër në krahinën e Drinit t' Epermë dhe n' anën e djathtë dhe të majë të lumejve ma të vegjël qi derdhen në te.

Qytetet e Malit të Zi Beranë dhe Andrijavica me gjith kundështimin e anmikut u pushtuen prej trupave gjermane, të cilat njikohsisht përparuen edhe ndër krahinat e nalta në Perëndim të Lumit Lim. Ndjekja e bandave të mëdha komunisite në krahinat qendrore të Malit të Zi po vijon.

Komunistët qi ndodhen në veri-prendim të Ballkanit humben prej datës 6-12 të Gushtit, brenda veprimit të njij armate, ma se 3500 të vdekun dhe aq edhe nji numur të math të zanun rob dhe t' ikun. U zunë 2 topa, 13 mitraloza, 2 granata-hedhëse, 3 mitralozë kunder-tanks, nji numur i math armësh dhe të tjera armë dore të ndryshme; perveç kësajë ma shumë se 10 karro me drith dhe 25 lundra banditësh. 162 lundra, të cillat banin sherbimin e nozullimit për bandat n' Adriatik, u mbyten. 2 katermotorsha dhe 4 ajrorë gjuetije u rrëzuen prej ushtris.

Pas «çlirimit» konfiskim pasurije ne te holla

Washingtoni pregatit mashtrimin ekonomik n' Europë

Para pakë kohësh, u arrijt, në Washington, një marrëveshje ekonomiko-financjare midis Aleatëvet dhe Qeverrivet të mërgimit, me anën e së cilës do të rregullohen, në vëndet e «liruar» faktoret ekonomikë, si qarkullimi monetar, detat publike dhe shkalla e pagesavet.

Në këtë marrëveshtje bëhet e detyruarshmë tërheqja, nga qarkullimi, i të gjitha biljetavet monetare. Zëvëndësimi i këtyre, me biljeta të ra, lejohet vetëm gjer në një sasi të caktuar. Zotëronjësit biljetash të vjetra që kalojnë sumën e caktuar, janë të detyruar t'i kthejnë këto në huara, në favor të qeverivet përkatëse, dhe vlejnë vetëm për pagesë taksash. Në këtë mënyrë, zyrat qeveritare do të jenë në gjendje, me anë taksash përkatëse, t'a përvetësojnë, ca nga ca, të gjithë pasurinë e blokuar monetare të popullsisë.

Kompetentët kanë llogaritur se, në Belgjikë dhe në Vëndet e Unjtë. të paktën një e treta dhe, në Francë, më tepër se gjysma e pasuris së popullit do të konfiskohej, me këtë mënyrë, prej Qeverrivet të ra.

Si duket, pra, «Çlironjësit» besojnë, me gjith mënt, se popujt e «çliruar» duan që t'iu kushtojë, dicka, «çlirimi» i tyne. Asnjë çmim nuk është i math, për një gjë të këtillë, besohet në Washington dhe në Londër. Aleatët po na e thonë që tashti, me të fjera fjalë: Ju, natyrisht, do të hani thonjt nga urija, këta njëzet tridhjet vjetët e arthmë, dhe nuk do të dini me se të ushqehi dhe të ushqeni fëmijën t'uaj, por, për këtë, do të jini të lirë.

Por, ay që s'ka ç'të hajë, vërtitet, do e mos, si pas ëndjes së fjetrit dhe flaket andej këtej, ku t'a dojë nevoja: shkurtër: ay s'është më njeri, por një kafshë pune, për të cilën do të tregohet një farë interesi gjer sa ajo të jetë në gjendje shërbimi. Me të vërtet një liri e çuditëshme kjo që na propozojnë këta Alealë! — Passi të na kenë «mjelë» së gjithash, shpresojnë të ecin aqë përpara, në pangopësin' e tyre, sa të na bëjnë që t'u shërbejmë edhe si skllevër. Si tha Roosevelti? «Pas luftës, Amerika do të jetë vendi m' i pasur i botës!»

Nje "Montgomery,, e prish dy here qytetin Caen

Edhe rreth vitit 1000 Englezët nuk i kursenin Kishët

— Korespondenti i gazetës "Nouveaux Temps,, ban nji zbulim interesant në lidhje me qytetin Caen. Ky qytet sikurse mujti ai të zbulojë, reth vitit 1000 u pushtue prej prijsi 1 ushtrije angleze të quajtun Montgomery dhe pjesërisht po prej këtij u shkatrue.

Korespondenti i gazetës "Nouveaux Temps,, shkruen sa vijon: "ky Montgomery i parë i la ushtarët e tij të shkatrronin Abacinë e qytetit Caen. Me kët rast ushtarët patën shkatrrue me spata organin e kishës e po kështu i patën vue zjarrin tribunës së korit tue shkatrrue edhe dritaret e kishës. Korespondenti në fjalë shton se Montgomery i vitit 1944 ka përfaqësue dënjësisht stërgjyshin e tij tue bamë shkretnime edhe ma të mëdha

Nuk ka mundësi të ndriçohen djemtë e Kansasit, të Tenneses të Broadwayt dhe të New-Yorkut për mbi domethanjen e atyne gjanavet që ata kanë shkatrrue, thotë një e përkohëshme letrare e Parisit, se për këta murët e gurët e vjetër nuk flasin. Shtëpijat e nalta të New-Yorkut kanë më tepër vlerë për t' a se sa një kishë e ndërtueme qysh në kohën e mesme e që asht vetëm 70 m. e nallë.

Edhe Sekretari i shtetit francez t' informatavet Henriot në fjalimin e tij të mbajtun në radio vuri në dukë martirizimin e Normandisë. "Një mori gërmadhash, tha ai u shkaktue në këto vende prej bombave që plasin me vonesë, prej të cilavet qindra të vdekunish deri tnsh s' kanë mujt me u nxjerrë. Qindra mijra francezë nën rebeshin e bombavet. Ata po enden te mpim e të hutuem, kërkojnë t' afërmit e tyne dhe po vuajnë urisë. Këtë gja guxon zoti de Gaulle t' a quajë "çlirim... Une po e padis kët njeri si organizues të masakravet që janë ba.

Normandezët ikun prej "çlironjësvet,, të tyre

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Hënë 28 Gusht 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 22 - ÇMIMI 1 LEK

Rrena e dyfisht e Rooseveltit

Ma parë rrejti popullin e vet e mandej popujt e Ballkanit

Në Shtetet e Bashkuara po zmadhohet keq-ardhja mbi trathtin e dobët të Roosevelltit për Polonin e për popujt e vegjël t' Europës që u lihen Sovjetëve.

Më 30 Tetor Roosevelti premtoj, në fjalimin e famshëm të zgjednjeve, përpara popullit amerikan, fjalë për fjalë:

«Kur unë ju flas juve nënave dhe etërve, unë ju jap fjalën, që edhe më parë ju kam dhënë dhe do t'a përsëris për gjith herë: djelmt e juaj nuk do të dërgohen në luftra të jashtme».

Kjo ka qënë gënjeshtra më e turpshme, me të cilën, përveç Amerikës, edhe bota mbarë u gënjye; sepse, tamam pas nji viti Shtetet e Bashkuara, kundra vullnetit të popullit, filluan luftën me Japonin dhe me Gjermanin. Dhe cili ishte përfundimi?

Pse heshtni, Zoti President?

Senatori i Shtetevet të Bashkuara Bridges-i ia dha botës përgjegjen në nji fjalim sensational përpara senatit. Ky fjalim u përsërit në vende të pa numurta në Shtetet e Bashkuara dhe pati një jehonë:

"Zoti President,

Për herë të parë në historin e Amerikës kërkohet prej të rinjvet, prej vajzavet dhe prej burrave të japin therorin më të lartë për plotësimin e një ideali, që ka humbur dukjen e vet, zërin e vet dhe kuptimin e vet. Neve amerikanët e trajtojmë jetën t'onë përpara të gjithëve dhe zmbrapsemi nga komunizmi. Populli amerikan nuk asht tërhequr në luftë, që të merret europa nën kontrollin e nji kombi ose e nji grupi prej kombeve jo europjanë, dhe, nuk hyri në luftë që të lërë t' ju diktohen formulat e tregëtisë së vet prej kryeministrit t'Anglisë ose prej diktatorit të Sovjetëvet.

Qysh prej mbledhjes së Teheranit, tha Bridges, dyke vazhduar, Roosevelti u ndryshua krejt dhe shikoj, pa të drejtë kundërshtimi, se si Stalini dhe Churchilli i dektaruan botërisht, si të kryera formulat e Kartës Atllantike me të katër liritë e sa

A don të thot kjo, zoti President, e pyeste Bridges-i Rooseveltin, që juve humbët krejtësisht inisjativën t' uaj në europë, dhe si Presidenti i një populli më të fuqishëm në botë. në mbledhjen e Teheran-it u shtërnguat të kompromentoheni për një paqë të vijuarshme? Heshtja e vijuar e Juaja na bën të zmadhuar frigën t'onë, që juve të drejtën t'onë, duke folur vetëm për neve, e keni shitur dhe Ju nuk keni të drejtën e lirisë të kasneconi idealet t'ona. Heshtja e Juaj na i shton paramendimet t'ona të këqija. Sepse ajo asht e pa duruarshme për nè: Churchilli flet dhe Ju heshtni, Stalini flet dhe Ju heshtni, Smutsi-flet dhe Ju heshtni, Fraser-i dhe Curtin-i flasin dhe Ju heshtni. Na e dimë, se Juve, zoti President, veni në lojë avenirin t'onë edhe avenirin e botës mbas lufte, duke bërë ata të mvarrur në vullnetin e Stalinit, çka kurrë nuk mund të pranohet prej popullit amerikan si mbrojtje kundra nji luftës së ré. Pse heshtni Ju zoti President? A thue ndodh kjo, sepse përbindëshi që Ju e keni lëshuar, nuk mund të zaptohet më dhe bën kërdin gjithkah?»

Shqiptarë, kur nji herë nji President amerikan e rrejti në këtë mënyrë popullin e vet, atëherë atij s'ka me i besue kërkush mà. Gjith bota e din se ai ka mohue qysh me kohë «Kartën e vet të Atllantikut» dhe se premtimet e tija janë porsi pluhuni në erë. Europa mund të mbështetet vetëm në fuqit e veta kundra Sovjetëve dhe ka me fitue po me fuqit e veta.



Gërmadhat e Donit të Sh. Pjetrit në Rigë, i cili u shkatërrua prej Bolshevikëvet. urrejtës të fesë. Kush beson edhe që Stalini u bë fetar, tashti së fundi?

Nji lojë djallore në Varshovi

Kryengritsit polonez derdhin gjakun e tyne per Stalinin

Në ditët kur kryeministri i qeveris së mergueme poloneze, Nicolajczyk, bani vizitën e vet të përvujtun në Moskë, por më kot se hangri shkelma, nacjonalistët polakë filluen në Varshovi nën udhëheqjen e gjeneralit Bor nji kryengritje në shpinë të trupave gjermane. Marrisht e të verbuem, sikurse kanë qenë gjithmonë politikanët e Polonis, kanë dashtë, me anë të nji grusht shteti me shti në dorë kryeqytetin qi kështu të mundnin me fillue me hy në bisedime me Sovjetët si nacionalista polakë me të drejta të barabarta.

Po çka ndodhi? Mbrenda pak ditëve kryengritësat u shpartalluen prej trupave gjermane të pathyeshme. Disa mija u vranë dhe me mija tjerë u zunë robë. Ndër këta qenë shumë nga ata të cilët kishin thye fjalën e dhanun të nderit. Kur mori fund lufta kundra Polonis në 1939, Gjermanija këta qi tash e thyenë fjalën e nderit i pat lëshue prej robnis mbasi patën pasë dhanë fjalën e tyne të nderit se s'kanë me luftue ma kundra gjermanëve. Ata ma në fund zemërgjanësin gjermane e shperblyen me tra'hti. Porse këtë trathti e paguen me jetën e tyne. Mëshirë s'mund të pritshin.

Në kaq qindron fakti ushtarak. Porse në këto ditët e luftimeve ndërmjet kryengritësave polakë dhe ushtarëve gjermanë në Varshovi, shtypi i aleatëve shkroi nji sasi levdatash të kota përmbi ndërmarrjet heroike në Varshovi. Shtypi i aleatëve e ngriti në të shtatin qiell gjeneralin Bor... por asnji ajruer nuk u dërgue për me u kujdesë për te. E pra anglo-amerikanët kanë nji sasi të pashterrun ajrorësh dhe kanë premtue me të madhe se do t'i përkrahin të gjithë kryengritësit kundra Gjermanis!

Po armata sovjetike, qi në këtë kohë qindronte 50-60 km. larg Varshovis tue luftue e ku po qindron edhe sot? Çka banë sovjetët për me i ndihmue t'ashtuquejtunit patriotë të Varshovis? Kurrgja! Asnji ajruer nuk u duk përmbi Varshovin, nga të gjithë ata ajrorë, me të cilët sovjetët i furnizojshin nga ajri mijra partizanësh. Asnji ajruer nuk hudhi armë, municjon e gjana ushqimore.

Vetvrasje me urdhër të Stalinit

Pse kjo lojë e mbrapështë? Nacjonalistat nji herë urdhnohen me luftue kundra gjermanëve, mandej lihen në baltë? Përse? Këtë pyetje polakët ia drejtuen njimijë herë botës. Dihet se sovjetët kishin dijeni për këtë kryengritje. Radio Moska e kishte lajmërue dhe ishte gëzue tepër. Fletorja poloneze «Gorniec Krakowski» e thotë kjartë këtë të vërtetë dhe akuzon rreptësisht trathtin britanike dhe brutalitetin sovjetik: «Çdo kryengritës polak, qi rá në këtë kryengritje vetëvrasëse, ia ka lehtësue barrën Stalinit për me mbytë njerzit me qellesë mbas zverku, në rasë se ky ban ndonji përparim edhe ma lufje për me pushtue edhe ato toka poloneze qi ende s' janë pushtue prej tij. Sidoqoftë Stalini ka arsyena të plota të gëzojë për likuidimin e këtyne nacjonalistave polonezë pse këta në t' arthmen do t'i pengojshin rrugët asajë qeverije të polonezëve sovjetikë qi komandohet prej tij. Prandej Stalini e vërente punën me nji qeshje të ftoftë se si nacjonalistat polonezë kryejnë vetërvasjen e tyne.

Vaj halli!

Pse po kjan, miku im?

Tash së fundi, ndërsa radio e Londonit po na tregonte prrallat ma të çuditshëme mbi gjendjen në Rumani, më ndodhi me ndie nji gja shum interesante prej nji mikut t'em. E takova në rrugë. Dukej shum i mërzitun dhe i demoralizuem. «Pse jeni kaq i mërzitshëm?» - e pyeta me interesim të madh. Së fundi të gjithë e dijnë se ai në shtëpin e mirrte të gjithë ditunin prej Tajar Zavaianit, e se paraplqente vetum pllaka jazzit amerikan dhe se do të kishte qef m'u veshë rroba stofi anglez, po t'i delte hesapi. Por le t'i lamë këto. Fundi i fundit edhe ai sikur shumë oparrvnista të tjerë të guzimshëm nuk kishte mbetë pa shkye diçka prej Jacomonit dhe tashti furnizoi si duhet ushtrin gjermane. Por sidoqoftë sod, mbassi radio e Londonit dha kaq shumë rrena fitoresh, e pritshe ma me në qet, sepse ai po i shifte realizueme andrat e veta. Por gabim i madh. Miku i im si duket kishte halle të tjera.

«Unë nuk kam fjetë gjithë natën e lume». m'u përgjegj i shqetsuem. «Perse». e pyeta i habitun. «Pash dje ushtrin gjermane kah po largohej prej qytetit dhe po kam frikë se gjermanët po largohen». «Ashtu», thash unë, «këtë gja ti gjithmon e ke dishrue». E ti si mik i deklaruem i Churchillit duhet t'ishej i gëzuem për ngjarjet në Rumani, po t'ishin të vërteta?» — «Si mund të mendojsh nji gja të tillë?» — m'u përgjigj anglofili me pezm. Me të vërtetë e sinqerisht ishte pezmatue. «Sikur të tërhiqeshin gjermanët, atëherë na mbrenda pak ditësh do t'i kishin në shpinë komunistat prej Serbis, Makedonis, e prej Greqis. E mue do të më duhesh m'u arratisë, tue lanë shtëpi e duqan në rrezik. Si duket anglezët nuk e kanë menden me zbarkue dhe mbas gjaset Shqipnin e kanë nda në mes të serbëvet dhe të grekëvet.»

«E për këtë shkak nuk ke fjetë gjithë natën? Po më thuej njiherë, çka mendon ti me të vërtetë? Ti ke nzitë të tjerët kundra gjermanëve dhe vetë ke ba tregti të mirë me ta. Ti ke ba sikur me zi e pritshe «çlirimin» dhe tashti po kjan pse po shef të largohen disa gjermanë. Në paranthezë po vijnë gjermanë të tjerë në vend t'atynëve që u larguenë dhe gjermanët nuk e kanë menden aspak me e lanë Balkanin dhe aq ma pak Shqipnin. Por teshti menjiherë po kujtohesh se vetun gjermanët mund të garantojnë Shqipnin ethnike. Tash po kujtohesh ti se çka do të ndodhte, sikur gjermanët të zbrasnin Ballkanin. Ah, mik i dashtun, se ç'oportunist i shkëlqyeshëm qenke ti. Ti jeton n'iluzione, ndersa bota paraqet fakte t'ashpra dhe ushtrija gjermane formon gjithnji faktet ma t'ashprat n'Europë».

Tanksi gjerman "Panther,, i cili u projektua dhe u vu në përdorim, brenda një kohe çuditërisht të shkurtër, sot i del përpara me sukses në të gjithë frontet, materialit të shumtë i armiqve t'Evropës.

Gjermanija dhe Islamizmi

/ Feja e Muhamedit midis kapitalizmit e komunizmit

Me besëlhyerjen tyrke kundrejt Gjermanisë, del në shesh përsëri pyetja e Islamizmit. Në çdo vënt të botës, ku imperializmi englez u takua me Islamizmin, politika engleze u tregua si armiku më i math i kësaj feje dhe i besnikëvet të saj. N'Indi n'Afrikë dhe në Lindjen e afërme i çfrytëzoj Anglija lëvizjet e ndryshme midis Myslimanëvet, ndërseu myslimanë kundër myslimanësh ose i trathëtoj këta me manevra të errëta religjoze besimesh të tjerë, gjithënjë në dobi të saj të zotnimit të përbotëshmë.

Edhe Sovjetët i kanë futur hundët në këtë lojdër djallëzore dhe përgëzojnë, ka disa kohë, një miqësi myslimane, pas si i ndoqnë dhe i vranë, një zet vjet rjesht, hoxhallarët dhe fetarët muhamedanë, dhe e bëjnë këtë se duan t'ua gëlabëritin "miqvet,, të tyre Anglezë fokat myslimane të Lindjes së mesme.

Përkundrejt këtyre, është Gjermanija i vetëmi shtet që kurdoherë dhe kudo është treguar në favor të të drejtavet të Myslimanvet. Ajo s'e ka kanosur kurrë zgjerimin e fesë myslimane, në tërë botën, dhe s'e ka çfrytëzuar për interesat e saja politike. Një dëshmimtar i rëndësishmë dhe i pakundërshtuarshmë i kësaj është Myftiu i math i Jerusalemit, mik personal i Fuehrerit, i cili i detyruar t'i nënshtrohej fuqisë engleze, iku në Gjermani, ku Fuehreri i la në dispozicion një banesë të lakmueshme.

Një fjalër provë e miqësis së sinqertë gjermane kundrejt Islamizmit janë ata repartet myslyman SS, të pajosun dhe të armatosur në mënyrën më moderne. Nër këta çquhet vullneti i të gjithë Myslimanëvet të Ballkanit për një luf të pamvarsije të plotë.

Pyesni ushtarët myslimanë në Ballkan

Një njohës i pagabuar i popullit engles ka thënë, dikur: «Kur Englezët thonë Krisht, ata mejtojnë Kattun» - d.m.th. industrit' e tyre të pambukut në Manchester, fitimin përkatës, galjetë e shitjes, shkurtër: tregëtit' e tyre. Ata nuk kanë mejtuar ndryshe, gjer sot, edhe kur kanë zënë ngojesh, me hipokrizi, emrin e Muhamedit. Dhe, për sa i takon miqësis së Sovjetëvet kund-ejt Myslimanëvet, gjejmë rrast në Ballkan, dyke pyetur ushtarët myslimanë prej Kaukazi, nga Turkmenistani dhe nga krahinat e Krimesë. Nuk luftojnë më kot, këta njerës, lark atdheut të tyre dhe në radhët gjermane. Sikur këta të mos kishin qënë të persekutuar, vjete me radhë, prej xhelatëvet të Stalinit dhe të mos ishin bërë skllevër, nga shkaku i besimit të tyre, e të mos ishin ndiekur për vdekje, sigurisht nuk do të rri in kelu dhe nuk do të ishin armiq për vdekjë të Bollshevizmit.

Moska dhe Londra dara shtypëse

Që edhe Tyrqija u tradhëtua prej Englezëvet, në favor të sovjetëvet, në çështjen e saj jetsore të Ngushticavet, utregua qysh tash. Në këtë mënyrë, u fut nënë mvarësinë e Llondrës dhe të Moskës edhe i fundit shtet i math mysliman. E tërë Myslimanizma është në rrezik të bëhet lojë e planevet të palëvet luftuëse për sundimin e botës.

Gjermanija nuk u shty vetë për detyrën e rëndë të shpëtonte Evropën. Për këtë detyrë ajo që e shtrënguar. Aqë më pakë kërkoj ajo të loste rrolin e mbrojtësit të Islamizmit. Edhe kjo barrë iu ngarkua nga rrethanat, veçanërisht nga sigurimi i Ballkanit. Vetëm fitimi i asaj munt t'a këputnjë darën, midis së cilës është kapur Islamizmi prej Englezëvet dhe prej Sovjetëvet, dhe t'a vendosjnë besimin e kanosur të Muhamedit përsëri në të drejtat q'i takojnë prej shekujsh, si një fe e përbotëshme, si një shtyllë e zakonevet të mirë njerëzorë.

Skllevër te Moskes

Rekrutime dhe çpronësime në Poloni

Një këshillë poloneze, e formuar prej Stalinit, u mbloth këto ditë në Lublin. Pas një telegrami brohoritës, drejtuar diktatorit të kuq të Kremlinit, këshilli vendosi një urdhnesë mbi rregjistrimin e samaparëshmë të të detyruarvet për armë dhe për punë nër krahinat polonezë të pushtuara prej Unionit sovjetik. Janë, në kryerje e sipër dërgesa të mbëdha punëtorësh polonezë nër qendra mobilizimi sovjetike.

Veç kësaj, u pranua dhe një ligjë për «sbatimin» e reformës agrare. Në këtë mënyrë u bë hapi i parë i vendosjes së systemit Kolkhos, d.m.th. i çpronjësimit të tokës. Policija poloneze do të çpërndahet dhe në vëndin e saj do të formohet një Milici, që, në praktikë, do të thotë një gardë sovjetike. Ç'u thotë Anglija këtyre gjërave, e cila ryri në luftë gjoja për lirinë dhe për të drejtat e Polonisë? Anglija hesht.

Sovjetët fillojnë "spastrimet,,

Burrat prej 12 60 vjeç transportohen

Gazeta «Uzi Suomi» njofton nga Revali se ndër krahinat e pushtueme prej sovjetëve e sidomos në Pleskau e në Mitau t'ashtuquejtunat reparte të spastrimit të sovjetëve qysh tashti kanë krye nji punë të madhe. Jo vetëm qi i janë marrë mjetet e ushqimit popullsis civile, porse pa përjashtim të gjith meshkujt prej 12 deri në 60 vjeç janë transportue ne Bashkimin Sovjetik me të njëjtat trena me të cilët furnizohet armata sovjetike qi vepron në front.

Trupa të reja italjane gati për luftë

Të stërvituna në Gjermani

Paraqitja e parë në publik të njisinave t'armatosuna republikane, të cilat kanë marrë instruksjone në Gjermani, ka ba nji përshtypje të thellë. Simbas sjelljes e përmbajtjes të këtyne trupave, shiten hollëvina qi apin me kuptue se kanë marrë nji disiplinë dhe nji sigurim të padështueshëm. Kështuqë, kur ndodhen disa aksidenta të nxitun prej elementash turbullues të popullsis, gjatë kalimit të divizioneve «Monte Rosa» dhe «San Marco», këta kundravepruen me nji herë dhe pushkatuen shkaktarët.

Rebelime nder anije lufte angleze

Denime me vdekje

Simbas nji lajmi të veçantë ardhun nga Lisbona dhe të riprodhuen në «Nipon Times», janë çfaqë rebelime ndër oficerat dhe marinarët e tri anijave luftarake britanike. Njizet veta u dënuen me vdekje, tetë me burgim të përjetshëm dhe të tjerë me dënim prej tre deri në njizet vjet

Çetavet u shkaktohen, në Kroaci, humbje të rënda

Në Herzegovinë 3460 të vrarë, të plagosun dhe robër

Një grup çetash që marshonte drejt Drinas, në bryllin jug-lindor të Drinas bosnjak, u ndalua nga vullnetarët myslimane SS dhe nga reparte kroatë dhe u shty arejt perëndimit, me humbje fort të rënda.

Humbje të përgjakshme pësuan komunistat edhe në Slloveni, ku vullnetarë kosakë, pas luftimesh të rreptë, çliruan qytetin e vogël Herzegovaç. U numuruan 134 Komunistë të vrarë dhe u zunë pushkë automatike, pushkë dore, lëndë plasëse dhe municion.

Çetat humbën edhe 32 të vrarë të tjerë dhe 10 robër, në malet Moslavaç shkakëtuar prej repartesh malore kroatë.

Ditët e fundit, armiku pati humbje të rënda nër luftime në rrethet perëndimore të Kroacisë dhe në anën veriore të zonës pjellore Krbvaska Polje, pranë qytetit Bunic.

Në zonën bregdetare dalmatine u çprapsën sulme lokale çetash.

Komandat t'ona malore patën, një kosisht, sukses edhe në Herzegovinen lindore. Pas përfundimit të ndërmarjes së spastrimit, t'aljeshme, e cila vazhdoj dy javë, si pas lajmevet të ra, armiku ka humbur, tërësisht, 3460 të vrarë, të plagosun të zënë rob dhe të desertuar. Veç kësaj, u zunë ose u prishën edhe 2 topa malorë, 46 mitraljoza, 3160 bomba pushke, disa mijra pushkë me mijra fyshekë 350 kuej dhe kafshë ngarkese ashtu dhe aparate lajmesh e material shëndetësor.

Komunistët humbën, në Ballkanin veriperëndimor, më 21 gushtë, 239 të vrarë. Ata patën edhe të tjera humbje në të plagosur, në robër e në të arratisur. U kapën 11 mitraljoza, 8 pushkë automatike, më tepër se 50 pushkë dore, ashtu dhe lëndë explosive dhe municion. - Në Shqipërin e jugës, një sulmë çetash kundër Beratit u çpraps.

Të dyja çetat e mbëdha komuniste, të cilat donin të bashkohëshin, në pjesën veriore të Malit të zi, për një sulm të përbashkët kundër Kosovës dhe Sërbisë jugë-lindore, u çpërndanë një her'e mirë. Ndërsa njeri grup përpiqet édhe t'ia arrinjë qëllimit të tij, në për malet Zlatibor dhe në për pjesën veriore të Sanxhakut, grupi tjetër u shty në anën perëndimore të krahines Durmitor. Trupat t'ona malore dhe çetat vullnetare vendase po i ndjekin këmbakëmbës. Qyteti Zablja ra në duart t'ona.

Spekulime me tregun e zi n'Afriken e Juges

Krizë sendesh ushqimore në nje vent te pasur

Si thonë lajme të ardhur nga Kapstadti, vështirësitë qeveritare, n'Unionin jugafrikan, po venë dyke u shtuar. Çmimet e sendevet ushqimore dhe të banesavet kanë hipur përmbi 40 për qint, ndërsa çmimet e veshmbathjes kanë arrijtur një shkallë edhe më të lartër. Misht, gjalpët, çaji dhe orizi me zi gjinden. Në Johamisburg, në Pretoria dhe në Kapstadt hapen disa thertore dhe vetëm për pakë orë. Si thuhet, në lidhje me këtë, spekulatorë me influencë e kontrollojnë 50 për qint tregëtin e kafshëvet për t'u therur dhe këta spekulonjës paguajnë çmime të lartër për të mos dalë kafshët në treg.

Nër qarqe politike jugafrikane deklarohet se Kryeministri Smuts s'qënka në gjendje t'u bënje ballë këtyne veshtirësive, passi ati i munguaka një direktivë e përbashkët dhe passi në kabinetin e tij, ashtu dhe në bashkimin e tij qeveritar, u ndothkan elemente në kundërshtim midis tyre. Edhe vetë ay po mbetka gjithënjë më pas nga Hofmeyer-i, i cili, në konferencën e Partisë kryesore, u proklamua si kryeministri i arthmë. Edhe brënda qarqevet t'anëtarëvet të qeverisë u folka se, së shpejti, drejtimi i vëndit duhet të vendoset në një dorë fjalër.

Liddell Hart gjykon me pesimizëm

Shpresat angleze dualln bosh

Në lidhje me shvillimin e luftimeve në frontin e invadimit dhe në lindje, kritiku ushtarak i gazetës «Daily Mail» Liddell Hart shkruen sa vijon: «Rezistenca e gjermanëve vijoi jë jetë gjithmonë e ashpërt dhe kështu shpresat në lidhje me pushtimin e Normandis, mbrenda 14 ditëve, duelën bosh.

Në frontin e Lindjes, shkruen Liddel Hart, në gjendjen ushtarake në këto 14 ditët e fundit, pak gja ka ndryshue. Përparimi i sovjetëve gjatë javëve të kalueme nuk ka pasë për shkak nji shpartallim të gjermanëve porse nji tërheqje të rregullte të bame prej tyne ndër pozita ma të mira. Në sektorin e luftës në veri-prendim te Varsovis dhe në jug të Rigës sovjetët hangrën prei gjermanëve grushta shumë të randë.

Një pjesë e Estonezëvet të masakruar prej Bollshevikëvet në oborrin e kështjellit t' Arensburgut. Gjak dhe lot — Ja, këto janë dhuratat e Stalinit për Evropën.

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Ejte 31 Gusht 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 23 - ÇMIMI 1 LEK

Xhelal Kodra

Forca e shpirtit

Popujt (të mëdhenj ose të vegjël qofshin) që kanë nji misjon përpara e qi e ndjejnë vehten e tyne të thirrun për me e përmbushë nji misjon, në çastet ma të vështira dhe ma kritike të jetës së tyne japin prova ma të shkëlqyeshme të forcës së tyne shpirtnore. Madje sa ma i math të jetë rreziku që i kercënon, sa ma të mëdha të jenë pengesat që duhet t'i kapërxejnë, kaq ma tepër u shtohet forca e shpirtit, kaq ma tepër u mprefet instinkti i jetës e kaq ma tepër u shtohet besimi në vet vehte.

Në rrezik, në vuejtje e në mjerim, kur tufani e rrebeshi kërcënon me përmbysje, ka rasën ma të bukur, qoftë individi qoftë kombi, të japë prova të shkëlqyeshme të forcës së vullnetit të vet e të gjallërisë së vet. Individuit që kërkojnë të kryejnë vepra të mëdha e kombet që kërkojnë të thonë fjalën e vet qytetëruese në jetën e kombevet dallohen me forcën shpirtnore që i ban t'a shikojnë rrezikun në sy pa u trondit ë aspak, t'i venë gjoksin përpara dallgës së pa mëshirë që kërkon t'i përmbysë, t'i përpijë.

Ligshtija përpara rrezikut asht nji shenjë dekadence. Kush i trembet rrezikut ai nuk meriton të jetojë. Kush ndeshet burrnisht me rrezikun, jep prova të meritës, të gjallëris për të jetue, qoftë si individ qoftë si komb e qoftë si racë. Kush nuk ka gjoks burri, s'ka forcë shpirtnore për me e shikue rrezikun drejt në sy, ai qoftë individ o komb nuk, vlen të ekzistojë. Ky asht ligji qi po sundon në këtë shekull e që në heshtje ka sundue edhe në të kaluemen.

Raca Shqiptare në rrezik

Raca shqiptare asht në rrezik. Re të zeza janë grumbullue mbi orizontin shqiptar. Prej ka vjen ky rrezik, prej kah vijnë ato dallga që kërkojnë t'a përpijnë? Ndeshje e gjigantëve nuk mundi t'a kursejë racën shqiptare prej rrezikut. Edhe kjo racë sado e vogël u përzie pa dashje në lodrën djallore, në ndeshjen e pa mëshirëshme të shpirtit me landën, të jetës me vdekjen, të virtutit me vesin, të drejtësis me pa drejtësinë. Në këtë ndeshje të tmerrshme raca shqiptare deri sot në trupin e saj ka pësue cënime të ndjeshme. Por sikurse e dishmon historija ka dhanë prova deri sot të nji gjallërije të jashtzakonshme. Ka nxjerrë burra që kanë dijtë kurdoherë të përballojnë rrezikun me vendimtari. E pse raca shqiptare nuk i asht tremb rrezikut, ka mujtë të pohojë ekzistencën e vet edhe sot e kësaj dite sa do që gjatë historisë shpesh e kanë rraf dallga të furrishme.

Rreziku i pansllavizmit

Nuk asht e para herë që ky rrezik kërcnon me çfarosje racën shqiptare. Historija ka regjistrue me shkronja të arta përpjekjen heroike të shqiptarëvet për me i bamë ballë këtij rreziku. Në dilët t'ona ky rrezik po paraqitet me trajtën e vet të vrashtë e të vërtetë si dikur. Sot asht veshun në petkun e nji ideologijje terheqëse sidomos për turmat e pa formueme. Pra po paraqitet me nji taktikë të re për me ia mbrrijtun qëllimit të vjetër.

Asht pyetja si do t'i qëndrojë raca shqiptare këtij rreziku përpara. A ka mundësi t'a përballojë? Nuk duhet të jemi shumë optimista për me pohue se me plotsimin e disa kushtevet raca shqiptare ka fuqi të plotë t'a përballojë këtë rrezik. Nji ndër këto kushte asht njohja e plotë e rrezikut që paraqitet në nji formë të gënjeshtërt. Cdo shqiptar duhet të kuptojë drejt se nën maskën e bolshevizmit asht rreziku pansllav që synon asgjasimin e racës shqiptare. Njohja e plotë dhe në këtë mënyrë e këtij rrezikut do t'u japë shqiptarëvet forcën e pa thyeshme të bashkimit. E ku asht forca e bashkimit atje rreziku kalon, nuk ka me lanë gjurma të rrenimit.

Ay që thotë të vërtetën, do të fitonjë!

Koleksion i ri ginjeshtrash nga an' e aleatëve

Por Gjermanija thotë të vertetën, qoftë kjo edhe e hidhur

Sa më tepër i afrohet përfundimit lufta e përbotëshme dhe sa më e madhe bëhet frika, n' Angli, nga armët e fshehta gjermane, aqë më tepër shtohen edhe qënjeshtrat e marra për të pakësuar dyshimin e pohimevet të shumtë të aleatëvet. Ja këtu disa shëmbëlla të dukëshme gënjeshtrash, nga ana aleate, q' i kundërshtojnë po ata vetë.

Më 22.8. njofton Reuteri bashkë me emisionin e de Gaulle-it nga Algjeri «Parisi u çlirua. Kryengritësit i xbuan Gjermanët». Më 23-8 ministri Eden i dërgon përgëzime qytetit të çliruar dhe de Gaulle-it.

Më 25-8 radio e Llondrës njofton: "Divizioni i koracuar francesgjeti kundërshtim të fortë. Parisi është edhe, si më parë, në dorë gjermane". Më 28 radio Londrës njofton: "Gjermanët luftojnë édhe ashpër në qendër dhe në veri të Parisit".

Më 24-8 njofton radio Algjeri: "Trupat aleate sbarkuan në afërsit'e qytetit Bordeaux". Më 25-8 radio Londra bën të njohur: «Bordeaux u çlirua».

Një ditë më von njofton Kuartieri i përgjithëshmë i gjeneralit Eisenhower "lajmi i pushtimit të Bordeaux nuk është i saktë".

Më 24-8 zyra engleze e Reuterit shkruan: «Divisionet amerikanë pushtuan Lion dhe e ndanë më dysh armatën gjermane».

Më 26-8 komunikata e gjeneralit Maitland Wilson thotë: "Trupat t'ona ndodhen 50 km. lark Lyonit".

Kumtesa e Stalinit, më 25-8 thotë: «Armata e kuqe çkëputi, pranë Kishinevit 12 divisione gjermanë dhe i çkatërroi». Më 27 radio Moska: «Pjesët e tre divisioneve gjermanë u asgjësuan pranë Kishinevit». Pra nga të 12 divisionet u bënë 3.

Në të vërtetë, kumtesa e F. t'A. gjermane njoftoj se divisionet gjermane në Besarabi u bashkuan me pjesët e tjera të ushtërisë.

Shqiptarë! Ay që gënjen, e ndjen vehten të dobët. Ay që ka kuximin të tregonjë edhe të hidhurat, është'i fortë. Kumtesa e F. t'Ar. gjermane thotë kurdoherë të vërteta, qofshin këto edhe të hidhura, se Gjermanija e ndjen vehten mjaft të fortë sa të thotë të vërtetën. E vërteta fiton ashtu si do do të fitonjë Gjermanija.

Ne kemi llogaritur edhe me të tjera gënjeshtra. Por këto nuk do t'i ndryshojnë vendimet t'anë, se faktet e formojnë historinë dhe jo fjalët.

Banjë gjaku rreth de Gaulle

Tankset amerikanë vrasin mijra parizianë

Me rastin e hyrjes në Paris të gjeneralit de Gaulle, u shkakëtua një kasaphane e tmerrshme. de Gaulle, i cilli bashkë me Churchiltin dhe me Roosewelltin është shkakëtari kryesor për bombardimet e tmershme të popullatës civile franceze, më 25 gusht hyri në Paris, i mbrojtur prej një shumice tanksesh amerikanë. Mizëri njerëzish kishin dalë rrugëvet për të parë çfaqjen. Pjesa m' e madhe e këtyne ish plotë zëmërim kundrejt de Gaulle-it dhe Amerikanëvet të cilët i kishin kthyer në fushë lufte ngastra të mbëdha të Parizit, dyke u dhënë urdhër komunistëvet të Parizit të bënin një kryengritje kunder garnizonit gjerman. Rjedhjet e kësaj qenë të tmershme për popullatën pariziane, e cila kish vojtur aqë shum prej bombardimevet amerikanë.

Kur de Gaulle po kalonte nëpër sheshin de la Concorde, u dëgjua një pushkë, pastaj këtë e vasdduan të tjera nga të gjitha qoshet dhe bryjet. Ushtarët amerikanë i pushtoj tmerri dhe paniku. Ata shtinë me top dhe me mitraljoz si të marrë, midis popullit të tmeruar, që ikte nga sytë këmbët. U zhvilluan sqena të papërshkruarshme, të cilat i njoftoj, hollësisht, reporteri radiofonist amerikan, Gordon Fraser, në radion e Parisit më 26 të k. m. Me mijra gra dhe fëmijë u shtrinë nënë tanksel për të gjetur mbrojtje ndërsa kolosët e çelniktë amerikanë shtinin pa mëshirë midis popullit. Numuri i viktimavet edhe nuk është njoftuar saktësisht, por duhet të arrinjë disa mijra.

Kur u njoftua madhësija e kësaj thertorje, Amerikanët dhe de Gaulle u munduan t'a fshihnin. Pushka që ish zbrazur,

ndotla nga pakujdesia e ndonjërit u kthye në një atentat kundër De Gaulle. U qëllua kundër tij nga të gjith'anët! Në këtë mënyrë duan t'a zbukuronjë pakë pamëshirësinë e pashëmbëlltë dhe padishiplinën e Degaullistëvet dhe t' Amerikanëvet. Por sa e madhe duhet të jetë ashpërsija e Parisianëvet kundër «Çlironjësvet» kur bëhen të besuarshmë atentate dhe qitje të përgjithëshme kundër De Gaulle. Kjo banjë gjaku e Parisit do të mbetet, për Francën dhe për Evropën, një shënjë e re e vepravet të turpshmë të të ashtuquajturvet «Çlironjës.»

Shbiptarë, kini mëndjen!

Jo politik të lehtë rrugësh

Ç' na shkruhet këto ditë .
nga qarqe shpiptarë :

Me transportimin e disa trupavet që kanë karakter të lëvizjes ushtarake në luftë të plotë që ndodhemi, shum e shum mendjelehtë të kapërthyem prej atyne që bajnë politikë sokakesh, hapin fjalë se gjermanët po barten së këtejmi!

Para se të lodhin gojën dhe truet burracakët propagandista le të mejtojnë pakëz se ushtrija Gjermane e patundun ban prezencë gjithnji në Kretë dhe Dodekanisi! Pyesim këta burracakë se gjeografikisht ku ndodhen Kreta e Dodekanesi dhe Shqipnija? Gjermanët mbas Kretës dhe Dymdhetishujvet, lypset të lirojnë krejt Greqin, Maqedonin e mandej mund t'i vijë radha Shqipnis!

Mblidhni mendët e mos merrni në qafë vehten dhe fmijtë t'uej tue u kapërthye prej propagandësh që bahen me të vetmin qëllim të ju damtojnë.

Lëvizje ushtarake janë ba e do të bahen, dhe ju thomi caktueshëm se:

As edhe nji shqiptar, sado të zgjuet dhe politikan t'a mbajë vehten *s'asht në gjendje të kuptojë arsyenat dhe karakteret e vërtetë teknikë të këtyne lëvizjevet.*

Si e dishmojnë fakte të gjallë historikë dhe aktual, Gjermanija dhe gjermanët kurdoherë janë mundue dhe do të mundohen për të mirë dhe lumtëri t'atdheut shqiptar dhe të kombit që e përban.

Kanë dhanë kaq albanologë, kaq historjenë për gjuhë dhe kombin shqiptar. Të gjith popujt e Ballkanit kanë pasë mprojtsat e tyne: sllavët natyrisht nanën Rusi, plus të mbështetun dhe të përkrahun prej Ingliterës dhe Francës. Grekët gjithmonë e jetës prej Anglezvet. Po Shqiptarët? Për ta ka qenë gjithmonë Gjermanija me ish Austrin që sot përfshihet pazgidhmenisht mbrenda sojet. Mjafton të mejtohet për nji ças se cili Pushted kje ai që nguli kambë dhe kje faktueri kryesuer për krijimin dhe pavarsin e Shqipnis. Gjermanija pra nuk don që t'i hyjë ferrë në kambë shqiptarit pse asht populli ma i dashtun dhe i preferuem në Ballkan. Mblidhni mendët pra dhe mos shkaktoni me damtue vehten t'uej tue rrejtë se gjermanët po barten.

Deri sa të kenë marrë fund lufta me fitim të dejë dhe të merituesheëm t'armvet gjermane që njiherit do të jetë shpëtimi i përjetëshem i Shqipnis, s' i lot gja prej visevet balkanike për pa u la gjithshka me gjak.

Kamxhiku i Moskës mbi Rumani

Rusija sovjetike kërkon nënshtrimin pa kushte

Qeverija kombëtare rumune njoftoj kushtet e kapitulimit që iu parashtruan Rumanisë nga ana sovjetike. Këta kushte përmbledhin 13 pika, prej të cilave cilado ka prirje t'a hedhë vëndin në vështirësina të pakaluarshme dhe t'a çkatërronjë.

Pika e parë cakton se ushtërija rumune lejohet të mbanjë armë gjer sa të marrë funt lufta në Transilvani. Rusija sovjetike kërkon, pra, ndihmë të armatosur kundër Ungarisë dhe mundohet, njëkohësisht, t'a ngjallnjë përsëri grindjen e vjetër ballkanike midis fqinjëvet dhe sa të jet'e mundur më shpejt. Pika e dytë e ve ushtërinë rumune nën komandën ruse,

Pika e tretë kërkon punën e njohur skllevërish, atë që kërkon Moska prej të gjithë popujvet evropjanë, d.m.th. 1.400.000 punëtorë dhe 100.000 specialistë teknikë, fati i të cilëvet do të ish po aqë i errët dhe i hidhur sa edhe ay i të tjerëvet që janë dërguar, gjer sot, në Rusi.

Pika tjatër përbën atë mengenen' e njohur, me anën e së cillës arrihen të gjithë ata kërkime që, në bazë marrëveshjeje, nuk munt të publikohen. Kjo pikë e bën të mundëshme kthimin e robërvet rumunë vetëm at'here kur të plotësohen, prej Rumunëvet, të gjitha sa kërkon pika tri. Kësisoj Rumanija munt të priste tërë jetën për kthimin e bijve të saj robër, se Rusija do të gjente kurdoherë shkak të të ankohesh për punën e kryer prej punëtorëvet skllevër, dyke thënë se ata nuk e kishin plotësuar, si duhej.

Në pikat e tjera vendoset bashkimi me Rusinë sovjetike i Besarabisë, i Bukovinës dhe Dobruça veriore. Veç kësaj, Moska pretendon edhe kontrollin e navigacionit mbi Danub dhe mbi të gjitha pikëmbështetjet e Rumanisë në det, në tokë dhe në ajr. Përkundrazi, mbetet e hapur pyetja se sa i math duhet të jetë tributi i Rumanisë, për të pasur, me këtë, darën në dorë për kërkime të tjerë.

Me të drejtë shkruan gazeta sviceране «Basler Nachrichten», për të cilën nuk munt të thuhet se është mike e Evropës së re, është një çmëndësi, për çdo shtet, të presë, nga Rusija sovjetike, kushte armëpushimi të tillë, pas të cilëvet të drejtohet lirisht. Se kushtet e Moskës janë: kapitulim pa kushte, kapitulim pa kushte, kapitulim pa kushte dhe çdo të thotë kjo në të vërtet, e shohin të gjithë popujt, me kjartësin më të tmershme, në shëmbullën e Italisë. Prandaj shteruan mundimet anglosaksonë për të mbrehur, në karron e tyre luftarake, satelitë të tjerë, se fundi i këtyre rroleve, për çdo popull, do të thotë vetëm një gjë: Nënshtrim, pa ndihmën më të vogël, nën kamxhikun sovjetik.

Ku janë fëmijët e rrëmbyer prej Rusëvet?

Anijet e Moskës te ngarkuara me «skllever» édhe s'po arrijnë

Lajmërohet nga Moska arrijtja e së parës anije nga ato, mbi të cilat ishin ngarkuar fëmijë italjanë të rrëmbyer, si skllevër të bardhë, nga Atdheu i tyre dhe të nisur për në Rusin Sovjetike.

Lajmi i arritjes së kësaj anijeje vërteton, plotësishit, parashikimet t' anë të tmershmë që ne kishim çfaqur, radhë pas radhe, mbi fatin e fëmijëvet italjanë, passi, në lajmërimin përkatës rus thuhet se anija në fjalë u vu në karantinë se pse brënda në' te zjente tifua, kolera dhe të tjera sëmundje.

Por ma i tmershmë është fundi i lajmërimit rus: ay thotë se nuk dihet gjë fare mbi fatin e anijevet të tjera, të nisura, nga Italia, më von se kjo e para.

Prapa këtyne radhëve të pakta fshihej diçka e tmershme: Edhe mbi anijet e tjera do të kenë plasur sëmundje çfarosëse dhe Moska do t'a ketë pasur mjaft një anije të molepsur, prandaj do të ketë dhanë urdhër që ngarkesa e anijevet të tjera të përdorej më ndryshe nga ajo e së parës! Dhe çgjë ndoth në det, nuk mund të kontrollohet aqë lehtë. Kësisoj, marinarët e anijevet të tjera ruse do të kujdesohen, në interesin e tyre shëndetësor, që fëmijët e cikur prej sëmundjesh dhe, mbi të gjithë, ata që çfaqen si të dyshimtë për një të tillë, të çduken nga anijet me një mënyrë fare të thjeshtë: dyke i dërguar atje, prej nga s'kthehet më njeri kurrë.

Nga Parajsa sovjetike e Kryekomitit Tito

Shtim i padishiplinës — Ç'tregojnë desertorët e shumtë

Kryetari i çetave Jozip Broz ka halle të medha. Grushtet e tmersheme që kanë ngranë rrogtarët e tij të rekrutuemit me pahir gjatë javëve të kalueme, i kanë dhetue çetat e tija dhe e çthuren dichiplinën e tyne.

Prandaj dha urdhën ai që oficerët e tijë të marrin të njajtin ushqim sikunder ushtarët. Porse oficerët e Titos qeshën me të sadoqi ata me ketë urdhën duhet t' ishin prekë në mënyrë të ndijshëme. Pse, sikunder dishmojnë dezertorët me thanjet e tyne, ata marrin perveç ushqimit të mirë që gatohet apostafat për tà edhe ushqimin e keq t' ushtarëve të zakonshëm, do me thanë nji shtim n' ushqim, të cilin o e kaperdijnë vetë o u a falin të tjerëve per sherbime private.

Shtresa oficerësh apo municion?

Nji urdhër i dytë i Titos që u gjet tek nji bandit i vram illustron shperdorimet në radhët e bandave.

Ky urdhen cakton se kafshët bartëse nuk janë për me transportue shtrojen dhe mbule sat e oficerëve, porse duhet të bajnë të plagosun municionin dhe nozullimet. Kështu duket në të vertetë baracija socialistike në mbretnin titojane për hir të Moskës.

Nuk ka kafshë bartëse per transportimin e të plagosunve, mbassi këto kafshë duhet të bajnë shtrojet e oficerëve.

Moska ka çpik mjaft rrena të bukura për me u hjedhë pluhun në sy atyne, qi nuk kanë qef të mendojnë ma gjatë. Por kush luftón në rradhët e çetave asht i shternguem me i hapë syt per me mujtë me pa.

Pjestarë të aratisun prej radhës së bandavet dijnë të këndojnë një kangë në lidhje me ato gjana. Kështu Mirco Anic, i cili më 26 të Qershorit në Glamoc tue ikë prej bandave erdhi tek gjermanët, njoftoi për sa vijon: «Bukë s'ka pasur ma. Bujqit qysh fash kanë mbetun pa mjete të mjaftueshme ushqimore, Në dimër ata janë kërcnue të gjithë të vdekjesin urijet.

Michael Mitrinovic prej Bijelina tue u arratisë prej radhës se bandave, njoftoi përsa vijon: «Të sëmurët randë e të plagosunit randë çduken, d.m.th. se ata i vrasin e mandje i mshefin nën dhé».

Në Turovac më 17 të Qershorit Jovo Ostojic që iku prej radhës së bandave njoftoi për sa vijon: «Komisarët politikë kanë qënë të pajisun me mitralozë dore, me të cilët na kërcnonin përhera. Pakënaqsija ka qënë e madhe. Vetëm roja e bamë me kujdes të math prej t'ashtu-quajtunve luftarë të vjetër ka mujt me pengue shumë orvajtje për aratisje të bamë prej banditvet».

Një përshkrim të pa disiplinës njerëzore që sundon në radhët e bandavet e bani Hasan Alivodiçi, i cili më 3 të Qershorit në ishullin Brac u aratis prej bandave dhe erdhi tek gjermanët. Ky tha: «Në kompaninë t'ime kanë qënë edhe 20 luftëtare. Ato qenë veshur si burra flokët i kishin qethun dhe e kishin lidhë gjoksin e tyne me nji shami, në nji mënyrë të tillë që nuk dukeshin aspak si gra».

Ata kanë ndër mënt Panslavizmin

Kështu qëndron gjendja ne radhët e rroktarëvet të Tito-s. Moska tash e vuni njiherë në plan për me i shpërdorue njerzit dhe për me i a u vjedhë lirin dhe pasunin. Flet për puntorë dhe mendon robët, flet për liri dhe synon panslavizmin. Flet për popuj ballkanas të shtypun dhe synon sundimin sovjetik mbi popujt e vegjël. Flet për çlirim dhe grabit drithin e baglin. Fjalë të bukura për me mshef qëllime kriminelë.

Pohimet e një oficerit sovjetik

Moska don të sundojë botën

Nga burime rumune lajmërohen deklaratat e nji oficeri sovjetik i zanun rob në ballin rumun. Ai ka dekllarue ndërmjet të tjerash: «Në qoftë se na do të mundemi me fitue luftën kundra Gjermanis, do t' ia fillojmë luftës kundra Anglis, pse ajo asht çerdhja e intrigave të vjetra e se mund të lëvizi nji revolucjon si revolucjoni bolshevik. Në t'arthmen nuk do t'ekzistojnë veçse dy fuqina të mëdhaja dominuese mbi botë, nji për zdo hemisfer: Shtetet e Bashkueme dhe Bashkimi i republikave Sovjetike. Anglija nuk do të bante tjetër veçse me ngatërrue. Pikërisht për ketë arsye na do t'a shdukim

---

Në një urdhër dite drejtuar Ushtëris filandeze, Presidenti i ri, Marashali Mannebeim deklaroj: Lufta për eksistencën t' onë. dhe për njëjësinë kombëtare të popullit t'onë vashdon me fuqi të pa pakësuara.

*

Nër luftimet e ballit të Karelisë, trupat finlandeze shpartalluen dy divisione këmbësorije ruse. Në këtë mënyrë, plani i Sovjetëvet, për t'a rrethuar ballin finlandes, dështoj plotësisht.

Britëm tmerri prej qelis së burgut

Auktori i këtij artikulli ingjenieri B. Podgorski që u aratis prej Bashkimit Sovjetik paraqet ndodhje të tmerrshme prej periudhës të gjatë që kaloi ai tue vuejtë në burgjet e njohur botërisht të GPU-së.

Porta e hekurt u mbyll prapa meje dhe unë u gjinda në banesën t'ime të re në qelinë e vetmueme Nr. 169 të burgut në rrugën Spalernaja.

Ka ndodhë në Marsin e vitit 1935 kur banorët e Leningradit dridheshin tue kujtue se kush ka me qënë ai që ma së afërmi ka me u arestue si i implikuem në vrasjen e Kirov-it, diktatorit të popullsis së Leningradit dhe anëtarit të përhershem të zyrës politike dhe të instancës ma të naltë të vendit. Kumtesa zyrtare tha se Kirov ra viktimë e nji grupi terroristik që vepronte mbrenda gjirit të partisë. Me gjithë këtë shumë veta, të cilët s' kanë pasur asnji lidhje me partinë, ndër ta edhe unë «pësuam torturat në rjedhim të rapresarjeve Kirovjane».

Ka qënë ora nji e natës. Unë u çvesha shpejt dhe rashë me fjetë në shtratin t'im të burgut që ishte i qelbët. U zgjova përnjiherit prej nji britme që erdhi prej së joshtmi. Si dnket rojet e burgut kishin prurë ndonji tjetër të burgosun dhe e futën brenda në qelinë qe ishte afër s'imes. Unë po përgjonja. Celsi i derës u kthye ë mandej gjithshka ra në qetsi.

Pa pritmas ndjeva unë disa trokitje që mezi dëgjoheshin në murin që më ndante mua prej fqinjit t'im. Këto trokitje më ishin të njohtuna qysh kur ishja në burgun e Nischergorockit. I shqetsuem e tue përgju ndigjova pyetjen: «A ka njeri këtu?» Unë u përgjegja dhe vijova me përgjue: « E di që s'kam me mbetë në jetë. Torturat janë të tmershme. Unë jam i pafajshëm veçse di shumë. Unë jam Katalymovi».

Unë e dijshem se Katalymovi qe nji ndër sekretarët e Komitetit krahinor të shoqnisë së rinisë komuntste dhe nji ndër krenat e implikueme në çashtjen Kirov. Asnji prej nesh s'ka marrë pjesë në vrasje. Vrasësi, Nikolajewi kishte marrë udhëzime prej Moskës. Stalini e mëninte Kirow-in. Nikolajew-i asht mik i Poskrebyschev-it, sekretarit privat të Stalinit. Nikolajew-i s'ka të bajë aspak me opozitën. Unë kam që kam për me vdek pse s'mund të duroj ma. Ndigjojeni ju të vërtetën.

Civila të masakruar prej Bollshevikëvet n' oborrin e njëj burgu të GPU-së.

Trokitja u pre. U çel dera e qelisë së fqinjit. Prapa u ndigjue nji za i mbytun, e mandej rifilloi qetsija.

Katalynov-i gjatë 48 orëvet vijuese nuk u kthye ma, mandej natën ndigjova unë prapë britma të mëdha dhe zhurmën e krismat e kujdestarëvet të burgut. Mbas gjaset Katalynov-i orvatej për me shpëtue: «Ku janë dhambët e mija, ku asht syni i em?»

Disa kujdestarë burgu të frikuem prej shqetsimit erdhën ke dera e qelisë. Tek dritarja e vogël e qelisë së Katalynov-it, nëpër të cilën jepet ushqimi filluen me trokitë me të fortë. Dritarja me kapakë u çil. Mandej u ndien goditje. Pa pritmas briti Katalynov-i: «Mbyllnie Stalinin në qelinë t'ime!» E mandej vijoi britma pa pushim: «Mbytlnie Stalinin në qelinë t'ime!» Dera u çil dhe kujdestarët hynë mbrenda në qelinë e të çmendunit. Prapë u ndigjuen goditje dhe nji britëm e mbytun, mbassi i kishin vue fytyrës jastëkun: «Mbyllnie Stalinin në qelinë t'ime!»

Mandej u ndigjuen rrënkime, xvarisja e robit për në hajatin e burgut dhe prapë goditje. Ma në fund e muernë dhe e çuen. Hapat filluen mos me u ndie dhe filloj me u bamë ma e heshtun britma: «Mbyllnie Stalinin në qelinë t'ime!»

Mandej ra qetsija e plotë. Nga pragu i derës së qelisë s'ime filloi të rjedhi nji vijë gjaku prej të çamjeve të derës brenda në qelinë t'ime.

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Hënë 4 Shtatuer 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 24 - ÇMIMI 1 LEK

Shqiptar, ç' rrugë ke marrë?

Çfaqjet e kohës tregojnë, kjartë, qëllimin në luftën e fatit t' Evropës

Ndër këto ditë vendimtare duhet që çdo shqiptar t'i lerë më nj'anë pasjonet dhe t'a gjykojë me gjakftohtësi gjendjen e sotëshme të Shqipnis në Ballkan. Shqiptar, hiq dorë prej illuzioneve dhe vëreji mirë faktet!

Cilët janë këta fakte?

1) Aleatët e trathtuan përfundimisht Polonin tue e dorëzue te Sovjetët. I nxitën nacjonalistat polakë në Varshovi që të çojshin krye. Churchilli u tha se të gjithë kryengritësit në luftë kundra Gjermanis mund të shpresojshin në ndihmën e tij Ai gënjeu. As Churchilli as Sovjetët nuk u dërguen ndihma. Polonezët u asgjasuan mbrenda pak ditëvet.

2) Aleatët gënjyen mbretin e ri të Rumanisë, sikundër edhe ma parë mbretin Pjetër të Jugosllavis që të shkëputej nga Gjermanija. Mirëpo Sovjetët nuk e njoftën armëpushimin e Rumanisë, dhe i muerën robë rumunët, të cilët, simbas urdhnavet të mbretit dhe tue shpresue në premtimet e aleatëvet, i ulën armët. Sekretari i Shtetit amerikan Hull deklaroj trathëtisht në Washington: "Regullimi i çashtjes rumune i përket vetëm Moskës. Na s'jemi informue zyrtarisht mbi vendimin e Rumanisë".

Kështu Rumanija u tradhëtua prej anglo-amerikanëve.

3) Aleatët kërkuan prej Bullgarisë kapitullimin pa kushte. Bullgarija asht e detyrueme me i marrë këto kushte prej Kajros. Por para se me ndodhë kjo gja, Stalini deklaroj zyrtarisht: "Qeverija Sovjetike e pranon deklllaratën e neutralitetit Bullgar". Moska nuk çan kokën për kushtet e aleatëve. Ajo don një Bullgari sovjetike me kufij sa ma të gjana.

Shqiptarë, a i shifni ndryshimet që sjell koha?

Kush i ka njoftë aq solemnisht kufijt e sotshëm dhe pamvarësin e Shqipnis?

Vetëm Gjermanija.

Kush ju mbron prej anmiqve t'uej, kush po ju jep armë dhe kush po e stërvit divizjonin Skanderbeg?

Vetëm Gjermanija.

Kush asht tue ba sot luftën e Europës dhe të popujve të vegjël kundra Rusis Sovjetike të pangopun?

Shqiptarë, bashkohuni dhe merrni shembull prej këtyne ngjarjeve. Nuk ju ndihmojnë dasinat e brendëshme as intrigat e mbrapështa, por bashkimi me Kosovë në luftën e përbashkët kundra armiqvet. Nuk asht e mundun me mbajtë gjithmonë dy lugë në bres. Duhet me hangër vetëm me nji lugë, në qoftë se nuk doni që të mbarojë Shqipnija.

Kritike kunder Roosewelt

Dorothy Thomson gjen një "qime në çorbët,,

Qarqet seriose të Shtetevet të Bashkuar, po e shohin, gjithënjë më kjartë, se politika e Roosewelfit po shpije në një kaos të përbotëshmë. Ata nuk e shohin më të nevojshme t'a mbajnë të fshehtë se një fitim tvalotë vet anglosaksonë-bollshevikë mbi Gjermaninë dhe Japoninë do ta shpinte botën në një luftë akoma ma të përgjakshme dhe më asgjësonjëse se kjo e tashmja.

Dorothy Thomson pohon, në «Cleveland Plain Dealer» organ i të besuarvet të Shtëpis së Bardhë, me një cinizmë të pakaluashme, se një fitim i Washingtonit dhe i Moskës nuk do t'i xgjithte, në as një mënyrë, problemet e botës, por, përkundrazi, do t'i ngatërronte më tepër. Ç'gjë i mban sot të bashkuar aleatët, pohon fletorja në fjalë, është vetëm frika nga Gjermanija. Me përjashtim të kësaj, konstaton tletorja, politika e shtetevet anglosaksonë-bolshevikë duhej të sundohej prej një frike të madhe të së arthmes.

Kujdesi m'i madh i të beslidhurvet Anglo-amerikanë është se si do t'u pritet hovi Sovjetëvet, kurse kujdesi kryesor i Unionit sovjetik është të mos u lerë Englezëvet as një influencë n'Evropë.

Pastaj politikanja amerikane thotë, me një kajtërsi të habitëshme, se përpara njëj gjendjeje të tillë dhe me rrastin e një fitimi nga ana e bashkimit anglosaksono-bollshevik, nuk èsht' e mundur të evitohet një tuft' e re, ashtu si e parashikon edhe vetë Roosewelti. Kjo luftë e dytë midis kontinentevet do të mbaronte me qytetërimin perëndimor.

Është për t'u shënuar, thotë Dorothy Thomson. që Amerika flet gjithënjë për realizmë, ndër sa i tërë njerzimi gjendet në rrugën e vetvrasjes kolektive. Sidoqoftë, Dorothy Thomson nuk nxjer asnjë përfundim nga gjykimi i saj, dhe nuk di ç'të propozojë, veç se nënshtrimin e Washingtonit dhe të Llondrës nën politikën sovjetike.

*

«Folkets Dagbladen» lajmon demostrata të mëdhaja antiçifute në Quebec të Kanada-s, ku ndër te tjera iu vu zjarri edhe Sinagogës.

Finlandija në vitin e pest të luftës

Vepra në vend të lajmeve të gënjeshtert - Beteja midis pyellit

Mbas ngjarjeve politike të fundit në Finlandë në lidhje me emnimin e presidentit të republikës e me formimin e qeveris së re, shtypi finlandez ra në nji qetësi të tille qysh prej disa ditëshë sa që shtypi i vendeve perëndimore lajmet e gënjeshtërta njëra mbas tjetrës i trillon vetë të cilat natyrisht mbas pak kuptohen sheshit se ishin trillue, ishin marrë prej ajrit. Kështu u trilluen sa e sa lajme në lidhje me nji lajm të botuem në Svedi mbi një mbledhje të fështet të Parlamentit finlandez.

Natyrisht permbi një mbledhje të tillë nuk mund të bahej fjalë mbasi Parlamenti finlandez zakonisht mblidhet gjithnji kah mezi i javës e mandej perfaqësuesat ikin me të shpejtë ndër shtëpijat e tyne per me u dhanë mbas punës bujqësore që si të gjithë banorët e tjerë të këtij vendit bujqësor të marrin pjesë edhe këta e të ndihmojnë në punimet pregaditore të korrjes. Per një korrje që populli finlandez ket vit ka një randësi shumë ma të madhe se sa në vitet e tjera.

Ngjarja ma e madhe qe këto ditë për popullin finlandez, të cilen ky popull e regjistroi me sodisfaksjon e me kreni të veçantë, beteja e zhvillueme në pyjet e Ilomantsi ku permbi dy divizjone sovjetike u asgjasuen dhe ku edhe nji herë u shkelqye taktika finlandeze e rrethimeve të bame qysh në kohen e luftimeve dimnase.

Dhe sa të gëzuem janë finlandezët per ket sukses kaq ma pak pjerrin ata per me mbi çmue ket sukses të randësishem. E dijnë mirë të gjithe se prova të reja të randa kanë me ardhë të cilave vetem me frymen e re të përbetimit të luftës të dimrit me frymen e re të luftës së verës së 1944 mund t' u bahet ball. Bash edhe gazetat finlandeze të provincave që shpesh janë ma të qarta dhe ma substancjale se sa ato të kryeqytetit dhe qi pasqyrojnë ma kjartë pikëpamjen finlandeze tash kanë marrë një qëndrim të matun në lidhje me betejen e zhvillueme n' Ilomantsi. Nderkaq asht fakt se nuk mund të perçmohet efekti që ushtroi ky sukses në rritjen e moralit të popullit finlandez.

"He 177 „

Aeroplan i ri gjerman katermotorsh

Arma ajrore gjermane që deri sot ka pasë vetem aeroplanë luftimi dymotorsha për të kryer bombardimet në vendet e largëta, tash po ve në veprim edhe aeroplanë të tillë me kater motora. Në gazeten e ushtarëve që botohet me titullin "Front und Heimat,, publikohen fotografinat e para të marruna permbi aeroplanin e ri me kater motora të typit "He 177,,. Këta aeroplana të rij kanë kohë që kanë marrë pagëzimin e zjarrit n' Angli.

Aeroplani i ri i typit "He 177,, të cilin ushtarët e kanë pagezue "Greif,, ka kater motora prej 2400 kuaj fuqi, të cilët janë të rrjeshtuem njeni mbas tjetrit dhe prej të cilëve njeri terheq e tjetri shtyn. Kështu ajrori ka pamjen e njij bombardjerit dymotorsh dhe krahet e tij janë 32 metra të gjatë. Ky ajror i ri mund të mbajë nji barrë të randë bombash e me gjithë këtë fuqija bajtëse e tij e vertetë formon ende nji sekret të ruejtun me kujdes të math.

Terror bandash në Kroaci

Fëmij te mitun kapen dhe treten

Shtypi i Zagrebit shenon me indinjate se, si u lajmue nga thanjet e të hikunvet e të banditeve të zanun rob, janë kapë perdhunisht në krahinat e Moslavatka Gora, Psunj e Papuk fëmij deri katermbëdhetë vjeç prej kryetarve të çetave dhe janë dergue në Sicili me anen e ajrorëve anglo-amerikane.

"Hrvatski Narod,, shkruen për kete gja: Bolsheviket pra kapin dhe tresin femij të pafaj kroate për me i ba vegla qorre për planet e tyne revolucionere dhe anglo-amerikanet jo vetun qe e durojnë këtë gja, por u ndihmojnë athue se revolucioni botnuer bolshevik nuk do ti zatesi edhe vendet e tyne. Dhe ky krim qi nuk asht pa deri me sod në historin e botës bahet në shenjë të "çlirimit,, si mbas parimeve e methodave demokratike: Çka do të ndodhte, në qoftë se reziku bolshevik do të merrte sundimin mbi ne? Reakcioni i ynë kundra këtij atentati kriminel asht vetun ky: Luftë për mbrotjen e liris s' onë deri në fund,,

Gjurmat e sulmit sovjetik në Baltik

Ja, në se janë kthyer, prej Bollshevikëvet, qindra shtëpi bujqrish në nisinë Oesel. Por vullneti ndërtonjës i Estonezëvet mbetet i pa thyer.



Gjermanija në shërbim lufte

53 përqint më pak

Munges prodhimi lufte n' Amerikë

Ministrija e Luftës së Shteteve të Bashkueme u jep plotsisht të drejtë qarqeve të ndryshme, qi janë tue pasë kujdes të math për zbritjen fatale të produkcionit luftarak në shtetet e Bashkueme. Ky konstatim asht ba në komunikatën e ministris së luftës, e cila ja ban me dijtë komisionit të posaçëm të diktimit me anë të General majorit Lucius Clay.

Në këtë komunikatë me të vërtetë se i ngjeshet produkcionit luftarak në përgjithsi predikati "shum mirë,, por për njiheri vihet në dukje zbritja fatale n'armatime gjatë muejit korrik. Ramja e produkcionit n" armatime deri me 53 përqind të materialit të ndryshëm, qi nevoitet shum, shkakton shqetsim të math. Asht frika se në muejin gusht, kështu thuhet në komunikatën zyrtare, zbritja në produkcion do të jet edhe ma e madhe.

Ministrija e luftës ia ven fajin sidomos mungesës së punëtorëve, lodhjes në punë e në luftë si edhe lajmeve të pa vend të luftës për këto ngjarje.

Terror në Letlandi

Vriten gra dhe fëmijë

Si deklaron "Helsinkin «Sanomat„ një gazet finlandeze me rëndësi, terrori bollshevik kundër popullsis civile nër tokat letuanëze te pushtuara prej Sovietëvet, po bëhet gjithënjë m'i pamëshirëshmë. Në Luadon u vranë, më 6 gusht, 630 veta, në shumic gra dhe fëmijë. Sicilido që nuk i bindet me një herë, urdhërit bollshevik, vritet në vënt, shpejt e shpejt.

"S'kisha pësuar kurrë nonjë gjë të tillë„

Përshkrime të njëj Riviste Amerikane mbi armën V. 1.

Rivista amerikane «Time» përshkruan, në një mënyrë çuditërisht të hapur, gjendjen shpirtërore të londinezëvet, të rrahur, pa pushim, nga V. 1.

Arma «V. 1.» është bërë një barrë e paduruarshme për të tetë milionët e Llondrës. Asnjeri nuk fle më aqë sa duhet. Nervat me zi mbahen. Tashti e dinë edhe Londinezët që bombat fluturonjëse janë shumë më të këqija se sa të gjithë sulmet ajrore që munt të kenë pësuar nonjë herë Englezët. Nervat e tyne janë tmerësisht të ngrehur dhe, më keq se kurrë. qenë javët e fundit, nër të cilat bombardimi vashdoj 14 orë rjesht dhe pa as më të voglën ndërprerje. Por vështirësija m'e madhe për Londinezët është fakti që nuk munt të parashikohen qitjet. E tmershme është fuqija plasëse e bombavet fluturonjëse. Rrezikun më të math duket se e përbejnë ciflat e xhamevet. Prandaj njeriu qëndron më mirë rrugëvet dhe, sa të jet'e mundur lark xhamesh. Një milion Londinezë janë larguar, zyrtarisht, nga qyteti. Në të vërtet, janë më tepër, se mijra e kanë braktisur qyteiin me vullnetin e tyre dhe zyrat përkatëse s'kanë mundur të bëjnë statistika ekzakte.

Heshtja në qytet bëhet gjithënjë m'e madhe. Radhët e gjata përpara tregëtorevet ushqimore janë bërë më të shkurtra, pjesërisht, janë xhdukur fare. Nër restaurantet dhe nër lokalet e natës ka prapë vënt të lirë. Natën mbushen përsëri vëndet e mbrojtjes, si në kohët e vjetra të luftës ajrore të vjeshtës 1941.

I tërë qyteti flet vetëm për «V. 1.» që në mëngjes e gjer në mbrëmje. Të tjerë bisedime po thua se s'ndihen fare. Edhe vetë lajmet nga Franca e nga frontet e tjerë të luftës s'janë më interesant. Ka rëndësi vetëm pyetja: «si do t'a kalojmë edhe një ditë me V. 1.?» Në fillim kërkuan të talleshin me V. 1. dhe t'i ngjitnin një mbiemër. Por kjo shaka mori funt shpejt, se puna qe serioze. Humori shkon gjithënjë dyke u pakësuar. Ka gjithënjë mungesa personeli nër zyra dhe qendra punimesh. Nëpunësit dhe punëtorët me zi çfaqen.

Popullsija e këtij qyteti mbahet vetëm prej kësaj fryme: Ah, sikur t'a shtynja orën më përpara, që të arrinja fundin sa më shpejt. Londinezi munt të «mbanjë» akoma, por edhe ay vetë e di se është pranë asaj që ay munt të duronjë. T'a themi hapur, ay është mbushur gjer në grykë dhe me zi mbahet!

Vërejtës në bregdetin jugor t' Anglis thonë se nuk kanë pësuar kurrë nonjë gjë të tillë. Qitjet «V. 1.» dërgohëshin aqë të shpejta m'at'anë, sa ushtarët englezë të mbrojtjes kundrëajrore nuk kishin ngeh të mernin as frymë. I tërë ajri ish mbushur me bomba të tilla.

Fjale te bukura ne vend te bukes

Mesazhi i Churchillit drejtue italjanve

Kur Churchilli e la Italin mbas një qëndrese të gjatë, i drejtoi ay popullit italjan ket mesazh: «Unë besoj se kombi englez do të jetë i lumtur të shohë ditën, në të cilën Italija një herë të marrë vendin e lirë e të përparueshëm ndër kombet qi do të rrojnë».

A mund të përfytyrohet nji cinizëm më i vrazhdë se ky?

Ç'ka nuk i ka premtuar Churchilli Italis me rastin e një kapitulimi? Dhe si qenë mbasandaj kushtet e armpushimit? Dy miljonë puntorë italjanë si skllavë t' aleatëve, prej të cilëve 800, 000 për të mos u parë më kurrë të dënuar me vdekje në Bashkimin Sovjetik. Humbja e të gjitha kolonive, detyrime të tmerëshme lufte, shkatërrimi i urave, i rrugëve dhe i vendeve më të bukura turistike prej anës së bombarduesve anglo-amerikanë.

Churchilli i pa turmat e grave e të fëmijve t' uritur n' Italin e Jugut. Ay pa mjerimin e tmerëshëm në Romë, si dhe mjerimin edhe më të math në vendet e tjera të shkatërruara. A pruri mjete ushqimi? A dha ky barna për të sëmurë? Kurgjë nga këto. Fjalë të bukura në vend të ndihmës. Burri që shtyu Polonin në luftë me garantit e veta dhe në vend të tyre i hodhi polakët në skëterrën sovjetike, mashtroi edhe Italin e Badoglios e cila u besoi premtimeve të tija.

Në fushën e rrenuar t'Italis shkon hapi i këtij shkatërruesi t'Europës edhe më tutje duke kaluar nëpër shkretimet e Francës deri sa t'i vijë ora dhe ati.

Sulm kundër procesioni

Terror komunist në Romë

Në Romë u xhvillua një përpjekje midis një parakalimi komunist dhe një procesioni katholik. Komunistët, midis tyre shum gra, po kthehëshin nga një mbledhje, nër të cilën kish folur udhëheqësi komunist Togliatti për "idealin e ri të gravet,,. Procesioni, që përbëhej në pjesën më të madhe prej vajzash, arrijti përpara kishës së famëshme Maria Maggiore.

Në një nga kryqëzimet më të mbëdhej të rrugës Via Nazionale u bë një kacafytje e vërtetë, në të cilën gratë komuniste u hodhën kundër procesionit, u rrëmbyen pjesëtarëvet të këtij qirinj dhe kurora dhe filluan të tallëshin e të përqeshnin hymnet religjozë.

Admirimi për Gjermanin

Një Tyrke flet mbi forcën gjermane

Ne nji interviste, qi dha artistja tyrke Adalat, qi për shum kohe ka qendruar në Berlin dhe tashti është kthye në vënd të vet, fletores stambuileshe «Son Posta», thuhet se populli gjerman asht plotësisht i bindur në fitoren e fundit edhe ne të pestin vjet të luftës.

Me admirim të math foli Adalat për procedimin e madh të punës të popullit gjerman për të cilën janë mobilizue i math e i vogël. Cdo njeri në Gjermani ban sod detyrën e vet. Gjendja ushqimore në Gjermani asht çuditerimisht e mirë megjithse ashtë luftë. Artistja mandej pati fjalë të këqija për sulme terroristikë anglo-amerikane mbi qytetin e Gjermanis.

Humbjet e Sovjetëvet, gjatë dhjet ditëvet të fundit të ofensivës së tyre të Verës arrijnë, të paken, në 534 tankse dhe topa sulmi, 503 topa antiajrore dhe në më tepër se 100 topash të tjerë, kalibri të ndryshmë.

Marija, vajza e Caen-it

Me zor Marija iu qe larguar gërmadhave të Caen-it.

E edukuar në një jetimore, në fillim u-regj në bombardimet e para të armikut në Caen. Porse ditën para se të invadohet Caen-i, kur u hothnë me tonelata gjyle dhe mjete plasëse mbi qytet, u shkëput prej rethit të saj ku ishte mësuar. Me mijra qytetarë kishin gjetur vdekjen. E tmeruar ishte futur Marija në një bodrum ku hante vehten e saj nga tmerri dhe sytë e saj të llaftarisur shikonin pamje të tmershme. Fjalët i mbetnë menjëherë, krahët i u prenë dhe sytë e errëta të saj u veshnë me shënjën e ethevet. Nuk bënte zë fare, pastaj u qetësua një farë soji, mbassi i qe larguar pamja e tmershme ngä sytë — kjo mundohesh tash t'iu përgjigjesh dhe t'i qetësonte të klithurat dhe të bërtiturat e të goditurvet nga plumbat, deri sa një detonacjon i ri i përplasi baltë e pluhur përpara dhe për një çast pushuan të çirurët e njerzvet. Më pas ra në një te qarë të pareshtur, dhe pushoj vetëm atëhere kur në qytet kishte hyrë heshtja e vdekjes, dhe ishte bërë një varr për 15.000 francezë.

Se sa ditë kaloj duke i ndihmuar vullnetarisht të plagosunvet që ndodheshin nëpër gërmadhat, nuk mund t'a mbante mënd. Në veri të qytetit ndodheshin ushtarë gjermanë në luftë me trupat e invaduara. Divizionet sulmuese kaluan nga rrëza e qytetit Caen nëpër pyjet drejt veriut. Qyteti vetë nuk u bë zonë lufte, por me gjithë atë u bë objekt i sulmeve të rënda e të shumta të artileris anglo-amerikane. Vetëm një pakicë prej banorëvet mundi të merrte arratinë. Gjakderdhja bëhej gjithënjë më e tmerrshme. Asnjë flamur i bardhë përmbi karron e dorës dhe asnjë shami e bardhë përmbi kryet e të ikurvet nuk i ndalonte plumbat e aeroplanëve të armikut.

Ajrorë armiq qëlluan me mitraljoz popullsinë civile franceze.

Marija përpiqesh si ndihmëse e pa-lodhur të ndihmonte ata që nuk ishin në gjendje të mernin me vehte ndonjë plaçkë; ajo u pregatiste ngrënjen këtyre të mjerëve, kështu që u ishte bërë e pa-evitueshme, duke qëndruar atje dhe kur vija kryesore e luftimit gjerman u spraps në jugë të qytetit, ku englezët po sulmonin pa pushim. Tash Marija menjëherë nuk qe më ajo vajza e vogël trime që nderohesh prej secilit dhe që ndihmohej prej personelit të sanitetit gjerman, po kishte mbetur në dorë të «shpëtimtarëvet» që e kishin «çliruar» sakaqë nga çdo mjet që kishte për të lidhur plagët, të cilët e «çliruan» nga ajo detyra e shenjt, që ajo kishte zgjedhur me vullnetin e saj dhe në vend të kësaj i bënin oferta edhe më «të bukura».

Marija u aratis nga «çlirimtarët». Ajo brodhi me të shpejt, e brengosur siç qe, nëpër shpella e gërmadha deri sa mbriti në vijat gjermane, ku tregoi lajmin e parë të trishtuarshëm. Më pas, mbassi i qe qetsuar shpirti i saj e njomë prej pësimevet të hidhura, tregonte fjalë për fjalë ç'i kishte ndodhur, po thua pa e përmendur vetvehten, me një zë të trishtuarshëm, duke u shprehur pa pra mbi veprën barbare të «çliruesvet» të saj.

Kush e ka parë këtë rini dhe ata sy të llahtarisur, kush dëgjon dit për dit dhëmbjet e njerësvet, të cilëvet u lëshohet armiku si një objektiv për të çfryrë në të pasjonet frivole të tij, sikurse e tregojnë vetë këta fatkeqë, ati do t'i dalë parasysh qortueshëm fytyra e të afërmve të tij, dhe urrejtja do të ngrihet edhe më e egërt kundra këtyne armiqve shtazarakë, dhe kësisoj do të bëhet ky një ushtar i patrandshim dhe i pashmangshim në punën e tij, për deri sa ta çfarosë englezë dhe amerikanë së bashku me materialë e tyre. Ay pra do të ngulet me urrejtjen edhe më të egërt kundra këtyre, në vëndin që është duke mbrojtur.

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Ejte 7 Shtatuer 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 25 - ÇMIMI 1 LEK

Rumanija në "grykën e ujkut,,

Tragjedija e trathtis së mbretit Mihail dhe e klikës së tij

Trathtija e mbretit Mihal të Rumanisë dhe e klikës së hoborit të tij nuk do të mbetet vetun nji njollë turpi për nderin e Rumanis shekuj me radhë, por do të jet njëkohësisht edhe nji marrëzi politike me pasoja të tmershme. Nuk ka gjë më të turpshëme se sa nji trathti e dështuar. Por nuk ka gjë më të tmershëme se sa nji trathti që ven në rrezik jetën e popullit.

Marrja rob e Antoneskut

Kur Mihali i ri dhe i papërvojë lue ia vue veshin këshilltarit të vet britanik De Casteloire qyshë në shkurtin 1944 u vendos kah ana e armikut dhe priste çastin e favorshëm të tërheqjes, duhej pranue se shkathtësija e tij ka qenë njaq e madhe sa dinakëria e tij. Porse ky sypozim ka qënë nji gabim trashanik Ai arestoi natën me 23-VIII kryetarin e qeverisë Marshallin Antonesku, mbajti nji fjalim në radio, me të cilën ftoi armatën që të pushojë luftën dhe njoftoi se Rumanija i kishte pranue kushtet e armpushimit me Sovjetët qysh në Fruer të vitit udhtues dhe se prandaj e konsideron Rumaninë qysh tash në nji gjendje të armëpushimit me Bashkimin Sovjetik.

Shka ndodhi? Fuqitë e armatosura gjermanë vazhduen me luftue gjithnji në front. Pjesë të mëdha të trupavet trime rumune qëndruen n'anën gjermane dhe vetëm disa divizione të veçanta bashkë me komandantët e tyne tradhtarë hoqën dorë prej rezistencës.

Por çka banë Sovjetët? Ata qeshën me Mbretin e ri naiv, i cili ra në grackë të lojës së tyne dhe rumunët filluen mei marrë rob me kënaqësi për në Siberi. Mbas tre ditëvet të tradhëtis njoftuan ata prej mikrofonit të radio Moskës se nuk dinin gja përmbi armëpushimin. Në të njëjtën kohë sekretari i shtetit për punët e jashtme amerikan Hull deklaroi në Washington se çashtja e armëpushimit i përket vetëm Sovjetëvet dhe rumunëvet dhe jo aleatëvet. Rumunët pra nuk mund të llogaritshin për ndonji ndihmë mbassi qenë armiq, të cilët duhej të kapitullonin pa kushte.

Trathtor i trathtuar

Me 29-VIII Sovjetët deklaruen, natyrish mbassi ata hynë thellë në tokat rumune të pambrojë se nuk asht nji gja e domosdoshme që ata mund t'i pranojnë kushtet e armëpushimit të caktueme në Fruer, Sovjetët banin përparime ndërsa Mihali i marrë nxitte trupat e veta të tuftonin kundra gjermanëvet dhe anarkija shtohej në gjansi gjithëmonë ma të madhe sa ma tepër që përparonin Sovjetët. Anglo-amerikanët ndër kohë pohuen në radio se mbreti veproj me kaq shpejtësi sa që nuk i vuri këta as në dijeni qysh ma parë dhe prandaj tashti duhej që ky të hinte vetë në marëveshje me rusët Loja e tmershme e meces me minë t'aleatëvet me tradhëtarët e marrë vijoi.

Me 2 të shtatorit, agjensija Reuter njoftoi, prej Moske se ndërmjetësi rumun ka ditë që po rri në Moskë dhe se, gjer sot. ay s'është pritur édhe në Kremlin, por po pret, si më parë, kushtet. Ay shpreson që në difët e afërme të vinjë në kontakt me të Dërguarit aleatë në Moskë.» Ndërkaqë, si pas njëj lajmërimi të kujdesçim të Reuterit, trupat e uritura sovjetike po plaçkitin dhe po rrëmbejnë, prej qytetevet rumunë, çdo gjë munt të transportojnë, se ata nuk janë të lidhur me anën e nonjë marrëveshjeje dhe e trajtojnë Rumaninë si një vënt të pushtuar. Veç kësaj Rusija sovjetike është i vetëmi shtet luftonjës i botës që s'i ka njohur dhe s'u është bindur kurrë konditavet të Ginevrës të K. Kuq. Çdo ditë përparimi rus, i kushton miliarda Rumanisë. Dhe Kremlini i le të presin përfaqësonjësit rumunë.

Ç'u vlejnë Sovjetëvet premtimet e dhënë më parë? Kush është aq i marrë sa të futnjë kokën në gojën e ariut, mbetet pa kokë. Ay që është mendje shkurtër. si Mihali i ri, t'i largohet ndihmës, ndonëse munt të luftonjë. ripet dhe shket nënë rrotën sovjetike. Një mësim itmershëm, dy herë fatal për një popull që nuk e meriton një mbret të tillë që dhe lufoj aqë trimnisht!

Refugjatë rumunë në rrugë drejt vëndesh të sigurtë

Sovjetët vjedhin 20.000 pjanofortë

Populisija e Bukureshtit nënë terrorin sovjetik

Agjensija eng'eze e lajmevet, Reuter, njofton nga Bukureshti se masat e para sovjetike q'u muar, në kryeqytetin rumun, që vjedhja dhe transportimi i të gjithë pjanofortevet që munt të gjendëshin. Si pas këti pohimi të turpshëm të Reuterit, ata rrëmbyen, në këtë menyrë, jo më pakë se 20000 pjanoforte.

Veglat muzikore, të çdo lloji, hë për hë, janë gjëja m'e fundit, për të cilën ka nevojë popullsija e munduar e Bukureshtit, por, nga madhësija dhe marrëzija e vjedhjes ruse, munt të nxiret përfundimi i sjelljes së përgjithëshme të pushtonjësvet bollshevikë në Rumani. Kur merren nga banesat e Bukureshtit 20000 sende me volumin dhe peshën e një pjanoforti dhe transportohen në lindje, vallë ç'far çastesh kalon popullsija civile e Rumanisë, në pjesët e zëna prej Sovjetëvet?

Këto turma ushtarësh bollshevikë të uritur prej vjetesh dhe të plakosur nga sa e sa mungesa, po sillen në një mënyrë të paimagjinuarshme në tokën e mjeruar të Rumanisë dhe në kryeqytetin e saj fatkeq dhe kjo është e kjartë, si pas ati njoftimit të Reuterit. Ay që nuk kursehet të vjedhë pjanofortë, mer dhe rrëmben çdo gjë që nuk është mbërthyer dhe e paçkulëshme dhe nuk ndruhet as pak për të kënaqur çdo nevojë primitive, dyke mos nderuar jetën dhe pasurinë e të pafuqishmvet.

Ne, me të vërtet, nuk i njohim édhe hollësirat e këtyre pamjeve të tmershme që po zhvillohen në Rumaninë lindore. por madhësija e ngjarjevet të llahtarëshme duket haptazi dhe në paraqitet, gjoja si një lajmë i dorës së dytë, po prej një aleati të Moskës.

Kaos në Bukuresht

Vrasje, plaçkitje dhe krime

Njoftohet, nga Budapesti, se një vark i paprerë refugjatësh po rrjeth, nga Bukureshti, drejt vijavet gjermane. Refugjatët thonë se në kryeqytetin rumun çdo gjë është bërë lesh e li. Për një fuqi qeveritare as që munt të bëhet fjalë. Vrasjet dhe sulmimet e plaçkitjet, në për rrugët, janë në urdhërin e ditës. Në të gjitho këto vepra të ndyra marrin pjesë elemente komunistë. Në bazë paditjesh qesharakë. bëhen perkizime, arrestime dhe krime. Popullsisë iu çperndanë afishe dhe, në për shtëpitë, ca nga ca, po valon flamuri i kuq. Popullsija e qytetit mer me vehte sendet më të nevojshmë dhe përpiqet të gjenjë sigurim, dyke ikur drejt perëndimit.

Atentat kundra generalit Giraud

Nji rojë senegaleze përpara vilës së generalit Giraud në Oran qëlloi generalin të cilt i çpoi të dy faqet pa i shkaktuar ndonjë dëm tjetër. Generali Giraud u çue me njiherë në spital.

Zezakë per Evropen

Një tregti çifute me Rooseveltin

Kryerabini i Algjerisë deklaroj, në një mbledhje çifutësh, se problemi racjal, në shtetet e Bashkuar, nuk zgidhet me vendosjen e të Zesvet n' Afrikën jugore, por me vendosjen e tyne n'Evropë.

Ay paska lajme se presidenti Roosevelt e ka në shqyrtim mirëdashës një propozim t'anëtarit të qeverisë Lehman, i cili, si çifut, ka bërë aqë shumë për çifutët. Lehmani paska propozuar që Evropa të pushtohet, kryesisht. prej trupash të Zinjsh dhe, kësisoj, Presidenti do të jetë në gjendje të çlirohet nga premtimi q'i ka dhënë popullit t'i kthenjë ushtarët e bardhë, sa më shpejt, n'Atdhen e tyre.

Në «kazanin e math, ku zjen problemi racjal nër Shtetet e Bashkuar, çifutët kanë gjetur një fushë vepërimi mjaft të përshtatëshme. Çifutë e rrethojnë presidentin Roosewelt dhe çifutë janë këshilltarët e tij.

Por kujdesi gjithënjë m'i math i Evropës,. kundrejt rrezikut jahudi, u duket çifutëvet si jo e këshilluarshme të kthehen n' Evropë, qoftë kjo edhe e mundur. Frika e tyre nga një reaktion evropjan, me kthimin e tyre, duket se i ka rrënjët të thella aqë sa ata nuk duan të marrin për sipër as rrolin aqë të dëshëruarshmë të xhelalit.

Për këtë, ata gjetën, në urrejtjen e tyre vdekëse, Zezakët. Por nuk do të kishin qënë çifutë të vërtetë po të mos kishin kurdisur, njëkohësisht, edhe një tregëti, fitimin e së cilës e futin vet'ata në xhepin e tyre. Dyke ia hequr presidentit Roosewelt nga supet barrën e problemit të rracës së zezë. ata duan të kenë një liri sa më të madhe, në dobi të tyre, dhe, me ndihmën e tija të fitojnë, në të gjithë botën. atë vënt që ua bën të mundëshme edhe në të arthmen, të ndërsejnë popujt kundër njert tjetrit. Se, jo në mirëqënje popujsh paqësore, por në fatkeqësinë dhe në armiqësinë e këtyre, midis njeri tjetrit, qëndron, në të vërtet, lulëzimi dhe fitimi i rracës çifute.



Një kishë ruse q'u klhye në një uzinë prej Sovjetikëvet



«Torpedua me një njeri» gati për nisje. Ky mjet luftimi përdoret nër ujra që s'janë të përshtatëshme për Nëndetse.

Kryetari i çetës, Spahiu, deklaron:

Çkatërrimi i Atdheut t'onë nji ndihmë e vlefshme

[Fjale te turpçme te njëj trathëtori në Shqipëri

Në fletoren propagandiste të caktuar për trupat gjermane në Shqipëri dhe të çpërndarë prej RAF-it njoftohet se Kryetari i çetës, Spahiu, ka deklarur sa vijon: Ndihma m' e madhe e Aleatëvet qëndron në sulmet kundër tokash shqiptare.

Para pak kohësh njoftuam së qyteti shqiptar, Peja, u bë rrafshë me tokën me lutje të kryekomitit Broz Tito. Këtë radhë, armiku na kalzon, po me anën e prapagandës së tij, një tjatër faktor për krimet e shumtë, ndër popullsinë civile shqipëtare, dhe për çkatërrimine çmëndur të pasuris shqiptare prej bombavet t' ajrorëvet terroristë armq; na kallzon kryetarin e çetës, Spahin.

Kaqë u vlën Atdheu i tyre këtyre avanturierëve të ikur nër male. Âta falenderojmë për çkatërrimet e vendit të tyre, prej ajrorësh armiq, dhe e çpallin si ndihmë të vlefshme masakrimin e mijrave grash e fëmijësh shqiptarë dhe thëresin akoma për vrasje mijrash të tjerë.

Këtyre trathëtorëve t'Atdheut do t'u jete çdukur çdo ndjenjë e foshnjëris së tyre, çdo ndjenjë për mëmën që i polli, për shtëpinë atnore që i rrifi Një komp që nuk çprapset, me të ndohtë, nga kreatura të tilla dhe që nuk i përdor të gjitha forcat e tij për t'u dhënë funt vepravet tyre të turpçme, nuk vlen të përmëndet midis kombevet të lirë. Por gërmadhat shtëpivet t'ona të rrëzuara, varret e të vrarëvet, çkatërrimet e Atdhaut duhet të na jenë, kurdoherë, porosi: Vdekje të gjithë trathëtorëvet t'Atdheut!

Te tjere suksese ne luften kunder çetavet

Aeror gjuejtës armik i rrëzuar prej armevet te kambesoris

Lëvizjes së ringjallur të çetavet komuniste në Ballkanin veri-perëndimor u mungoj çfardo suksesi, me kundër sulmet e Wehrmachtit gjerman dhe të aleatëvet të tij. Në kufirin perëndimor të Maqedonisë u shty në çetë, në bashkëpunim me reparte t'ushtërisë bullgare. Sulme të forta çetash, në krahinën Kolasin të Malit të Zi. u çprapsën me sukses, ku u çqua përsëri trupi vullnetar montenegrin. Edhe në Sonxhakun veri-perëndimor u shty prej repartesh të malit, një grup komunist dhe pësoj humbje të rënda. Trupat malore SS u prenë rrugën çelavet që donin të kalonin nga Mali i Zi në Herxegovinë, me drejtim ne veri të Bosnjës. Ceta të forta komuniste që donin të pushtonin një grykë, në Kroacinë jug-perëndimore, u shpartalluan me zjarr artilerije. Në këtë vepërim dhanë ndihmë të vlefshme reparte vëndës. Një regjiment malor kroat, në një ndërmarrje spastrimi, xbuloj, në rrefhet e lumit Dobra (Kroaci perëndimore) një depo fornizimi çetash. Midis armiqvet të vrarë u gjenden edhe një komisar dhe një oficer.

Nga një sulm i befasishmë prej vullnetarësh kozakë, në Sllovenine qendrore pranë Pozegas u shpartallua një grup i math çetash. Rezultati i këti vepërimi qe: 80 armiq të vrarë, 4 mitraljoza të zënë dhe shumë pushkë. Fuqitë policore rrëzuan me armë infanterije, në rrethet e BANJA LUKAS, një gjujtës amerikan.

Ambasadori japones pranë Fuehrerit

Fuehreri priti, për bisedim, ambasadorin imperial japones Oshima. Më parë. ambasadori Oshima pati një bashkëfjalim të përzemërt me Ministrin e Jashtmë të Reichut von Ribbentrop.

Lufta për skelat franceze

Thirja për ndihmë e Eisenhoverit për furnizim materiali

Kryekomandanti i trupavet të invadimit, Generali Eisenhover i drejtoi nji telegram shefit të furnizimave amerikane, ku i thotë se trupat e tij kanë nevojë për 150.000 tonelata materjal në muaj dhe të paktën 90 tanke në ditë për të zëvëndësuar humbjet. Gjithashtu thuqet në të se formacjonevet të bombarduesvet amerikanë mbrenda kohës së invadimit kanë humbur përmbi 3200 ajrorë, ndër keta vetëm në luftën për Parisin kanë humbur 223. Në bazë të këtyne shifravet kërkon generali Eisenhover për forcimin e furnizimeve të materialit.

Për t'a bërë të mundur këtë armiku ka nevojë për skela. Cherbourg-u si pas pohimeve engleze nuk është ende i përdorshëm. Për veç asaj kjo skelë nuk është e sigurtë, nga shkaku i stuhivet të shumta të vjeshtës që së shpejti priten të vijnë. Skelat Brest, Lorient dhe St. Nazaire janë ende në duart glermane. Edhe St. Malo është gjithënjë e mbyllur prej baterive defare gjermane në ishullin Cecembre që kundërshtojnë vazhdimisht. Anglo-amerikanët i kanë bërë furnizimet deri tash në rërën e hapur. Në kohrat e vjeshtës shkarkimi në rërë do të pengohet por së tepërmi.

Ka ardhur koha ku pa skela eksigjencat e trupavet armike nuk mund të përballohen. Nga këto shkake fiton lufta për skelat nji randësi të madhe. Sulmi mbi Le Havre duhet pra së shpejti të fillojë, mbassi provat, për të shtënë në dorë skelat e Bretanjës deri tash kanë shkue kot me humbje të mëdha për armikun.

Gjyle mbi breg-detin englez

Topa gjermane rahnë për katër ore

Mbas nji lajmit të Reuter-it nga Londra topa me qilje të largët gjermane hodhën katër orë resht nji sasi të madhe gjylesh mbi breg-detin britanik. Mjaft qytete patën dëme të rënda. Gjyle të shumta plasën në afërsit e Dover-it.

Zjarri vinte si duket prej topavet me qitje të largët nga Calais dhe Cap Gris Nez, më von mershin pjesë edhe topat në Wimereux. Gjermanët e çkëmbejn forcën e qitjeve, por me gjith ate digjohesh vashdimisht që pëlcysnin të paktën katër gjyle.

Nji leter e Mahatma Gandhit

Anglija nuk lëshon pe

Sherbimi i lajmeve britanike njofton se Mahatma Gandhi i ka përgjegjë letrës së fundit të Nën-Mbretit Wavell si vijon: «Shifet kjartas se Qeverija britanike nuk kujdesohet aspak me lehtësue pushtetin qi ajo ushtron mbi 400 miljon njerëz. Në qoftë se indianët nuk janë aqë të fortë sa me ia heqë at pushtet, unë nuk do t'a humbi kurr shpresën qi Indija të mos ia dali qëllimeve të veta me mjete thjeshtësisht morale. Korrespondenca e botueme provon qi unë jam orvatë me ba ç'mos për me kënaqë Nën-Mbretin. Përgjegja e fundit e Qeveris asht nji provë pozitive qi dishmon se Anglija nuk kujdesohet me fitue për vehte as opinionin publik.

«... dërgomëni Wehrmachtin»

Kushdo i njeh, në Shqipëri, njejesit vullnetare të myslimanëvet dhe e dinë se me sa ashpërsi luftojnë ato kundër helmit komunist q' u ka hyrë në vatër. Por, pa ndihmën e ushtërisë gjermane, ato do të mbetëshin ngushtë: ajo është kolona m' e fortë në luftën për çlirimin e Atdheut të Shqiptarëvet.

Qysh ne orët e para të mëngjezit, i ka sjellë tok një urdhër i përbashkët. Me një shtrënguarje të fortë dore, shëndetojnë njëri tjetrin oficeri gjerman, komandant kompanije në divisionin «Tiger» dhe kryetari trim i një çete myslimane të vetmbrojtjes.

Disa orë me von, çeta e vulnetarëvet gjendej në luftim të rreptë kundër dy bataljonësh komunistë që mundoheshin t'a rrethonin kundërshtarin e tyre shumë herë më te vogël në numur. Në zjarrin e pa prerë dhe në ulërimat e egërta të Banditëvet u sul, në ndihmë vetë komandanti gjerman, me ushtarët e tij ndonëse i qëlluar nga të gjitha anët. Ay u shty gjer në vijën e parë, ku rrethimi ish m'i keq, dhe, me parë nga çdo gjë, nisi të plagosurit për në vëndin e mjekimit.

Kryetari në rrezik vdekjeje

Pa pandehur, del, nga shkarpat, nje lajmëtar dhe lajmi i tij kalon, shpejt, nga goja në gojë: «kryetari i çetës vetëmbrojtëse ndodhet në luftim shumë më thellë!» Brënda një sekonde, jepet urdhër: «grupi i parë, majtas, grupi i dytë, djathtas, dretj perpara, gjer në bregun e afërmel» Dhe ushtarët rrëmbejnë armët dhe nisen. Qitje të veçuara përshkojnë korijen. Plumba mitraljozi vërshëllejnë mbi kokë. Atje më tej, zjen një pushkë automatike. Ushëtima e bombavet të dorës dhe një thirrje e mbytur tregon ashpërsin' e luftimit trup më trup.

Ushtarët luftojnë egërsisht, ndërsa oficeri gjesman kërkon kryetarin e çetës vulnetare. Ja, diçka lëvis në dushnjen e afërme. Syri dhe pushka drejtohen. atje; mik apo armik, zëmra pushon një çast. Është kryetari. Ay është plagosur dhe është tërhequr, xvarre, gjer aty, me ndihmën e dy shokëve besnikë. Nuk munt të ecinj më, se një plump i ka thyer kryqet. Kështu takohen përsëri të dy kryetarët.

Kameratizmë me çdo kusht

Zjarri bëhet gjithënjë m'i rreptë dhe lufta ndizet, çdo sekondë. më tepër. Shpejt një batanije, futet brënda i plagosuri dhe e ngrenë ushtarë gjermanë dhe kroatë. Rruga gjendet nënë zjarr të rëndë mitraljozi. Të shtrënguar pas dushnjevet, ata vaxhdojnë përpara. Me çdo çmim, duhet të arrihet bregorja e afërme. Edhe kjo rrihet nga të katër anët, por sa e vlefshëmë është në një tokë të tillë! Afrohen dy grupe, pas këtyre, hidhen bomba dore, dhe ushtarët i furren së përpjetës, me një hurra të fortë. Me grupin e fundit oficeri gjerman sulmon nga krahu i djathtë, drejton zjarrin e armëvet të rënda, siguron tërheqjen dhe pastaj rri me të plagosurin.

Disa ushtarë mundin të hapin një farë rruge, por bregorja është tepër e forcuar, bilë armiku ka fuqi edhe të sulmojë. Ay del, pa pandehur, nga shkarpat, nga një arë me grurë, nga dushnjet e një pylli të vogël dhe sulmon. Mitraljozat kërcasin pushkët automatik vjellin zjarr të paprerë për mbi grupet dhe, midis tymit të murrmë të bombave të dorës, shihen disa banditë që rrukullisen në tokë. Por rruga mbetet e mbyllur. Tashti duhet të na ndihmonjë natyra e tokës. Me një vërshëllim të gjatë në mënyrë banditi. oficeri gjerman jep urdhër për depertim nga e djathta, drejt dëndësirës mbrojtëse, I plagosuri ngrihet me kujdes, në për mjet barishtave te gjata një bojë njeriu, dhe rruga ecën përpara, ndonëse shumë herë ngëc midis shkarpavet.

Por banditët ulërinjë. përsëri, nga të katër anët. Me anë thirrjesh dhë vërshëllimash, unjen nga bregu një shumice syresh dhe i përvishen kërkimit të dëndësirës. Grupi ynë tenton të hapnjë shtek. por e sheh që fuqija kundershtare është tepër m'e madhe. Tashti është çasti të vepërohet si pas taktikës së bandavet.

Me besa-besën

Kryetari i plagosur lëshohet shesh, midis barishtavet të dëndura, dhe mbulohet me fletë e me dega. Dy nga shokët e tij fshihen aty pranë, për t'iu ndodhur në ndihmë. Të tjerë, marrin urdhër të zënë vënt grupe grupe, ose, në rrast nevoje, edhe një nga një.

Disa orë më von, oficeri gjerman mbleth ushtarët e tij. Këta janë të gjithë, ndonse luftimi që i rreptë dhe trup më trup. Të plagosurit e paktë u mbarën dhe u nisën për mjekim. Së pari, ay falënderoj ushtarët dhe pastaj tha se duhej të tërhiqej, me çdo kusht kryetari i plagosur që kish mbetur në pozitat armike. Këtë ay ia njoftoj edhe Komandantit.

Ja, arrin, në komandën e bataljonit, një civil që me zi mer frymë. Ay nxjer nga xhepi një copë letër dhe ia jep komandantit Komandanti i bataljonit e sheh që ay është njëri nga ata të dy që kishin mbetur me kryetarin e plagosur. Rrëmben, me të shpejtë, letrën dhe sheh se ajo përmban atë që ata vetë kishin vendosur të bënin:

Kapitenit Ahrendt!

Gjendem i plagosur në pyll dhe nuk munt të lëvis. Për hir të Zotit dërgomëni Wehrmachtin. Lajmëtari e di se ku ndodhem. Hein Hitler!

Setko Hoxhiametaviç

Një gjysëm ore më von ish formuar një grup i fortë luftimi dhe i udhëhequr prej vetë komrndantit, sulmoj banditët dë kishin zenë përsëri vënt I asgjësoj ose i çprapsi dhe u shty brënda nër pozitat e tyre. I tërë kujdesi ish për kryetarim e plagosur. të cilin banditët nuk duhej t'a xbulonin as në tërheqjen e tyre. U nis, me një grup qitësish të xgjedhur, dyke përgjuar nga të gjitha anët, ca nga ca, arrijti në vëndin e duhur. Kryetari plagosur ish ngritur më këmbë, mundi t'i shtrëngonte dorën përsëri një oficeri gjerman dhe tha, plot krenari dhe besim; "Unë e dinja që Wehrmachi gjerman do të më shpëtonte»

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Ejte 14 Shtatuer 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 27 - ÇMIMI 1 LEK

Rrenë e trathëti se bashku

Lajmet gënjeshtare t'aleatëvet

Metodat e marra të gabojnë për fuqi ma të madhe

Ndër këto ditët e fundit rrena rrenën nuk e pret. »Lirija e Shqipnis» e ka marrë përsipër me i nxanë rregullisht këto rrena ku janë ma të mar rrat dhe me i a u paraqitë të gjith shqiptarvet.

Sa shpesh asht thanë në javën e fundit edhe prej njerzvet ku janë ma serioza, se aleatët kanë zbarkue në në Shqipni? Nji herë u tha për Ulqinin, mandej për Vlonën, por nji fjetër ma vonë tha se ishte Spliti, ku u banë zbarkimet. Sidoqoftë fakti asht se deri tashti nuk asht pamë kërkund as edhe nji Tommy.

Kur ja se lajmohet nga kuartjeri i përgjithshëm i Tito-s se Belgradi u pushtue dhe se trupat gjermane janë pré. Në të vërtetë trupat e Tito-s në Mal të Zi janë qitë jashtë nga të gjitha vendet ma të mëdhaja. Të gjitha rrugat ma me randësi dhe të gjitha qytetet ma të mëdhaja të ish Jugosllavis janë në dorë gjermane. Çelat e Tito s vuajnë nga urija.

Ka dy javë që radiot e aleatëvet lajmojnë se Sovjetikët i kanë shkapërcye kufijt e Prusisë lindore. Në të vërtetë nuk gjindet asnji ushtar aleat në tokën gjermane, as në lindje as perëndim.

Mandej, a nuk u tha së paku dy herë në radio të Londonit dhe të Barit, se Turkija i kishte shpallë luftë Gjermanisë dhe ky lajm mbrenda dy ditëvet a nuk doli rrenë?

Mbassi javë me radhë, mbas atentatit kundra Adolf Hitlerit, u treguen në radiot e aleatëvet ngjarje të tmershme mbi revolucjone në Gjermani, tashti ia kanë fillue me nji metodë të re dhe ma të marrë. Radio e Londonit lajmon prej zyrës së Reuter-it: «Qeverija amerikane i asht sjellun qeveris argjentine që mos të pranojë kurrnji nazist të hikun. Nji hap i tillë u ba edhe në Spanjë». Me këtë gja don me e sugjerue botën, që zen besë lehtësisht, se prijsat gjermanë kanë ikë tashma në dhena të hueja. Se ç'lojë e marrë. A për kaq të marrë dhe të tehtë në besim i mbajnë lexuesat e këtyne lajmevet?

Na për tashti duem me u pyet nji send tjetër. A e ka lanë ndonji herë kumtesa e Wehrmachtit gjerman ndonji lajm pa e tregue edhe atëherë kur ky ka qënë i pakënaqëshëm për Gjermaninë? Ju duhet t'a konstatoni vetë: Se Gjermanija asht e fortë dhe nuk ka nevojë me e drashtë të vërtetën. Aleatët shtihen se janë të fortë dhe janë të detyruem me rrenjtë. Ata e dijnë se po nuk u fitue kjo luftë në këtë vjeshtë, ajo për aleatët asht e humbun për shkak të armë vet të reja gjermane. Dhe kjo luftë asht e humbun për aleatët.



Populisija e Prusis lindore u pregatitë sovjetëve nji prilje pervluese

Churchilli trathton Polonin në Sovjetët

Përsbkrimi që bën nji deputet englez ne gazete

Në gazetën "New Cronicle» shkruesi politik dhe deputeti i mirënjohun Vernon Bertlett, -- sikur e lajmëron edhe sherbimi i lajmeve britanike. -- merret me çashtjen poloneze dhe shkruen se, mbas Varshovis, Polonija asht nderlikue në nji gjendje qi mund të ketë pasoja ma të mëdhaja se vdekjen e mija «patriotëve» polonezë. Thuhet se Britanija e Madhe dhe Shtetet e Bashkueme paskan kërkue tash s'afermi në Moskë me shvillue komunikacjonin ajruer ndërmjet Italis dhe Bashkimit Sovjetik, me qëllim qi me ndihmue Varshovin. Thuhet se kjo kërkesë qenka refuzue nga ana e Moskës.

Sovjetët nëpërmjet të radios paskan premtue nji ndihmë, por ky premtim ishte i shoqnuem me kercnime, pse ata dashkan me i paraqitë në Gjyqin e Luftës drejtuesat e kryengritjes së Varshovis. Vermon Bertlett shton se Qeverija e Emigrueme Poloneze në London pa dyshim e mban përgjegjësin e randë, pse ajo ia kishte lanë «gjeneralit Bor» inicjativën për me zgjedhë çasin e përshtatshëm të kryengritjes. Së fundi kjo kryengritje do të kishte fillue pá marrë konsultime nga qeverinat britanike dhe sovjetike.

Deputeti anglez vijon tekstualisht: «Kjo masë unilaterale duhet të konsiderohet ma shumë se e marrë. Disa antarë të Qeverisë s' Emigrueme në London besojshin pa dyshim se «patriotët» e tyne shkojshin me çlirue Varshovin, ndërsa të tjerë pandehshin se do të mundshin me dhanë proven e forcës së qëndresës për me i dhanë nji mbështetje ma të mirë kryeministrit Mikolajczyk, qi gjindej pikërisht n'udhtim për në Moskë.

Vernon Berflett ven në dukje mbasandej se duhej me nxjerrë nga kjo ngjarje tri përfundime jo të favorëshme për aleatët, në qoftë se nuk i arrihet qëllimit me shdukë divergjencat qi ekzistojnë. «Tri përfundimet qënkan këto qi vijojnë: 1) mija polonezësh do të vriten; 2) mosbesimi polonez kundrejt Bashkimit Sovjetik duhet të shtohet edhe ma tepër; 3) Churchilli e paska deklarue shpesh herë se ai do të mundet me i konsiderue të gjithë këta si aleatë qi «zbresin» prej gjermanëve. Kryeministri britanik paska shtue njikohësisht se nuk mundet me thanë asgja mbi çashtjen e kryengritjes poloneze pa ndie thellësisht dishirën për me ndihmue njerzët qi e paskan organizue ketë qëndresë. Marrëdhanjet ndërmjet tri vendeve të mëdhaja aleate pikësynojnë kah ngjarjet poloneze, dhe sidomos në nji çast kur bashkëpunimi i tyre asht ma i dishrueshëm se kurr.»

Mjaft fjalë te bukura prej Londre

Një leter zemrimi për Westmisterin

Renat e propagandës amerikane, me fjalët e saj demokretike dhe humanitare, dalin në shesh nga një letër e njëj tetari t'armës ajrore britanike, e cila ra në duart gjermane. Në këtë letër thuhet, fjalë për fjalë: «Nuk pret më, edhe shumë, koha që zotërinjt e Westmistrit t'a pranojnë se duhet, ata kanë vendosur që ne të mos marim më shumë se sa kemi marrë gjer tashti. Unë kam frikë se, pas lufte do të jetë shumë vështirë dhe Zoti e di se kur do të mundim të martohemi ne të rinjte. Parashikimet, për të fituar mjaft sa për të mbajtur shtëpine dha familjen, janë fare të pakët. Me gjith këtë, do të kalojnë kohë, gjer sa ne të mësohemi e të bëhemi zot të vehtes. E arthmja duket shumë e errët. Këta njerës që mendojnë sigurimin për të gjithe, sa po kalon çdo gjë, më bëjnë vetëm të qesh. Me mënyrën, si pas së cilës ata po ecin përpara, ne do të jemi të pregatitur edhe për paqën po aqë keq, sa qemë edhe për ulltën.»

Simbas lameve t'Agjensis kroate, humbjet e partizanëve gjatë muejit gusht arrijnë në 4916 të vramë dhe ma shumë se 1000 të zanun robë o të plaguem. Në vijim po t'atij muejit u rrëxuen e 32 ajrorë anglo-amerikanë.

Bjerrje të bandavet Greke

Në Peloponez dhe në Epir

Në malet e Greqisë së veriut trupat gjermane afër qytetit Edessa kanë ba nji plaçkë të mirë. Ata i ranë nji kolone të madhe furnizimesh të bandavet dhe shpartalluen krejt rojën e saj. Plaçka e zanë në këtë rast përbahet prej 50 vagonesh të ngarkuem me drithë, 300 që dhe përveç këtyne edhe 90 kamiona mbas luftimit të paktë u zunë në zjarr.

Këto ditë njisina të marinës gjermane gjatë veprimeve të spastrimit ndër skelat e Peloponezit jugor zunë 5 motoveljera ndërsa 20 vapore të tjera e ndër këta shumë motoveljera u shkatrruan.

Gjatë ndërmarrjes së bame me qëllim spastrimi pak kohë përpara në krahinat ndërmjet liqeninit Agrinion dhe në jugë të malevet të Pindit kundra bandavet komuniste u shenue nji sukses prej anës të trupavet gjermane që veprimevet këto dit atje u dhanë fund. Njisina të ushtrisë, dhe të tilla SS i shkaktuen armikut bjerrje të randa e të përgjakëshme. Bandal u orvatën me të kotë me u mbrojtë gjatë tërheqjes së tyne tue ba rezistencë penguese.

Ata patën nji bjerrje prej 298 të vramësh dhe 171 të zanë rob. Simbas thanjes së robvet edhe numuri i të plagosunvet duhet të ketë qënë shumë i naltë. Gjatë ndërmarrjes u muerën plaçkë e pjesërisht u asgjasuen 23 granad-hedhësa, 74 mitroloza 543 revolvera e veç kësaj shumë pushkë nji sasi e madhe municioni, shumë bombë dore, mina, materjal exploziv, 3 depo ushqimi dhe nji spital.

Kruja qyteti historik u spastrue prej kriminelave bolshevike

Si nji zjarr u përhap lajmi gjithkah, se nji çetë kriminelësh bolshevikë sulmoi qytetin e Krujës, qi asht i shenjtë për çdo shqiptar. Çdo nacionalist shqiptar i ndershëm dridhet kah mendon, se Kruja, kështjelli i Skanderbeut mundi të bijë në dorë të vagabondave internacionalë.

Mbi sulmin e pabesë tregohet, se çeta bolshevikësh ju afruenë qytetit të pafaj natën si cuba dhe mandej hynë ndër shtëpija tue vram dhe tue prem.

Në nji spital të smurësh prej malarje u hudhnë moskovitët mbi ushtarët e smundë e të pa mbrojtun, të cilët ma von u gjetnë të vram e të coptuem mizorisht.

Wehrmachti gjerman nuk vonoi, me marrë me njiherë masa kundra bolshevikëve. U shtijnë në veprim armë të randa dhe kriminelët u bitnë jashtë nga malet e Krujës si edhe nga vetë qyteti. Pasoja e këtyne vrasjeve të kriminelëve, "lufta çlirimtare", e të cilëvet asht nji varg krimesh të poshtra, ka me qenë, se Wehrmachti gjerman ka me marrë masa hakmarrjeje pa skrupel, për të cilat kanë m'u çuditë dhe ata vetë.



Vendosja e nji fuçije hekuri për mbylljen e ujnave.

Për mbrojtjen e brigjeve, prej sulmeve të shpejta e të pa pritura, vendosen veglat e mbyllijes t'ujnave. Vegla që shifet peshon pesë tonelata, dhe asht si pikëpshtetje e krahnave që rrethojnë ujnat.

Vobegsija si dogmë e politikës shtetnore

Libri i Sigrid Undset "Përseri ne t'arthmën,,

Shkrimtarja norvegjeze, Sigrid Undset, mbajtësja e çmimit Nobel të Literaturës, ka botuar një liber, në të cilin eksperimenti shoqror komunist gjykohet shum objektivisht (Përsëri në t'arthmën, Shtëpija botuese Oprecht, Zuerich.)

Shkrimtarja më 1940 shkoi n' Amerikë nepër Rusi. Megjithse ajo nuk qëndroi shum kohë në këtë vent, zbuloi diçka që nji këqyrësi të përciptë nuk do kishte rënë në sy. Ajo ka shenuar nga jeta e Rusis mjaft hollësira pa prapamendimin e nji propagande. Përshtypja e përgjithëshme që ka kjo norvegjeze mbi eksperimentin shoqror komunist, çdo gjë tjetër munt të jet por kurrë inkurajuese.

Çka e habiti këtë më shumë, ka qenë monotonija e pamjes së përgjithshëme, gra e burra të veshun njisoj si njëra ashtu edhe tjetra palë njëlloj të vobektë, të veshun me plaçka të kualiteti të keq. Këpucë lëkure janë përjashtim, vetëm ushtrija është e veshur dhe e mbathur mirë.

Sigrid Undset - dhe më tepër djali i saj, i cili në fillim tregonte simpathi për komunizëm - janë tmeruar prej jetës së përbashkët, si ndër shtalla baltish, ku rrojnë popullsitë ruse, si dhe prej mjerimit të përgjithshëm dhe ajrit të qelbur, pa asnjë kujdesi shëndetsore, që janë shenjat dalluese të jetës së popullsis. I biri i romancierës në fjalë e pohoi vetë se nuk mund ta duronte më këtë pamje të trishtueshëme të vobeksisë së përgjithshëme. Mëma bëri vërejtjen, se dëshprimi i tij i dukej mjaft komik në çastin që ei u sigurua se realiteti ishte krejt ndryshe, nga ç'e kishte përfytyruar ai regjimin komunist. Më tutje shpjegon shkrimtarja se ndarja e lëmoshave është i vetmi mjet për të shpenzuar të holla në Moskë, mbassi atje mugnon çdo gjë për të blerë.

Pastaj ajo ven në dukje sidomos mjerimin e madh që ekziston në banimin e shumicës së popullatës ruse. Kjo konstatoi se Rusija mbas njëzetepesë vjetë eksperimenti komunist në fushën shoqnore, në krahasim me vendet e Europës prendimore, qendron tmersisht prapa.

Ky libër i shkruar pa pasjon do t' u hapte syl mjaft mirë të gjith atyre, të cilët e përfytyrojnë Rusin-Sovjetike si një parajsë shoqnore.

Lodra fallso e titos

Mbreti Peter vetëm një figurë e tij

Simbas nji urdhnit të mshefië të Titos, i gjetun ke nji kryetar partizanësh i zanun rob, del në shesh se partizanët nuk e kanë aspak mendjen me e njoftë ish-Mbretin Pjetër, as edhe mbas koncesjonesh qi ai u ka dhanë. Në ket urdhen thuhet tekstualisht: «Na nuk jemi aspak të mendimit me marrë urdhna çëfarëdo qofshin prej Londonit. Na nuk bashkëpunojmë aspak me qarqet reaksjonare qi s'mendojnë veç për vehte, por me armatën e kuqe.»

Indija e begatëshme dhe varfër

Ankimi kundra konditës politike çfrytzuese t'Anglis

Për atë që i njeh metodat e sundimit anglez n'Indi, është e qartë si dielli se politikanët anglezë nuk bëjnë një politikë ndertimi, porse ushtrojnë çfrytzimin ekonomik të vendit. Po të lidhet me këtë urija që është përhapur në Indi dhe që ka marrë forma kronike, kuptohet fare mirë shkaku.

Në vjetin 1943 Indin e mbuloi ky mjerim përsëri. Me mijra e mijra njerzë gjetën vdekjen e urisë. Epidemira u çfaqën me shumicë dhe rrugët e qyteteve të mëdha u mbushën plot me kufoma. Edhe korrespondentat anglezë si edhe udhtarë qenë shterngua të botonin veprat e turpshëme të tyre dhe iu desht më në fund që ti luteshin qeverisë për ndryshimin e kësajë situate.

Para pakë kohe edhe Sir Firoz Khan Noon, komisar i naltë i përulur i anglezve, është shprehur rreptë kundra politikës demografike t' Anglisë. Anglija me gjithatë nuk mendon aspak të bëj ndryshime në politikën e saj të tashme. Tamam tashti në luftë po çfrytzohet dhe thithet Indija deri në kulm. Është për t'u vajtue që përhapja e epidemive të mëdha n' Indi është e lidhur me zinë e urisë.

Vuejtjet e pa preme te popullit Indjan

Po të hedhim një sy në të kaluarën, na del kjo pasqyrë përpara: Dy herë ra zija e madhe e urisë ne vjetët 1825 dhe 1850 deri më 1857. Vjetët më të vështira për Indinc ka qenë koha prej 1876 deri më 1900, në të cilën 32 miljon njerzë u shuanë krejtë. Së fundi u çfaq zija e urisë dhe influenca e epidemisë në vjetin 1918 deri më 1919, si pasojë lufte, në këtë vend fatkeq, në të cilin pati 17 miljon të vdekur.

Mbi këtë Indija është sot vendi më i pasuri i botës. Prej statistikave të ndryshëme del në shesh se Indija ka nji tokë pune bujqësore prej 33 miljon hektarësh. Me produkcionin e saj të orizit, të sheqerit të kallamit dhe të jutës është e para në botë. Është e vërtetë se një pjesë e tokes s' orizit me ndarjen e Birmanisë ka humbur. Mbi 9,5 milion toke mbillet pambuk, me të cilin Indija merr vendin e dytë në këtë prodhim mbas Shteteve të Bashkuara. Prodhimi i çajit prej 182 miljon kg, kapërcehet vetëm nga ai Kinës. Në mbëledhjen e linit Indija, pas Rusisë sovjetike dhe pas Argjentinës, merr vendin e tretë. Produkcioni magnezitit qëndron në shkallën e pestë, fitimi i saj në plumb merr vendin e gjashtë në produkcion e përbotëshëm. Me produkcionin e ergjendit zë vendin e shtatë, me atë të qymyr-gurit zë vendin e tetë në prodhimin e përbotëshëm. Me prodhimin e hekurit Indija hyn në shkallën e nëntë dhe me prodhimin e hekurit të minierave zë vendin e dhetë. Edhe në fitimin e vojgurit ka arritur India vendin e njëmëdhetë. Nevoja e përbotëshëme në celuzet mund të plotsohej me bambusin që rritet n'Assam dhe në Birmani. Pasurija pyllore e Indisë është çështja për më tepër se 36 miljon hektar pyll-ka filluar të çfrytzohet që 10 vjetë e këtej.

Po të mbajmë para sysh këtë pasuri të pafund që pasqyrohet ndër këto numra të thata, dhe këtë t'a krahasojmë me mjerimin e tmershem të masave të popuilit në këtë vend kaq të begatshëm, atë herë do të shohim në këtë gjë ankimin trondites që ngrihet kundra politikës çfrytzuese t'Anglisë. Indija do ta gëzojë pasurinë e vet kur ta hedhë poshtë robërimin anglez dhe një qeveri kombëtare e indisë të drejtojë vet fatet e saja.

Zi në Sarajevë

Amerikanët rrenojnë brutalisht

Përsëri sulmi brutal ajruer kundra qytetit të Sarajevës, që u krye prej ajrorëve amerikanë me 8 Shtatuer, ka shkaktue nji idhnim të math në të gjithë popullsin islame të Balkanit. Sikundër lajmërohet, prej këtij sulmi terroristik janë rrenue shumë xhamija, ndër të cilat edhe ajo e Begovës, ma e bukura dhe ma e nderueshmja nder të gjitha xhamijat në Balkan. Nji sasi e madhe qylymash të mrekullueshem dhe enash bakri, qi i nepshin të pamit karakteristik Sarajevës, janë prishun gjithashtu. Nder qarqe islamike bahet kjo vërejtje se, ndersa Gjermanija bani fushatën e Ballkanit, e kursej qytetin e Sarajevës dhe u ruejt prej operacioneve n'afersit e saja.

10,000 therore në Paris

Lufta civile bënë kërdinë në Francë

Kryengrijet dhe tribunali kanë shkaktuar vetëm në Paris 10.000 therorë. Gjyqet «punojnë» pa pushim. Goditje midis grupevet të de Gaulle-it dhe të «Maquis-it» kushtojnë gjithnjë me tepër jetë njerzish. Se si shkon puna në një proces gjyqi të tillë, na lajmon një fletore zvicerane.

Gjëndja që ekziston në sallat e gjyqit të Francës së de Gaulles-it, botohet në gazetën zvicerane «Der Demokrat» një lajm të një dëshmimtari që e ka parë me sy. Këtu e ndjen vehten njeriu sikur është në kohën e tmerrit të revolucjonit francez; salla e gjyqit është mbushur me spektatorë, të cilët herë pas here marrin pjesë në procese.

Barometri është në kulm. Të paditurit mbulohen me të sharat e spektatorëvet. Herë pas here dëgjohet thirrja: «për vdekje! për vdekje!» Të paditurit qëndrojnë të pa lëvizur kundrejt kësaj buçitjeje. Vetëm pakë e nbrojnë vehten, mbasi e shofin se nuk shërben gjë mbrojtja. Për seicillin të paditun «përdoren» vetëm pak minuta. Vendimet me vdekje që u aplikohen menjiherë, priten nga masa e madhe që mbush sallën e gjyqit me brohoritje.

Gjeneral de Gaulles-i nënë shtypjen e bolshevikëvet u detyrua të ndrojë Komitetin Qeverritar.

Statuja e gjallë prej akulli

Për shkak të një gabimit teknik në numrin e kaluem kemi sjell të njejtin titull mbi një artikull që s'kishte lidhje me të. Në këtë numur po sjellim titullin bashkë me artikullin përkatës. Një ish shkrimtar sovjetik, i cili, si një nga miljonet e të dënuarvet, kaloj pesë nga vjetët e tij më të bukur nër qëndra të ndryshme dënimi sovjetik, përshkruan, në radhët e poshtëme, vdekjen e llahtarëshme të Profesorit të metereologjisë Nadeshdin, i njohur në Leningrad, i së cilës vdekje, shkrimtari në fjalë ka qënë dëshmimtar.

Profesori i metereollogjisë Nadeshdin u suall në një kompani dënimi në minierat Sturmowoi, në Kolima. Ay ish dënuar me 25 vjet burgim të rëndë, se i biri i tij ish munduar të kalonte kufirin sovjetik, për t'u bedhur n'Estlandi. Të birin ia kishin vrarë si «tradhëtor t'Atdheut», kurse profesori si bashkëdijës dhe bashkëvepruës, u suall në fushën e përqëndrimit. Pastaj e suallnë në kompanin e dënimit për «Sabotage» se ay s'kish qënë në gjendje të plotësonte as punën më të vogël që parashikonte rregullorja, d. m. th. të shtynte me qerren e dorës, një kapicë dheri prej 4 metrash kubik.

Administrata e kompanis së dënimit përbëhej, në pjesën më të madhe, prej elementesh kriminelë. Disa syresh vuanin dënim për vrasje, vjedhje ose përdhunim; të tjerë sapo ishin liruar nga qendrat e dënimit dhe tashti vlenin si pjesëtarë me uniformë dhe me armë, në shërbim të GPU-së. Një palë prej tyre ishin pranuar edhe në Parti.

Profesorit, të cilit i a flisnin këtë titull me talljen e zakonëshme të përqëndrimit, i takoj fati i keq të duronte, gjithënjë zëmërimin e «Drejtorit» ose të loste rrolin e buffonit, kur ata ishin në orë të mira. Kur ay ish i kapitur nga puna q'i kalonte fuqit' e tija, e detyronin të këndonte këngë të ndyra, të loste valle ose të bënte sa e sa palaçollëke të tjera. Një herë e nxuarnë jasht, në një të ftohtë prej 40 gradësh, dhe e detyruan të këndonte në dëborë. Një herë tjatër, pas si ay kish gjithënjë uri, e detyruan të gëlltitte një kusi të tërë plot me mbeturina e me të lara enësh.

Në shkurt, kur të ngritët ish m'i rreptë, erdhi, në fushën e përqëndrimit një komision inspektimi nga Magadani. Natyrisht si nuk pritej ndryshe, çdo gjë u gjent në rregull të plotë, ndonëse atje vdisnin, çdo ditë, 10 gjer 20 të dënuar. Përfundimi i kënaqëshmë i inspektimit dha rrast që në shtëpin' e Komandantit të fushës të organizohej një orë dëfrimi. Të bërë qeflinj nga pirjet e ndryshmë, pjestarët e kësaj tryeze të çmendur vendosën të improvizonin një koncert. Ndonëse ish kohë gjumi të thellë, u çfaqen në barangë disa rojtarë për të marë «profesorin». Kundër zakonit të tij, ky u mundua sikur të kundërshtonte dhe murmuritte se nuk e ndjente vehten mirë. Natyrisht, s'ia vuri njeri veshin dhe u hoq tutje, ndërsa shokët e tij, të zgjuar nga zhurma, vashduan gjumin.

Të nesermen në mëngjes, kur u dha shënja e ngritjes dhe ata u mblodhe përpara barangës, ish ëdhe natën e errët. Kur, ja, përnjëherësh ranë, mbi një shul të ngulur midis sheshit, rrëzët e forta të një projektori; pas shulit qëndronte, pa as lëvizjen më të vogël, trupi i «profesorit». Kur iu afruan, panë se i tërë trupi i tij ish mbuluar, këmb' e kokë, me një cipë akulli. Më von u muar vesh se «Eprorët» kishin qënë zëmëruar, natën e parë, nga kundërshtimi i tij për të kënduar, dhe kishin urdhëruar që të bënin prej, 'tij, një «statu». E kishin lidhur, pra, "profesorin», pas shulit dhe rojtarët e kishin cpërkatur me ujë, gjer sa ay kish ngrirë në funt e në kryet.

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Hënë 18 Shtator 944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 28 - ÇMIMI 1 LEK

Mjeti i ri gjerman luftimi

Anije eksploduese të dirizhueme prej së largu

Deri tash fundosen 35 anije transporti prej 225000 tonelatash

«Anije eksploduese» të dirizhueme prej së largu janë vënë në veprim prej marinës luftarake gjermane si mjet për betejat detare kundra anijeve transporti të tlotës s' invadimit që kryen shërbim ndër brigjet detare të Francës e që qëndrojnë ndër këto brigje. Këtë gja e shpalli nji folës prej anës së Komandës së Përgjithshme të marinës luftarake gjermane.

Prej veprimit të këtij mjeti të ri të luftimit deri tash janë shkatrrue 35 anije transporti me 225.000 tonelata. Mjeti i ri i luftimit të marinës gjermane përbahet prej dy anijevet d.m.th. prej "anijes eksploduese,, që zhvilion nji shpejtësi të madhe qi ka formën e "Speed Boats,, të njohur prej kohës së paqës dhe që asht mbushun tej e për tej me lang eksploziv që pëlcet menjiherë dhe prej nji anije komande që ka për detyrë të zhulojë objektivën armike dhe të sjellë anijen tjetër të mbushur me land eksploziv afër deri tek largësija e qëllesës.

Anija e komandës që njikohësisht drejton nji radhë «anijesh eksploduesë» dirizhohet sikurse edhe vetë «anija eksploduese» prej nga nji njeriut të vetëm. Këta njerës nuk janë t' armatosun. Mbajnë nga nji këmishë noti dhe mbi veshjen e tyne prej gome me nji orë specjale që përdoret edhe mbrenda në ujë prej tyne. Kur «anija eksploduese» i afrohet maksimum 200 metër objektivit atëherë drejtuesi i «anijes eksploduese» pregatit fillin e materjalit eksplodues në anijen tjetër tue bamë atë gati që të eksplodojë përnji herë porsa të vijë në prekje. Mandej drejtuesi i anijes së komandës merr përsipër drejtimin edhe dirizhimin e anijes së mbushun me materjal eksploziv tue drejtue këtë anijeve armike.

Në kundërshtim me torpedon njeri të ngadalshëm, "anija eksploduese,, nuk mundet t'i avitet armikut pa u diktue. mbassi prej shpejtësis së saj të jashtzakonshme le gjurma mbrapa të dukshme, sidomos natën. Por me gjith këtë me shpejtësin e vet të rrufeshme përballon mbrojtjen e armikut me anë befasinash. Në rrjedhim të materjalit eksploziv tepër të ndishmë që mbas çdo prekjeje të lehtë mund të hidhet në erë, mjeti i ri i luftimit të marinës nuk mund të vihet në veprim në detin e furishëm. Anijet armike të transportit e msyem «anijevet eksploduese», sikurse deklaroi folësi i komandës së përgjithëshme të marinës patën në çdo rast bjerrje totale mbassi sasija e materjalit eksploziv që u suell afër tyne asht tepër e madhe dhe kjo prej prekjer prekjes ma të vogël eksplodon.

Mbassi prej anës së aleatëvet vuemja në veprim e këtij mjeti të ri të luftimit në brigjet e Kanalit, u pranue, fuqitë gjermane të vëzhgimit konstatuen se anije të transportit t'anmikut iargohen prej skelavet për me iu shmangë çdo ndodhjeje të papritun. Kjo dëshmi regjistrohet në Berlin në favorin e në suksesin e «anijeve eksploduese».

Mortaji asht i mbushun

Ngrihet dorze e fundit të nji mortaje te bremza automatike.

Prej nga e merr Moska arin

Mjerim i përgjithëshem në uzinat ku lahet florini

«Legalizimi» i vendeve të punës së detyrueshme, i njoftuar para pak kohe nga Moska, tërheq vrejtjen së tepërmi të botës, mbi këtë institucjon krejt bolshevik.

Në bazë të planit të pregatitur nga qeverija Sovjetike, kjo fushë përqëndrimi për punë të detyrueshme gjigante e cila shtrihesh mbi të gjithë cepin veri-lindor të tokës azjatike dhe që përmblidhte afro gjysmë milioni rob të dënuarish, duhesh brenda verës 1938 të nxirte nga toka e tharë si gur 300 tonelata ar. Me dhjetra mijë njerës të dobësuar të raskapitur dhe gjysmë të ngrirë, tli të terrorit të Jeshow-it u transportuan në sondazhet e arit dhe të metalit nën administrimin fabrikavet veriore të minjeravet.

Dita pune prej 16 orësh

Fushata e larjes së arit kishte filluar; porse norma e nxjerrjes së arit që ishte caktuar për shpellën Tumany, sikurse për të gjithë vendin e Daljstroi-t nuk qe mbrijtun asnjiherë. Administrata e fushës së përqëndrimit për t'i shmangur qortimet e vazhdueshme të Moskës, vendosi shtimin e nxjerrjes së arit t'a bente me anën e «intensivimit» të punës. U vu në veprim dita e punës 16 orësh. Brigatat e punës që përbëheshin prej robrish politikë u vunë nënë «pushtetin e urdhnimit» të kriminelëvet të privilegjuar, të cilët, ata që mbetshin prapa në punë i torturonin brutalisht. Shpejt u ralluan radhët e punëtorvet nga shkaku i shkatrrimit të nervave nga puna dhe nga racjoni krejt i pamjaftueshëm i ushqimit me gjith «veprimin» energjik prej anës së trupavet shtazarake të rojës. Me gjith këto masa të marruna, përfitimi i arit ishte gjithënjë ne zbritje.

Mbassi kishin shkuar këto të gjitha edhe ari që donte qeverija për qëllimin e pregatitjes së luftës dhe të revolucjonit botnor, nuk u fitua. hyri terrori i Jeshow-it me të gjithë forcën brutale në Kolyma «Komisjone prej tre vetash të NKVD» të posaçmë të pajosur me fuqi të jashtzakonshme u bënë zotër mbi jetë dhe vdekje të robërvet te dënuem.

Si përherë u fillua prej së «sipërmi». Nji sasi inxhinerë eprorë të administratës dhe të minjeravet të arit u pushuen nga puna, duke i dënuar me më shumë ose më pak kohë me premje lirije ose edhe duke i vrarë.

120.000 njerz të vdekun

As shërbimet e njihershme, as gradimet nuk mund t'i shpëtonin këta nga ky fat. Njerzit e administratës të tremë bur nga kjo gjë u nxitnë pra t'ja lënpërgjegjesinë e mos-haritjes së shifravet nga plani i parashikuar krejt robërvet të dënuem dhe u paraqitnë «komisjoneve të të treve» të tmershme materjal të mjaftë kundra tyre. Çdo mëngjes këndonte komandanti i fushës së përqëndrimit para robërvet të reshtuar në radhë, nji listë të gjatë emrash në një qetësi varri, e cila mbaronte përherë në formulën: "... për sabotazhe kundra-revolucionare dënuar per vdekje me pushkatim. Vendimi i zbatuar menjiherë,,.

Natë verën e paharrueshme asnjeri nuk ishte i sigurt, se a do t'a shifte ditën e nesërme. Rastësisht, dëgjoi një rob i dënuar, i cili ndodhet tashti në Gjermani, nji fjalim midis shefit të minjërës së arit Swirin dhe shefit të administratës Pliner, një çifut Tschekist i përmendur. Nga ky fjalim u muar vesh se në verën 1938 përmbi 120.000 njerës lanë jetën në krahinën e Kolymas. Në administratën e minjerës së arit Tumanny duhesh të resitshin si të humbur 13.000 burra ose 26 për qint nga gjendja e përgjithëshme e personelit.

Ky është ari, me të cilin Moska paguan agjentat e saj në të gjitha shtetet: ar i fituar me gjak për të derdhur edhe më gjak.

Ardhja në vehte dhe këthimi

Kujto Pejën

Letra që vijon asht nji përgjegje. Asht shkrue prej nji djaloshi shqiptar, i cili pak përpara pat marrë nji letër prej nji vajze nga malet.

E dashura shoqe Georgia!

Letra e jote më ra në dorë, dhe po e këndoj me lot ndër sy, dyke mejtuar që drejtohet nga një çupë shqipëtare që ka lenë vatren dhe prindrit e saje për të cillët nuk don të dijë gjë më përpara interesit të Atdheut që gjendet nën kambën e okupatorit gjesman!

Edhë i nënshkruari shoqja ime ka qenë për ca muaj në radhët e atyre që gjendesh ti, por dyke kuptuar që, prapa kurrizit kemi Tito-n që d.m.th.: TRAJNA INTERNACJONALNA TERRORISTNIÇKA ORGANIZACJA (organizata internacjonale e mshehtë e terrorit), e cila po sundon për shkatrrimin e vendit t'onë, dhe të smadhimit të një tjetrit që ka patur gjithnjë aspirata të çdukjes dhe të farosjes të fisit shqipëtarë, gjeta rastin dhe shpëtova nga thojtë e ujqve gjakpirës. Meladinit me shokë!

E njoha udhën e gabuar dhe u gtheva, e tani m'eshtë mbushur koka që kam patur të drejtë, dhe prova të fundit mbi Rumanin, Finlandin, e Bullgarin, e forcojnë edhe më tepër mejtimin t'im se kam qenë i gabuar.

Ti më mbure o shoqe që i paskeni dhenë grushte të forta okupatorve nga ana e jugut, por nuk mejton që popullsija e jugut u shkatrrua krejtësisht, dhe që përmbi të gjitha, dhe vllezrit ose shokët e shoqet grekë po vazhdojnë terrorin mbi armiqt e prijsave t'uaj të huaj, vllezër t'onë të Camëris?

A nuk mejton pak tragjedin e Pejës, t'urdhëruar nga symboli i liris së popujve TITO?

A nuk mejtoni që veprimet terroristike t'uaja në kohën e fundit, po shkaktojnë djegëje e rrenime të popullsis të rretheve?

Natyrisht juve nuk mund të gjykoni më gjatë se e keni mendjen ndër stervilje të sportit, dhe të theatros, por nuk mejtoni që ato copa që po i pregatitni, do t'i çfaqni përpara gërmadhave të qyteteve ku do të shkelni! Besonj që me kaq do të mjaftojë, që të kuptoni që jeni në udhën e shkatrrimit t' ATDHEUT.

Të fala paqësore:
(Shoku Ziqerija)

Humbja e përgjithëshme mbrenda tetë muajve: 26700 ajrorë

Një forcim i fuqivet mbrojtëse ajrore gjermane është shkaku, që qysh prej ditësh është duke u kaluar qindi i ajrorëve të rrëxuar prej mbrojtjes ajrore gjermane, deklarohet në rethet ushtarake të Berlinit. Forcimi i mbrojtjes ajrore gjermane, ka të bëjë me vënjen në veprim të sasiravet të shumta ajrorë gjuejtës.

Po t'u shtohen këtyne humbjeve t'armikut edhe rrëzimet që kanë bërë gjermanët në perëndim dhë në lindje, të cilat janë shënuar me 24.000 ajrorë të rrëzuar gjitsejt në të njëjtën kohë, atëhere del humbja totale e armikut me nji shumë prej 26.700 aeroplanë në muajt.

Të shpartalluar e të asgjësuar. Ata mbajnë veshje civile: një provë për mënyrën dhelparake të luftës bollshevike.

Gjakderdhje e madhe sovjetike në frontin e lindjes

Humbje të mëdha materiali - Nuk ka sukses strategjik të Moskës

Mbi çashtjen e sukseseve difensive të dallueshme të trupave gjermane në frontin e lindjes, qi kanë përfundue me asgjasimin e afro 4200 qerreve të blindueme dhe 5000 topa në vazhdimin e këtyne katër javëve të fundit. Zyra e lajmeve mëson edhe disa hollësina të tjera: «Si pasojë t'orvajtjes për depertim të bolshevikëve në veri të Njemen-it në fillim të gushtit në sektorin e njij armate me elementa të blinduem, 259 qerre të blindueme janë shkatrrue mbrenda dy ditëve.

Në zhvillim të luftës difensive pranë Rasinen qi ka vijue gjashtë ditë, trupat gjermane, prej datës 4 deri në 9 gusht kanë asgjasue pothuej të gjithë efektivën e qerreve të blindueme të dy trupave të blindueme sovjetike. Në vijim të terheqjes së bolshevikëve, te cilët synojshin me arrijtë Rigën, dy divizjone fanterije, me mjete të reja luftimi antikarrosh, në bashkëpunim me nji brigadë topash sulmi, mbrenda tri ditëve kanë shkatërrue 108 qerre të blindueme, ndërsa në veri-lindje të Varshovis granadjerët e armatës, t'SS gjilhashtu edhe parashutistat e divizjonit Herman Goering, nën komandën e mareshallit Model, kanë kthye mbrapa trupin e tretë të blinduem sovjetik.

Nji armatë elementash të blinduem, e vume në vijën e pjesës veriore të sektorit të mesëm, ka asgjasue ose zanë plaçkë, ndërmjet 26 korrik dhe 25 gusht, 1244 qerre të blindueme, 1612 copa artilerije dhe ma tepër se 1000 mitra.joza dhe bomba-hedhëse, gjithashtu edhe 72 ajrorë kanë qenë rrëzue me armët e fanteris. Në qoftë se shtojmë humbjet e lajmërueme për muejin gusht në kumtesën e forcave t'armatosuna gjermane të sotëshme, humbjet në qerre të blindueme prej 3900 copësh, të lajmërueme me datën 3 gusht për muejin korrik, sovjetët në vashdimin e këtyne dy muejve të fundit kanë humbë ma shumë se 8000 qerre dhe së paku të njejtin numer copash artilerije.

Këtyne humbjeve duhet t'u shtohen edhe humbjet e armëve të tjera të fanteris, gjithashtu edhe të forcave ajrore, të cilat janë nallësue tash së fundi në shifra të mëdhaja, si nëpër regjimentet sovjetike të luftimit ajruer, ashtu edhe ne gjuetarët sovjetikë. Këtyne humbjeve të mëdhaja në materjal, duhet me u shtue edhe humbjet e përgjakëshme jashtëzakonisht të randa në vazhdim të luftimeve të rrepta ku kanë mbetë 80,000 të vramë dhe 300.000 të plaguem. Këto shifra tregojnë haptazi me çë farë flijimi i kanë pague bolshevikët fitimet e tyne në toka pa mundë me ia dalë qëllimit.

Bombat mbi trupat kanadez

Si derdhet gjak për Angli

Dy herë i ka ndodh armatës së parë kanadeze ndër sulmet e fundit kundra Falaise, qe të bambardohen trupat dhe depot e municjoneve të tyne prej ajrorëve të anës së tyne. Të parën herë pësuenë kanadezët dame me 8 Gusht, kur bombarduesët e randë amerikanë gabuenë në qëllesat e tyne. Të dytën herë qenë ajërorët Lancaster dhe Halifax të britanikëve ata, që gabuenë. Megjithse u dhanë shenjat e njohtimit të rreguilluenë me bomba kanadezët, të cilat bomba ranë deri 4000 Yard mbas vijave të tyre.

Kësaj radhe së dytë kanadezët ndejnë si mbas deshmive t'atyne që panë, nji orë rresht nen breshnin e bombave angleze. Madhësija e humbjeve tregohet prej korrespondentave anglezë tue shenue se nji formacion që ashi gati për sulm pëson humbje shum ma të mëdha prej kësi soj bombardimesh se sa anmiku, që asht gati në prituje të sutmit dhe që gjindet në mbroje.

Morali luftarak gjerman i pathyeshëm

Lajmerime nga fushat amerikane të përqendrimit të robve

Dëshmit bindëse të moralit luftarak të pathyeshëm që populli gjerman po tregon bash në këto ditë të goditjevet që po pëson, për armiqt e gjermanisë janë si nji gja e papritur, mbassi atai kanë pritur të kundërtën. Riçeta, mbas së cilës agitacjoni bahej në London e në Washington, e me të cilën ajo deri sot asht tue punue, asht e thjeshtë. Ajo tregonte prralla përmbi nji ndarje të nacjonal-socializmit e të popullit gjerman tue parathanë se kriza ushtarake ndërmjet këtyne të dyve së shpejti ka me shkaktue ndarjen e plotë dhe përleshjen midis këtyne automatikisht. 20 Korriku 1944, me gjithë pasojat e veta dishmoj lamam të kundërtën dhe tregoi, se nji ndarje ndërmjet nacional-socjalizmit dhe të popullit gjerman asht e pa mundun për shkakun e thjeshtë, se këto të dyja janë identikë.

Në lidhje me ngjarjen e randësishme edhe për kundërshtarin t'onë që përmban akcionin e pastrimit të bamë në Korrikun e këtij vjetit, William Shirer-i, i cili vite me radhë ka qënë korrespondent gazetash e radiosh në Berlin, në gazetën «New York Times» ban aludime mbi nji realitet. Shirer-i, thekson në mënyrë të plotë, se shumica dërmonjëse e popullit gjerman ditë e vjete gjithnji përkrah Adolf Hitlerin tue krye punë mbinjerëzore për me sigurue fitoren finale gjermane. Në artikullin e tij thuhen fjalë për fjalë këto: «Amerikanët që pandehnin se shumica e popullit gjerman asht kundra nacjonal-socializmit, le të kqyrin robët gjermanë të tuftës që ndodhen tash n'Amerikë. Këta ushqehen dhe trajtohen prej amerikanëvet konform në Konventën e Gjenevës. Gazeta amerikane janë vënë në dispozicion të tyne dhe mund të ndëgjojnë njikohësisht edhe radio. Shumë veta besojnë për këtë shkak se gjermanët janë gati t'i përshtalen sistemës s'onë demokratike. Mbi këtë gja nuk duhet aspak të mendojmë. Ata këtu n'Amerikë u banë edhe ma tepër nazista nga ç'kanë qënë në Gjermani. Ata besojnë në Adolf Hitlerin me nji fanatizëm që mund t'a bante nji i sëmurë dhe janë të bindun në fitoren finale gjermane.

Shirer-i shkon aq gjatë në përshkrimin e besimit që kanë gjermanët tek Fuhrer-i e tek fitorja e tyre, sa këtë besim e bindje t'a paraqesë s'i nji shembëll përpara amerikanëvet. N'Amerikë të shumtët e njerzvet janë të bindun, se radiot amerikane dhe shtypi amerikan i gënjen. Ai kujton rezultate që dhe pyilje e bame në «Detroit Free Press», mbas të cilavet rezultate populisja e këtij qytetit nuk beson aspak mbi poshtërsitë që tregon në lidhje me Gjermaninë e në prralizat që tregon shtypi dhe radio-ja amerikane mbi Gjermaninë. Ai asht i bindur se pohimet që bahen sot prej shtypit e radios së Shtetevet të Bashkueme në fund të luftës do të provohen si gënjeshtra të çpikuna.

Çifutnit nuk durohen

Mbi të njëjtën themë d. m. th. mbi moralin luftarak gjerman shkruen edhe George Herald në gazetën amerikane «Pic». Robët gjermanë të luftës janë në gjendje të mirë. Oficerë të rinj amerikanë shpesh nuk janë në gjendje mos me e çfaqë sheshit admirimin e tyne për këta ushtarë. Gjermanët nuk tregojn aspak shenja qoftë edhe ma të vogla të bjerrjes së moralit. Herald tregon se robët gjermanë të luftës tash po vijojnë me përshëndetë me përshëndetjen gjermane me dorën tue thanë «Heil Hitler». Kjo përshëndetje në nji çast shkaktoi komplikime por ma në fund Ministrija e Amerikane e Luftës dhe urdhër që oficerat amerikanë të pranojnë përshëndetjen zyrtare të ushtrisë gjermane. Gjithashtu robët gjermanë të luftës nuk kanë duruar që ushtarët amerikanë çifutë të kryejnë shërbime n'ato vende ku janë përqëndrue këta, dhe kështu kanë ndërhy që të tillë ushtarë amerikanë të largohen prej këtyne shërbimeve.

Ramja e pikës në Moskë

Kryeministri finlandez si viktimë

Kryeministri finlandez, dhe kryatari i marrveshtjes për paq në Moskë, z. Hackzell, u godit prej pike në njoftimin e konditave sovjetike, i cilli u paralizue në anen e mbajtë të trupit, e, humbi edhe gojen.

Zyrja e jashtme gjermane njofton se, Hackzelli u nis për në Moskë me shndet të plotë. Por kushtet sovjetike e shternguen njeriun e fortë të rrxohet për dhe.

John Bulli, këcimtarja e baletit e GPU

Para ca kohë, John Bull ish ambasadori i Shtetevet të Bashkuar në Moskë me rastin e nji pyetje që iu bë nga ana e Institutit-Gallup mbi marëdhënjet me Rusinë Sovjetike çfaqi kënaqësinë e tij të vërtetë për «miqësinë» anglo-bollshevike që ekzistonte.

Mbi qëndrimin e tij në Unionin Sovjetik zoti Bulli ka shkruar një libër mjaft të begatshme. Këtë libër e përdorin tash bolshevikët si nji dokument politik për vërtetimin e miqësisë ndërmjet të Shtetevet të Bashkuara dhe të Unionit sovjetik. Porse këtu auktori i lë në heshtje disa sende, që janë si me thënë baza e simpathisë së Bullit ndaj Sovjetëve,

Nuk mund të shifet si gjë e jashtzakonshme që Bull atëhere mori pjesë në një çfaqje të Ballett-it të Moskë dhe që ishte kënaqur së tepërmi nga vallja e balerinës Olga Lepeschinskaja. Poso kishte çfaqur ambasadori gjykimin e tij, i muarnë lejën atij me njëherë për t'ja prezantuar artisten. Ndërkaqë prapa perdes e shtytën balerinën mbi interesimin e gjallë të amerikanëve dhe iu kërkua që t'a ftonte kjo ambasandorin në çfaqjen e ardhshme. Lepeschinskaja e mori vesh mirë se ç'kuptim kishte kjo kërkesë e direktorit të theatrës shtetnore. Me disa fjalë kortezije që i a patnë ngulur kësaj në vesh e ftoi Bullit-in, i cili vajti pikërisht në orën e caktuar duke i shpënë edhe një byzylyke të çmuarshme. Lepeschinkaja, si pjestare e organites së rinisë komuniste, i u drejtua sekretarit të Komsomol me pyetjen, «në se kishte të drejt si pjesëtare e Komsomol-it, të pranonte nga një përfaqësues të kapitalizmit peshqeshe, mbassi kjo gjë ishte në kundërshtim me statutin dhe programin». Sekretari i pakëshillueshëm i u drejtua për këtë gjë komitetit të partisë. Me një herë i erdhi përgjigja nga ana kompetente: «në interesë të proletarjatit dhe të revolucionit të përbotshëm duhet Lepeschinskaja t'i lërë me nj'anë bazat themelore të Komsomol-it. Është e nevojshme që kjo t'i vijë pas qefit në çdo mënyrë Bull-it». Mbi këtë e pranoi balerina dhuratën kapitaliste.

Dal nga dalë Bullit-i u pushtua krejtë prej Charm-it të gruas së re. Ay çfaqi dëshirën që t'a vizitonte në shtëpinë e prindërvet të saj. Por mbassi kjo banonte në një lagje të ndyrë të mjerumish, e rregulloi partija që kjo t'a priste dashnorin e saj në nji shtëpi luksoze të pregatitur posaçërisht. Në darkën e zgjedhur, që dha Lapeschinskaja për nder të ambasandorit muarën pjesë një tok miq, të cilët kjo nuk i njifte fare por që duhesh t'i prezantonte kjo si të afërmit dhe si të njohurit e saj.

Bullit-i u ngatërua kështu krejt në rjetat e GPU. "Të afër mit dhe miqtë" e dashnores qenë tashti përcjellësit e përherëshëm të tij dhe në udhëtimet e dëfrimit nëpër Moskë dhe ndër gostirat në ambasandën amerikane e bënë për vehtë për luftën e përbashkët të Shteteve të Bashkuara dhe të Unionit Sovjetik kundra Fashizmit.

Aventurat e Zotit Bullit u përhapnë ndërkaq edhe në Amerikë. E shoqja kërcnonte me procese skandali edhe rethet e opozitës kundra Roosevelt-it i përdornin këto për dobi të vet. Roosevelti u detyrua t'a heqë Bullit-in nga Moska edhe t'a shtyjë dallaverën e pregatitjes së luftës për disa vjet. Lepeschiskaja u shpërblye mirë. Kjo mori ndër të tjera, Urdhërin e Lenin-it dhe u zgjodh deputete në Këshillin ma të Naltë. Prej kësaj historije kuptohet mirë nënshtrimi i Bullit-in nën Sovjetët, i cili e shprehu këtë në nji fjalim që mbajti në Philadelphi afro para nji viti: «Neve sëbashku me Sovjetët duhet të caktojmë të ardhmen.»

Nji Katyn i dytë?

Polonezët nën kërbaçin sovjetik

«Nji Katyn i dytë?» pyet gazeta «Voz» në lidhje me lajmet e përhapura nga një stacjon polak, mbas të cilavet 220 oficerë dhe ushtarë, të ashtuqujtura trupa të polltikës së mbrendëshme, janë zvarritur prej rusvet në një vend të papërmendur mbrendà në thellësirën lindore të Rusisë. Në lidhje me Katyn in zgjuan ky lajm një tmerr. Stacjoni i radios polake paska lajmëruar edhe se grumbuj ajrorë rusë paskan qarkulluar Varshovinë, pa i u siellë ndonjë ndihmë polakëvet luftues edhe pa i prekur gjermanët por vetëm e vetëm për të kqyrur gjendjen në qytet.

Kështu e trajon Rusija Sovjetike atë vend, për qefin e secilës fuqitë perëndimore hynë në luftë. Nga ana e fuqivet perendimore nuk u bëka ndonjë prolëstë. Thirrjet që iu drejtojnë aleatëvet polakët të pafat nuk paskan shërbyer asgjë. Rusija paska përhapur një hije të rëndë ndër aleatët. Moska paska vendosur të jetë barbare përkundrejt polakëvet edhe pasko qëllim t'a vazhdojë këtë mënyrë pa u shmangë. Me gjith atë paska njerës, të cilët presin prej Moske një bashkëpunim të çmuarshëm për rindertimin e botës.

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Premte 22 Shtatuer 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 08 344 — Nr. 29 - ÇMIMI 1 LEK

Bombat "V. 1.„ fluturojnë prap

Woolton korigjon Churchillin dhe Morrisonin

E verteta permbi efektin e pamohueshem te "meteoreve-dinamitë„

A e mbani mend se çfarë gënjeshtrash shpallnë gazetat dhe radiot angleze kur ranë të parat bomba fluturuese mbi Londonin? Atëherë u patën thanë se ajrorët anglezë të gjuetisë përnjiherë rrëxuen dhjetë prej këtyne bombave fluturuese. u patën thanë se damet e shkaktueme ishin të pakta dhe se nji qen ishte goditun prej nji bombe fluturuese dhe njëra nga këto bomba fluturuese kishte mbetur në nji pemë, etj. etj. gënjeshtra të pa krypë. E si qëndron e verteta?

Lordi Woolton, Ministri britanik i rindërtimevet tash dha nji njoftim t' hollësishëm përmbi të vërtetën. Ky njoftim i cilson deklaratat e bame ma parë prej Ministrit të Mbrendshëm Morrison e prej Kryeministrit Churchill si gënjeshtra të plota, pse damet e pësueme janë shumë ma të tmershme nga sa kujtoi bota.

Bombat fluturuese vetëm në London shkatrruen krejtësisht as ma pak as ma shumë se 23.000 shtëpija dhe damtuem 1.1o4.ooo të tjera.

Ndërsa prej msymjevet ajrore qysh prej fillimit të luftës e deri sot vetëm 84.000 shtëpija u shkatrruen dhe 142 mij të tjera u damtuen, brenda dy muajvet të veprimit të bombavet fluturuese u shkatrruen 23.000 shtëpija dhe 1.104.000 të tjera u damtuen. Porse Lordi Woolton konform me zakonin e englezëvet, të cilët kurrë s' e thonë krejt të vërtetën, heshti përmbi damet e shkaktueme prej Dynamit-Meteorëvet n'Anglinë e jugut, jashta Londonit.

A e dini tash se përse nuk kursejnë amerikanët dhe anglezët asnji bjerrje për me përparue sa ma shpejt në Francë? Përse sakrifikojnë pamëshirë kaq tanksa e njerës? Ata duen me i shkatrrue sa ma shpejt bazat prej kah nisen bombat fluturuese V. 1. nga Franca.

Porse tamam në natën mbas bisedës së mbajtun prej Lordit Woolton, u shtërngue agjensija Reuter të lajmëronte se bombat fluturuese, Meteorët-Dyaamit i a nisën prapë punës së tyne të shkatrrimit të tmerrshëm kundra Anglisë tue ardhë tash nga nji drejtim linduer dhe jo nga jugu si ma përpara. Me V1 mund të gjuhet prej nji largësije shumë ma të madhe nga çka besuen englezët.

Lordi Woolton i u lut anglezëvet të ikun, të cilët kanë besue se ditët e tmerrit kishin kalue, që të vazhdojnë të rrinë atje ku janë. Aftësija gjermane për me shpik mjete të tjera djallore shkatrrimi ende asht e pambaruem. Wooltoni tha se 83.000 puntorë, pra nji armatë e plotë, asht tue punue tash për tash vetëm në London për me i riparue shtëpijat. Sa do të jenë ata nesër? Sa të tmerrshme do të jenë bjerrjet anglo-amerikane kur të vihen në veprim armët e reja, të cilat u njoftuen prej Dr. Goebbels-it? A e dini tash sepse Churchilli e Roosevelti pa pritmas gjermanvet po u bajnë me urgjencë propozime për me ba paqë?

Sepse ata e dinë se faza ma e tmershme e luftës vetëm tash ka me fillue.

Gendja do të ndryshoj

Dr. Goebbels flet mbi armë të reja

Ministri i Reichut Dr. Goebbels në nji intervistë që i dha përfaqësuesit t'agjensisë Japoneze «Domei» deklaroi për sa vijon: «Ndryshimet që do të decidojnë mbi gjendjen e luftës, kanë me u çfaqë përsëafërmi. Masat e marruna për luftën totale deri tash kanë luejtur nji rol të shkëlqyeshëm. Divizionet e rekrutuem në Gusht janë gati për veprim. Për Shtatorin duhet të mbledhim dhe ma shumë divizione. Edhe këtë kërkesë do t'a plotësojmë punktualisht.

Efekti i armëvet të reja do të jetë i tmerrshmë. Armiku brenda pak kohe ka me e shijue efektin e tyne. Mbassi armiku e di efektin e tmerrshëm të këtyne armëve përpiqet t'a mbarojë shpejt luftën. Me këtë munt shpjegohet presioni i fortë i armikut në të gjitha frontet. Por me gjith këtë nuk ka njeri në Gjermani, i cili do t'isfrte gati me kapitullue. Armiku ka derdhë shumë gjak. Ai duhet të sakrifikojë edhe ma shumë e ma në fund ka me kuptue se Gjermaninë kurrë s'ka me e mposhtë e me e mundë.

"Çlironjësit„ si udhë-tregonjës të bollshevizmit

Agjentë të Moskës turbullojn Evropën perëndimore

Bashkë me përparimin në Ballkan sovjetikët po bajnë nji ofensivë me sukses të plotë edhe prapa vijave të anglo amerikanëve. N' Itali grupe të kryengritësve kanë vue dorë mbi depot e ushqimit të trupavet okupuese aleate n' Apeninët. Nji dergatë sovjetike asht në rrugë per në Romë për me u bashkue atje me shokët e tyne të parimit komunist, që të veprojnë edhe në punët politike të mbrendshme italiane. Ata deklaruenë sheshit se Moska duhet të ndërhyjë.

E njejta pamje paraqitet edhe në perëndimin e okupuem. Në Paris botohen 14 fletore të përditshme, ndër të cilat fletorja komuniste «Humanite» botohet në 200.000 ekzemplarë; fletorja social-demokrate «Populaire« botohet në 160.000 ekzemplarë, të tjerat fletore botohen në 120.000 ekzemplarë. Fletorja e vetme ëë Bruksel asht fletorja komuniste «Flamurì i Kuq».

Agjentat sovjetikë hodhën në zjarr në Bruksel pallatin e famshem të Drejtësis.

Zhvillimi i këtyne ngjarjeve formon objektin e bisedimeve dhe të këshillimeve të thella edhe në Quebec. Tashti aleatët po formojnë nji ide përmbi aleatët e tyne të kuq, të cilët dikur vetë i patën thirrë. Prej Londonit e prej Washingtonit ju ba me dijtë de Gaulle-it për me qendrue kundra bolshevizmit të Francës. Porse për zbatimin e nji qëllimit të tillë, edhe sikur të donte, ai si krijesë dhe si kukull e Moskës asht ma i papërshtatshmi ndër të gjithë francezët, gja kjo që nuk len asnji dyshim.

"Daily Telegraph" çuditet

Ma shumë për të blerë se në Londër

Supriyat e korespondentave britanikë në France dhe në Belëgjikë nuk kanë mbarim. Tash edhe korespodenti i gazetes angleze «Daily Telegraph» konstaton së jo vetëm në Francë, por edhe në Belgjikë për habinë e tij ma të madhe rethanat janë shumë ma normale se sa pandehej në London. Nuk mund të konstatohet kurgja për sa i përket shtypjes së popullit, shkatrrimit t'industrivet dhe të tokavet për bujqësi. Për tregtoret gjinden ma shumë gjana për me u ble se sa për dyqanet angleze dhe ushqimet janë ma të mira e ma të bollëshme se sa edhe në restaurantet ma të shtrenjt angleze.



Afje tej, mbi rërë, duken disa pika të zeza: janë mina. Personeli i armës mbrojtëse kalon në për ujë, drejt atyre, për t'i bërë ato të padëmshme.

Parajsa e puntorvet

Si e mendojnë n' Amerikë

Në «Courrier de Geneve» të datës 17-5, u botuan mendime mbi skllavërinë bolshevike të punëtorëve të fabrikave. Fletorja shenon profesorin e Universitetit Columbia, Max Eastman, nji specialist për çështjet sovjetike, që ka qëndruar për dy vjetë rresht në parajsën e kuqe. të cilën e përshkruan në këtë mënyrë: «Në fabrika nuk ekziston barasi, liri, as të drejtë për të krijuar korporata të pamvarura punëtorësh; atje nuk ka të drejtë për greva, as nuk ka të drejtë punëtori të ndrroje punë.

Punëtori asht i lidhur ndaj maqinës dhe i shtrohet tarifit të pagësës si ne asnji vend tjetër të botës. Tarifi i pagës në krahasim me çmimet është shumë më i ultë se në kohën e Carit. Si mbas të çmuarit prej anës s' atyre që e njohin më mirë gjendjen, ekzistojnë të paktën 10 miljon njerës që rrojnë ndër fushat e përqendrimit të punës së detyruarshme, ku shuhen 10 miljon skllevër. që ushqehen keq, banojnë keq, vishen keq, të mjeruar dhe të përbuzur. Kjo është klasa më e fundit, në të cilën bazohet ndertesa e ashtu quajturës demokrati ekonomike».

Në te vërtet, jo një fakt enkurajonjës për ata. të cilët besojnë se komunizmi do t'u sjellë lumtëri dhe mirëqënje.

Sofia ne tmerin e kuq

T'aratisun në kufirin turk

Simbas nji lajmi t'ardhun nga Sofja thuhet se qindra automobilash me personalitete të shqueme, të cilët akuzohen si bashkëpuntorë me gjermanët, kanë mërrijtë në kufinin turk. Mirpo auktoritetet turke nuk i kanë lanë me kapërcye kufinin. Populli i Sofjes po pret në tmerr ardhjen e ushtarëve sovjetikë. Shumë personalitete të jetës kulturore, si mjekë. advoketen, shkrimtarë dhe politikanë kanë vra vehten.

Njisite poloneze te lodhuna

Kanë heqë dorë nga çdo shpresë

Polonezë të zanë rob, të cilët patën ba pjese në njisitë e gjeneralit Anders dhe që patën luftue në frontin Italjan, deklaruen se këto njisina po tregojnë shenja të forta të nji lodhjeje nga nji luftë e nga nji gjak-derdhje që po bajnë në toka të huaja e për interesa të huaja. Nji urdhën dite që pat lëshue gjenerali Anders këto kohët e fundit përmban nji fjalim shumë t' ashpër, e në të cilën thuhet se polonezët duhet të luftojnë "deri në të mbramin njeri pa u shkëmbye prej njisinash të tjera„. Natyrisht ky urdhën po të merret parasysh gjendja dhe fati i Polonisë ka kontribue për me e keqsue edhe ma teper moralin e njisinavet poloneze.

Robët e zanë deklaruan se ushtarët polonezë kanë heqë dorë krejtë, nga shpresat e tyne për me u kthye edhe nji herë n'atdhe. Ndjenja se vendi i tyne iu dorëzue bolshevizmit pa kurrnji ndihmë, i ka dëshpërue së tepërmi. Edhe shpresat e vjetra se Anglija do të hynte në veprim për rikrijimin e shtetit polonez, tue marrë parasysh se anglezët gjithmonë po lëshojnë pë e po zmbrapsen përpara kërkesavet sovjetike, po thuaj u çdukën krejt.

Fabrika e madhe e Revalit «Pushk ja pojad» e çkatërruar prej Bollshevikëvet. Si shihet, m'Unionin sovjetik çpronësohen edhe punëtorët.

Fuqitë perëndimore s'kanë kohë për veprime lufte

Gjendja e tashme si pas gjykimit t'armikut

Fletorja «Volkischer Beobachter» sjell nji lajm prej Lisbone nën titullin: «Fuqitë perëndimore në ngushticë kohe për veprime ushtaraku tue aludue në këtë rast mbi tletoren amerikane «Mew Herald Tribune», e cila boton gjykimin e nji oficeri të naltë të shtabit të përgjithshëm amerikan.

Në qottë se anglo-amerikanët dhe Sovjetët nuk ia mbrrijnë fitores së tyre mbrenda vjetit 1944, atëherë ka me u krijue nji gjendje e re zhvillimi dhe fundi i së cillës nuk mund të parashikohet.

Fletorja "Volkischer Beobachter„ shkruen në lidhje me këtë se as Roosevelti as Churchilli janë të kënaqur me rezultatet qoftë ushtarake, qoftë politike t'ofensivës së tyne të bame në Francë. Disa lajme t'ardhuna prej Washingtoni njoftojnë se në Quebec u prekën mjerisht problemat e luftës së ardhëshme në Pacifik.

Në lidhje me luftën e Pacifikut bashkëpuntori i shtypit Levis Sebring shkruen në të njajtën tletore amerikane se plani për nji ofensivë në Pacifik parashef kryemjen e veprimeve ushtarake për krejt vjetin 1945 dhe se askush që njeh faktet mund t'a shikojë me optimizëm mbarimin e kësaj lufte. Amerika duhet t'a ngushtojë shumë rypin e saj para se mbarimi i kësaj lufte të duket.

Anglija koloni veri-amerikane

Lufte për zotërimin e përbotëshmë

Kthyerja e Anglisë në një koloni e Shtetevet të Bashkuara po bën hapa gjithënjë me tej. Në gazetën "Times„ flitet se ka të ngjarë që Shtetet e Bashkuar të zgjedhin nisinë britanike si bazë të tregëtis së tyre n' Evropë (natyrisht kjo do të që në dëm t' eksportimit engles). Tregëtarët e Shtetevet të Bashkuar kanë nevojë të sherbehen nga njoftimet e ekonomisë engleze në tregëtin evropjane. Anglia qënka "ideale„ si bazë ekonomike për Shtetet e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuar duhet t' a kuptojnë këtë.

Gjer sot Anglia qëndronte, në të gjithë tregjet e botës e, mbi të gjith n' Evropë, në konkurrencë të madhe me Shtetet e Bashkuar, kurse tashti ajo po i shërben ekonomisë veriamerikane për tregëti në kontinentin evropjanë. Dhe kjo ekonomi e Shtetevet të Bashkuar shpreson të bënjë pas lufte. më ndihmën e çifutëris së përbotëshme dhe në kurris të popujvet t'Evropës, me bollshevizmin, tregëtitë më të mbëdha që munt të jenë zhvilluar nonjë herë në Wallstreet, Tregëti amerikane për gjak evropjan dhe në këtë duhet të kontribuonjë Anglija, si koloni e Shtetevet të Bashkuar.

Fuqinat bullgape të çarmatosun

Njësi të forta gjermane kanë marrë persipër mbrojtjen e krahinave, që deri tashti kanë qenë të pushtueme prej bullgarve. Nji pjesë e divizioneve bullgare u dëftue e gatshëme me vazhdue në mbajtjen e detyrimeve, që rrjedhin nga besëlidhja. Mbas shpalljes së luftës bullgare pjesa ma e madhe e njësive u çarmatosë pa ndonjë incident. Tentativa e dy bataljoneve për me kundërshtue mujt m'u pengue që në fillim.

Churchilli dhe politika e tij sovjetike

Kush nuk e shef mimetizmin e Stalinit ai mbaron keq

Edhe sikur t'a marrim parrasysh se bolshevizmi theksin e internacjonales e ka veudosun në nacionalizmin rus. prap një gja e tillë nuk shënon asnji hap përparimi në dobi të botës. Parimet themelore të Bolshevizmit d. m. th. asgjasim i t'ashtuquajtunës formë jete borgjeze, shkatrrimi i pronës private. sundimi absolut dhe i përgjakshëm i partisë komuniste i shtrimë deri në jetën private të qytetarëvet sovjetikë etj, prapë janë në fuqi në Bashkimi Sovjetik. Nji sintezë e dinamikës së bolshevizmit me qëllimet e imperjalizmit rus për botën do t'ishte nji rrezik edhe shumë ma i math i shumëfishtë në fuqinë e vet shkatrruese se sa forma edikurshme e revolucjonit botnor bolshevik.

Edhe vetë Churchilli nuk ka me e mohue se partia komuniste në vendet e ndryshme edhc sot digjonë urdhërat e Moskës dhe vepronë me ndihmën e aparatit diplomatik sovjetik të nxitun prje agjentash të msheftë sovjetikë. E ashtuqeituna shpërndarje e kominternit në këtë mes nuk luen asnji rol. Stalini në vend të kësaj trilloi nji marifet tjatër të ri edhe ma të rrezikshëm: Ai i ka urdhnue komunistët kudo që ndodhen këta që të mvishen me petkun e nacionalivmit dhe kështu tue qëndrue në krye të t'ashtuquajtunavet «lëvizje çlirimi» të bahen kështu shkaktarët kryesorë të luftimit e të përpjekjevet luftimi e kundërshtimi në kampin e kundërshtarit.

Porse me këtë difamimi i partisë komuniste u ba i pamundshëm prej ndonji kundështari të karakterit burgjez e kombëtar, pse sikurse llogarit Moska askush s'ka me guxue e me iu shmangë me dyshim komunistave, të cilët qëndrojnë në krye për shembëll të ndonji lëvizjeje sërbe, greke franceze të shlirimit; përkundrazi kanë me ndjek elementin bolshevik me duar të lidhuna. Bolshevizmi i vjetër i mshefun në petkun e nacjonalizmit formon nji metodë të rë, me të cilën Moska kërkon t'iu a mbrrijë qëllimeve të saja të vjetra

Moska desheron shekullin e bolshevizmit

Le t'sypozojmë, për me i dëlë përpara në lamën e vet arsyetimit të Churchillit se bolshevizmi ia mbrrin me ndihmën engleze dhe amerikane të të shkatrrojë kalanë e mbrojtjes gjermane në kufijtë lindore të Europës. Çfarë forma jetësh kishin me u krijue n'Europë vallë ato të demokratisë perëndimore apo ato të lindjes moskovite? A ka ndonji mbush-mendje të tillë të gabuem Churchilli se përnjimend do të mund të përballojë efektet dhe pasojat e psikologjisë së popujvet tue ia mbrrijtë me i drejtue këta kah nji rrugë demokrate e qytetare? Ne rrjedhim të ligjevet politike dhe të psikologjisë së popujve do të ndodhte pa tjatër kjo që po themi këtu: Bolshevizmi kishte me dhanë dëshmi se në këtë luftë dhe në këtë fitore format e jetës bolskevike dhanë provat ma të nalta në fushat e betejës dhe këto prova qenë të zonjat me i mbajtë si në fushat e betejës ashtu edhe në atdhenë Sovjetik e se këto forma jete nuk janë nji teori marksiste e kotë por. u banë nji realitet i gjallë e që u dishmuen si ma të fortat përkundra të gjitha formave të tjera të jetës.

Pasoja do t'ishte nji përforcim shumë i math i idevet bolshevike në Bashkimin Sovjetik. të cilat idé tue pasë edhe tuqinë në dorë me të drejtë kishin me pasë pretendim me i diktue këtij shekullit ligjet e veta. Ky kishte me qenë çasti ku edhe në vende të tjera e para te gjithash në vendet armike do të jepte shkas nacjonal bolshevizmit nji shtytje të mbrendëshme për me ba nji hap drejt pushtimit të shtetit. Për ndihmë kishte me i ardhë në këtë rast para të gjithash n'Angli admirimi që propaganda angleze ka ngjallë në masat e popullit të vet përkundrejt aleatit bolshevik dhe fuqija fërheqëse e asaj mistike që në qarqet intelektuale dhe në qarqet e së mëngjërës asht tue u ngjallë përkundrejt Bashkimit Sovjetik prej mikrob-hedhsash çifutë n'Angli.

Terrori i kuq mbretëron midis popullit të Lembergut

Deklarata të bame prej t'aratisunish dhe emigrantash polonezë

Nji përfaqësusi te gazetës poloneze të Krakovis që botohet me titullin "Coniec Krakowiski» banorë të Lembergut që ia mbrijtën me kalue për tek pozitat gjermane tue u aratisë i banë njoftime interesante përmbi gjendjen e për mbi rethanat që sundojnd në Lemberg.

Mbas këtyne Sovjetikët qysh ditët e para rekuizuen të gjiha ndërtesat e mëdha dhe ndërtesa të tjera të posaçme. Njerzit filluen me u arestue në grup dhe u shtinë në burg. Nji numur jahudinjsh. të cilët duallnë prej vrimave të tyne të mshefjes, më këtë rast luejtën rrolin e spiunëve. Popullsija po jeton me ato mjete t'ushqimit që të kuqet kanë grumbullue në depo tue plaçkitë popullsinë andej këtej dhe të cilat mjete ushqimi i shiten popullit në tregun e zi me çmime jashtëzakonisht të nalta. mbassi nji shpërndarje e rregullt dhe e organizuem e ushqimeve nuk ekziston.

Të gjithë meshkujt prej 18 deri 50 vjeç duhet të paraqiten. Atyne që u shtërnngu me përdhunë të hyjnë në shërbimin ushtarak iu dhe të kuptojnë kjartë se në rast të mos-bindjes kanë me u dënue me vdekje. Mbas nji pregatitjeje e stërvitjeje prej 8 ditsh, seicilit prej tyne iu dha armë municion dhe iu dha nga dy bomba dore e u dërguan përnjiherit në front, ku nji pjesë e madhe e tyne kaloi tue u dorzue për tek trupat gjermane.

Trupet sovjetike sikurse deklaruen këta t'aratisun. grabisnin e plaçkitnin gjithshka që u bie në dorë. Njëri prej këtyne t'aratisurvet tha se ai e kishte parë vetë me sy se si ndaloi nji oficer sovjetik nji udhtar me revolin në dorë e si filloi me i kërkue xhepat e atij tue i a grabitë orën. Nji tjetër njofton se ai në nji vend kishte pá të vriten në rrugë 24 persona, e mbi kufomat e të cilëvet kaluen mandej tre tanksa sovjetike tue i shtypë e tue i ba copa copa.

T'aratisun polakë nga Lenbergu deklarnjnë se Sovjetët të gjithë banorët meshkuj i xvarritin nëpë vendet lindore ose i bashkojnë me kriminelë ndër kompani të dënuarish.

Casma në malet Marsavin u pushtua

Mbas luftimesh, që u zgjaten për dy javë, njësi kozakësh dhe kroatësh i kanë kryem ndër këto ditë veprimet e spastrimit, që i banë në Kroaci verilindore. Gjatë këtyne veprimeve, që u banë në krahinën e pyllzueme të masivit të Papuk dhe ndër male të Molsavin dhe të Bilagonës, çetat komuniste patën gati 800 të vdekun. Ashtu edhe numri i të plagosunve qe shum i madh. Pikëmbështetja e çetave në Casma, në prendim të malevë Moslavin, u pushtue. Ndër vende të tjera u ba një prejë e madhe. Humbjet t'ona qenë të vogla.

Permbi 100.000 finlandezë duan të aratisen në Suedi Autoritetet suedeze nuk dinë se si të sillen kundrejt kësaj vale të aratisunish. mbasi nuk kanë marrë ende Instrukcjone nga qarqet qeveritare.

Churchilli tjetër

Churchilli tha në një tjalim në radjo më 30 Mars 1940.

«Qeverija Sovjetike tue sulmue Finlandin heroike, i tregoi botës mbarë shkatrrimet, që komunizmi në substancë i ban çdo kombi, i cili bie tli e kësaj sëmundje shpirtnore dhe morale të vdekshme.»

Po sot?



Një top sulmi niset për veperim në sektorin e mesme të lindjes. Artiljeri shikon tokën, me vërrejtje të madhe. ku po e pret zjarri i armikut, i fshehur më së miri.

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Hënë 25 Shtatuer 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 56 035 — Nr. 30 - ÇMIMI 1 LEK

Vernon Bartlet i nxjerr lakrat në shesh

Ç' ngjau, në të vërtet, në Quebec?

Rusija Sovjetike nuk duron të nxitet kundra Japonisë

Komunikata zyrtare përmbi përfundimet e konferencës së mbajtun në Quebec avht gjith'aq e errët sa të gjitha komunikatat me këtë karakter. Vërejtësit neutralë ndër kohë kanë vue nji radhë momentash të papritura, të cilat të hedhin nji dritë të kjartë mbi rezultatet o ma mirë me thanë mbi dështimin e kësaj konference. Piksëpari u theksue përgjithsisht se për këtë konferencë ka pasë nevojë Roosevelti për me mujtë me e fitue përzgjedhjen e tij, votën e banorëvet që banojnë kah brigjet e Pacifikut në Shtetet e Bashkueme. Banorët e Kalifornisë e te Oregonit nuk interesohen për luftën që po zhvillohet n'Europë, por kishte me u interesue ma fort shpartallimi i Japonisë. Pra iu desht Rooseveltit që t' u premtonte këtyne se do të bënte nji ofensiv kundra Japonisë. Mirë po, Rusija me Japoninë po jetojnë në nji paqë të mirë. Për këtë arësye Stalini nuk mori pjesë as në konferencën e Kajros, mbassi ajo drejtohej kundra Jeponisë. Refuzoi gjithashtu të marrë pjesë në konferencën e Quebecut, tue mos dërgue atje as ndonji ambasador, ose Ministër të Jashtëm. Kështu lehtësisht mund të konkludohet se para të gjithash në Quebec nuk u mbrrijt aspak nji marëveshje me Rusinë sovjetike përmbi regullimin e problemavet europjane.

Varnon Bartlett, deputet anglez dhe komentatori politik ma i përmendun i radios angleze gjatë kohës së konferencës së Quebecut i drejtoi nji apel Kremlinit, me të cilën ai e qiti macen prej thesit. Ai ia bani me ditë Stalinit se Japonija vetëm me ndihmën e Sovjetëvet mund të mundet. Sovjetët duhet të kenë ndonji interes për me mbajtë për vehte skelat e Mandschurisë, d.m.th. ato krahina q'i janë premtue Çiangaishekut d.m.th. aleatit t'aleatëvet të vet. Vernon Bartlett u lut për këtë ndihmë sovjetike kundra Japonisë tue u ofrue Sovjetëvet me fjalë lakuriqe Dardanelat. Stalini pra të derdhë gjakun krejt në sherbim t'aleatëvet, që kështu ai në mbarim të luftës botnore të mos formojë ma ndonji rrezik për ta që t'ja bajn mandej edhe atij po ashtu sikurse i a banë Italisë me 1919 në paqën e Versailles-it.

Stalini si nji llogaritës gjak-ftohtë i punëvet e di se edhe vetë në rast të nji mundjes së pagjashme të Gjermanisë Japonija për të do të jetë gjithmonë nji shok shumë i nevojshëm në nji luftë të ardhshme të sovjetëvet kundra aleatëvet. Kremlini ka me fitue në bashkësi me Japoninë pafundësisht shumë ma tepër nga çka mund të fitonte tue qëndrue n'anë të aleatëvet kundra Japonisë.

Ushtrija japoneze gjatë luftës deri sot nuk asht prekun aspak në mënyrë serioze. As Anglija as edhe Shtetet e Bashkueme kanë me qënë ndonji herë në gjendje me vumë në veprim ushtrina të mjaftueshme ndër largësinat e mëdha të Pacifikut, po të merret parasysh edhe se Japonija disponon ende mbi nji flotë të paprekun dhe me ushtarë e marinarë që përbuzin vdekjen.

Dilema kryesore e dy kryefajtorëvet të luftës d.m.th. e Churchillit dhe e Rooseveltit tash në orët vendimtare të luftës po bahet ma e kjartë: Ndërsa zyrtarisht thonë se fitoren gjoja e kanë në xhep e dinë që të dy se nji fitore e tyne eventuale kundra Gjermanisë kishte me u bamë e pavleftë për shkak të nji lidhjeje ndërmjet Japonisë dhe të Sovjetëvet. Në lidhje me Japoninë sovjetët kishin me sjellë n'Europë gjithçka të donin, sikur mos t'u qëndronte përballë Gjermanija. Mirëpo, tash asht Gjermanija në nji lidhje të pakëputshme me Japoninë. Madje u dëshmue kjartë se vetë lufta në kufitë e Gjermanisë, fuqinë goditëse të Gjermanisë aspak nuk e pakësoi dhe se vetë Ministri i Luftës i Shtetevet të Bashkueme Stimson tha se fitorja asht largue së tepërmi.

Për se jeni tue ba këtë luftë pyesin njerzit me kuptim në Shtetet e Bashkueme. Për se janë tue dhanë jetën e tyne qindra mijra amerikanë të rinj n'Europë? A mos vallë që të vijnë Sovjetikët në trashëgim të Gjermanisë dhe flijnat t'ona të gjakut të shkojnë kot? Këto janë problemat e mëdha e të randa që i preokupuen orë me radhë në bisedimet e Quebecut dy shkaktarët kryesorë të luftës, Churchillin dhe Rooseveltin.

Bashkëpunimi gjermano-ungares

Dy gjeneralë t'ushtërivet të beselidhura në një bisedim mbi gjendjen.

Nji vjet regjim urije n' Itali

Nji intervistë tronditëse në nji gazetë amerikane

Themeluesi dhe kryetari i dikurshëm i shoqatës së shtypit katolik n' Itali Don Sturzo deklaroi gjatë nji bashkëfjalimi me nji përfaqësues të shtypit amerikan se ai ka frikë në lidhje me gjendjen n' Itali,

Sturzo në mënyrë të veçantë ia u hodhi në sy anglezëvet dhe amerikanvet, se ata me skllavërimin e ekonomis italjane i hapën dyert komunizmit n'Itali. Për kohen e tashme mund të konstatohen këto: Italija tash për tash asht tue jetue prova tragjike të cilat sigurisht nuk kanë me mbetë pa ndonji intluencë mbi jeten e popullit italjan. Shpresat e Sturzos se anglo-ameriknët kanë me i ndihmue popullin italjan janë shdukë.

Asht nji fakt se mbas nji vjeti okupimi anglo-amerikan rethanat n' Itali janë keqsue e po vijojnë të keqsohen në mënyrë të dukëshme. Popullì po vuan prej urisë dhe s' ka ma besim në t'ardhmen. Mjerimi filloj me çvleftësimin e plotë kë iu ba lirëtës nga ana e trupavet t' okupimit. Tregu i zi, në të cilin vetëm ushtarët amerikanë dhe britanikë mund blejnë dhe jo italjanët, qe hapi i parë që përfundoj mandej në urinë e në inflacjonin. Fakti se sot n' Itali komunizmi asht përhapë në formën e vet ma të dallume asht protesti i vetëm kundra kushteve të vështira të jetës. Urija dhe mungesat e kanë ba për të shumtët e italjanëvet të pa durueshme jetën.

Përmbi pyetjen në se në lidhje me këtë pasiguri të jetës në Itali asht prekë apo jo edhe feja, Don Sturzo u përgjegj në mbarim të revistës se mbas provave të tilla nuk ka dyshim se para të gjithash rinija italjane po bolshevizohet gjithmonë e ma tepër. Autoritetet kishtarë janë prekun së tepërmi për shkak të propagandës atheiste që po zhvillohet në Itali.

Një aserbaidschanas dekorohe

Në ndërmarrjet e spastrimit me sukse në Varshavi në një grup luftimi gjerman merrshin pjesë edhe formacjone vetëdashëse. Në luftimet e rrepta në rrugët e nëpër shtëpitë mundën vullnetarë aserbaidschanas dhe kaukasjanë të veriut të çlironin grupe të rethuara përkohësisht dhe t'u shkaktonin humbje të rënda kryengritësvet. Shumë vullnetarë u dekoruan për trimërinë e treguar me kryqin e hekurt. Si vullnetar i parë kaukasjan, një aserbaidschana mori kryqin e hekurt të klasit të parë.

Gjithkush për vehte

E ardhmja e Shqipnis

Pyetja përmbi të ardhmen e Shqipnis kudo po bahet në këtë vend prej të mëdhenjve e të vegjëlve, diku çiltas e diku mbylltas tue vumë në nji shqetsim shpirtnat dhe tue shkaktue të mehen energjitë në kryemjen e defyravet private dhe zyrtare. Mbas gjendjes shpirtnore e mbas pikpamjes, diku përgjigjet me nji po që shpreh nji bindje e diku përgjigjet me nji jo të dëshpëruem, me nji fakt ende të paskjaruem por, të parashikuem me hamendje. Në qoftë se Gjermanija e humbet luftën a kanë me e ndihmue vallë anglezët Shqipnin kundra sovjetëvet?

Sikur të hedhim syfë mbi të kaluemen e afërme do të shofim se lista e atyne shtetevet, të cilët Anglija, për hir të ndihmës Sovjetike i lëshoi në dorë të Moskës, ndërkohë u shtue së tepërmi. Ndër shtetet që u lëshuen pa kusht në dorën e Moskës gjindet nji radhë popujsh, të cilët kanë qënë shumë afër pikës së zjarrit të ndodhjeve politike të sotshme se sa Shqipnija. Për hir të pamvarësisë së Polonisë hyjnë gjoja anglezët në luftën e sotshme. Me gjith këtë ata ja hodhën bolshevizmit Poloninë, porsi nji llomkë.

Premtime qi s'u plotesuan kurrë.

Për Finlandën që në dimrin e vitit 1939-1940 i bani ballë mirë armatës së kuqe Churchilli në vitin 1940 shprehu fjalë enthusiazmi, njikohësisht krejt Amerika e Veriut u shpreh solidare me Finlandën dhe nga të gjithë qoshet e Perandorisë britanike u banë premtimet ma të nxehta për ndihmë të Finlandës. Me gjith këto Finlanda tash asht tue vuejtë fatin e nji shkatrrimi të plotë dhe gjithkush që flet anglisht në botë përdor fjalë mâllkimi kundra luftës heroike që bani Finlanda për pamvarësinë e për jetën e saj. Greqija që qëndron përkundrejt posedimenteve angleze të ishullit Cipros e të Egjyptit dhe që mbron rrugën e perandoris britanike, mori premtimet ma të mbëdha për në mbarim të luftës dhe qeverija Papandreu në Kajro, mori prej Londonit njanën mbas tjetrës karta të bardha për me ushtrue pushtet të plotë në çështjen e Detit Egje dhe në brigjet e këtij të banuem prej grekëvet. Por sot hesht Anglija mbi faktin që trupat sovjetike janë në marshim drejt Trakës.

Sikur të marrim parasysh problemat e së kaluemes së afërme atëherë parashikimet për Shqipninë që nuk asht në sy edhe kaq t'Anglisë dhe që përballë kësaj ka nji randësi të dorës së fundit, nuk janë veçse të errëta. Por ndoshta kaq ma tepër rrjedhimi politik ose llogaritë politike janë ato që në çastin a tashëm mund të jenë ma të shumta? Eh mirë, le t'i kqyrim njiherë mirë këto.

Në Teheran, Anglija ia lëshoi Moskës Ballkanin si nji hapsinë të influencës, Stalini vetë mbas nji lëshimi të titlë vuri në veprim fuqitë e mbrame të armatës së kuqe. Ai kaloi me të shpejtë me ndihmën e tradhëtarvet bullgarë e rumunë miopë. Rumaninë e Bullgarinë, ai po ve dorën për me zanë edhe krahinat ma të pasuna të Greqisë dhe njikohësisht në ish-Jugosllavinë ka vëndosur si pararojë dhe si ndihmonjës për likuidimin përfundimtar Marshallin e tij të bandave Titon. A ka me u ndalue prej Shqiptarëve? Mjafton të hedhim një sy mbi hartën gjeografike të Ballkanit për t'a zbulue se nji pikpamje e tillë asht e marrë.

Porse e patëm fjalën qysh në fillim përmbi anglezët. Anglezët sikurse nuk po ka



Ky avjator terrorist amerikan, si shumë nga shokët e tij, nuk e arritji tokën e Reichut. Ay u shtrëngua, mbi Hollandë, prej gjuajtësvet gjermane të çkëputej nga skuadrilja dhe pastaj u qëllua rëndë prej baterisë kunderajrore, mbrojtëse

ma asnji dyshim kanë vendosur Ballkanin me e lëshue plaçkë në dorë të sovjetëvet. A thoni se vetëm Shqipninë e kanë kaq në zemër sa nuk kanë me lejue që të venë kambë ushtarët e kuq në tokat e Shqipnis? A thoni se për hir të Shqipnisë, për këtë copë të vogël të Ballkanit të math janë vendosë ata, besëlidhunit dhe shokut te tyne të armës, Stalinit t'i dalin përpara, t'i thonë ndal edhe t'ja nisin nji luftë të tretë botnore kundra tij? Që kjo pikpamje asht edhe m'absurde se e para asht afër mendesh. Kjo pikpamje nuk asht vetëm imbecile por edhe e marrë dhe e trashë.

Na e dimë se çfarë përpjekje gjigantike janë tue ba fuqitë perëndimore tash për tash për me i dhanë fund sa ma shpejt që të jetë e mundun luftës. Nuk asht vetëm frika prej armëvet të reja gjermane ajo që i nxit për nji punë të tillë, por njikohësisht edhe nji lodhje nga lufta që shifet gjanë e thellë në masat e popullit të tyne. Ushtari anglez dhe amerikan para të gjithash dëshiron me shkue në shtëpi.

Vendimi nuk do te jepet m'at'ane kufivet

A thoni se Anglija e lodhur dhe e këputun në luftë t'i dalë përpara sovjetëvet për me i nxjerrë prej Ballkanit dhe në tokat e nji Gjermanije të mundun t'ja nisë prapë nji luftë të përgjakëshme e të luftojë njikohësisht në shtetet e perëndimit t'Europës punën dhelparake e dinake të nëndheshme të komunistavet? Kush mundet me e besue këtë?

Në këtë pikë në lidhje me ardësyetimet t'ona bahet e kjartë se problema e pyetja mbi të ardhmen e Shqipnis ashtu sikurse vihet, asht vumë gabimisht. Pse nuk asht puna për Gjermani dhe për fitoren o humbjen e kësaj, por asht puna për Europë. Askush në kontinentin t'onë ka mundësi t'optojë ndërmjet Gjermanisë dhe Anglisë. As njeri ka të drejtë ndërsa pyet përmbi të ardhmen e vendit të vet të presë deçidime përtej kufive dhe të bajë sikur të koshte dy kuaj në stallën e vet, prej të cilëvet njan sigurisht do t'a çonte tek qëllimi. Mbi pyetjen e së ardhmes së Shqipnis do të përgjigjet në zemrën e secilit shqiptar dhe deçidimi bahet këtu. Që rruga për atje asht caktue prej fatit nuk mundet e nuk duhet të bajë kënd të çkujdesun, të lodhun dhe pritës. Ekziston nji gatishmëni e rezistencës ma të madhe dhe e fenacitetit ma të madh që edhe në situatat që duken të dëshpërueshmë bile bash në të tilla situata ia mbrinë fitores. Gjermanija me këtë asht porsi shembëll në krye dhe Europa e shitun prej anglo-amerikanëve ka me e ndjekë Gjermaninë në rrugën e mbrojës gjurmë për gjurmë.

Kryengritje në Krime

Rrjedhim i politikës sovjetike

Robër sovjetik, q'u kapën në Rumani, thanë, të gjithë nje soj, se në Krime, në rrethet e Aaidarit ka plasur një kryengritje e kafundarëvet tartarë. Shkaku i kësaj lëvizjeje qënka politika gjaksore e Sovjetëvet, të cilët duan t'i futin Tartarët përsëri në Kolchoset, dyke u rrymbyer, njëkohësisht, edhe sendet yshqimore q'ata kishin grumbulluar gjate kohës së pushtimit gjerman.

Para provash të vërteta

Cashtja e rezistencës gjermane

Prova e vertetë për anglo-amerikanët asht në fillesën e saje, thot gazetari i famshëm Liddell Hart në fletoren «Daily Mail» në lidhje me rezultatet në frontin e perëndimit. Gjermanët ia mrrijtnë me terheqë ma shum trupa nga Franca nga çka thuhej prej anës anglo-amerikane. Këto trupa të bashkueme me njësina të reja t'ardhuna prej Reichut i dhanë mundësin Gjermanis për sigurimin e kufijve të saje, madje jo vetun për ndërmarrje hezituese, por për një mbrojtje përfundimtare.

Zëra svicerane mbi mobilizimin total

Gjenerali englez mbi armët e fshehta gjermane

Në një kryeartikull mbi fillimin e vitit të gjashtë të luftës gazeta "Basler Nationalzeitung„ shkruan se energjitë që vihen në dispozicion me anën e mobilizimit total nuk duhet të përçmohen. Ky nuk duket të jetë bërë me qëllim që t'i mbrihet një barazimi numerik në produksjon. Përkundrazi, simbas informatavet që mund të merren është çështja më tepër për tipa armësh të cilat drejtohen më tepër kundra një fuqije më të madhe, sidomos kundra armës ajrore. Në qarqet neutrale tlitet mbi një shuarje t'afert të armës ajrore në anën e aleatëvet. Edhe në qarqet e marines bëhet fjalë se edhe arma e nëndetsevet nuk e ka thanë fjalën e fundit. Që në Gjermani punohet me një fuqi përmbinjerëzore për mbarimin e këtyre armëve, nuk mund të dyshohet.

Mbi armët e fshehta gjermane shkruan gjeneralmajori engles Futler në "The News Englisch Weeky„ se gjermanët me këto armë kanë zgjidhun problemin kryesuer, d. m. th. qitjen e njerzvet nga lufta, si me thanë kanë krijuar vetvetishmëninë e armëve. Problemi kryesor i luftës së ardhëshme nuk është elektrizimi por, largimi i elementit njeri nga lufta - pengimi historik në çdo luftë - mbassi njeriu ka ndjenja dhe nerva.

Një gjyle topi përshembull është një metal pa nerva, porse duart e njeriut, që përdorin këtë top mund të dridhen. Prandej qellimi i zhvillimit të armëve duhet të jetë në zbritjen në një minimum të kontaktit të njeriut me armët. Pra këtu është fjala për të zbuluar një armë, e cila të funksjonojë mbas një vullneti që dirizhon për së largu. Kjo armë mund të rrëzohet vetëm me anën e të qëlluarit direkt, përndryshe kjo vazhdon rrugën e saj deri në objektin që synon. Fuller-i mbaron duke thënë se ky vijim mendimesh u vërtetua prej bombavet fluturuese. Këto shkaktojnë një përtrimje revolucjonare, të cilat as mund t'i trembësh, as mund t'i dëbosh. Pra është një armë me të vërtetë e tmerrshme.



Më parë këtu fabrikoheshin sende të modës. Në vënt të çamtavet dhe të kuvertavet, tashti fabrikohen, prej një stofe të posaçme, mbulesa mimetizimi për ushtërinë gjermane.

Revolucion në taktikën ushtarake

Përpara vendimesh të rinj te veperim luftarak

Gazeta e madhe spanjolle "informaciones„ shkruan se Gjermanija po kalon, në këtë çast, periudhën më serioze dhe me të asherë të luftës. Armët që suallnë fitimin e 1940 dhe taktika e atëhereshme u kopjuan prej armikut, i cili, për hir të pasuris së tij, të popullsis së tij të panumert dhe të fuqis industriale, diti edhe t'a kalonte kundërshtarin. Ky kalim munt të neutralizohet po me atë menyrë q'u përdor, aso kohe, kundër epersisë numerike franceze dhe ruse, d. m. th. me një revolucion të taktikës.

Ky revolucion taktik që Gjermanija bëri atëherë në qetësi, brenda gjashtë vjeteve që prej largimit nga pakti i Versailles e gjer në fillim të luftës, duhet të përseritet edhe tashti. Gjersa të vinjë çasti vendimtar, Gjermanija do të luftonjë po me ato armë e mjete që disponon edhe armiku, ndonëse jan në sasi më të paktë. Vetem trimerija legjendare e ushtarit gjerman, aftësija e Komandantavet dhe vullneti i pathyeshem për kundërshtim dhe fitim e bënë të pamundëshme që tërheqja nga Normandija dhe Bretanja të kthehej në një katastrofë urhtarake.

Në se tërheqja në Lindje qe një kryevepër e llojit të saj, çlirimi i trupavet gjerman nga Normendija do të studjohet, një ditë, si një operacion, ku u bashkuan cilësija m'e larlër e Komandantit me heroizmin më të math t'ushtarit. Po të jetë Gjermanija në gjendje të duronjë edhe një periudhë të shkurtër, pa mundur armiku të pushtonjë pjesë me rëndësi jetike të tokës gjermane, atëherë do të ngjasë ndryshimi strategjik, që do të kryhet me hyrjen në veprim të një armate të re dhe me një taktikë krejt të pa njohur, dhe ky ndryshim do të bëhët në çastin, i cili do të jetë, pa tjetër, vendimtar.

Një veper e kuximshme

Sulm në një fluturim zbulimi

Dy ajrorë gjermanë sulmuan, një fluturim zbulimi mbi Karpatet, një skuadrilje të plotë kundërshtare. Ata vunë re se, nga një aerodrom rumun, po nisej një skuader armike. Me gjith epersine numerike të kundërshtarit, të dy avjatorët trima u turrën drejt mbi ta dhe i qëlluan me mitraljozat e tyre.

Në pakë minuta, i pari rrezoj tri maqina kundërshtare, kurse i dyti rrëzoj një dymotoresh. Të dyja maqinat gjermane u çkëputnë, të pa dëmtuara, prej armikut, dhe pastaj kryen misionin me të cilin ishin ngarkuar.

Trathtare te trathtuem

Muravieff arrestohet prej sovjetëve

Si mbas lajmeve t'ardhuna prej burimesh anglo-amerikane nga Sofja shumë ish-ministra bullgarë u arrestuan prej sovjetëve. Ndër ta gjindet edhe Muravieff, i cilli prishi marrëdhanjet e Bullgarisë me Gjermaninë.

Sa kohë ka që emri i Muravieff-it u duk në shtyllat e gazetavet? Vetëm qysh prej pak javësh e këtej. Atëherë të gjithë miqtë dhe armiqtë në nji pikë ishin të bashkuar se ky njeri pamvarësisht se çfarë pikpamje përfaqësonte tue marrë parasysh paktin e miqsisë së ngushtë ndërmjet Gjermanisë e Bullgarisë duhej të quhej nji tradhëtar.

Por si në anën e armikut ashtu edhe këtu në Shqipni kanë qënë të tillë persona që kanë mendue tue zgërdhi se kjo tradhëti ka me i sjellë frutat e veta të bollëshme. Por para të gjithash disa të urtë që i njofin mirë metodat sovjetike ishin në dyshim. Ata edhe në këtë rast kanë pasë të drejtë. Tradhëtari në nji rrjedhim të shpejtë të pabesueshëm u tradhëtua prej sovjetëvet, sikurse përpara tij u tradhëtuan, Viktor Emanueli, Badoglio, Konti Scorza, Mbreti Mihael i Rumanisë dhe shumë të tjerë. Sepse kush u shërben bolshevikëve për të hedhur nji çap në mënyrë të pa shmangshëm ka me u shkelmue prej tij dhe ka me ranë nënë rrotat e maqinës së tij të tmerrshme, gjurmat e të cilit qëndrojnë në vija të gjana prej gjaku.

★

Në Rumani, Sovjetikët filluan të dërgojnë, në Siberi, oficerë, ushtarë dhe një numur të math civilash. Në Bukuresht u formua një gjyq ushtarak nënë kryesinë e komisarit çifut Rabinoviç me zëvëndës një avokat çifut.

Poglavniku ne Fuehreri

Bashkfjalime dhe me von Ribbentrop

Fuehreri pranoi në kuartierin e tij të përgjithshëm Poglavnikun, kryetarin e shtetit kroat, me të cilin pati nji bashkëfjalim të gjatë e të përzemërt mbi problemat dhe planet e përbashkëta të dy shteteve. U përmend marrja e masave, që kanë me sigurue lirin dhe pamvarsin e Kroacis. Bashkfjalimet, në të cilat prej anës gjermane muernë pjesë edhe ministri i jashtëm von Ribbentrop, Generalfeldmarshalli von Keitel, u zhvilluenë në nji atmosferë të miqsis së sinqertë e të plotë.

Ish trashëgimtari i Italisë, princi Umbert depozitoj, në një bankë veriamerikane, një shumë prej 50 miljonsh lireta ar, të cilat ai don t'investonë me anë çifutesh Newjorkezë, n'industrinë e kautçukut. - Pas trathëtisë fillon tregëtija me të holtat e çpërblimit perkatës.

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Ejte 28 Shtatuer 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 56 035 — Nr. 31 - ÇMIMI 1 LEK

Prill 1939 - Shtator 1944

Diktaturë apo Demokraci?

Atdheu ynë po kalon çastet më kritike t'istoris së tij: lufte jete a vdekjeje

Vërtetohen ngjarje në jetën politike të një Kombi të cilat sjellin pasoje vendimtare në historin e 'tij. Sa herë edhe Kombet, ashtu si njeriu, pendohen të kenë bërë ose të mos kenë bërë diçka. Vetëm koha, eksperienca dhe pësimet i mësojnë dhe i udhëheqin popujt, ashtu si njerzit, në parimet, në vendimet dhe në veprimet e tyre. Ashtu ngjau edhe në jetën shqiptare. Kombet që nuk kanë një eksperiencë të gjërë politike dhe shoqërore një ditë paguajnë mëkatet e tyre, qajnë gabimet e bëra.....

Populli i yne, pa dyshim, i ka në sinthezë, elementet e kombësis, faktorë për të qënë Komb në kuptim të plotë të së Drejtës; ka fuqira intime krijonjëse (vis intima creatrix) të numërohet nër radhët e të tjerve me të drejta jete dhe lirije. Por, si eksperiencë Shteti jemi të rinj jemi të papregatitur, qoftë në lëmë të kulturës, qoftë në atë të edukatës politike dhe shoqnore. Jemi pa dyshim, një Komb në ecje, në lëvizje; jemi Shtet në formacjon, në fillim të punëve politike, të fuqizimit dhe të organizimit. Dhe, mjerisht, lozim me fatin e Atdheut t'onë, bëjmë prova të rënda, më të rrezikëshme, në trupin e një Vëndi të dobët dhe anemik, që sapo ka dalë nga errësira në dritë. Pa-realizuar edhe tërësinë tokësore, po përpiqemi, duke u vrarë dhe duke u prerë, t'i shtijmë ndër deje Shqipëris së vogël një virus të fortë ideologjik, me rrezik t'i helmatisim gjakun dhe t'a përmbysim përfundërisht.

Na jemi duke bërë eksperimentin mjeksor të një dijetari, çpikës i ndonjë formule të re kimike mbi trupin e ndonjë kafshe. Kjo është, në përmbledhje, një provë tragjike, sepse turmat të ekzaltuara nga gjëndja e luftës dhe nga propagandat e jashtëme, të rrëmbyera nga parime të huajë, të udhëhequr nga idé të huaja, me një bajrak dhe me formula të huaja përpiqen dhe sakrifikohen për t'i çelur një Partije, me çdo mënyrë dhe me çdo mjet, rrugën për në Qeveri. Është vënë si bazë përdhunija; violenca është ngritur në sistem për të kënaqur ambicjonet e disave, për të ngopur nepsin e një klase që synon pushtetin, dhe për të mbritur në sundimin e Shtetit don të përmbysë çdo institucjon dhe çdo traditë. Humbjet nuk numërohen, dhe këto nuk përligjin as parimin, as qëllimet, as përfitimet.

Lozën të parët (pesë vjetë me radhë) - ambicjozë, mashtruesa dhe spekulatorë - me fatin e Atdheut; Lozën para nesh, njerës pa-skrupul. duan të lozin dhe të tjerë mbaskëtaj. Populli i vuajti, Kombi po i vuan; askush nuk u padit, askush nuk pagoj dëmet....

Lodra vazhdon; përsëritet aventura. Para ca kohe, disa gjetën shteg, patën guximin të paraqiten edhe një herë në skenën politike, në skenën tragjike, të përgjakëshme Shqiptare, pa pikë turpi, pa frikë, pa qortim ndërgjegje. Mos marveshjet t'ona u dhanë shkak dhe guxim; pasojet qenë nefaste..... Ndërkaq disa të rinj, pa-pregatitje politike, janë duke përsëritur, me të tjera metoda, lodrën e rrezikëshme në kurriz t'Atdheut, në dëm të liris, të Shqipris. Ndër këta, ndofta, ka edhe të sinqertë. Por asnjë pregatitje s'kemi bërë për nesër, për t'ardhëshmen e pa njohur, për luftrat që na presin. Populli është i përçarë, klasa drejtonjëse e inteligjencës dhe e pjekuris politike edhe më e përçarë. Kufijt janë të zbuluara dhe të kërcënuara vazhdimisht nga fqinjët t'anë të çdo tendence politike. Jemi në pragun e çasteve vendimtare..... Nuk u jepet dy herë rast njerzve të ndërtojnë vepra të mbëdha; nuk u jepet dy herë Kombeve të bëjnë histori, të fitojnë liritë, të bëjnë vepër ndërtimtare në Shtet dhe për Shtet. Luftrat kombëtare kanë ideale kombëtare dhe këto ideale realizohen vetëm me bashkim dhe grumbullimin e të gjitha energjive nën një komandë, nënë një bajrak. Me 7 të Prillit në humbëm një dava të madhe sepse qemë të pa pregatitur; humbëm rastin për një vepër historike, humbëm një luftë të madhe si Komb, si popull dhe si Shtet.

7 Prilli do te qe data per nj'epope të shkelqyer

Të Prëmten e Zezë t'asaj prendvere të largët, t'idhur ne Shqiptarët patëm ditën t'onë, rastin të shkruajmë me gërma të arta faqen më të shkëlqyer në historinë t'onë kombëtare. Më 7 të Prillit na erdhi koha ma e volitëshme të ndërtonim epopenë t'onë më të madhe me gjak dhe me hakë. Dikush bëri detyrën e tij: luftëtarë të pa-njohurë derdhën gjakun herojikisht, dhe mbi atë gjak né rifilluam luftën, vazhduam betejën pesëvjeçare. Por, një ditë lufte s'qé e-mjaftë: ishim të pa pregatitur politikisht dhe ushtarakisht..

Shtatë Prilli 1939 do të shënohej n'analet e historís s'onë si gjesti më i madh patriotik i një Kombi që - i vendosur për jetë e vdekje - luftonte për vehte, për të drejtat e tija, për tokën dhe lirit e tija. Lufta e Vlorës, që përmendet si gjesti epik më i shkëlqyer, do t'ish mbuluar prej dritës së betejave të 1939-tës, sepse prej maleve të Shkodrës gjer në cepin më të largët të Shqipris së Jugut një Komb i tërë ishte më këmbë: i gjithë një popull ish gati të mbronte të drejtat e tija me thonjë, me dhëmbë dhe me gjak. Historija do t'i gjykojë më mirë shkaket dhe efektet, si do që të thonë disa politikaxhinj - të dështuarë shumë herë në fushën politike - me verbalizmin e tyre shterp në stil feshisto-byzantin, mbasi ata do të mundohen gjithmonë të përligjin veprën e tyre në dëm t'Atdheut, Dikush do të bëjë sotizma, por në të vërtetë shkaket që determinuan këtë gjendje të mjeruar i kanë burimet e tyre në vendimet e 1939-tës. Të marrim shëmbëll Finlandën, të marrim mësim nga ay popull kreshnik - i vogël si né - që mundi të mprohet dhe të dalë me nder nga një luftë vigane. Na nuk duam të bëjmë polemikë, regjistrojmë fakte dhe gjykimin ja lëmë historisë.

Nacionalizma Shqiptare atë ditë u ndodh, fatkeqësisht, e pa pregatitur, e dobët dhe e përçarë: - me një pjesë jashtë Atdhëut, tjetra brënda, të ndara pesëmbëdhjet vjetë resht pa-shkake të thella politike, ideologjike, as historike, - u ndodh pa-pritmas përpara, një gjendjeje që nuk e përballonte dot. Gjëndja ndërkombëtare edhe s'qé në favorin t'onë. Kombi i ynë atë ditë humbi rastin e një beteje të madhe, sepse disa qindra dëshmorë do t'i kishim kursyer Atdheut anemik ekatombën më të modhe: sakrificën e shumë mijra viktimave, të gjumtuarë dhe të mjeruarë në kryengritjen katër vjeçare kundra pushtuesit dhe në përleshjen vllaznore që, me përpjestimet tragjike që ka marë, mund të ketë epilog fatal. Do të kishim bërë historinë dhe do t'i ish kursyer Vëndit lufta civile. Lufta kombëtare për liri, luftë tri ditësh a tri javësh t'atij Prilli të largët, do të ish një arsye, një garanci, një e drejtë për mbrojtjen e aspiratave t'ona legjitime në Kuvëndin e Paqës. Të tjerat s'janë veç pasoje naturale të pa ndalueshme. Lirija fitohet, merret, mbrohet! Sanguis heroum semen libertatis! (gjaku i heronjve është farë për liri).

Më katërmbëdhjetë të vjeshtës së parë të 1943-së na u desh të rifillojmë, të rindërtojmë, të rikrijojmë. Ishim pa Qeveri, pa garanci, pa asnjë premtim formal për t'arthshmen t'onë. Pasigurija, frika dhe anarkija mbretëronte më të katër anët, Çdo gjë ishte e çthurur nga sundimtari i huaj. Gjatë pesë vjetëve pushtimi, nga një armik dinak dhe i pa zot. Populli Shqiptar me gjoksin e tija, me gjakun e tija, me zëmrën e tija bujare i mbuloj gabimet e politikanëve të tij, të drejtuesave të tij, të asaj «elite politike» në shërbim të agresorit fashist. Ay - me intuitën e tij të thellë, me mënçurin e tij - e kuptoj se fqinja e madhe ja kish me të pa-besë. Historija e provoj dhe ay u dha një mësim të mirë atyre të inteligjencës drejtonjëse të atij regjimi që përdhunuësin e lirisë e quante liberator, që armikun e thirri vëlla. Populli i ynë e bëri detyrën e tij; sakrificën me gjak dhe me plaçkë. U hoth trimërisht në luftën çliruëse kundra

Çeshtje ndërgjegjeje

T'u qetsua zamra tashti?

Pardije pashë mikun t'im të vjetër që po rinte në vendin e zakonshëm në Kafe "Sahati,,. Duke bërë muhabet me miqt përqark tryezës, po shijonte me ëndje kafenë e tij. "Të uroj për shërimin", i thashë unë. Të gjithë qeshnë pakë, sepse seicili e dinte që ky me të deklaruar luftën Bullgarija Gjermanisë, ishte çdukur menjiherë diku nëpër male. Atëhere, n'ato ditë dukej sikur Perëndija e kishte goditur në sytë, sepse ky nuk i shikonte më miqt e tij, sidomos kur këta rinin sëbashku me gjermanë. Por, tash menjiherë syte iu shëruan, si duket dhe fitluan t'i shkëlqejnë andej këtej. Ja ku shikon që për së largu një oficer gjerman dhe e përshëndet përzëmërsisht.

Po, po, ka gjithë farë sëmundjesh në këtë botë. Porse shiko se sa lehtë shërohen ngadonjëherë.

Ka disa zhurma, që ngadonjëherë u japin gajret mjaft zëmrave të frikëshme. Kur dëgjohet aty këtu ngadonjëherë në mes të mbajë veshin. Të gjithë shikojnë shoqi shoqin me shqetsim: "Artilerija e rëndë gjermane bën ndonjë manevër." Kur buçitnin topat e rëndë nepër rrugët e Tiranës, na kujtuam shumë veta mbi një artikull të kësaj gazete që u shkrua me rastin e largimit të topavet të lehtë gjermane prej këtej. Atëhere jepej sigurimi, se në vend të këtyre topevet do të vinin të tjerë. Ah, ju zemërngushtë, a e shikoni tashti se kush pati të drejtë? Perëndija u forcoftë zëmrat dhe u shtoftë besimin...

Tash sapo duken përsëri fytyrat e njohura në qytet. Ndoshta e ka kuptuar mileti që është marrëzi t'u vesh veshin të gjitha llomitjevet të radio-Londrës dhe asaj të Barit. Nja katër afate të caktuara që kanë dhënë pë zbarkim kanë kaluar me kohë. Çetat me yllin e kuq, ndërkohë kanë harxhuar shuhë fyshekë, qytetarët e Tiranës, që duan qetsinë, kanë ndjerë disa ndryshime që janë bërë në qytet, të cilat nuk ia zbukurojnë pamjen, porse u sigurojnë atyre një gjumë më të qetë, edhe kjo gjë jo vetëm se i gëzoi me të vërtetë, porse u ka shtuar edhe besimim.

T'a themi shkurt dhe rrumbullak: Miq të dashur, kush ha me tri lugë, në vend që të hajë me një, e fëlliq pallton me njolla dhe bën vehten e tij qesharak.

Rusija pa maskë

Në vjetin 1876 shkrimtari rus Dostojewski pat shkrue në "Ditarin e një shkrimtarit., sa vijon

"Heret ase vonë Stambolli duhet të bahet i yni qoftë edhe në shekullin e arthëm; na rusët duhet t'a mbajmë këtë vijimisht para syvet."

Nderkohë imperializmi rus u paraqis nën mbulojen e bolshevizmit. Porse me këtë iu shtue për së tepërmi oreksi. Nuk po don ma vetun Stambollin, por krejt Ballkanin.

Me një automobil-barkë në lumë
Në një ekskursion zbulimi në ballin e lindjes

okupatorit-dominator, kundra të huajit mizor, me një emër në buzë, me një dëshirë në zemër: për Shqipri, për liri! U çfrytëzue pa masë, dhe për qëllime të tjera, për pasjone vehtjake gjaku bujar i popullit, hovi i djalërisë; spirita e aventurës bëri vënd në lëmë të politikës. Për këto shkaqe, edhe këtë radhë (për fajën t'onë) Shqiprija po humbet një çështje të madhe: betejën e vërtete për liri, për demokraci, për vllazëri! Sepse lufta popullore për liri dhe për Atdhe ndrroj qëllimin dhe drejtimin: degjeneroj në luftë politike, luftë ideologjike, luftë klase për sundim dhe për zgjedhë: për diktaturën e proletariatit. Pasojet s'munt të ishin të ndryshme. Orvatja përpoqi në qëndresën e pjesës më të urtë dhe më t'arsyeshme të popullit: prej kësaj rodhi lufta e brëndëshme, lufta civile. Dy data, dy beteja të humbura regjistron në historin e këtyre vjetëvet të fundit populli Shqiptar. Né e kemi parandjerë me kohë rrezikun, e paralajmëruam të keqen. E thamë dhe e përsëritëm, e kemi shprehur një mot më parë mendimin t'onë. Eksperimenti i pa kohshëm demokratik më 1924, solli si pasojë, në jetën politike të Shqipris, sundimin e malësive për pesëmbëdhjet vjetë me radhë. Eksperimenti komunist për revalucjonin shoqnor në periodën 1943-44, u bë shkak i vëllavrasjes, mbolli luftën civile. Prej luftës civile lind, si rrjedhje naturale e pa ndaluëshme, Shteti autoritar, reaksjoni, diktatura. Diktatura e bardhë, e zezë a e kuqe është gjithnjë diktaturë. Dhe diktatura është kufizim lirije edhe kur është e ndritur (sic).....

Grindjet e brëndshme lindin autokraci

Edhe në politikë historija është mësonjëse më e mirë. Prej Athinës dhe Spartës në Helladen e vjetër, gjer në Romën e Madhe të Marius dhe Silla; nga Revolucioni Frances, që nxorri Napoleonin Imperator, n'atë të Rusisë më 1918; prej grindjeve politike të Italisë së mbas luftës, që solli fashizmin në fuqi, gjer në luftën e Spanjës që polli Gjeneralin Franco; ashtu dhe në kryengrijet e Greqisë para diktaturës së Gjeneralit Metaksas, provohet në mënyrë absolute, të pa-kundërshtueshme kjo e vërtetë e hidhur: prej grindjeve të brëndëshme lindin vetvetiu, natyrisht regjimet autokratë. Dhe kjo llogjikisht, historikisht, fatalisht do të vërtetohet dhe në Shqipri në se ne do të vazhdojmë të ecim edhe në këtë rrugë. Shqiprija humbi dy raste të mëdha, të rëndësishme, vendimtare: betejën kombëtare më 1939 dhe atë politiko-shoqnore më 1943 për triunfin e parimeve demokratikë. Rryma e kohës ecën, ngjarjet përsëriten..... Por fajën nuk e ka populli, jo edhe djalërija, as Shqipërija; por mjerisht, fatalisht, padrejtësisht hakën e paguan gjithnjë populli, e shpërblen me gjak rinija, e qan me lotë Shqiprija!

* * *

Historija përsëritet dhe në Shqipri: 1912, 1922, 1924, 1939, 1944?

Dy beteja të humbura, por lufta vazhdon. Ndeshja vazhdon dramatike, e ashpër, e dëndur, e përgjakëshme. Luftë jete a vdekjeje; përpjekje vendimtare, luftë Shqiptare, por jo për liri, jo dhe për Shqipri, as edhe për demokraci!

E ardhëshmja do t'a provojë, më mirë se çdo tjetër fakt, në së né kemi arsye, ose të paktën, në se kësaj Shqiprije ja kemi patur me hilé apo me të drejtë.

Klika e oborit të Bukureshtit

Shteti i shkatrruem i Karolit u dekompozua krejt

Ngjarjet në Bukureshl muarnë një të till rrjedhim që të bën të kujtojsh intrigat, poshtërsitë, egoizmin dhe paburrninë që karakterizonte kohën gadi të harruem kur në krye të punëvet shtetnore të Rumanisë qëndronte Karoli me të dashurën e tij Lupescu. Kur u largue prej Rumanisë Karoli i II me të dashurën e tij çifutnëshë Lupescu, Rumanija mori frymë lirisht dhe filloj të shpresojë në Mbretin e ri Mihael. Por sikurse i ati ashtu edhe ky, popullit rumun i solli turp dhe një fat të zi.

Karoli qysh kur ishte trashëgimtar i frontit luante rolin kryesur ndër historitë e skandaleve të ndryshme që ngjanin në shoqnin e Bukarestit. Një ndër Një ndër këto skandale të kryeme prej tij qe martesa morganatike që bani me Zizi Lambrino, e cila mandej u mbyll në kishën Prolovski të Odessas, por e cila zgjati vetëm për pak muaj pse i ati i Karolit urdhnoi Divorsin dhe trashëgimtarin e zhytur në dashuri e internoi për një kohë tue detyrue të rrinte i arrestuem në një pallat. Porse ky ndëshkim mbeti pa efekt. Porsa u lirua trashëgimtari i fronit, filloj dashurinë e vet me çifutneshën Elena Lupescu.

Lufte "mbretnore,, per çifuten Lupescu

Kur kjo filloj dashurinë me trashëgimtarin e fronit qe tue u nda prej burrit të saj Tampeano. Karoli e shpejtoi ndarjen me çdo mjet. Prapë me me këtë rast u ba një grindje ndërmjet babajt e të birit, që përfundoj me vendimin që Karolin e detyroj të martohej me princesën greke Elena. Kjo martesë qysh në fillim u pa se ishte fatzezë, pse Karoli nuk hoqi dorë nga Lupescu dhe kështu kjo martesë formon një ndër kapitujt ma të zeza të historisë së tij. Kundërshtitë në oborrin mbretnor të Rumanisë u banë gjithmonë e ma të ashpra dhe përfundun me heqjen dorë të Karolit nga froni në favor të birit të tij Michael. Mbas kësaj ndodhjeje Karoli shkoj me të dashurën e tij për në Paris.

Ndërkohë në Rumani punët shkojshin rrëmujë. Në vend të Michaelit që ende ishte i mitur frenat e shtetit gjoja i mori në dorë një këshillë regjence, porse në të vërtetë punët i kishte në dorë mbretnesha Marije e ama e Karolit. Katundarët rumunë po vuanin dhe ekonomija e vendit po shkonte poshtë. E vetmja gja që ishte në lulëzim ishin partitë e ndryshme. Në çastin kur u duk se puna mori krejt tërposhtë, u kujtua mendimi i zi për, me e sjellë prapë Karolin në fron. Karolit kur i u paraqitën kushtet se Lupescu nuk mund të kapërxente kufitë e Rumanisë e se do të rifillonte jetën e regullt me bashkëshorten Elenën e Greqisë nuk kundërshtoj dhe bilë premtoj bindje dhe përmirësim. Gjith kjo ndodhi në vjetin 1930, por në të vërtetë ai nuk hoqi dorë aspak prej Lupescut dhe nuk zgjati shumë kur çifutnesha prapë erdhi në Rumani dhe grindja në shtepin mbretnore të Bukarestit filloj rishtas. Kësaj herë përfundoj me ndarjen e Karolit prej së shoqës.

Nuk i mungunte mbretit aktiviteti dhe zelli për të hartue plane, porse çka ndreqte më njanë e prishte m'anën tjetër me hovardhallëkun e tij dhe me pa qëndrueshmëninë e tij. Baza e lij në Obornin Mbretnor dhe fjalët e tija të mëdhaja nuk i përgjigjeshin aspak matunis dhe sigurisë që duhet të ketë një sundimtar me qëndrim burrnor. Mbreti i kishte venë në dispozicion Lupescut një villë në Bukurest. Kjo filloj të sundonte në Rumani, sikurse dikur Madam Pompadour në Francë. Karoli ra krejt nën influencën e saj. Shumë ma tepër udhëhiqej prej këshillavet të kësaj që kishte për mik të ngushtë Ministrin e Oborrit Urdarianu se sa prej këshillavet të politikanëve të tjerë t'urtë.

Me gjith se Lupescu ruhej për me u dukë në sy të popullit se ajo luan role politike prapë këtë e bante me një dhelpri të hollë tue mbulue çdo gjurmë jashtë prej miqvet të saj, të cilët e paraqitshin këtë sikur nuk interesohej aspak per punë politike. Në të vertetë dora e saj ishte brenda në çdo tregëti politike Ne vilën e saj emnohesin Ministra dhe rrëxoheshin të tjerë. Më von u dishmue edhe se vrasja e luftëtarit rumun për liri dhe themeluesit të gardës së hekurit Zelea Kodreanu ka qenë një veëer e Lupescut.

Dihet mandej se Lupescu asht mundue me gjith fuqi që çifutët në Rumani të marrin ma tepër fuqi. Kështu që të përmendim vetëm një shembëll në të ardhunat e popullit 65 për qind ishin pjëstarë çifutë. Gjithashtu dihet edhe se në natën e 6 Shtatorit 1940 kur Karolit i u desht të japi dorëheqjen Lupescu asht mundue me çdo mjet që të largohej njikohësisht me ta edhe trashigimtari i fronit Michael. Si kur t' ja kishte mbrrijtë me e realizue këtë plan atëherë ajo do të kishte luejtun njërën o tjetrën nga kartat e saja të fundit.

Me valixhe plot xhevahiresh jasht kufirit

Në ditën e përmendun të 6 Shtatorit u gjetën në Boudoirin e Lupescut qindra kutija boshe të gjanavet të çmueshme. Llogaritet se gjanat e çmueshmë që kishin pasë qënë në to kapnin një shumë prej 700.000.000 lei. Me kaq bujari e pati kujtuar të dashurën e vet Karoli, ndërsa populli jetonte ne mizerje. Një dollap argjenti ishte zbrazë krejt. Shumë pako e valixhe të mëdha u mbushën atë ditë me gjana të çmueshme, të cilat Lupescu, i dashuri i saj mbretnor dhe parasitët e tjerë reth tyne i muernë me vehte.

Kur ata kaluen kufirin rumun e dinin se i kanë mbushur bollë xhepat për të jetue mbasandaj si zotnij në botën e madhe edhe sepse qysh përpara kishin dërgue jashtë bollë të holla. Kështu popullin rumun e lanë në fatin e vet.

A nuk u përsërit vall këto ditë kjo histori? Nuk e tha vallë në thirjen e vet qeverija kombëtare rumune se edhe mbreti Michael me klikën e tij qysh disa muaj përpara kishte tillue me dërgue jashte pare për vehte mbassi popullit rumun e shtetit rumun do t'i jepte shkelmin?

Sikurse ka qenë fillimi ashtu edhe mbarimi i regjimit të Karolit ka qënë i çndershëm. Populli rumun u vu kundra mbretit. Në të gjitha qytetet e katundet e Rumanisë, në ditët e vështira të verës 1940-ës në Rumani ndodhen kryengritje e trazime të ndryshme. Edhe Bukuresti vetë po ziente. Në këto çaste thirri Karoli gjeneralin Antoneskun, të cilin pak javë përpara e pat quejt rrebel. Antonesku i patrembun edhe besnik qëndroi në krye të detyrës që mori përsipër më 1940. Ai besoi njikohësisht në besnikerinë e mbretit të ri, porse Michael e trathëtoj.

Në vitin 1881 kur Rumanija u ba mbretni zejtarët rumunë gëdhenden kunoren mbretnore rumune prëj hekuri të një topi, që ishte zënë plaçkë në luftën e bame në Plevna. Kjo kunorë e hekurt do të ishte një vërejtje për rumunët në lidhje me sjelljen e padejshme që kanë tregue kundra Rumanisë fqinjtë e lindjes. Sot nuk ka turp aspak mbreti i Rumanisë popullin e vet që vjele me radhë luftoj trimnisht kundra armikut të lindjes, me ia dorëzue bolshevizmit. Si një mjet i verbët në dorë të një klike të oborrit, sikurse i ati i tij edhe ky në çastet e vështira u tregua i padejshëm për besimin që populli rumun kishte vumë në të.

Bolshevizimi i Finlandisë

Edhe atje filluan deportimet

Përmbi gjendjen në Finlandë njoftohet se me ardhjen e komisjonit sovjetik të kontrollit përnjiherit u mbyll kufiri i Finlandës që kështu bolshevizmi të mundet me e vumë nën zgjedhë të vet krejt vëndin. Sikurse në Rumani, ashtu edhe në Finlandë shumë veta u ban viktima të mitralozavet të bolshevikëvet: Gjyqet e GPU-së po kanë shumë punë. Shumë veta nga puntorët transportohen për në lindje. Ma së pari duhet të dërgohen 3.000 elektroeknikë dhe 4.000 puntorë druvarë, për në Siberi.

Sikurse njoftohet të 23 pikavet të marrëveshjes së armëpushimit me Bashkimin sovjetik, do t'u shtohen edhe paragrafe të tjera.

*

Komisionet bolshevikë të kontrolit në Finlandië kanë kerkue perposë dorzimit të gjithë oficierave edhe dorzimin e ushtarëve, qi janë dallue në luftë kundra sovjetëve. Finlandija gjindet para një dimni urije. Qysh tashti kanë fillue me mungue dita me ditë ma tepër gjanat e ushqimit dhe furnizimet nga Gjermanija dhe nga shtetet e tjera janë pre. Një nenoficier finlanez i deklaroi një fletorarit amerikan: «Rrethanat janë ba shum ma të këqija se sa vetë lufta; na pothuaj kemi vdekë, sado që ende po marrim frymë.»

Nji grusht kundra Titos

Kapen komunista në Belgrad

Policija e Belgradit ka mujtë t'i japë një grusht me sukses qendres së komunislave në Belgrad. Kryetari i organizates komuniste serbe u arrestue bashkë me të gjithë pjestarët e randësishëm t'organizatës. Një shtypshkronjë dhe një radio trasmetuese e mësheftë u shtinë në dorë.

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Hënë 2 Tetor 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 56 035 — Nr. 32 - ÇMIMI 1 LEK

Kush bije përsëri në grackë?

Prallat e mbrame aleate mbi zbarkimin

Reuter beri prap nji blof në Shqipni - Mos bahen ma të marrë

Ndonse rrenat e pësërituna gjatë muajvet të fundit, popullin shqiptar duhej t'a kishin ba pak ma të mençur, prapë shumë veta me nerva të dobëta u banë viktima të nji rrene të ré të shpërndarë prej agjensisë Reuter. Agjensija Reuter nëpër radion aleate me 27-IX dha këtë lajm: «Prej komunikatës së sotshme të flotës del se, janë në zhvillim e sipër veprime ushtarake në ishujt dalmatine. Mandej se njisina trupash aleate kanë zbarkue në disa vise kryesore të Shqipnis.» Nji komunikatë e veçantë për Ballkanin tha këto: «Forca detare dhe parashutista jan tue veprue në nji front të gjanë në brigjet e Adriatikut tue përfshi Shqipninë dhe ishujt dalmatikë».

C'ka ndodhi? Trupat gjermane qëndruan në qetsi të plotë. Ata dismuen gjakftohtësinë e tyne të njohun dhe qëndrimin e tyne të qetë. Qysh prej kësaj shqiptarët të zgjuet duhet t'a kishin kuptue se asht fjala prapë për nji rrenë, e cila synonte të shkakëtojë panik dhe trazime. Por, me gjith këtë shumë llafazanë histerikë ngane me vrap nga nji kojshi tek tjetri tue thanë: "A e ke digjue, aleatët mbrrijtën në Shkodër?,. Nji tjetër "ishte informue mirë,, se, aleatët e kishin pushtue Vlonën dhe nji tjetër edhe ma mirë i informuem thoshte se ata kishin pushtue Shkupin.

Në të vërtetë po njashtu sikurse përnjëherë edhe gazeta «Bashkimi i Kombit» njofloj zyrtarisht, asnji ushtar aleat kishte vu kambë në tokën shqiptare.

Nji shqyrtim i imtë i bamë përmbi komunikatën aleate dha këtë rezultat. Kuartieri i Përgjithëshëm aleat në Mesdhe donte të bante diçka për me i a shtue namin nji formacjonit të ri që quhet fuqi ushtarake toksore vepruese në Adriatik LFA. Ky formacjon i ri pat bërë disa ndërmarrje të vogla kundra ishujvet dalmatine dhe njiherë me 29 të Korrikut 1944 bëri një veprim befasije kundra nji baze gjermane në Himarë ku përnjiherë edhe u hodh në det. Me rastin e të përmendunit të kësaj vepre «heroike» u formullue fjalija që vijon: "Njisina trupash kanë pasë zbarkue edhe në vise kryesore shqiptare". Radiot aleate këtë fjalim ma vonë e shkëputën prej lidhjes së saj me fjalit e tjera dhe banë kështu nji lajm sensacional.

Shqiptarë, kështu orvatet gjithnji me anë blofesh të fitohet në poker nji lojë kur e di mirë njeriu se nuk i ka kartat e mira në dorë për me fitue lojën. Fuqit e armatosuna gjermane sikurse po dëshmohet i kanë nervat ma të forta e ma të qeta për me e fitue këtë lojë. Budallenj janë ata që janë kaq histerikë sa të bien në grackë prej çdo rrene dhe që besojnë çdo marri që trillon ndonji rrenacak i paguem në radion e Londonit, të Barit e të Algjerit.

Ndoshta nesër kanë me lajmue se parashutistat aleatë kanë zbarkue në «hanë». Na jemi të sigurtë se kanë me u gjetë të tillë budallenj, të cilët edhe këtë kanë me e besue, pse nji fjalë e ungjillit thotë kështu: «Sikur t'a shtypësh në havan të marrin sa t'a bësh pluhur, ai prapë se prapë i marrë do të mbetet».

Çka nuk përmendi Churchilli

Ai po vret mendjen për nji luftë të re

Tre konkluzjone mund të nxiren prej fjalimit që mbajti Churchilli me 29 të Shtatorit. 1. Mos marëveshje ndërmjet anglo-amerikanëve dhe sovjetëve në lidhje me çështjen polake lypin që të bahet nji konferencë e re, në të cilën të marrin pjesë Stalini-Churchilli e Roosevelti. 2. Frika nga nji luftë japoneze pa i pasun me vehte aleatët sovjetët. 3. Roosevelti u orvat në Quebec qysh tash që të bajë batakçillëkun e vet me pretendimet e veta mbi perandorinë britanike. Për, ndryshe për çka i u desht Churchillit të numuronte përpara Jenkive humbjet dhe divizionet britanike? Natyrisht Churchilli nuk u zgjat përmbi akuzën kryesore që i bahet prej Washingtonit, e mbas së cilës akuzë Churchilli flet gjithmonë përmbi perandorin tue heshtun se në çfarë gjendje të keqe gjindet veprimi i Anglisë në krahasim me sakrificat e gjakut që kanë ba Dominionet. Ai për veç këtyne për humbjet armike në Francë që kapin 235.000 vete nuk përmendi ndonji ditë të caktuar.

Ciniku i vjetër si me thanë grisi këmishën e vet përpara Parlamentit si shenjë zije për fatin e Polonisë. Por, asnji fjalë nuk u tha se Rusija Sovjetike vuri dorë më 1939 mbi nji të tretën e Polonisë a se po kjo xvarisi në mërgim, nji milion e gjysmë polonezë dhe bëri kërdinë e Katynit. Çka mund të blejnë polonezët me komplimentat që u bani Churchilli për dhjetë minuta rjesht, kurse ai në anë tjetër u premtoi gjithshka sovjetëvet çka këta pretenduan nënë pretekstin të njohur e prrallor të sigurimit?

Finlandezët, rumunët dhe para të gjithash bullgarët u shanë në nji mënyrë fyese dhe u hodhën pa mëshirë si nji llomkë, gja që formon nji deklarim ma cinik të falimentit prej anës së krijuesit të kartës së Atlantikut që ka mujtë të digjojë bota. Tradhëtarit Badoglio iu ba nji elozhë dhe nji aludim se do të kujtohej ma tepër Italija sikur të bante ma tepër përpjekje në luftën kundra Gjermanisë. Por, asgja nuk tha përmbi mjerimin e math në Itali dhe asgja përmbi insuksesin katastrofal të auktoritetevet administrativë anglo-amerikanë, gjithashtu nuk rrëteu asgja përmbi kaosin bolshevik, të cilin ai e gjeti në Itali gjatë udhtimit të tij të fundit që bani në këtë vend. Në qoftë se ndokush në radhët e anglo-amerikanëvet do të ushqente shpresën se lufta do të mbarojë shpejt, atëherë atij prej Kryeministrit i thuhet se lufta do të vazhdojë edhe në vitin 1945, tue e lumnue me parashikimin se kanë me ardhë vite të vështira të mësyemjes kundra Japonisë. Bash mbrapa fjalëvet kujdes plotë përmbi luftën kundra Japonisë. qëndron drojë e pashprehun: si mund t'a sjell unë tuqinë kryesore sovjetike në Manxhuri kundra Japonisë për nji gjakderdhje e për nji shkrimje, në qoftë se unë, ndërsa fuqija anglo-amerikane asht e lidhun në Pacifik, nuk duhet t'a rrezikoi krejtësisht Europën. do të thotë frutin e luftës pesë-vjeçare në Europë?

Asgjasimi i divizionit të parashutistave britanikë në Arnheim ka qënë përgjegja e parë në frontin gjerman të perëndimit të përforcuem kundra profecivet të Churchillit. Sa e kënaqshme mund të jetë gjendja shpirtnore e londinezëve të pagjumë për shkak të veprimit të V 1, kur ata dëgjojnë se po u premtohet mbas luftës decizive n'Europë nji luftë tjetër ma e përgjakshme e ma e kushtueshme kundra Japonisë.



Sulmuar prej tanksesh gjermane dhe çkaterruar

Në përpjerimin e rrufeshme të njëj reparti të regjimentit të korracuar "Grondeutschland,, u pushtua një vënt me rëndësi. Veç materialit Bollshevikët lanë edhe shumë topa

Eksperiencë e hidhur

Politikani dhe historiani svedez Dr. Essén, një njohës i mirë i Rusisë, tha në një konferencë, që mbajti në Maj të këtij viti në Helsinki:

"Të gjithë popujt europianë, heret ose vonë, do t'a kuptojnë, se rrezikn i vdekjes që kërcnon Europën nga Lindja, mund të përballohet vetëm dyke shtënë në veprim të gjitha fuqitë e përbashkëta,,.

Sot e ndjen Finlanda në trupin e vet të vërtetën e këtyre fjalëve.

Bullgarët thyhen ne Thrake

Gjermanët zunë shum plaçkë lufte

Divizioni XV i Kambësoris bullgare pësoi nji thyemje asgjasuese të tillë prej trupave gjermane sa vetëm mbeturinat e këtij divizjoni kanë mujtë me shpëtue tue marrë malet. Bashkë me shumë të vram e të plagosun Bullgarët patën një bjerrje të madhe në topa, në pushkë, në mitraloza dhe në municjon. Veç kësaj edhe nji sasi automjetesh ranë në duerë të gjermanëve.

★

Bujqët bullgarë që njihen me ndjenjat e tyne kundra komuniste tash nuk po duanë ti punojnë tokat, sepse fryti do të bjeri në dorë të komunistave.

V. 1 prodhon gjitnji kokëçarje

900.000 shtëpija të pabanueshme

Zanet plot kujdese mbi V 1 shtohen gjithnji prej Londonit. Para pak ditësh lajmërohesh vetë zyrtarisht se ky rrezik vdekje-prues ishte largue krejtësisht prej Londonit dhe prej Anglisë jugore Por tash qëllesa e bamë e randë në këto 48 orët e fundit i ka bamë anglezët që pohimet e tyne guximtare t'i çfuqizojnë krejt. Tash po shpejtojnë edhe nji herë të deklarojnë se askush nuk mund të thotë se s'ka me u bamë edhe ma keq.

Ministri i punvet Botore angles Bevin njoftoi se 900.000 shtëpi do të mbeteshin të pabanueshme në qoftë se nuk do të reparoheshin përpara se të vijë dimri. Ndërkaq askush nuk e di se kah do të merren puntorët për me i krye kyto punë.

Banesat e ndërtuara, ndërkohë, nga nevoja, shkakëtojnë moskënaqësi midis të dëmtuarvet nga bombat.

Uzina për reparimin e "Tigrit,, në ballin e luftës. Për të reparuar, sa më shpejt, dëmet që munt të pesojne tanksel "Tiger,, janë ngrehur uzina pakë Km. prapa ballit të luftës, në të cilat punojnë fuqi specialiste.

Luftohet me trimni në Karpatët

Trupat hungare luftojnë shkëlqimisht

Agjensija DNB merr lajmin, se në nji sektor lufte nder Karpatët 5 bataljone hungareze kanë ba të dështojnë nji orvatje depertimi bolshevik në nji luftim dhetë ditësh në nji terren pyllor Këto bataljone luftuan rreptësisht në nji vend malor, që ngrihet deri në 1800 m. naltësi, dhe e smbrapsen sulmin e dy divizioneve sovjetikë. Kumtesa e Komandës së përgjithëshme të Fuqive t'Armatosuna gjermane e ka vue në dukje në kohën e fundit këtë qendresë të dalluëshme të këtyne reparteve, që i përkasin brigadës malore hungareze.

Luftimet ishin me humbje aq të mëdha për bolshevikët, sa që u kishin premtue trupave të tyne, që ishin kapërthye ndër këto luftime dhe që i kishin thye hungarezët, se me njiherë mbas këtyne luftimeve do të zavëndsoheshin me të tjerë. Me gjith humbjet e mëdha sovjetikët i përsëritnë sulmet e tyne dhe humben kështu ma tepër se 1400 vetë. Shumë kompani kundershtare përbahen tashti vetëm prej 20 vetësh. Tre ushtarë nga Banati, që takuen ndër male nji grup prej 60 bolshevikësh, i sulmuenë këta papritmas me nji guzim të madh, me gjith se ishin 20 herë ma shum në numër dhe i vuenë në hikje.

Franca në buzë të greminës

Lufte sistematike kundra francezeve te shquem

Në Francë po vlon me tërbim lufta civile. Ky vend që katër vjet me radhë gjatë pushtimit gjerman u kursye prej vuejtjevet të luftës. sot po luftón për ekzistencën e vet të thjeshtë. Nga dal nga dalë po dërmohet nën masat qeveritare të marruna prej Gjeneralit tradhëtar de Gaulle. dhe prej aktivitetit djallëzor e të nëndheshëm të komunistit Thorez. Ata ndër francezët që si pritësa gjatë katër vjetëve kanë pritë «çlirimin» tash janë tue jetue këtë nc nji mënyrë të tillë sa as nuk e kishin pa në ëndërr.

Viktimat e përditshëm të luftës ideologjike nuk po janë vetëm politikanë. Ma tepër asht i kërcënuem seicili prej seicilit dhe mjerimin e gjendjes franceze e dishmon sidomos fakti se po vriten e po vuajnë shumë bash të tillë francezë që janë largë politikës. Asht mjaft që sot në Francë ndokush të jetë i shquem me veprimtarinë e tij të çfarëdo karakteri të bamë në ndonji vend që të mos t'a ketë ma jetën e tij të sigurtë. Ky asht nji fakt i pamohueshëm se në Francë janë tue veprue forca. të cilat nuk e kanë në zemër rindërtimin e Francës as edhe paqen por, që dëshirojnë që ky vend të shkatrrohet e të hidhet në kaos.

Përndryshe si mund të spjegohet se nji radhë artistash të kinematografit që gëzojnë nji famë botnore të bien viktima të trazimeve që po ndodhin në Francë? Kështu u ba viktimë artistja tërheqëse Danielle Darrieux, figura e së cilës në sqenë ka tërhequn admirimin e gjithë botës. Ndërsa Gabi Morlay dhe Sacha Guitry dy emra, të cilavet filmi frances i a u di për nder famën e vet u arrestuen. Maurice Chevalier, i cili milionave u ka sjellë orë dëfrimi dhe kënaqieje, u bë viktimë i nji plumbit.

Por nuk kanë ndonji fat tjetër as shkencëtarët, të cilët larg kundërshtimeve politike të ditës, në degën e tyne tue i studjue e tue i vështgue kanë krijue diçka të naltë në lamë të kulturës. Kështu tre historianë të përmendun francezë si Benoist Mèchin, Bonnafou dhe Carcopino u hodhën në gjyq.

Armiqsija e komunizmit duket sheshit kundra religjionit sidomos në dënimin që i u ba priftit katolik Soleire. Ky prift ka përmbushun detyrën e tij fetare tue i këndue nji meshë përshpirtjeje për Henriotin e vramë. Për këtë vepër, të cilën ai si prift duhej t'a bante tash u dënue me katër muaj burgim dhe me nji gjobë prej 2000 fr. franceze.

Franca që në luftën fatale të Europës. s'ke marrë pjesë dhe pa vendimtarinë e nevojshme ka qëndrue në nji anë tash po fiton mbushmendje në nji mënyrë të tmerrshme mbi rrezikun, të cilin fuqitë e armatosuna gjermane katër vjet resht e kanë mbajtë larg prej tokës së saj paqësore.

Lufje e kotë për ndihmë

Dëshpërimi në kulm i lituanëvet

Shumë lituanas në Shtetet e Bashkuara i drejtuan një lutje Rooseveltit dhe Churchillit për të ndaluar vrasjet mizore të sovjetëvet në atdhenë e tyre. Ata u tregonin në këtë lutje, që Sovjetët në difët e para të pushtimit të gjithë popullatën e katër vendeve kufitare ja se i vranë, ose i zvaritën nga Siberija. Por që kjo lutje nuk ka për të pasur asnjë sukses është e tepërt t'a përmendim këtu.

Mbas thanjesh të një oficeri amerikan me rastin që turma komuniste e perzieme bani nji sulm kundra pallatit të Drejtësis në Romë u vranë 11 priften katholikë. Atheistat me afishet e tyne kerkojnë që të bahet nji sulm edhe kundra Vatikanit.

★

Në kufirin sërbo-rumun u qëlluan shumë të arratisun rnmunë prej aeroplanëvet sovjetikë që fluluronin ultas. Që të gjithë këta gjetën vdekje.

Parashutist n'Arnheim krejtsisht asgjasue

6450 rob dhe mija të vdekunish në fushën e betejës

Në sektorin e Arnheimit u thye me 26 Shtatuer qendresa e fundit e divizionit të parë britanik parashutist, që ishte rrethuem. Në nji luftim të rrebët që zgjati për dhet ditë, mujtnë fuqitë e përmbledhuna shpejt të tri pjesëve të Wehrmachtit me asgjasuem krejt nji divizjon të zgjedhun anglez me gjith kundërshtimin e rrebët dhe ndihmat e tjera t'ardhuna nga ajri.

Të gjitha përpjekjët e anmikut nga jugu, për m'e liruem divizjonin e rrethuem, deshtuenë me humbje të mëdha për ta. Krejtsisht u zunë robë 6450 velë dhe u vërtetuenë me mija të vdekunësh dhe u shtinë në dorë 30 topa antitankse dhe të tjerë si edhe shumë armë të tjera dhe 250 automjete. Përveç kësajë u shkatruenë ose u shtinë në dorë 1000 ajrorë bartësa pa motor dhe u rrëzuanë për mbi 100 ajrorë.

Korespondenti ushtarak amerikan Murrow i krahason luftimet e parashutistavet britanikë në Arnheim me luftimet e bame prej armatës angleze në Dunkirchen në vitin 1940, dhe dëklaron se vërejtja e Amerikës asht drejtue kah luftimet që po zhvillohen në Arnheim. Beteja në Arnheim ka të njajtën randësi që ka pasun dikur beteja në Trafalgar e në Wasterloo.

Lutta në Hollandë e bjerrun për anglo-amerikanët

Faza e parë e luftës në Hollandë asht e bjerrun për anglo-amerikanët, shkruen shtypi spanjol në lidhje me suksesin gjerman n'Arnheim. Gjithashtu me këtë kuptim asht e humbun lufta për me pushtue krahinen e Ruhrit dhe fushën veriore gjermane. Ndërmarrja e Britanis së Madhe në Hollandë ka qenë e ngutun dhe do t'ishte gabim të flitej për improvizacione gjermane. Sepse Komanda e larlë gjermane e ka dijtun kjartas se anmiku ka dashtë të depertojë në krahinën e Ruhrit.

Gjermanija ka dijtë me ba n'Arnheim nji luftë tërheqjeje të mrekullueshme. Përveç kësaj nuk duhet të harrohet se dimni asht përpara derës dhe se lufta për armatë moderne në nji krahinë me mjegullë, të ftoftë e ditë të shkurtëna sjell me vehte vështirsina të mëdha.

Kështu u pushtue Casma

Atje ku malet Moslavina zbresin tëposhtë dhe ku shrihen toka të gjana të mbjelluna me misër gjinden katunde kroate të vorfëna. Plot varietet paraqitet e me zgjuarësi asht ba vendosja e banorëvet në këto krahina sikurse në Gjermani në kohën e luftës tridhjet-veçare. Sot po kalojmë me kozakët në këto katunde dhe nesër banditët i përzënë banorët prej kasollevet të tyne, ose ua marrin gjanë e gjallë.

Në mes të të këtyne malevet shquhet e nallë e duket prej së largu kisha e Casmas.

Casma asht nji qytet i vogël, në të cilën qëndron qysh muaj me radhë nji shtab i math i bandavet që drejton prej këtej veprimet e veta të grabitjes e të sabotazhit. Populli asht tue pësue mungesa të mëdha dhe tortura dhe të shumtët e tyne nuk banojnë ma ndër shtëpija.

Mbrapa shpinës së nji malit janë ndërtue kasollet, ndërtime të vjetra dhe llogore në shkëmbenj. Cdo rrugë që çon në qytet kalon për kah mali. Si duket mbi këtë gja i kanë bazue edhe bandat llogaritë e tyne strategjike për me i sundue prej së largu rrugët e kalimit.

Këtë qytet i a mbrrijtëm na me e pushtue bashkë me njisitë e kozakëvet. Qysh prej atës na ishim në marshim. Në agim kur duallën të parat reze drite njisinat e kalorësisë I a mbrrijtën qytetit që shtrihet në kambë të malit.

Para se na të hynim u ndie nji britëm në katund. Sikurse na e freguan banorët e këtij katundi, kjo qe britma e banditëvet të frikuem. Ata thirrën: po vijnë Tscherkesët, e me këtë kuptonin kozakët.

Në katunde para qytetit në rreth-in e gjanë të pyjevet u ba nji pushim i vogël. Artilerija zuri pozicjon dhe trupat e sigurimit po derdheshin ndër pyjet dhe ndër tokat e mbjelluna me misër. Trupa zbulimi kaluen me kalë përpara dhe gadi i a u mbrrijtnë trupavet të sulmit kalorës që ishin përpara tek ura e prrojt.

Sipër asht qyteti. Na ende s'e dimë se ç'ka gjindet atje. A janë me qindra mija, apo ma shumë vete? A kanë mendue bandat për mbrojë? A po mos kanë kalue ata ndër pyje prej frikës nga kozakët? Këto janë pyetje të paskjarueme.

Trupat e sulmit shtyhen deri tek pozitat e sigurimit të kundërshtarit bolshevik. Andej e këtej ndihet zhurma e pushkave dhe e mitrolozavet ndër tokat e mbjelluna me misër. Kjo nuk i trazon aspak kalorsit kozakë. Ka nji fuqi të madhe kalorësi kur ai asht i përkulun mbi shpinën e kafshës. Pak kanë kurajo t'i dalin atij përpara. Pushimi asht i pakët. Urdhësi erdhi. Sulmi kundra nji llogoreje të banditëvet filloi.

Poshtë ne projë rrjedh nji lumë. Në këtë vapë të madhe pak ujë gjindet mbrenda. Sipër tij asht nji urë e drunjtë. Këtu asht maja. Kuajt hedhin çapin ngadalë në rërin e pluhnosun. Sytë e luftëtarëvet këqyrin me vërejtje malin përpjetë. Duhet me u ruejtë për mos me ramë në ndonji grackë.

Kuajtë e parë janë tue prekun kujdesëshëm urën. Duhet me pasë kujdes se mos janë vendosur mina. Kozakët kanë nji moral luftarak të naltë, përndryshe ata do të ishin mendje-lehtë. Si nji vale turret vrulli i kalorsvet mbi urë. Mbrapa ngrihet nji rë pluhuni mbi rrugën.

Tash rruga merr të përpjetën. S'ka kohë për me u mendue. Te parat kasolle kanë mbetun mbrapa sulmuesavet. Të shtimet e para fillojnë papritmas dhe paralajmërojnë sulmin e ardhëshëm. Permbi ushtarët ulurijnë granatat e artileris s'onë. Larg prej nesh përtej qytetit në pyllë shpërthejnë gjyjet. Atje asht tërhequn në pjesën më të madhen armiku. Porse përshndetjet t'ona të çelnikta arrijnë edhe atje.

Luftimi i paktë i bam me mpraparojën e armikut nuk merret aspak para sysh. Kryet e kaloris hyni në sulm përpjetë malit në galop. Dielli përvëlon. pluhuni çohet dhe kuajt hyjnë në qytetin malor tue dihatë prej së lodhuni. Djersa shkon rrëkaj, pluhuni dhe të nxefit të djegin syt. Mandej kuajt ndalen sipër në rrugë.

Kë asht kundërshtari?

Fuqit e mbrame të sigurimit janë zhdukun nepër ara të mbjelluna me misër, tue hikun mbrapa kasolleve ndër pyje. Kozakët gjuajnë tue kërkue nder rruga, nder shtëpija dhe ndër kasolla. Aty këtu gjejnë nga nji bandit dhe e marrin me vehte. Banditët të veshuna n' uniforma gjermane të vjedhuna ose edhe civila t'armatosun.

Casma asht boshatisë. Të shternguem prej çetavet banorët i kishin braktisë vatrat e tyre. Ata kishin shkue diku ndër pyje bashkë me çeta tue marrë gra e fëmij me vedi, Ata kishin besue fjalët që u kishin thanë mbi tmeret që bajnë kozakët dhe prandej ishin aratisë. Kështu ra Casma. Qyteti a pushtue.

Nata kaloi e qetë. Trupa sulmi kanë kërkue gjithë natën çetat ndër pyje. Aty këtu bahen ndeshje të vogla dhe zihen ca rob. Po përgjithsishl asht qetsi. Porsa zbardhon drita dalin prej pyjeve dhe prej arave banorët e qytetit. Ngadalë këthehen ata. Tashti kqyrin për s'afërmi çerkezët dhe u çelen isyt atyne.

Pse u besuenë fjalëve gënjeshtare të çetavet? Kosakët janë nën urdhënat e gjermanëve. Dhe duhet me dijtë me i kuptue ata.

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Ejte 5 Tetor 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 56 035 — Nr. 33 - ÇMIMI 1 LEK

Shpërblimi aleat për trathëtarë

Churchilli pëlqen trathëtin por, nuk i don trathëtaret

Zyra aleate e Reuter-it para disa ditësh përhapi pikpamjen që pason: «Përnjiherë me nji të pamë mund të kuptohet ndryshimi ndërmjet politikës aleate dhe asaj gjermane në Europë. U asht rezervue mëshirë gjithë atyne, të cilët gjatë luftës kanë veprue me pa të drejtë kundra nesh. Porse vetëm atëherë kur ata të japin prova se janë radhitë serjozisht në anë t'onë, mund të llogarisin se kanë me e pasë prapë pamvarësinë e tyne».

Le ti krahasojmë njiherë këto fraza tingëlluese me të vërtetën. Çka muarnë finlandezët, rumunët dhe bullgarët për tradhëtinë që ata banë? Dhe para të gjithash çka ndodhi me Italinë? A i a mbrrijtën të gjithë këta vende paqës, për të cilën qëllim kapitulluan? A pushoi lufta për ta? A u respektue pamvarësija e tyne shtetnore? Jo. Njimijë herë jo. Të gjitha këto shtete, kundra vullnetit të tyne u shtërnguen t'ia hyjnë luftës prapë tashma kundra ish-aleatit të tyne. Lufta me gjithë tmerret e saj po vazhdon për ta dhe medje po zhvillohet bash në tokat e këtyne. Ata nuk muarnë asnji garanci të shëndoshë për kufijtë e ardhëshme të tyne shtetnore, për të cilat po bajnë prapë flijim gjaku. Churchilli në fjalimin e tij të fundit foli me përbuzje për ta. Nji filosof francez thotë kështu: «Asht e pëlqyeshme tradhëtija por, kurrë nuk duhen gja tradhëtarët.» E pra kështu duket mëshira e aleatëvet.

Kurrë nuk kanë qënë ndonji herë të ftuem popujt e vegjël të gërmojnë vetë vorrin e tyne, sikurse janë ftuem kësaj here me fjalë të bukura e miqësore prej aleatëvet. Çka lanë mangut në premtimet e tyne që u banë popujvet të vegjël? Ç' qe falënderimi dhe mirënjohtja mbas tradhëtisë? Shkelmi! Të lodhunve nga lufta i u impozue prapë të mërrin armët në dorë dhe iu thanë këto: «Bëhu tash i denjshëm për jetën tënde të ardhëshme prej skllavi. Ide luftue tash kundra Gjermanisë».

Le t'a vendosim këtë praktikë djallëzore nji herë qetësisht përkundrejt udhëheqjes gjermane në luftë. A i u desht vallë Bullgarisë të luftonte në anë të Gjermanisë sado pak për fitimet e mëdha që ajo pati prej kësaj lufte? Finlandezët, italjanët dhe rumunët a nuk kanë marrë vallë e, a nuk kanë përfitue vallë prej gjakut gjerman e prej materjalit luftarak gjerman kaq shumë sa Gjermanija, ka mundun t'i ndihmojë? A nuk ka qënë Gjermanija ajo vallë që shtetevet baltikë ja u rikëtheu autonominë dhe e cila krijoi shtetin e ri të Sllovakisë dhe shtetin Kroat? A nuk e garantoi Gjermanija pamvarësinë e Shqipnis?

A ka shtrëngue Gjermanija ndonji nga shtetet që pushtoi gjatë vitevet 1939-1942, që të rrokin armët kundra ish-aleatëve të tyne? A u desht vallë francezëvet, të luftojnë kundra anglezëve për me meritue armë-pushimin? Në çdo veprimtari të Gjermanis qëndron principi i rrespektit për ekzistencën e kombeve të vegjël. Asnji çekut dhe asnji polonezi nuk i u desht të luftojë, pse Reichu Gjerman ka pasë për qëllim të krijojë bashkësinë europjane të popujve dhe aspak nji grumbull të popujve të vegjël, të cilët ma vonë të skuqeshin prej turpit për shkak të fë rrokunit të armëvet kundra ish-aleatëvet të tyne vetëm për me mujtë me fitue nji armë-pushim të turpshëm, pa mujtë me fitue nji paqë sido kudo.

Chuchilli i mohon polakët

Edeni refuzon të japë çdo informatë

Në Wilhelmstrasse e quajnë dëklaratën e Churchillit, që dha mbi polakët në Dhomën e Komuneve, si nji cinizmë që ka kaërcyer kulmin. Deklarohet, se kryeministri britanik kerkon sot t'i shmanget përgjegjsisë për fatin e Polonisë, ku thotë se Anglija është lark nga fusha e operacionit, që të merrte barrën e një veprimi ushtarak në Poloni. Kurse në vitin 1939 qeverija britanike nuk la kohë të humbiste, kur ishte puna që me anën e deklaratës së garantisë për Polonînë, të çonte në vend aktin e saj të çmendur kundra Reichut.

Frika, që u krijua për deportimin e kryengritësve polakë, u bë shkak i nji pyetjeje në Dhomën e Komuneve. Në përgjigjen e tij Edeni pohoi që kishte lajme se pjesëtarë të kryengrities polake, të cilët i nënshtrohen auktoritetit të qeverisë s'emigruar polake dhe që janë takuar me trupat sovjetike, janë kapur prej auktoriteteve sovjetike dhe janë deportuar në Tarnopal të provincës së Lublinit si edhe nëpër provincat të tjera.

Edeni njoftoi se qeverija angleze ka të kerkuar nga qeverija sovjetike shpjeg me mbi këtë çështje dhe se kjo ishte përgjegjur, se lajmet në fjalë nuk i përgjigjen krejtësisht ndodhjes së vertetë, që kishin ngjarë në vendet e pushtuara nga gjermanët. Qeverija sovjetike deklaronte, se po thua të gjitha njësitë e armatosura, që u takuan gjatë marshimit sovjetik në Poloni, luftojnë për krah trupave sovjetike. Edeni bëri rekomandimin në Dhomën e Komuneve, që të kenaqeshin me këtë deklaratë, mbassi përgjigja ishte shumë delikate në marëdhënjet midis aleatvet.

Mbas luftimit të panzerve

Komandanti i nji togës së "Panther", që pati sukses të veçantë, tue shkatrrue 23 tanke armike

Megafon i çpuar me plumba

Pse ay kërkoi dorëzimin

Nji korespondent ushtarak lajmëron se kështjellës së Boulanjës i u propozua dorëzimi me anën e megafonit. Këta megafone u qëlluan mirë në mes dhe u shkatërruan. Kjo qe përgjegja e propozimit të dorëzimit.

Mbarimi i luftes "shtyhet,,

Pesimizmi n'Angli dhe n'Amerikë

Korespondenti luftarak i "New York Times,, i cili në përcjellje të armatës së parë kishte marrë pjesë në luftë në Hollandë, është i mendimit se përparimi anglo-amerikan drejt Rinit dhe Hollandës veriore do të ngecte në këtë dimër. Amerikanët ndoshta mund t' a harjinë Rinin. Toka e vështirë më atë anë të lumit dhe vështirësitë e shumta të tjera që janë lidhur ngusht me opracjonet e mëdha ne Europën perëndimore, në mbarim të vjeshtës dhe të dimrit, e bëjnë një depertim në zemërën e Gjermanisë të pamundun.

Në qarqet ushtarake amerikanë janë të mendimit se mundësija për një depertim nëpër mbrojën e perëndimit dhe në Rini është më pak e mundur se sa dy javë përpara.

Data e fitores së fundit kundre Gjermanisë duhet të shtyhet, sepse gjermanët kanë luftuar në Arnheim me një, ngulm fantastik dhe këtë kishin për t'a bërë edhe në të ardhmen. Mbesimi i optimistëve britanikë se lufta mbaron më 15 Nëntor nuk do të përmbushet. Pesimizmi çon peshë në Londër, mbassi kërcnon lufta e dimrit. Arnheimit është më e madhja fitore gjermane qysh se filloj invadimi.

Dëshira ma e madhe ish nji orë

Si hynë Rusërit në Bukuresht dhe në Hermannstadt

Korrespondenti gjerman, Edwin Konnerts, i cili qëndroj në Bukuresht edhe dy ditë pas si hynë Rusërit dhe që u kthye në Gjermani pas shumë peripetinash, bën këtë përshkrim mi pushtimin e kryeqytetit rumun prej Bolshevikëvet:

Natën e 23 gushtit filluan demostrata nëpër rrugët. Unë pashë se si bënin patrulla çifutët e Bukureshtit t'armatosur me revolverë dhe pushkë. Unë pashë edhe fëmijë që qëllonin qetësisht.

Që ditën e parë të hyrjes të trupavet ruse në qytet, një bukë kushtoj 2000 lei. 24 orë më parë kushtonte vetëm 38 lei. Gjatë ikjes s'ime, unë takova rrugës, jasht qytetit, mjete të ndryshmë udhëtimi të ngarkuar me sendet më të nevojshme të mijrave refugjatësh që mergoheshin.

Restorantët e Bukureshtit ishin plot me ushtarë të kuq. Passi pjesa m'e madhe e popullsisë ish fshehur, nër rrugët e qytetit, qysh pasdreken e ditës së parë, shiheshin vetëm ushtarë sovjetikë. Midis tyre ishin edhe disa policë amerikanë. Por këta, me urdhër të Moskës, u detyruan të largohen, sa më shpejt, nga qyteti.

Kur arrijta në Hermanstadt, jeta vazhdonte edhe ritmin e parë. Kjo ndryshoj sa po arrijtën trupat e para sovjetike të motorizuara. Kriminelat e burgut të Adjud-it u suallnë në Hermanstadt. Këta organizuan korteun e parë demonstracionesh. Ata kalonin rrugëvet me flamur të kuq, ndersa banorët e qytetit futeshin në për shtëpit' e tyre.

Mbi automobila sovjetikë unë pashë edhe shumë gra me uniformë, midis tyre edhe të tilla si oficerë. Çdo automobil rumun u rekuizua përnjeherësh. Ushtarët e kuq u turren, sa po erdhë, mbi dyqanët e sendevet të çmuar. Dëshira m'e mëdhe e tyre qenë sahatët. Natën rrugët ishin plot me ushtarë të kuq të dehur. Ner dyqanë ata nuk pyesnin kurrë për çmimin. Ata mernin ç'të donin.

Simbas nji lajmi të stacjonit të radios së Napolit ushtarët amerikanë në Romë kanë hedhur grá nga dritaret e trenit, të cilat u kanë kundërshtur kërkesave imorale të tyre. Gratë pësuan menjiherë vdekjen.



Anije të shpejta gjermane të ndërtuara në seri

Kanosje presioni kundër Argjentinës

Cmiri veriamerikan për ushqime gati për represalje

Si njoftohet nga Washingtoni. Drejtorija e thesarit amerikan e ndaloj imbarkimin e floririt argjentinas për n'Argjentinë gjersa të «ndryshojë gjendja diplomatike». Në lidhje me këtë, korrespondenti i fletores «New York Herald Tribune» njofton se ndalimi i floririt është vetëm fillimi i një vargu vepërimesh «për t'a bindur Argjentinën të bashkohet me politikën e solidarësis s'emisferit të perëndimit».

Korrespondenti është i mendimit se midis masavet që do të merren do të jetë edhe ndalimi i furnizimit të mishit. Qysh tash po bisedohet n'opinionin amerikan, mbi sanktione kundër Argjentinës, shtetit më të forte ekonomikisht t'Amerikës spanjolle. Antagonizma midis Shtet-vet të Bashkuar dhe Argjentines u duk çiltas, prej kohësh edhe në ndalimin e importimevet veri-amerikane për ne Argjentinë, në kundërshtim me shtetet e tjerë t'Amerikës së jugës, pa mundur Shtetet e Bashkuar, t'a arsyetonin disi këtë masë.

Edhe fakti që Argjentina u përjashtua nga konferencat e ndryshme të ashtuquitura ndërkombëtare, si prej konferencës ndërkombëtare të monedhës e të financavet, tregon kundërshtimin e Sht. të Bashkuar. Ndërkaqë, ky kundërshtim është pa themel, se Argjentina i preu, me dëshirë, marrëdhënjet me Fuqit e Boshtit dhe u ka dhënë Aleatëvet ndihma të vlefshme ekonomike. Por përmirsimi ekonomik i Argjentinës ka kohë që është halë në sy për Shtetet e Bashkuar.

Kjo shkakëtohet, më tepër, nga shtimi i lëvizjevet tregëtare midis shtetevet iberoamerikanë, nënë udhëheqjen e Argjentinës. Urrejtja e Shtetevet të Bashkuar, për këtë shtet që po ecën përpara, shkakëtohet edhe nga kërkesa gjithënjë m'e madhe e sendevet industriale argjentinas. Se nuk duhet të mos merret parasysh që industrializimi i këtij vëndi ka bërë hapa të mbëdhenj nër këta vjetët e fundit; për vitin 1943, vlefta netto e produktevet industriale që m'e madhe se ajo e produktevet tokësore.

Amerikanët nuk dëshërojnë që, në kohën pas luftës, të pakësohen fitimet e tyre nër tregjet e Amerikës së jugës dhe t'Amerikës së mesme. Kapitalistëvet dhe industrialëvet veri-amerikanë nuk u intereson as përpjekja për një bashkim doganor, midis shtetevet ibero-amerikanë, e cila përpjekje po bëhet më tepër prej Argjentinës. Kësisoj, pra, Shtetet e Bashkuar vendosën të marrin masa më efikase. Shtetet e Bashkuar që gjoja luftojnë për «liri dhe drejtësi» po përdorin një taktikë, e cila, në jetën private, quhet shtypje, se veç pression munt t'i thuhet ndalimit q'i bëhet daljes jashtë t'arit argjentinas, një marrëveshje që është vendosur me një çkëmbim tregëtar të rregullshmë midis Argjentinës dhe Shtetevet të Bashkuar.

Anglija nuk do t'a shohë me sy aqë të mirë ashpërimin e marrëdhanjevet midis Shtetevet të Bashkuar dhe Argjentinës, se ajo interesohet fort për importim mishrash të ndryshme nga Argjentina.

Sukseset gjermane në Francë

16500 rob ne Shtator - 1392 tanksa te shkatrrueme

Zyra ndërkombëtare gjermane njofton nga fronti i perëndimit si vijon: Me luftimet e rrepta në fushën e betejës së perëndimit gjatë muajit Shtator ka mundur të bëhet një përforcim i math i frontit d'he një shtim i fuqisë mbrojtëse gjerm ane. Kjo e vërtetë nënvijohet në mënyrë të qartë prej shifravet që kemi në dispozicion. Në muajin Shtator kanë zënë trupat gjermane 16.500 robër. Këta kanë zënë ose shkatërruar 1392 tanke. Kjo shifër nuk përfshin të gjashtë tanket T që janë zbritur me aeroplan transporti, prej të cilavet një pjesë e rëndësishme u kap në kohë të vënjes në përdorim. Përveç kësaj janë zënë ose shkatërruar 268 topa llojesh të ndryshme, nga të cilat një sasi e mjaftë ka qënë mortaje dhe bateri të motorizuara si dhe topa anti-ajrore, bashkë me 360 automjete të motorizuara. Përveç kësaj janë rrëzuar përmbi 1000 aeroplanë velash dhe 140 aeroplanë të ndryshmë. Gjithashtu është kapur një sasi e madhe mitrolozash, mortaje, vegla lamesh, armë automatike si dhe shëmë municjon dhe lëndë djegëse.

Tyrqia lip ne Llonder

Për gjendje katastrofale t'importimit

Prerja e marëdhenjevet me Gjermaninë e ka shpënë Tyrqinë në buzë të katastrofës në pikpamje fornizimi. Qeverija tyrke mori vendim të dërgonjë në Llondër një delegacion tregëtar, i cili do të përpiqet për plotësimin e premtimevet të politikës tregtare të dhënë nga Anglija dhe për zëvëndesimin e importimevet t'industris së rëndë që kryhëshin nga Gjermanija.

Një përfaqësues shtypi veriamerikan njofton nga Parizi se puntorët francezë të minieravet janë kanosur me një grevë të përgjithëshme. Ata nuk janë të kënaqur me gjendjen e krijuar pas pushtimit t'aleatevet.

Në Siqeli shtohet nga dita në ditë lëvizja e kryengrifjas. Pronarët e tokavet janë çqetësuar prej frazimevet të komunistëvet në Itali edhe përkrahin me çdo mjet kundra-lë vizjet të popullsis katundare.

Ne vimë më parë

Një fjalim sovjetik puntorvë italjan

Tarasoff, kryetari i n sovjetike puntorësh n'Itali, bëri të njohur se Rusija, gjatë kësaj u, humbur 800000 veta. Nga ky shkak ati i mungojnë puntorët, se, mbi të gjitha, duhet të ndërtohet Rusija sovjetike.

Ky është edhe shkaku që puntorët sovjetikë nuk munt t'u japin ndihmë atyre italjanëvet, të cilët kanë nevojë të ngutëshme. Përkundrazi, është e nevojshme që punëtorët e vendevet të pushtuar prej Sovjetëvet, të dërgojnë punëtorët e tyre në Rusi, për të ndihmuar më parë këtë vënt.

Natyrisht gjendet "arsyeja" e deportimit, për në Siberi të punëtorëvet evropjanë, ashtu si «arsyetohet» çdo gjë që munt të arrihet. Por arsyeja që jep Tarasoff-i është kaqë imperialiste, sa s'e gëlltitin dot as komunistët italjanë më të tlaktë. Se, ndërsa familjet e tyne po vdesin nga urija, ata vetë duhet të shërbejnë: dhjetra vjete me radhë, në një tokë të pa njohur dhe me klimë të tmershme për një popull të huaj.

Zbulohet një rrenë

Nji folës i radios amerikane lajmoi me 9 Shtatuer se u zbulue në Francë në krahinën e Nancy nji depo anmiku me material kimik ushtarak, që përfshinte nji sasi të madhe gazesh. Në lidhje me këtë deklarohet nga ana ushtarake gjermane: Landët kimike të luftës, që janë gjetun, përbahen prej 50 treneve francezë municioni gazesh, që u shtinë në dorë, mbassi qenë braktisë në sektorin e Mars la Tour. Ky municion nuk u hodh n'ajr, për mos me damtue popullsinë. Shenjat e embalazhit të këtyne landëve nuk tregojnë, në se janë depozita franceze.

Punë angarije në natën polare

Fletoret e Moskës janë mbushun me artikuj mbi lulëzimin e nji Donbsit të dytë në Wolkuten transpolare. Workutugolj asht nji fushë përqendrimi i NKWD, në të cilën nuk janë përqendrue vetun rob sovjetë, por edhe shumë persona të internuem prej Polonisë, Rumanisë dhe prej Baltikut. Nji ish i burgosun, nji ekonomist, i cili ka bashkëpunue në hartimin e planeve të Workutugoljit tregon per mbi përpjestimet e punës, që bante në këto qendra gjigjanteske t'angarisë. Workuta asht ajo krahinë, për ku Stalini ka me i përmbledhë në rasë së nji fitores së vet me miljona njerzish prej vendeve të ndryshme.

Nji emnim i pa të keq a po jo: Workutugolj nji industri e madhe e kombinueme. Kush kishte me dyshue se mbrapa kësaj tabele gjindet ndërmarrja gjigjanteske e GPU d. m. th. që mbrapa kësaj mshifet fusha e përqëndrimit Workuto-Petschorsky. Në krahasim me këtë perpjestimet e kanalevet të tjere të detit të Bardhë, si Kolyma, Ssolofki dhe fusha tjetër e përqëndrimit lindjen e largme mbeten në hije.

Workutugolj, ka nji histori pesëmbëdhjet vjeçare mbrapa vehtës. Në këtë fushë përqëndrimi kanë qënë me qindra mijra robët e Stalinit. Vëshgimi i burimit shoqnuer i robëvet kishte me qënë plotësisht për këta nji kurs i shkurtë përmbi historinë e partisë komuniste të bolshevikëvet, sidomos gjatë periudhës së Stalinit. Të gjitha dredhitë e të gjitha ndryshimet në vijën e përgjithëshme ndryshuan themelisht në njerzit që formojnë turmën në qendrën e përqëndrimit.

Me këta njerës të mbledhun andej këndej me ndihmën e armës së GPU dhe me ndihmën e repartit të tretë, kanë krijue bolshevikët në rrethin polar nji industri armatimi të kombinueme e gjigantike.

Kjo fushë përqëndrimi ka radio stacjon, skuadrilje ajrorësh, ajrorë, anije dhe baza ma të fuqishme të transportit në të gjitha qytetet e veriut.

Këqyrni kartën gjeografike të Francës. Në nji tokë kaq të gjanë sa Francë ushtron pushtetin e vet GPU mbi viktimet e saj, prej Kotlas deri në Ural, prej Narjan-Mara deri në Perm, në 500 000 km. katror.

Përmbi kushtet e ndërtimit të kësaj krahine, s'kemi çka me thanë ndonji gja të re. Ndërtimi i kësaj u bë ashtu sikurse i të tjeravet pra, sikurse në Ssolofki, në kanalin Belomor, në Kolymë dhe në qindra vendesh të tjera të tilla, ku robët vdesin sikur t'ishin miza. Në këto vende vuajnë njerzit prej mushkonjavet, prej tartabiqdvet dhe administratës. Në dimër i veshin me robe të lehta me këpucë konopi e rrogozi, kurse në verë me shajak.

Kjo fushë përqëndrimi sikurse tregon ish robi ekonomist i përmendun sipër, po të merret parasyesh klima edhe puna e pa dureshme ka qënë një fushë përqendrimi ndeshkimore, se ma tepër se pesë gjashtë vjet nuk mund të duronte njëri këtu.

Në vitin 1943 kanë qenë këtu 300.000 veta dhe mesatarisht gjatë pesëmbëdhjetë vjetëvet, në këtë fushë përqëndrimi kanë qënë nga 100.000 veta. Kjo do të thotë se robët në këtë kanë punue jo ma pak se nji gjysëm miliard ditë për hesap të GPU-së.

Workut Ugolj gjindet 200 km. larg prej hehur-udhës kryesore Archangelsk, Wjatka, Perm. Ky vend asht i rrethuem prej moçalesh e prej tundrash. Nji fuqi kundërshtare nuk ka se si kalon në këto krahina. Roja që e ka rrethue ban të pamundun çdo aratisje. E në rast se robët bëjnë nji kryengritje atëherë u pëzallohet dërgimi i ushqimevet dhe kështu ata mbesin në rrezik të vdesin urije, para se të munden me i a mbrrijtë katundit ma t'afërt. Simbas planit të parapamë Workuta për deri në vitin 1948 duhet të prodhojë 25.000.000 tonelata qymyr. Dhe që t'ja mbrrihet këtij prodhimit duhët të dergohen atje përafërsisht 2.000. 000 puntorë spacialistë. Në vitin 1940 kur na hartuem planet e punimeve në Workuta vramë mendjen se bolshevikët prej kah do t'a marrin atë mori njerzish që u duhet. Përse vullnetarisht nuk ka me shkue kush në nji vend ku të ftoftit harrin në 60 nën zëro dhe në nji vend ku mushkonjat e mizat të hanë se gjalli. Për punët që parashifte plani i vitit 1938-1938 mjaftonte numuri i robëvet atëherë. Për vitin 1940-1941 u desht të dërgoheshin 150.000 robë dhe 5.000 veta prej Shtetevet të Baltikut e prej Galicisë. Por, në mbarim të vitit 1943, 25 pës qind të këtyne vdiqen. Pjesërisht për shkak të klimes e pjesërisht psej keqpërdorimit që u bante GPU. Fushat e gjana të veriut u banë vorre për qindra mija robësh.

Në Distriktin e ndërtimit të urës së hekurt mbi Petschora në vitin 1941 afër katundit Koschwa vdiqën 20.000 rober, nji e katërta e të cilëvet ishin robë polonezë dhe jo ma pak se 2.000 ishin ushtarë bolshevikë, të cilët kishin pasë rënë robë në Finlande dhe që u muarrën këtej. Këta nuk u vranë me plumb mbas zverkut por, patën nji fat shumë ma tragjik se sa ata që u gjetën të vramë e të hedhun në vorre për masa në Winniza.

Cështja e dërgimit të njerzvet për në krahinën Workutugolj me përparimin e armatës së kuqe drejt perëndimit po bahet gjithmonë ma e dukshme. Kështu u ba qysh tash trasportimi i shumë vetave nga Galicija, nga Besarabija dhe nga Ukrajna.

Vorkutugolj-i nuk ka rëndësi vetëm rëndësi në pikpamje të industrisë luftarakë por edhe në pikpamje politike. Ndërra Stalini kundërshtarët koshientivë të sistemës së tij i mban këtu, mendon ai që me nji grusht të vrasë dy miza, d. m. th. të krijoj njikohësisht edhe nji bazë mbrojtjeje për rasën e nji lufte eventuale, e cila bazë as në rrugë ajrore, as në rrugë toksore mos të mbrrihet. Dhe për me mbajtë këtu qetsi, rend e disiplinë i mjaftojnë atij 200.000 invalid lufte.

Ky asht shkaku sepse Stalini ka vënë në dispozicjon shuma të mëdha parash n'atë industri që qëndron në drejtimin e G P U. Gjatë pesëmbëdhjetë vjetëvet kjo industri ka marrë prej shtetit pesë miliardë rubel dhe prej GPU qindra mijra puntorësh pa pare.

Kështu u ba Vorkuta vendi ma i math i sklavëve dhe i popujvet për çdo kohë që kapërdijnë ma tepër njerës se sa para e materjal.

Lirija e Shqipnis

Anmiqt t'uej - Anmiqt t'anë

E Hanë 9 Telor 1944 — BOTOHET PREJ FUQIVET T'ARMATOSURA GJERMANE - DIENSTSTELLE 56 035 — Nr. 35 - ÇMIMI 1 LEK

Komunistët e Balkanit-kuklla te Stalinit

EAM-i trathton Greqinë-Stalini nuk e respekton marrëveshjen aleate

EAM-i lot rolin në Greqi, sikurse Nacjonal-Çlirimtarja në Shqipni. Ajo udhëhiqet prej komunistavet nën urdhërin Moskës, për të vënë në shërbim të Moskës nacjonalistët pamje shkurtër. Para një vjet shpërndante EAM-i në të gjithë Greqinë veriore një thirrje: «Tutje në kufitë. Bashkohuni nën flamurin me drapën e çekiç!»

Njikohësisht, vrisnin të poshtrit e EAM-it oficerë dhe nëpunës nacjonalistë të përmendun, njerës të Zervas. Tamam kështu si në Shqipëri Meladini me Dushanë, nën urdhërin e Titos gabojnë Nacjonal-Çlirimtarët dhe vrasin burra si Mustafa Gjinishin, kështu udhëheqsit e EAM-it të përbërë prei grekrish, që kanë ardhur qysh më 1922 prej Rusisë Sovjetike në Greqi dhe punojnë përsëri për Rusinë.

Se sa indiferentë janë EAM-i dhe Nacjonal.Çlirimtarja për kufitë ethnike në Ballkan, këtë e tregon trádhëtija e naltë e EAM-it në Maqedhoni dhe në Thrakë. Sikurse qeverija tradhëtare komuniste bullgare e Georgeffit njoftoi EAM-i lidhi një kontratë me Georgeffin, mbas të cilës trupat e okupacjonit bullgar, në marrëveshje me EAM-in kanë të drejtë të qëndrojnë në Thrakë dhe në Maqedhoni, me gjithë se të gjithë grekrit sëbashku me Anglinë kërkojnë zbrazjen e vendeve të pushtuara nga Bullgarija.

Nga kjo shifen dy gjëra:

1). Që të gjitha partitë komuniste në Ballkan kanë marrë urdhërin nga Moska t'i shkulin kufitë kombëtare në dobi të pansllavizmit ballkanik, i cili merr urdhnat nga Moska. Kjo vlen si për EAM-in, si për Nacjonal-Çlirimtaren ashtu edhe për Titon.

2). Që Anglija nuk është e fortë mjaft për të vënë në vend kërkesat nacjonoliste greke përkundrejt bullgarëvet, prapa të cilëvet mshihet Moska, me gjith se Anglija i ka garantuar kufitë greke dhe Churchilli me Edenin, në fjalimet e tyre të fundit i përkrahën këto edhe njiherë.

Korespondenti londinez i fletores "Manchester Guardin., shkruen: Prej burimesh turke vijnë lajme shqetsuese mbi Ballkanin, mbas të cilavet lajme Rusija e Bullgarija qënken të vendosun për me e pushtue bashkrisht Thrakinë perëndimore dhe lindore. Simbas nji fletoreje turke zakonisht të informueme mirë, Ministri i Jashtëm bullgar njoftoj nji marrëveshtje të plotë për këtë qëllim të bamë ndërmjet komandës së përgjithëshme ruse e bullgare. Kështu në lidhje me këtë thuhet edhe se, qenka zgjedhë një komisjon i përzjerë, i përbamë prej dy grekësh, dy bullgarësh edhe nji turk. Sikur këto lajme që vijnë prej burimi bullgar të vërtetohen, atëherë kjo marrëveshje ndesh në marrëveshjen e bamë me aleatët, mbas të cilës Bullgarija para nënshkrimit të armë-pushimit duhet të tërhiqet prej Jugosllavisë e prej Greqisë. Edeni të premten përforcoi se aleatët në këtë janë dakord.

Anglija trathëton edhe Turqinë

Dardanelet mund te shkojn t'i marrin sovjetet

Mbi të ardhmen e ngushticavet boton historiani englez Sir John Marriott në të përkohshmën "The Fortnightly., një artikull, rëndësija e të cilit shifet nga fakti që agjensija zyrtare engleze e ka botuar rishtas intësisht. Ky artikull përmban konstatimin sensacjonal që Anglija kërkesat sovjetike, përsa u takon ngushticavë turke nuk ka me i kundërshtue. «Në qoftë se Bashkimi Sovjetik do të kërkojë Stambollin shkruan autori i përmendun - aleatët e tij nuk kanë për të qënë kundra kësaj kërkesë, pra do t'a pranojnë, gjë që Anglija dhe Franca kanë qënë gati t'ja pranonin edhe shtetit carist. "Marriott bën mandej disa kundërshtime, ku deklaron se do të kishte qënë në interesin e Britanisë së Madhe, në rast se kontrolli mbi ngushticat turke nuk do të lihej në duart e nji fuqije të vetme, e cila do të priste t'a bënte këtë kontroll nënë kushte, që nuk do të ishin më të lehta se ato të vitit 1923. Konditat e 1923-së ishin ndsyshuar në favor të Turqisë me marrëveshjen e Montreux-së. Autori shton se Turqit otomanë mbajnë gjithnjë zgjidhjen e problemit balkanik në duart dhe se në nji farë mënyrë paqja europjane mvaret prej kësaj, gjë që, autori e quan për paradoks, Ay shton, se kurrë nuk do të qëzphej një paqe e qëndrueshme, deri sa të qëndronte siujdhesa Ballkanike në paqetësi.



Lloje të ra të "vezëve infernale,,

Qysh në fillim të luftës është përpjekur armatimi gjerman, me sukses të shtuar, dyke bërë vashdimisht kursim në prodhimet e para, për t'i përmirsuar dhe për t'i bërë më efektiv mjetet luftarake. Edhe minët muarnë një formë të re. Në vend të minës së njoftun në formë rrumbullake u vu një fron prej betoni, i cili mban nje mjet plasës, me anën e të cilit hudhet në ajër krejt copra copra një barkë zbarkimi, kur ndeshet në të. Ngarkimi i këtyne mineve të ra bëhet prej një anijeje minu-

Pohoben prej vete aleatëvet humbjet enorme në ajrorë

Zyra e Reuter-it njofton për sa vijon: Komandanti i përgjithëvhëm i armës ajrore të Shtetevet të Bashkueme Gjenerali Arnold dje në nji konferenc të shtypit pranoj se humbjet në luftime ajrore mbi Gjermaninë kanë qënë paprifunisht shumë ma të mëdha nga çka ishte llogaritë. Gjenerali amerikan me këtë vertetoi saktësin e komunikatavet gjermane tue qitë poshtë rrenat dhe kumtesat prrallore të pilotëvet amerikanë.

Lajme tendencjoze false mbi Hungarinë

Në qarqet kompetente të Berlinit nuk dihet gjë mbi perpjekjet e armikut për të bërë të njëjtën presjon mbi Hungarinë, sikurse mbi Bullgarinë dhe vende të tjera. Si përgjegje mbi këtë çështje u deklarue në Wilhelmstrasse, se atje ishin në dijë, që shtypi anglo-amerikan diskutonte vazhdimisht mbi kushtet e armëpushimit për Hungarinë dhe se disa diplomatë hungarezë i vinin në lidhje me këto lajme të përhapura rreth një armëpushimi me Hungarinë. Gjermanija ndërkohë e ka treguar kjartë se nuk e duron në asnjë mënyrë heqjen prej saj të ndonjë nga të besëlidhunit.

Kapiten Ritter von Schramm:

Fronti i ri gjerman në perendim

Nga lufta e lëvizjes në luftën e pozicionit

Kumtesa gjermane me datën 27 Shtator njoftoi se njisina të koracueme gjermane, në mësymje të nji mbanjishme të bame ndërmjet Chateas Salins dhe të pyllit Parroy, mbyllëu nji depertim që kishte ba armiku. Por, para së gjithash kumtesa njoftoi asgjasimin e të parit divizion parashutistash anglezë në qarkun e Arnheim-it. Të dy ngjarjet nuk kanë qënë në nji lidhje me njana tjetrën në operecjonet ushtarake, e me gjith këtë historija e luftës do t'i rregjistrojë në mënyrë të veçantë në analet e saja: Pse forcat gjermane të perëndimit muarnë prapë inisjativën në dorë dhe mbas luftash difensive të bame javë me radhë kaluan n'ofensivë tue i a mbrrijtë prapë gjendjes për me i dhanë armikut grushta të ashpra, bile vendimtare për gjendjen e përgjithëshme.

Kushte strategjike ne favor te Gjermanise

Dy kushtet të randësishme të këtij suksesit qenë vumë në dorë me anë të luftimeve qysh përpara, d.m.th. tërheqja e armatavet gjermane prej Francës jugore dhe jug-perëndimore dhe mbajtja e paprekun e fuqisë gjermane të luftimit në krahun e djathë të frontit gjerman të perëndimit. Të dy ngjarjet me randësi duhen marrë si suksese operative.

Me këtë u dha kushti që në krahun e kërcënuem të frontit gjerman të perëndimit të ndërtohej një front difensiv dhe i cili së brendëshmi mundi të zgjanohet. Po t'i kujtojmë ato javë të tensjonit të rreziksmë në perëndim e para së gjithash po të kujtojmë fillimin e Shtatorit, atëherë na duket krejt nji mrekulli fakti, që trupat t'ona edhe njiherë i dhanë nji ndal armikut. Ka qënë koha kur anglo-amerikanët triumfonin dhe kur me të gjitha mjetet e agitacjonit lajmëronin shpartallimin t'onë, që simbas tyne ishte i pa evitueshme. Historija e luftës, veprimet t'ona ushtarake të tërheqjes nga Franca ka me i rregjistrue si veprime të shkëlqyeshme, pse nëpërmjet të këtyne veprimeve qe e mundur që armatat gjermane të dislokueme larg njena tjetres siç ishin në fillim të mund të përqëndroheshin të padamtueme prej presjonit armik dhe ma në fund të mund të përmblidheshin në nji front të shkurtë, të cilën t'a mbanin mandej dhe të mund t'a mbronin kundra fuqive të koracueme të armikut në mësyemje të përherëshme. Kështu me këtë gja pothuaj kah mezi i Shtatorit objektivat e veprimeve gjermane u mbrrijtën ndërsa planet armike për shkatrrimin e armatavet gjermane të perëndimit dështuan.

Heroizma e fortesave gjermane t'Atlantikut

Nji faktor tjetër i mbrojës gjermane ka luejtun në këtë mes nji rol shumë të randësishëm. Ky faktor qe mbajtja në dorë e skelave të shumta në brigjet e kanalit e të Atlantikut. Në fortesat e tyne u lanë fuqina vepruese në masë të mjaftueshme. Këto fuqina kanë pasur për detyrë t'i mbajnë këto

skela mundësisht sa ma gjatë në dorë dhe te ndalonin që armiku të mund t'i përdorte për furnizime. Njikohësisht muernë ato detyrën përsipër për me i shpërnda armatat armike që msynin, me tërheqë kundra vehtes forca të konsiderueshme të armikut dhe të angazhonin mjetet armike të msyemjes. Mund të thuhet se këtë detyrë e përmbushën në masën ma të gjanë, dhe po vazhdojnë me e përmbushë.

Ndonse anglo-amerikanët pothuaj e rifituan krejt Francën e ndonse ata janë tue kërcnue kufitë gjermane në Mosel dhe në Eifelin perëndimore, tue kapërcye këtë kufi në qarkun e Aachen-it prapë mund të thuhet me siguri se nuk qe ky qëllimi i tyre që këtu të banin nji ndal, njashtu sikurse nuk qe qëllimi i sovjetikëvet që të banin nji ndal përpara kufijve të Prusisë Lindore. Me këtë plani kryesor strategjik i tyne dështoi, pse plani synonte asgjasimin e armatave gjermane në perëndim dhe mandej me nji veprim lëvizës në nji front të gjanë të depertonin në tokat e Reichut. Orvajtja e përsëritun për me i a mbrijtë këtij qëllimi m' anë të nji grupi parashtistash dështoi prapë, tue pësue anglezët bjerrje shumë të mëdha.

Morali luftarak gjerman i pathyeshem

Në përgjithësi armiku po gjindet sot përballë nji fronti të mbyllun që mbështetet si në pengesa natyrore, ashtu edhe në fortesa, dhe i cili front ndërkohë asht pajisun me njisina të freskëta në ushtarë dhe në mjete. Kështu paraqitet gjendja në mbarim të Shtatorit të ketij vjeti. Me këtë lufta në perëndim s'kishte ma karakterin e lëvizjes në hapsina të mëdha por, karakterin e luftës në pozicion.

Na e dimë se ç'kemi humbur në perëndim dhe ç'duhet të mbrojmë sot. Fuqitë dhe mjetët e armikut janë të forta, ushtarët e tij janë të fortë, komandat e tij janë të vendosuna me hedhjen në betejë të masave të reja për nji orvajtje për me i a mbrrijtë nji decidimi përfundimtar, d.m.th. për me mujtë me i a mbrijtë nji fitoreje kundra nesh para se të vijë dimri. Porse komanda gjermane e vendosun dhe mbrojtja e ashpër kanë fitue ndërkaq kohë të çmueshme. Na do t'i dalim përballë armikut në perëndim me kondita të reja.

Lufta dimnore ne perendim

Preokupimet e fletores "Times,,

Se me çfarë preokupimesh e gjykojnë gjendjen në Francë, vrejtësit ushtarakë britanikë, ajo kuptohet prej nji artikullit të ekspertit ushtarak të fletores londineze "Times,, që pa dritë në këtë fletore. Me gjithë se nji sasi skelash në brigjet atlantike tashma janë në duar të aleatëvet, këto skela u banë të papërdorëshme për tà; kaq sa furnizimet po bahen edhe tash po prej atyne skelave që u pushtuen në fillim të invadimit d.m.th. në nji bseg të largët. Furnizimet me amë të ajrit u ba nji faktor i pashembëllt në historinë e luftës.

Moti i mirë në Tetor kishte me vijue sikurse deri sot me kenë i përshtatun për furnizime me anë të ajrit por, mbas Tetorit moti i favorshëm do të jetë vetëm nji çast i rallë. Luftat ma të ashpra përpara vijës Siegfried dhe përpara Rinit duhet të bahen në nji kohë kur moti do të jetë ma i keq. Ne rsugë të mira ndofta edhe mund të babej furnizimi por, për shkak të furnizimeve të shpejta brenda nji kohe të shkurtër edhe rrugët më të mira transformohen në moçale.

Shtrumica u pushtue

Trupat gjermane ripushtuen Shtrumica (në jug të Maçedonis), e cilla u mbroheshe prej komunistave edhe prej trppave bullgare. Anmiku pësoi humbje të mdha, 31 mitraloza e 4 granata hjedhës u mueren prej anmikut.

Moska premton - dhe likuido

Fati dhe mbarimi i gjeneralit kryengritës Bor

E gjithë bota e di sot prej fjalës së Churchillit që rebeljoni polak në Varshovi u fillua prej qeverisë së emigruar polake të Londrës me pëlqimin e Stalinit. Gjeneral Bor-i komanduesi mendje lehtë i këtij rebeljoni që u mposht përfundimisht prej grushteve gjermane, u emërua Komandant i Përgjithshëm i Polonisë, pasardhësi i Gjeneral Sosnokowski.

Nënë presjonin sovjetik e shtërnguan britanikët qeverinë e emigruar të Polonisë në Londër që t'a pushonte Gjeneral Sosnokowskin, sepse ky kishte bërë një padi të flaktë kundra britanikëvet për gjakun e derdhur kot të polakëvet dhe u kërkonte këtyre llogari. Posa ishte mënjanuar patrioti i parë polak, që kishte guxuar të ngrinte zërin për lirinë e Polonisë, kur menjëherë fillojnë intriga të rënda kundra pasardhësit të tij, Gjeneraiit të përmendur Bor, që në të vërtetë quhet Komarovski, nga ana e Moskës. «Qeverija» komuniste polake e paguar nga Moska, e cila në përcjellje të armatës ruse hyri menjëherë në Poloni, që për t'i bërë të aftë polakët për bolshevizmin me anë të vdekjes dhe të vrasjes do tashti t'a hedhë gjeneralin Bor përpara gjyqit, për t'a dënuar si përgjegjës për kryengritje në Varshovi. Ndërkohë, gjenerali Bor, pas shuarjes përfundimtare të kryengritjes ne Varshovi, ra rob në duart e gjermanëve.

Çfarë hipokrizije! Gjithë bota e di që stacjoni i radio Moskës i thërret pa pushim polakët, bullgarët, hungarezët edhe gjermanët vetë për të ngritur armët kundra Wehrmachtit gjerman. Dhe tashti duan t'a dënojnë me vdekje një polak që i u bind thirrjes! E pse? Pra, vetëm e vetëm për të gabuar opinjonin e pëbotshën gjithë bota padit sovjejët për sh që u bënë polakvet për kryengritje t'i lënë më në fund pa asnjë përje e ndihmë në fatin e tyre. Njëpitull i përgjakshëm më tepër në torin e tradhëtisë britanike dhe vijotike për popujt e vegjët.

Mbarimi i pergjakshem i Varshovise

Zyra Nderkombëtare e Lajmeve njofton: Ndeshja e përgjakëshme e Varshovis mori fund. Qendra më e fundit dhe më e fortë e kryengritesvet në mes të qytetit, që shtrihesh në nji radhë mjaft të gjatë shtépish deri në lumin e Vistulës, kapituloi sot më mengjes pa kushte. Topat e të gjitha kalibrave pushuan. Kollonat e gjata të njerzëve t' uriturvet. Ndër rebelet gjenden edhe gra me fëmijt e tyre, të cilët nuk i lejonin kryengritësit që të largoheshin nga zona e luftës. Atje, ku qendra e luftës afrohej me lumin e Vistulës bënë kryengritësit prova të shpeshta për t'a kapërcyer lumin, me qellim që të bënin lidhje me bolshevikët. Por këto tentativa deshtuen nën zjarrin e forcave gjermane.

Musulmanët u dekoruen

Së bashku me njisinat ushtarake të armës SS e të policis, mueren pjesë grupe vullnetare prej prendimit, për shtypjen e kryengritjes të Varshavis.

Ushtaret e regjimentit SS Nr. 1 të përbamun prej musulmanve të perendimit, dhe dy bataljona t'aserbajxhonve të regjimentit 111, u dekoruen shumica me kryqin e hekurt të klasës II, për trimni që treguen kundra kundrerhtarve.

Vepra e ndihmës për Europën e lirueme

U provua se ishre nji batakçillëk

Nji njoftim i fletores Neue Zuericher Zeitung mbi t'ashtuquajtunën UNRRA që pak përpara në Montreal, në Kanada pati kongresin e saj të dytë.

Korespondenti prej Washingtoni i gazetëv svicerane «Neue Zuericher Zeitung», i cili para fillimit të bisedimeve në Montreal ka qënë optimist mbi qëllimet e mundësitë e kësaj vepre të ndihmës, tash në nji njoftim përfundimtar paraqet nji konstatim të hidhur në lidhje me UNRRA-në.

Këshillimet e bisedimet që zgjatën dhjetë ditë rresht në Montreal për habinë ma të madhe të vrejtësit dhanë këtë rezultat: Ndërmjet shteteve pjesëtarë në UNRRA-në ekzistoinë mosmarrëveshjet ma të mëdha. Nji prishje e hapët e marrëdhanjeve ka mujtë me u ndalue deri tash vetëm prej anës së nji diplomacije të shkathët. Prej programit ideal të dikurshëm fare pak ka mbete ende. UNRRA në ma pak se nji vjet u ba nji vegël e politikës së zgjerimit, e cila trupëzon aksjonet të ish lidhjes së kombeve. Tue shkrue mbi detalje korespondenti shton se UNRRA u ba nji demokraci shpenzuese të hollash, në të cilën sidomos shtyhen amerikanët, të cilët kërkojnë të fitojnë shumë para në nji mënyrë komode. Kontributat e shtetevet pjesëtarë u përdorën prej organizatës për rroga. Shtetet e Bashkueme po e perdorin këtë vepër ndihme për qëllime politike. Shtetet e Europës do të banin mirë sikur të mos mbështeteshin aspak mbi këtë vepër ndihme. Asht decizive se bolshevizmi këtë vepër ndihmëtare don t'a shfrytëzojë për zbatimin e frymëzimeve të tija n' ato vende të lindjes e të jugëlindjes që janë në sferën e influencës së tij. Në lidhje me këtë korespondenti në fjalë aludon mbi sovjetët polonezë në Lublin, që i drejtuen nji lutje UNRRA-së, me të cilën kërkuen para dhe artikuj industrorë, mirëpo, UNRRA-së ia kanë ndalue çdo veprimtari në krahinat që sundohen prej tyne.

Amerikanët, shkruen korespondenti i fletores "Arriba,, prei New Yorku aspak nuk çuditen në qoftë se Shtetet e Bashkueme Anglija dhe Rusija nkk do të jenë në marrë-veshje mbi problemat nryesore të paqes së ardhëshme. Lajmet konfidenciale të ardhuna nga Dumparton Oaks, flasin përmbi kundërshtime të medha dhe të jashtzakonshme. Deklarohet se sovjetikët çdo bisedim edhe çdo ndcrhyrje arbitrare në punë të zgjerimit të influencës së tyne në Poloni, në shtetet baltikë dhe në Besarabi kanë refuzue. Simbas të gjitha gjasavet Stalini dëshiron me pasë me ba në kufitë sovjetike vetëm me të tilla qeveri që janë në nji miqsi të ngushtë e në nji mendim me të.

*

Agjensija telegrafike italjane njofton se, partija komuniste po pregatit 900 djelm prej moshes 7 deri 18 vjet, për me i dërgue në bashkimin sovjetik. Këta djelm do t'i shtrohen në Rusin bolshevike çitjes bolshevike. Qindrimi i tyne në Rusi asht parapa për nji kohë prej s[illegible] vjetesh.

ermane në Francë

or - 1392 tanksa te shkatrrueme

njof-
vijon:
etejës
pr ka
math
broj-

më. Gjithashtu është kapur një sasi e madhe mitrolozash, morfaje, vegla lajmesh, armë automatike si dhe shëmë municjon dhe lëndë djegëse.

Ne vimë më parë

Një fjalim sovjetik punforvë italjan

guar se nji flot formacjonesh [illegible] ajrore gjermane kanë treguar një vlerë luftimi të veçantë dhe se do t'a tregojnë edhe më tepër paskëtaj, gjë që anglo-amerikanët duhet t'a vënë në llogari.

Thirrje punëtorëve rumunë n' Gjermani

Creste Popescu, këshilltar socjal pranë ambesadës rumune të Berlinit, që me urdhën të qeveris rumune përfaqëson interesat e punëtorëve rumunë në Gjermani, në thirrjen e tij u drejtue kundra propagandës armike, që bëhet ndër punëtorët e huaj. Ay i ftoi punëtorët bashkatdhetarë të tij në Gjermani të kontribuojnë me anën e punës së tyre per mëkambjen përsëri të Rumanis si edhe për shpëtimin e saj nga vershimi bolshevik. «Përpiquni si bashkëpunëtorë besnikë të besëlidhunit gjerman që të farkohen armët në një mënyrë sa më të fuqishme qe kështu të bëhet e mundur krijimi i atdheut 'onë, Rumanis, të lirë dhe të lumtur».

Sundimi mizuer aleat n'Itali

Ç'shkruan organi i Vatikanit

Në fletoren Papnore «Osservatore Romano» u botue nji artikull sensacjonal që s' muejt me u ndalue as prej vetë aleatëvet. Organi i Vatikanit fton aleatët që t'i japin fund sundimit mizuer e të tmerrshëm të tyne që prej trupave aleate në krahina të gjanta t'Italisë asht tue u ushtrue. Fletorja i fjalë merr qëndrin, kundra trupavet negersh, francezësh, anglezësh dhe braziljanësh tue shkrue ndërsa të tjerash këto: «Përdhunime kundra populsisë civile e para të gjithash kundra grave e fëmijvet dhe vjedhje, e shkelja e rendit publik, karakterizojnë sjelljet e këtyne ushtarëvet. Duhet të thohet se komandantët e tyne u treguen të pa-aftë për me i ndeshkue, ose për me i ndalue këta kriminela. Qytete dhe katunde të tjera janë hedhë në nji gjendje të anarkisë. Nuk e lyp vetëm humaniteti që kjo gjendje të marrë fund por, njikohësisht para të gjithash edhe prestigji dhe auktoriteti i trupavet të okupimit që asht në lojë.

E pra, kështu duket në të vertetë «çlirimi» që i bajnë nji vendi aleatët. Me gjith këtë nji Churchill guxon të deklarojë në dhomen e komuneve se atij popullsija italjane i kishte thënë nji mirëseardhje të përzemert gjatë kalimit të tij n'Itali. Ka gjasë se auktoritetet e okupimit simbas shëmbëlltyrave të përdoruna me sukses edhe kësaj here t'a kenë terheqë popullin për në rrugat duke i dhënë bukë dhe lireta.

Sikurse gazeta «Times» mëson prej Moskës, autoritetet arësimorë sovjetikë po tregojnë nji shqetsim të math për shkak të tolerancës që asht krijue përkundrejt jetës fetare të rilindur në Bashkimin Sovjetik. I u deklarue të gjithë mësuesvet dhe profesorëvet sovjetikë se politika e caktuem prej Presidentit Kalinin asht në fuqi dhe kështu partija komuniste po mbahet në kërkesën e saj se besimi fetar asht nji trashëgim, të cilën duhet t'a përmirësojnë me një mësim dhe edukatë të zgjimit.